



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT

6866/3
Nr. ___ Prot.

Tiranë, më 28.10.2025

URDHËR

Nr. 552, datë 28.10.2025

PËR

MIRATIMIN E KURRIKULËS BËRTHAMË PËR ARSIMIN E MESËM TË LARTË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, të shkronjës “c” të pikës 2 të nenit 45 të ligjit nr. 69, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të shkronjës “dh” dhe “e”, të pikës 5, të kreut III, të vendimit nr. 98, datë 27.02.2019 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar” dhe të urdhrit nr. 497, datë 29.09.2025 “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit, znj. Orjana Osmani”,

URDHËROJ:


1. Miratimin e kurrikulës bërthamë për arsimin e mesëm të lartë (e përditësuar), bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
2. Kurrikula bërthamë për arsimin e mesëm të lartë (e përditësuar) fillon zbatimin si vijon:
 - a) Për klasën e dhjetë në vitin shkollor 2026-2027;
 - b) Për klasën e njëmbëdhjetë në vitin shkollor 2027-2028;
 - c) Për klasën e dymbëdhjetë në vitin shkollor 2028-2029.
3. Kurrikula e mëparshme shfuqizohet sipas fillimit të zbatimit të kurrikulës bërthamë për arsimin e mesëm të lartë (e përditësuar) në klasat e sipërcituara.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTRI

ORJANA OSMANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

KURRIKULA BËRTHAMË

(E përditësuar)

Arsimi i Mesëm i Lartë
2025



PËRMBAJTJA

1	HYRJE.....	4
2	KURRIKULA BËRTHAMË PËR ARSIMIN E MESËM TË LARTË	6
2.1	Veçoritë e arsimit të mesëm të lartë	6
2.2	Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe	7
3	FUSHAT E TË NXËNIT TË ARSIMIT TË MESËM TË LARTË	18
3.1	Fusha e të nxënit: “Gjuhët dhe komunikimi”	19
3.2	Fusha e të nxënit: Matematika	41
3.3	Fusha e të nxënit: Shkencat e natyrës.....	57
3.4	Fusha e të nxënit: Shkencat shoqërore	76
3.5	Fusha e të nxënit: Arte	103
3.6	Fusha e të nxënit: Edukimi fizik, sportet dhe shëndeti	115
3.7	Fusha e të nxënit: Teknologji dhe TIK-u	126
4	PLANI MËSIMOR.....	142
4.1	Përshkrimi i planit mësimor	142
4.2	Menaxhimi dhe zbatimi i planit mësimor nga shkolla	144
5	KURRIKULA ME ZGJEDHJE NË ARSIMIN E MESËM TË LARTË	145
6	KURRIKULA NË BAZË SHKOLLE NË ARSIMIN E MESËM TË LARTË	146
6.1	Organizimi i kurrikulës në bazë shkolle.....	146
6.2	Planifikimi dhe metodologjia e zhvillimit të kurrikulës në bazë shkolle	147
6.3	Vlerësimi i kurrikulës në bazë shkolle	148
7	UDHËZIME METODOLOGJIKE	149
7.1	Hyrje.....	149
7.2	Të nxënit bazuar në kompetenca	149
7.3	Të nxënit me në qendër nxënësin	149
7.4	Të nxënit e integruar	150
7.5	Zhvillimi i temave ndërkurrikulare	151



7.6	Zhvillimi i veprimtarive ndërkurrikulare	151
7.7	Zhvillimi i veprimtarive ekstrakurrikulare.....	152
7.8	Të nxënit sipas qasjes STEM	153
7.9	Përdorimin e teknologjisë digjitale	153
7.10	Platformat digjitale në edukim	154
8	UDHËZIME PËR VLERËSIMIN	157
8.1	Llojet e vlerësimit.....	158
8.2	Vlerësimi i jashtëm.....	159
9	FJALORI I TERMINOLOGJISË KURRIKULARE	161
10	REFERENCA.....	178

1 HYRJE

Dokumenti i Kurrikulës Bërthamë për Arsimin e Mesëm të Lartë shërben si bazë për arsimin parauniversitar në Shqipëri, në përputhje me Kornizën Kurrikulare Kombëtare të Arsimit Parauniversitar. Ai përshkruan të gjithë rrugëtimin mësimor për nxënësit në arsimin e mesëm të lartë, duke përfshirë elementët kryesorë, si:

📖 **Rezultatet e të nxënit:** Në këtë dokument përcaktohen rezultatet e të nxënit për çdo kompetencë kyçe dhe fushë lëndore, të përshtatura për nivelin e arsimit të mesëm të lartë.

📖 **Metodologjia:** Ky dokument ofron udhëzime për metodologjitë efektive të mësimdhënies dhe të nxënit për zbatimin e kurrikulës dhe që duhet të mbahet parasysh në të gjithë kurrikulën e shkruar dhe të zbatuar.

📖 **Vlerësimi i nxënësit:** Në këtë dokument përcaktohen mënyrat, llojet dhe teknikat e vlerësimit për përparimin dhe arritjet e nxënësve.

📖 **Ndarja e kohës:** Ky dokument përfshin një plan paraprak mësimor, duke caktuar kohë specifike për secilën fushë lëndore.

Dokumenti i Kurrikulës Bërthamë të AML vepron si një plan, duke i paraprirë zhvillimit të dokumenteve të tjerë thelbësorë të kurrikulës, si programet lëndore dhe udhëzuesit e kurrikulës, të cilët mbështesin drejtpërdrejt procesin e mësimdhënies dhe të nxënit dhe shërben si standard për përmbajtjen e fushave të të nxënit.

Si i tillë ky dokument i shërben:

- **Hartuesve të dokumenteve kurrikulare** për zbatimin e komponentëve të këtij dokumenti në fushat e të nxënit.
- **Hartuesve të testeve** në provimet kombëtare për të përcaktuar filozofinë e ndërtimit të testit në provimet kombëtare të AML dhe jo vetëm.
- **Nxënësvë** për zhvillimin e kompetencave kyçe të të nxënit, në mënyrë që ata të përballojnë vlerësimet ndërkombëtare, sfidat e shkollimit të mëtejshëm dhe të integrohen në shoqërinë e së ardhmes.
- **Mësuesve** për planifikimin dhe realizimin e veprimtarive mësimore në klasë dhe jashtë saj bazuar në filozofinë e përcaktuar në këtë kurrikul.
- **Prindërve** për njohjen me kriteret e vlerësimit dhe rezultatet e pritshme të arritjeve të fëmijëve duke nxitur bashkëpunimin dhe mirëkuptimin.



Kurrikulat bërthamë të tjera që lidhen me dokumentin e Kurrikulës Bërthamë të Arsimit të

Mesëm të Lartë janë:

- Kurrikula bërthamë për arsimin fillor;
- Kurrikula bërthamë për arsimin e mesëm të ulët.

Kurrikulat bërthamë të të gjitha niveleve kanë të përbashkëta:

- Kompetencat kyçe;
- Fushat e të nxënit.

Kompetencat kyçe në kurrikulat bërthamë janë:

1. *Kompetenca e komunikimit në gjuhën amtare;*
2. *Kompetenca e komunikimit në gjuhë të huaja;*
3. *Kompetenca në matematikë, shkencë, teknologji dhe inxhinieri;*
4. *Kompetenca digjitale;*
5. *Kompetenca personale, shoqërore dhe e të nxënit;*
6. *Kompetenca qytetare;*
7. *Kompetenca e sipërmarrjes;*
8. *Kompetenca për vetëdijen dhe shprehjen kulturore.*

Fushat e të nxënit në kurrikulat bërthamë janë:

1. *Gjuhët dhe komunikimi*
2. *Matematika*
3. *Shkencat e natyrës*
4. *Shkencat shoqërore*
5. *Teknologjia dhe TIK-u*
6. *Artet*
7. *Edukimi fizik, sportet dhe shëndeti*

Rezultatet e të nxënit për fusha, i bëjnë të dallueshme kompetencat dhe fushat e të nxënit të secilit nivel formal të arsimit.



2 KURRIKULA BËRTHAMË PËR ARSIMIN E MESËM TË LARTË

2.1 Veçoritë e arsimit të mesëm të lartë

Arsimi i Mesëm i Lartë në Republikën e Shqipërisë përfshin klasat 10-12. Arsimi i mesëm i lartë ofrohet si arsim i mesëm i përgjithshëm (gjimnaz), arsim profesional dhe arsim i orientuar. Ai ofrohet në shkolla publike dhe private.

Arsimi i mesëm i lartë, është faza përfundimtare e arsimit parauniversitar dhe zgjat tre vjet në arsimin e përgjithshëm ose të orientuar, pas arsimit të mesëm të ulët, si dhe katër vjet në arsimin profesional. Kurrikula dhe lëndët në arsimin e mesëm të lartë janë më sfiduese dhe më rigoroze sesa në arsimin e mesëm të ulët. Nxënësit pritet të kenë një kuptim më të thellë të lëndëve dhe të zhvillojnë të menduarit kritik dhe aftësitë e zgjidhjes së problemeve.

Arsimi i mesëm i lartë është projektuar për të përgatitur nxënësit për nivelet e tjera të shkollimit në arsimin e lartë, për tregun e punës si dhe pajisjen e tyre me aftësi për të nxënë gjatë gjithë jetës.

Arsimi i mesëm i lartë ka më shumë autonomi dhe përgjegjësi më të madhe për të mësuarit, pasi nxënësit pritet të menaxhojnë kohën, ngarkesën e tyre të punës dhe në mënyrë më të pavarur të studimit. Institucionet e arsimit të mesëm të lartë ofrojnë një gamë të gjerë aktiviteteve jashtëshkollore, si sportet, artet, muzika dhe klubet, për të promovuar zhvillimin holistik dhe mirëqenien e nxënësve. Në arsimin e mesëm të lartë përdoren një sërë metodash të mësimdhënie - nxënies, të tilla si: shpjegime, diskutime, punë në grup, eksperimente dhe aktivitete praktike, për t'iu përgjigjur stileve dhe nevojave të ndryshme të nxënësve si dhe forma të ndryshme vlerësimi, si: provimet, detyrat, projektet dhe prezantimet, për të matur rezultatet e të nxënësve dhe përparimin e nxënësve.

Gjithashtu në institucionet e arsimit të mesëm të lartë mund të ofrohen mundësi për nxënësit që të fitojnë një perspektivë globale, me programe të tilla si: programe shkëmbimi, olimpiada apo konkurse ndërkombëtare, kampionate, evente artistike etj., për t'i përgatitur ata për një botë të globalizuar. Arsimi i mesëm i lartë është një fazë kritike në rrugëtimin arsimor të nxënësve, pasi ai vendos themelet për ndjekjet e tyre të ardhshme akademike dhe karriere. Ai u siguron nxënësve njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që u nevojiten për të pasur sukses në një botë që ndryshon me shpejtësi dhe i përgatit ata për arsimin e lartë, tregun e punës dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës.

Ky nivel arsimor ofron mundësi që nxënësit të kuptojnë, të zhvillojnë dhe të komunikojnë ide dhe informacione në gjuhën shqipe standarde; të lexojnë, të shkruajnë, të dëgjojnë e të komunikojnë ide dhe informacione të paktën në një gjuhë të huaj; të analizojnë faktorët



kryesorë që ndikojnë në zhvillimin e shoqërisë; të shfaqin të kuptuarit e botës si një bashkësi sistemesh të ndërvarura; të marrin, të analizojnë, të vlerësojnë dhe të përdorin informacione nga burime të ndryshme. Atyre do t'u mundësohet njohje më e thelluar e mjedisit shoqëror, natyror e kulturor në të cilin veprojnë, si dhe përdorimi i aftësive, shkathtësive dhe qëndrimeve të nevojshme për të punuar e për të bashkëpunuar me të tjerët.

Arsimi i mesëm i lartë mundëson që nxënësit të thellohen në njohjen dhe kuptimin e ligjeve bazë të shkencave të natyrës dhe në kuptimin e vlerës praktike të njohurive të fituara. Nxënësit e këtij niveli përfshihen në procese që synojnë kuptimin e sistemit të vlerave dhe krijimin e sistemit vetjak të vlerave, bazuar në kuptimin e çështjeve morale dhe shpirtërore.

2.2 Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe

Rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe për arsimin e mesëm të lartë shprehin kërkesat themelore për zhvillimin e kompetencave kyçe në përfundim të klasës XII, si dhe kushtin për kalim në arsimin e lartë ose në tregun e punës. Rezultatet e të nxënit për kompetencat kyçe nxisin integrim të mëtijshëm të fushave të kurrikulës në funksion të zhvillimit të kompetencave kyçe. Ato parashikohen që të përvetësohen nga të gjithë nxënësit.

	Klasa X-XII
1	Kompetenca e komunikimit në gjuhën amtare
	<i>Për të dëshmuar kompetencën e komunikimit në gjuhën amtare, nxënësi:</i> - komunikon si dëgjues, folës, lexues dhe shkruer në situata të ndryshme dhe për qëllime të ndryshme; - monitoron dhe përshtat komunikimin e tij me kërkesat e situatës; - përdor dhe dallon lloje të ndryshme tekstesh, përfshirë tekstet digjitale; - kërkon, mbledh dhe përpunon informacione duke përdorur mjete ndihmëse; - formulon dhe shpreh argumente me gojë dhe me shkrim në përshtatje me kontekstin; - ndërton identitetin e tij kulturor dhe gjuhësor, si dhe kontribuon në transmetimin dhe pasurimin e trashëgimisë gjuhësore amtare; - përdor gjuhën për të krijuar dhe për të vlerësuar krijime artistike, të cilat shprehin emocionet, përjetimet dhe idetë e tij; - shpreh para një audience të caktuar, çështjet thelbësore të ngritura në një fjalim ose në një interpretim për një temë të caktuar nga fusha të ndryshme, përmes së

	paku një forme komunikimi (gjuhës, simboleve, shenjave, kodeve, performancës artistike etj.); - diskuton në grup, në mënyrë konstruktive duke dhënë informacion, argumente dhe duke shtruar pyetje në një dialog prej disa minutash, për një temë të caktuar në gjuhën amtare; - përdor drejt strukturën dhe rregullat e drejtshkrimit të gjuhës amtare në një numër të caktuar kontekstesh, si: ese, e-mail, letra formale dhe joformale etj.; - lexon rrjedhshëm një tekst të përbërë prej disa paragrafësh dhe shprehet në forma të ndryshme të komunikimit për organizimin, qëllimin, leksikun e përdorur, si dhe argumenton mesazhin që mbart secili paragraf (teksti mund të jetë narrativ, përshkrues, artistik etj.); - prezanton një temë të caktuar nga arti, shkenca, jeta e përditshme dhe në mënyrë efektive komunikon me audiencën, duke përdorur TIK-un dhe mediet e tjera të shkruara dhe elektronike; - shpreh mendimin e lirë, opinionin dhe qëndrimin e tij për një temë të caktuar nga jeta, shkenca, profesioni, shoqëria dhe mjedisi, duke përdorur forma të ndryshme të komunikimit, me gojë ose me shkrim; - angazhohet dhe kontribuon në një diskutim me të tjerët për një temë të caktuar p.sh., për edukimin mediatik, duke paraqitur argumente të bazuara në fakte, për rolin dhe ndikimin e televizionit, radios, shtypit dhe mjeteve të tjera të informimit në shoqëri, në procesin e përgatitjes së të rinjve për jetë të pavarur dhe orientim në karrierë; - përdor në mënyrë efektive, programet e TIK-ut gjatë procesit të të nxënies (duke përfshirë edhe të nxënies në distancë) si dhe gjatë kryerjes së detyrave në një fushë të caktuar mësimore.
2	Kompetenca e komunikimit në gjuhë të huaja
	<i>Për të dëshmuar kompetencën e komunikimit në gjuhë të huaj, nxënësi:</i> - komunikon rrjedhshëm në gjuhë të huaj, duke krijuar një atmosferë pozitive dhe mbështetëse, pyet për të identifikuar qëllimet e përbashkëta, krahason opsionet e ndryshme dhe jep sugjerime se çfarë duhet bërë më tej; - zhvillon më tej idetë e dhëna nga bashkëfolësit, parashtron pyetje që kërkojnë reagime nga këndvështrime të ndryshme dhe propozon zgjidhje ose hapa të mëtejshme;

	- përcjell informacion të detajuar dhe jep argumente në mënyrë të besueshme, (p.sh. pikat e rëndësishme të përfshira në tekste komplekse), të strukturuar mirë brenda fushave të tij të interesit profesional, akademik dhe personal; - thekson rëndësinë personale të ngjarjeve dhe përvojave duke dhënë shpjegime të qarta dhe duke mbështetur pikëpamjet e tij me detaje dhe argumente përkatëse; - shkruan qartë tekste të detajuara për një sërë temash që lidhen me fushën e tij të interesit, duke sintetizuar dhe vlerësuar informacionin dhe argumentet nga një sërë burimesh; - përshkruan dhe prezanton qartë dhe me detaje të hollësishme një gamë të gjerë temash që lidhen me fushën e tij të interesit, duke zgjeruar dhe mbështetur idetë me shpjegime dhe shembuj përkatës; - lexon, kupton dhe prodhon tekste, përfshirë tekstet digjitale, me një shkallë të madhe pavarësie, përshtat stilin dhe shpejtësinë e të lexuarit të teksteve të ndryshme duke përdorur burime të përshtatshme referimi; - respekton dhe vlerëson gjuhët dhe kulturat e vendeve të tjera; - promovon shumëgjuhësinë si një mjet për të arritur komunikim gjuhësor dhe kulturor sa më të mirë; - vlerëson se si ndryshimet kulturore ndikojnë në përdorimin dhe komunikimin e gjuhës; - përdor drejt strukturën dhe rregullat e drejtshkrimit të gjuhës së huaj, në një numër të caktuar kontekstesh, si: ese, e-mail, letra formale dhe joformale etj.; - lexon rrjedhshëm një tekst në gjuhë të huaj dhe shprehet në forma të ndryshme të komunikimit për organizimin, qëllimin, leksikun e përdorur, si dhe argumenton mesazhin që mbart secili paragraf (teksti mund të jetë narrativ, përshkrues, artistik etj.); - prezanton një temë të caktuar nga arti, nga shkenca, nga jeta e përditshme dhe në mënyrë efektive komunikon me audiencën, duke përdorur TIK-un dhe mediet e tjera të shkruara dhe elektronike; - shpreh mendimin e lirë, opinionin dhe qëndrimin e tij për një temë të caktuar nga jeta, nga shkenca, nga profesioni, nga shoqëria, nga mjedisi, duke përdorur forma të ndryshme të komunikimit, me gojë ose me shkrim; - angazhohet dhe kontribuon në një diskutim me të tjerët për një temë të caktuar p.sh., për edukimin mediatik, duke paraqitur argumente të bazuara në fakte, për
--	---



	rolin dhe ndikimin e televizionit, radios, shtypit dhe mjeteve të tjera të informimit në shoqëri, në procesin e përgatitjes së të rinjve për jetë të pavarur dhe orientim në karrierë; - përdor në mënyrë efektive, programet e TIK-ut, aplikacionet digjitale dhe IA gjatë procesit të të nxënimit (duke përfshirë edhe të nxënimit në distancë).
3	Kompetenca në matematikë, shkencë, teknologji dhe inxhinieri
	<i>Për të dëshmuar kompetencat në matematikë, shkencë, teknologji dhe inxhinieri, nxënësi:</i> - zbaton parimet dhe proceset themelore matematikore në kontekstet e përditshme të jetës reale, përfshirë aftësitë financiare; - ndjek dhe vlerëson organizimin logjik të argumenteve; - arsyeton matematikisht; - kupton vërtetimin matematik; - komunikon me gjuhën matematike; - përdor mjete ndihmëse të përshtatshme, duke përfshirë të dhënat statistikore dhe grafikët; - përdor dhe trajton mjetet dhe pajisjet teknologjike; - hulumton natyrën përmes eksperimenteve të kontrolluara; - përdor dhe trajton të dhëna shkencore për të arritur një qëllim, për të marrë një vendim ose për të nxjerrë një përfundim bazuar në prova; - njeh karakteristikat thelbësore të kërkimit shkencor; - komunikon përfundimet dhe arsyetimet që çuan në një përfundim të bazuar në prova; - sqaron ecurinë e zgjidhjes së një problemi në klasë apo jashtë saj, duke e vërtetuar zgjidhjen e problemit përmes metodës së analizës dhe e prezanton para moshatarëve ose para të tjerëve; - gjykon rezultatet e arritura, nga analiza e të dhënave të një projekti apo programi të realizuar dhe i interpreton ato me gjuhën e matematikës dhe të fushës përkatëse, i paraqet grafikisht, në formë tabelore, duke nxjerrë përfundime të vërtetuara (p.sh., projekt me bazë shkolle, projekt për gjelbërimin, koncert, ekspozitë tematike, orë letrare, punë laboratorike etj.); - hulumton në mënyrë të pavarur për një çështje të caktuar, duke përcaktuar fazat dhe procedurat e hulumtimit, paraqet dhe interpreton rezultatet e fituara në tabela



	dhe grafikë, duke përdorur teknologjinë informative; - identifikon burimet e informacioneve të nevojshme dhe i shfrytëzon ato në mënyrën e duhur për të zgjidhur një problem në nivelin e caktuar të vështirësisë, duke dhënë shembuj konkretë; - vlerëson cilësinë e informacioneve në një material të shkruar për një temë të caktuar (p.sh., për ngrohjen globale, për diversitetin kulturor dhe etnik etj.), identifikon elementet kryesore, i diskuton me moshatarët, duke dhënë propozime konkrete për shfrytëzimin e shembujve pozitivë në kontekstin lokal apo global, duke shprehur qëndrimin personal; - argumenton rezultatet e arritura gjatë një eksperimentimi në shkollë apo diku tjetër, duke përshkruar qëllimin, hipotezën dhe mënyrën e vëzhgimit të dukurisë së manifestuar, rezultatet i paraqet në mënyrë tabelore dhe grafike;
4	Kompetenca digjitale
	<i>Për të dëshmuar kompetencën digjitale, nxënësi:</i> - përdor, filtron, përpunon dhe vlerëson përmbajtje digjitale; - interpreton dhe analizon të dhënat për të nxjerrë përfundime dhe për të marrë vendime të mirë informuara; - identifikon dhe zgjidh probleme të ndryshme duke përdorur teknologjinë dhe mjediset digjitale; - krijon, programon dhe shpërndan përmbajtje digjitale; - menaxhon dhe mbron informacionin, përmbajtjen, të dhënat dhe identitetet digjitale; - përdor mjete digjitale për të prodhuar, për të paraqitur dhe për të kuptuar informacione komplekse; - njeh dhe angazhohet në mënyrë efektive me softuerët dhe pajisjet; - kupton dhe përdor inteligjencën artificiale për të analizuar dhe për të interpretuar të dhënat, për të zhvilluar dhe për të trajtuar modele parashikuese, si dhe për të zgjidhur probleme të ndryshme; - përdor teknologjinë digjitale për të krijuar dhe për të bashkëpunuar me të tjerët drejt qëllimeve personale, sociale ose tregtare; - demonstroi shkathtësi të përdorimit të TIK-ut në situata të përditshme dhe në përmbushjen e kërkesave të ndryshme gjatë të nxënies (p.sh., për ndërtimin e tabelave, grafikëve apo diagrameve, për vizatimin e një plani të shtëpisë, apo për



	përgatitjen e shkresave dhe të prezantimeve etj.); - përdor programet e TIK-ut në mënyrë efektive për të komunikuar dhe për të bashkëpunuar me bashkëmoshatarët gjatë procesit të të nxënës, duke përfshirë edhe të nxënës në distancë; - prezanton një projekt, duke përdorur sekuenca animimesh, videosh, figurash për demonstrimin e temave mësimore; - vlerëson cilësinë e informacionit që gjendet nga një shumëllojshmëri burimesh dhe mediesh; - përdor sistemet e duhura kompjuterike (hardware, software, networks dhe softet) si: Word Processing, Database, Power-Point, Publisher, Internet Explorer për përdorimin e TIK-ut në situata të ndryshme të të nxënës (ndërtimin e tabelave, grafikëve, diagrameve, vizatimin e një plani, përgatitjen e shkresave dhe të prezantimeve); - është krijuar në zbatimin e njohurive që përmbajnë shkencat kompjuterike dhe mediet digjitale; - tregon rregullat e sigurisë që duhen zbatuar për të ruajtur privatësinë personale sipas kodit të etikës së komunikimit personal dhe në grup; - është aktiv dhe i pavarur në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies për gjetjen dhe përdorimin e metodologjive që lehtësojnë këtë proces; - ndërjegjësohet mbi globalizmin dhe larmitë e kulturave, duke shkëmbyer me nxënësit e vendeve të ndryshme përvojat e vendit tonë.
5	Kompetenca personale, shoqërore dhe e të nxënës
	<i>Për të dëshmuar kompetencën personale, shoqërore dhe të nxënës, nxënësi:</i> - identifikon përparësitë dhe dobësitë personale, përparon duke u mbështetur në përparësitë e tij dhe punon për kapërcimin e dobësive/mangësive; - organizon të nxënës, fokusohet dhe vendos qëllime; - vlerëson në mënyrë kritike punën e tij duke iu referuar qëllimeve fillestare; - motivon dhe vlerëson veten; - mëson dhe punon në mënyrë të pavarur dhe në bashkëpunim; - shpreh dëshirë dhe vlerëson nevojën për të nxënës gjatë gjithë jetës; - komunikon në mënyrë konstruktive dhe bashkëpunon në ekip; - menaxhon në mënyrë efektive burimet, kohën, njerëzit, karrierën, mjedisin dhe ndërveprimet e tij me shoqërinë;

	- negocion në mënyrë efektive, kupton ndjenjat, mendimet dhe perspektivat e të tjerëve; - menaxhon stresin, pasiguritë dhe zgjidh konfliktet ndërpersonale në mënyrë konstruktive; - kupton dhe vlerëson mënyrën e jetës së shëndetshme; - diskuton në grup për mënyrat e bashkëpunimit me të tjerët për të zgjidhur një situatë të re mësimore (ose një problem nga jeta e përditshme ose për të menaxhuar konfliktet me bashkëmoshatarët), tregon mënyrën e shfrytëzimit të përvojave paraprake për të zhvilluar njohuritë dhe shkathtësitë e reja në zgjidhjen e situatave dhe problemeve të tilla; - shfrytëzon, në mënyrë të duhur, këshillat dhe informacionet e marra për përkrahje në zgjidhjen e një detyre apo problemi të caktuar, pastaj rezultatet i paraqet para të tjerëve; - bën përpunimin e informacioneve për një temë të caktuar në mënyrë të pavarur dhe efektive, rezultatet e punës i prezanton me shkrim ose me gojë para të tjerëve, duke dhënë shpjegime për mënyrën e zgjedhjes dhe të shfrytëzimit të burimeve të informacionit; - paraqet një plan studimi (në formë skice, vizatimi, shkrimi etj.) për ndonjë çështje të caktuar (p.sh., vlerat kulturore të rajonit të vet, vlerat e edukimit në shoqëri etj.) duke respektuar të gjithë hapat e planit të studimit dhe e paraqet para të tjerëve; - shkruan një letër motivuese në të cilën arsyeton angazhimin e vet për pjesëmarrje në një prezantim ose konkurs nga një fushë e caktuar mësimore, duke vënë theksin në aftësitë dhe cilësitë personale; - përzgjedh punimet kryesore të dosjes së vet për të shpjeguar para një audience të caktuar strategjitë që ka zbatuar për të ndjekur avancimin e vet dhe masat e zbatuara për të përmirësuar përparimin në mënyrë të vazhdueshme; - vlerëson, në mënyrë kritike, punën e vet duke iu referuar qëllimeve fillestare të punës p.sh., në mënyrë të pavarur redakton një dorëshkrim të tij për përmirësimin e organizimit të shkrimit, e qartësisë së mendimit etj.; - menaxhon në mënyrë produktive, burimet që ka në dispozicion (kohën, njerëzit, mjetet e punës etj.) gjatë kryerjes së një aktiviteti ose detyre të caktuar në një fushë mësimore apo në situata të jetës së përditshme.
--	--



6	Kompetenca qytetare
	<i>Për të dëshmuar kompetencën qytetare, nxënësi:</i> - angazhohet në mënyrë efektive me të tjerët në çështjet publike; - tregon solidaritet dhe interes në zgjidhjen e problemeve në nivel shkolle, komuniteti e më gjerë; - merr pjesë në mënyrë konstruktive në aktivitetet e komunitetit; - vlerëson diversitetet dhe demonstroi tolerancë, mirëkuptim, respekt dhe qëndrim të hapur ndaj dallimeve; - merr pjesë pjesë në proceset demokratike të vendimmarrjes në të gjitha nivelet (p.sh. në familje, në shkollë, në komunitet lokal/aktivitete të lagjes, si dhe në proceset e politikave lokale dhe shtetërore); - demonstroi vlerat dhe parimet e të drejtave të njeriut në jetën e përditshme (p.sh. respekti i dinjitetit personal, luftimi i paragjykimëve dhe diskriminimit të të gjitha llojeve; promovimi i barazisë gjinore etj.); - menaxhon dhe zgjidh konfliktet në mënyrë konstruktive dhe të paanshme; - demonstroi sjellje etike dhe të përgjegjshme ndaj mjedisit dhe kontribuon në qëndrueshmërinë mjedisore. - prezanton mënyrën e funksionimit të mjedisit shoqëror në nivel lokal dhe më gjerë, si dhe me shembuj konkretë tregon kontributin e vet në ruajtjen dhe kultivimin e vlerave të mjedisit; - harton një listë propozimesh për zbatimin e të drejtave themelore të njeriut në një situatë të caktuar, i kategorizon propozimet sipas rëndësisë dhe urgjencës, duke veçuar argumentet kryesore që mbështesin qëndrimin e vet; - prezanton në formë të ndryshme, se si i ushtron të drejtat e veta në shkollë dhe në jetën e përditshme dhe si i njeh e i respekton të drejtat e të tjerëve, duke dhënë shembuj konkretë; - paraqet në formë të ndryshme të të shprehurit, vlerat kryesore të diversitetit në shoqëri apo në mjedisin ku jeton, i diskuton ato me të tjerët, duke i krahasuar me shembuj nga jeta e përditshme që tregojnë tolerancë, respekt dhe qëndrim të hapur ndaj dallimeve; - ilustron me shembuj nga jeta e përditshme, praktikën e menaxhimit dhe të zgjidhjes së konflikteve në mënyrë konstruktive, duke ndarë me të tjerët përvojat, mendimet dhe ndjenjat e veta gjatë diskutimeve të shembujve ilustrues në këtë



	fushë; - merr pjesë në proceset demokratike të vendimmarrjes në nivele të ndryshme (në familje, në shkollë, në komunitet etj.), i diskuton me të tjerët përvojat personale dhe paraqet propozime të argumentuara se si të përmirësohet pjesëmarrja demokratike dhe vendimmarrja në shoqëri; - prezanton në një debat me të tjerët ose në një formë tjetër të të shprehurit, masat për mbrojtjen dhe zhvillimin e vlerave dhe parimeve të të drejtave të njeriut në jetën e përditshme, duke veçuar shembuj konkretë të ndonjë aktiviteti (p.sh., aktivitete për promovimin e barazisë gjinore, shmangien ndaj paragjykimeve dhe diskriminimit, luftën ndaj varfërisë etj.); - ilustron me shembuj, zgjidhjen e problemeve të caktuara në nivel shkolle ose në nivel komuniteti, si dhe e arsyeton atë me argumente para një audience të caktuar (p.sh., demonstroi mënyrën e ofrimit të ndihmës së parë në rastet e fatkeqësive natyrore ose njerëzore); - merr pjesë në përgatitjen dhe në organizimin e një aktiviteti (në shkollë apo në komunitet) për mbrojtjen e mjedisit natyror dhe atij të krijuar nga njeriu dhe në mënyra të ndryshme kontribuon për zhvillimin e qëndrueshëm të tij; - ndërmerr apo udhëheq një aktivitet për vlerësimin e cilësisë dhe të saktësisë së informacioneve në një faqe <i>web</i> që shfrytëzohet më shumë nga moshatarët, arsyeton aktivitetin dhe vlerësimin e bërë, ofron këshilla të mbështetura në etikën morale dhe profesionale për shfrytëzimin e përgjegjshëm të internetit.
7	Kompetenca e sipërmarrjes
	<i>Për të dëshmuar kompetencën e sipërmarrjes, nxënësi:</i> - mendon në mënyrë strategjike dhe zgjidh problemin; - përdor imagjinatën e tij gjatë proceseve krijuese dhe novatore; - menaxhon projektet, planifikon, organizon, drejton dhe delegon; - merr vendime financiare për koston dhe vlerën si dhe çmon koston e shndërrimit të një ideje në një aktivitet që krijon vlerë; - planifikon, merr dhe vlerëson vendimet financiare; - komunikon në mënyrë efektive dhe negocion me të tjerët; - përballet me pasigurinë, paqartësinë dhe rrezikun për vendime që ndërmerr; - identifikon pikat e forta dhe kufizimet; - punon në mënyrë të pavarur si dhe bashkëpunon me të tjerët;

	- përcakton prioritete, jep zgjidhje cilësore për përmirësimin e mjedisit, si dhe zbaton parimet e tregut të lirë dhe të buxhetimit në situata të jetës reale; - ndërmerr iniciativë në aktivitete të ndryshme me interes për lëndën/fushën mësimore, për klasën, për shkollën dhe për mjedisin ku jeton, si dhe tregohet i përgjegjshëm në plotësimin e detyrave, përmbushjen e detyrimeve dhe respektimin e afateve, referuar projektit apo planit; - argumenton me shembuj konkretë lidhjet midis punës, profesionit dhe karrierës, prezanton vendimmarrjen personale referuar mundësive në dispozicion për arsimim/ trajnim të mëtejshëm, mundësive personale dhe financiare, si dhe argumenton zgjidhjet për realizimin e planit personal të karrierës; - planifikon dhe menaxhon me sukses një projekt me objektiva të caktuara, si p.sh., një projekt për organizimin e ndërmarrjeve të vogla që ofrojnë produkte dhe shërbime për qytetarët, duke u mbështetur në kërkesat aktuale të tregut të punës; - paraqet modelin e një drejtuesi të një ndërmarrjeje ose organizate, sipas imagjinatës personale dhe duke respektuar karakteristikat kryesore të një sipërmarrësi të suksesshëm; - përdor aftësitë digjitale për llogaritjen, analizën, interpretimin dhe paraqitjen e të dhënave me informacione të nevojshme (p.sh., të një mjedisi të biznesit), duke renditur të dhënat sipas nevojave dhe prioriteteve të ndërmarrjes ose organizatës; - zbaton udhëzimet dhe rregullat e shkruara në udhëzues, katalog, apo skicë për përdorimin e drejtë të mjeteve laboratorike, makinave dhe pajisjeve teknike, gjatë një ushtrimi ose aktiviteti (në klasë, në laborator etj.), si dhe tregon për të tjerët mënyrën e zgjedhjes dhe përdorimit të tyre; - paraqet kompetencat e nevojshme për të përballuar situata të ndryshme jetësore apo për zhvillimin e karrierës në një fushë të caktuar; - merr iniciativa të suksesshme për organizimin e aktiviteteve të ndryshme që nxisin bashkëpunimin e ndërmarrjeve me komunitetin, duke promovuar interesin e dyanshëm.
8	Kompetenca për vetëdijen dhe shprehjen kulturore
	<i>Për të dëshmuar kompetencën për vetëdijen dhe shprehjen kulturore, nxënësi:</i> - njeh, respekton dhe çmon kulturën e tij si dhe vlerat, besimet dhe kulturat e të tjerëve; - shpreh dhe interpreton idetë, përvojat, emocionet figurative dhe abstrakte me



	ndjeshmëri në arte të ndryshme dhe forma të tjera kulturore; - shijon dhe vlerëson veprat e artit; - shpreh veten në medie të ndryshme, duke përdorur dhe përmirësuar kapacitetin personal; - identifikon dhe realizon mundësitë për të shprehur vlera personale, sociale ose tregtare nëpërmjet arteve dhe formave të tjera kulturore; - angazhohet në proceset krijuese individualisht dhe kolektivisht.
--	---

3 FUSHAT E TË NXËNIT TË ARSIMIT TË MESËM TË LARTË

Fushat kurrikulare përbëjnë bazën e organizimit të përmbajtjeve mësimore dhe procesit të nxënies në institucionet arsimore, për çdo nivel arsimor. Kurrikula e arsimit parauniversitar përmban këto fusha:

1. Gjuhët dhe komunikimi
2. Matematika
3. Shkencat e natyrës
4. Shkencat shoqërore
5. Teknologjia dhe TIK-u
6. Artet
7. Edukimi fizik, sportet dhe shëndeti

Çdo fushë përcakton rezultatet e të nxënit që orientojnë përzgjedhjet e përmbajtjeve dhe situatave mësimore që zhvillohen në procesin mësimor. Njëherazi, arritja e tyre dëshmon zotërimin e kompetencave kyçe nga nxënësit. Fushat përfshijnë një ose më shumë lëndë që zhvillohen të orientuara nga rezultatet e të nxënit të përcaktuara në programet lëndore përkatëse.

Rezultatet e të nxënit sipas fushave sigurojnë:

- ✓ Zhvillimin e kompetencave kyçe përmes një tërësie të përbashkët përvojash mësimore të ndërlidhura.
- ✓ Lidhjen ndërmjet lëndëve dhe veprimtarive mësimore që realizohen në kuadër të një fushe të nxëni, me synim integrimin e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve që mundësojnë këto lëndë.
- ✓ Zbatimin e praktikave të reja të mësimdhënies në nivel shkolle.
- ✓ Përdorimin e platformave interaktive dhe të teknologjisë në fushën/lëndën përkatëse.

Secila nga fushat e të nxënit, nga pikëpamja e organizimit të materialit, paraqitet sipas formatit të mëposhtëm:

1. Hyrje
2. Qëllimi i fushës
3. Tematikat e fushës dhe përshkrimi i tyre
4. Përshkrimi i kompetencave që zhvillon fusha
5. Rezultatet e të nxënit
6. Shpërndarja e kohës mësimore
7. Udhëzime metodologjike



8. Udhëzime për vlerësimin
9. Përdorimi i teknologjisë
10. Materialet dhe burimet mësimore

3.1 Fusha e të nxënit: “Gjuhët dhe komunikimi”

3.1.1 Hyrje

Fusha “Gjuhët dhe komunikimi” është një nga fushat më të rëndësishme në arsimin e mesëm të lartë. Kjo fushë përqendrohet në zhvillimin e aftësive gjuhësore, komunikuese dhe letrare të nxënësve për të përcjellë mesazhe në mënyrë efektive në një shoqëri ku komunikimi është me rëndësi të jashtëzakonshme.

Në arsimin e mesëm të lartë, fusha “Gjuhët dhe komunikimi” përbëhet nga lëndët e kurrikulës bërthamë (Gjuhë shqipe, Letërsi, Gjuhë angleze) dhe nga lëndët e kurrikulës me zgjedhje (Gjuhë shqipe, Letërsi, Gjuhë e huaj e dytë).

Të gjitha lëndët e kësaj fushe synojnë zhvillimin gjuhësor e letrar që është boshti themelor për rritjen dhe zhvillimin intelektual, shoqëror, estetik dhe emocional të nxënësve. Më konkretisht, kjo fushë i aftëson nxënësit që ta përdorin gjuhën për të komunikuar, për të plotësuar interesat e tyre personale, për kënaqësi estetike, për të marrë informacion, si dhe për të përmbushur kërkesat e shoqërisë dhe të vendit të punës. Studimi i gjuhëve dhe i letërsisë mundëson nxënësit të eksplorojnë aspektet e ndryshme të gjuhëve, duke filluar nga gramatika e deri tek komunikimi jo verbal. Përmes kësaj fushe, nxënësit zhvillojnë aftësitë e nevojshme për të shprehur mendimet e tyre në mënyrë të duhur, për të kuptuar dhe për interpretuar mesazhet, si dhe për të shpërndarë informacionin.

Fusha “Gjuhët dhe komunikimi” iu siguron nxënësve mundësi që të ndiejnë fuqinë e gjuhës si një mënyrë për të shprehur përvojat e tyre dhe për të thyer vështirësitë që ndajnë individët. Duke u mbështetur në studimin e teksteve të ndryshme (të folura, të shkruara, mediatike dhe digjitale) tradicionale, moderne dhe bashkëkohore, lëndët e kësaj fushe nxitin vlerësimin e trashëgimisë së pasur kulturore dhe letrare. Përveç zhvillimit të aftësive individuale, studimi i gjuhëve dhe letërsisë promovon bashkëveprimin ndërkulturor dhe diversitetin gjuhësor, duke krijuar një mjedis të pasur dhe të frytshëm për diskutim dhe reflektim. Në një botë ku teknologjia po ndryshon në mënyrë shumë të shpejtë mënyrën se si komunikojmë, njohuritë dhe aftësitë e fituara në këtë fushë janë thelbësore për integrimin në shoqërinë e informacionit.

3.1.2 Qëllimet e fushës “Gjuhët dhe komunikimi”

Fusha “Gjuhët dhe komunikimi” ka për qëllim që nxënësi:

- të shprehet qartë, saktë dhe duke respektuar normat e gjuhës standarde në të dyja format e komunikimit (me gojë dhe me shkrim);
- të diskutojë rreth teksteve që lexon, dëgjon ose sheh dhe të japë argumente bindëse për to;
- të analizojë veçoritë e strukturës dhe të formës së teksteve të ndryshme letrare dhe joletrare;
- të gjykojë tekstet e ndryshme mediatike dhe dallojë mjetet që përdoren në këto tekste për të ndikuar tek audienca;
- të kuptojë rëndësinë kulturore, historike dhe shoqërore të gjuhëve dhe të letërsisë;
- të vlerësojë letërsinë si një mjet për të pasuruar botën e tyre emocionale dhe njohëse, si dhe për të zhvilluar imagjinatën dhe shpirtin krijues;
- të analizojë vepra të letërsisë shqipe dhe botërore dhe t’i lidhë këto vepra me jetën e tij dhe botën përreth;
- të gjykojë rreth drejtimeve e periudhave të ndryshme letrare dhe të veçojë tiparet e tyre kryesore nëpërmjet studimit të krijimtarisë së shkrimtarëve përfaqësues të këtyre drejtimeve dhe periudhave;
- të zhvillojë aftësitë gjuhësore dhe komunikuese në nivelin e nevojshëm për t’u përshtatur në shoqëri dhe tregun e punës;
- të zhvillojë aftësi efektive të folurit, të dëgjuarit, të shkruarit dhe të lexuarit për të komunikuar me sukses në situata të ndryshme në jetën reale;
- të vlerësojë shumë gjuhësinë si një mjet i fuqishëm për ndërmjetësimin gjuhësor dhe atë kulturor;
- të përgatitet për t’u bërë pjesë e shoqërisë së informacionit, duke u njohur me teknologjitë e informacionit dhe komunikimit dhe duke promovuar njohuritë dhe aftësitë e tij të mediave digjitale dhe të informacionit.

3.1.3 Qasja e bazuar në kompetenca

Sipas Kornizës Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar, procesi i të nxënies duhet të synojë ndërtimin dhe zhvillimin e kompetencave kyçe dhe lëndore. Kompetencat përcaktohen si njohuri, shkathtësi, vlera dhe qëndrime që një nxënës duhet të fitojë gjatë procesit mësimor.

Fusha “Gjuhët dhe komunikimi” nëpërmjet lëndëve të saj synon të ndërtojë dhe të zhvillojë:

- a) kompetencat kyçe, të cilat janë përcaktuar në kornizën kurrikulare dhe që synojnë që ta aftësojnë nxënësin për jetën dhe tregun e punës;

- b) kompetencat e fushës/lëndës, të cilat e pajisin nxënësin me njohuri, shkathtësi, vlera dhe qëndrime, të cilat mundësojnë formimin e përgjithshëm letrar dhe gjuhësor.

Më poshtë janë dhënë rezultatet e të nxënit.

3.1.4 Lëndët “Gjuhë shqipe” dhe “Letërsi”

Rezultatet e të nxënit në përfundim të klasës së 12-të
Të dëgjuarit dhe të folurit për qëllime të ndryshme
Nxënësi: - merr pjesë në diskutime për tema të ndryshme, mbështet ose kundërshton një pozicion të caktuar, merr në konsideratë qëllimin, audiencën dhe situatën në një diskutim, si dhe përmbledh përfundimet e një diskutimi. - vlerëson cilësitë estetike të gjuhës së folur. - përdor strategjitë të ndryshme për mbledhjen e të dhënave të nevojshme që do të përdorë gjatë prezantimeve. - përzgjedh fjalët dhe shprehjet e përshtatshme në mënyrë që të ndikojë te dëgjuesit, si dhe përmirëson zgjedhjen e fjalëve duke përdorur mjete retorike dhe të figurshme. - realizon prezantime të ndryshme me gojë, përdor strategjitë e duhura për të përmbushur qëllimin që ka dhe, për të tërhequr vëmendjen dhe interesin e audiencës, respekton kohën gjatë prezantimit. - përdor TIK-un dhe vlerëson rolin e përdorimit të tij gjatë prezantimeve. - përdor strategjitë e të dëgjuarit për të kuptuar, analizuar, reflektuar dhe vlerësuar tekste të llojeve të ndryshme. - analizon tiparet e formës dhe të përmbajtjes së teksteve. - zbulon kuptimin e fjalës duke hetuar mbi origjinën e saj, analizon dhe interpreton kuptimet e dyta dhe të figurshme që merr fjala brenda një konteksti. - rikujton përmbajtjen e informacionit, si dhe analizon mënyrën në të cilën stili dhe struktura e një fjalie ose një ligjërate mbështet qëllimin e saj. - reflekton mbi informacione të llojeve dhe fushave të ndryshme, si dhe përgjigjet në mënyrë të përshtatshme në një debat. - demonstroi aftësitë e domosdoshme për të dëgjuarit e qëllimshëm. - krahason retorikat gojore bindëse me ligjërimet e thjeshta gojore.
Të lexuarit e teksteve të ndryshme
Nxënësi: - përdor strategjitë e të lexuarit për të kuptuar tiparet e formës e të përmbajtjes së teksteve.

- përdor materiale udhëzuese dhe hulumton fjalët e teksteve të ndryshme për të pasuruar fjalorin, shfrytëzon për qëllime vetjake përdorime të gjuhës së teksteve të ndryshme, vlerëson gjuhën e këtyre teksteve.
- përdor njohuritë dhe aftësitë për të kuptuar, analizuar dhe vlerësuar formën dhe përmbajtjen e llojeve të ndryshme të teksteve.
- realizon punë kërkimore, përzgjedh burime të ndryshme informacioni, të përshtatshme për kërkime, përdor informacionin për të mbajtur qëndrim ndaj një çështjeje të caktuar, vlerëson argumentet dhe mënyrën sesi ia nxitet interesi lexuesit.
- krahason dy ose më shumë tekste që kanë të njëjtën formë ligjërimi dhe trajtojnë të njëjtat tema, për të treguar sesi autorët nxjerrin përfundime të njëjta ose të ndryshme.

Krijimi i teksteve të ndryshme

Nxënësi:

- realizon hapat e përcaktuar dhe të domosdoshëm gjatë të shkruarit, përdor strategji të ndryshme për të planifikuar shkrimin e tij, organizon në mënyrë logjike mendimet dhe idetë, redakton shkrimin duke përdorur edhe mendimet e të tjerëve.
- shkruan qartë, me një stil vetjak dhe në mënyrë logjike, tekste për qëllime dhe për audienca të ndryshme.
- shkruan tekste të llojeve të ndryshme për qëllime personale dhe funksionale, duke zbatuar kriteret e domosdoshme për secilin lloj (formë).
- përzgjedh leksikun e duhur dhe format gramatikore e strukturore gjatë të shkruarit, si dhe respekton rregullat drejtshkrimore.
- përdor materiale të ndryshme burimore që e ndihmojnë gjatë procesit të shkrimit.

Përdorimi i drejtë i gjuhës

Nxënësi:

- ndërton dhe zhvillon njohuri dhe aftësi të reja rreth gramatikës, stilistikës dhe leksikologjisë përmes studimit të funksionit dhe ndikimit të tyre në tekstet që lexon.
- përdor njohuritë gramatikore dhe leksikore gjatë të folurit dhe të shkruarit për të arritur qëllime ose efekte të caktuara.
- dallon disa ndryshime mes gjuhës së folur dhe gjuhës së shkruar, mes regjistrave formale dhe joformale, mes dialekteve dhe gjuhës standarde.
- zotëron rregullat e drejtshkrimit dhe të pikësimit në gjuhën shqipe.
- shkruan saktë, pa gabime, dhe argumenton mënyrën e të shkruarit, duke cituar rregullat drejtshkrimore.

- përdor me saktësi terminologjinë gjuhësore në diskutime gjatë të folurit dhe kur shkruan.

NJOHURI DHE KONCEPTE

- Komunikimi në ditët e sotme.
- Komunikimi verbal dhe jo verbal.
- Komunikimi në situata të ndryshme.
- Gjuha dhe shoqëria, gjuha dhe individ.
- Funksionet e gjuhës.
- Karakteristikat e gjuhës së folur.
- Përdorimi i gjuhës standarde gjatë të folurit.
- Hartimi i prezantimeve të ndryshme, mënyrat dhe mjetet e prezantimit (përfshirë edhe TIK-un).
- Mjetet që përdoren për të tërhequr vëmendjen dhe interesin e të tjerëve.
- Strategjitë e të lexuarit dhe të dëgjuarit.
- Karakteristikat e teksteve të shkruara, të folura, digjitale dhe mediatike.
- Struktura e organizimit dhe veçoritë gjuhësore të teksteve.
- Analiza kritike e teksteve.
- Shkrime të llojeve të ndryshme të teksteve.
- Llojet e fjalive.
- Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta, llojet e tyre.
- Klasat e fjalëve, të ndryshueshme të pandryshueshme, kategoritë gramatikore.
- Mënyrat dhe llojet e fjalëformimit.
- Leksiku, gjuha standarde, familja e fjalëve, fusha leksikore.
- Stilet dhe regjistrat e gjuhës.
- Shenjat e pikësimit dhe rregullat e drejtshkrimit.

QËNDRIME DHE VLERA

- Korrektësi në komunikim.
- Vëmendje gjatë të dëgjuarit, të lexuarit dhe të shkruarit.
- Pjesëmarrje në diskutime duke respektuar dhe pranuar mendimin ndryshe.
- Empati gjatë komunikimit.
- Bashkëpunim në grup.
- Motivim për të lexuar për kënaqësi dhe informacion.
- Respektim i etikës gjatë komunikimit personal dhe në grup.
- Vlerësim i kontributit të të tjerëve gjatë kryerjes së një detyre.

- Vetëbesim dhe vetëvlerësim gjatë kryerjes së detyrave të ndryshme.
- Vullnet gjatë kryerjes së detyrave.
- Tolerancë dhe respekt për kulturën, traditat dhe gjuhën e tjetrit.
- Imagjinatë dhe mendim krijues për zgjidhjen e problemeve.
- Vullnet dhe gatishmëri për punën individuale dhe atë në grup.
- Pavarësi dhe vetë-iniciativë në vendimmarrje dhe veprime.
- Kureshtje për hulumtim dhe kërkim.
- Kujdes për veten, të tjerët dhe mjedisin.
- Respektim dhe pranim i diversitetit gjuhësor dhe kulturor.
- Respektim për kulturën dhe traditat kombëtare dhe botërore.
- Ndërgjegjësim për rolin e gjuhëve në komunikimin e përditshëm.
- Etikë në përdorimin e burimeve gjuhësore dhe intelektuale.
- Ndërgjegjësim për ndikimin e teknologjisë në gjuhë dhe komunikim.
- Ndërgjegjësim për kontributin e gjuhëve në zhvillimin e mendimit kritik.

LETËRSI

Interpretimi, analiza dhe vlerësimi i teksteve të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare

Nxënësi:

- bën dallimin mes llojeve dhe gjinive letrare në veprat që studion dhe i analizon ato duke u mbështetur në karakteristikat e llojit dhe gjinisë.
- analizon lloje të ndryshme prozash si dhe jep shembuj të autorëve që i kanë lëvruar.
- përcakton temën, idetë, analizon personazhet dhe marrëdhëniet mes tyre, i lidh elementet e mësipërme me jetën dhe botën rreth tij, ilustron me detaje nga teksti idetë dhe interpretimet e tij.
- dallon llojet dhe nënllojet e dramës dhe i analizon dhe vlerëson ato.
- përcakton gjininë dhe motivet kryesore në tekstet poetike, formulon idetë e tij dhe analizon gjuhën e figurshme.
- shpjegon elementet e tekstit letrar, figurat stilistike dhe i përdor ato gjatë analizës dhe vlerësimit të gjuhës dhe të stilit të këtyre veprave.

Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe botërore në periudha të ndryshme letrare

Nxënësi:

- analizon tiparet kryesore të folklorit tonë, përshkruan origjinën dhe përmbajtjen e eposit kombëtar dhe vlerëson rëndësinë historike dhe kulturore të tij.



- analizon tiparet kryesore të letërsisë antike greke dhe romake, të letërsisë së Rilindjes Evropiane, të letërsisë së vjetër shqipe dhe të klasicizmit.
- përcakton periudhën historike në të cilën u zhvilluan këto drejtime ose periudha letrare, gjinitë dhe llojet letrare që u lëvruan, si dhe veprat dhe autorët më përfaqësues.
- analizon tiparet kryesore të romantizmit dhe të realizmit, të letërsisë së Rilindjes evropiane, të letërsisë së vjetër shqipe dhe të klasicizmit.
- përcakton periudhën historike në të cilën u zhvilluan këto drejtime ose periudha letrare, gjinitë dhe llojet letrare që u lëvruan, si dhe veprat dhe autorët më përfaqësues.
- gjykon për vlerat njerëzore, etike dhe estetike që gjejnë shprehje në krijimtarinë letrare, si dhe shpjegon preferencat ose pëlqimet e tij në letërsi.
- analizon dhe vlerëson karakteristikat kryesore të letërsisë së shekullit XX, drejtimet kryesore letrare, gjinitë letrare që u lëvruan, si dhe autorët përfaqësues dhe veprat e tyre.
- analizon dhe vlerëson periudhat kryesore në letërsinë shqipe të shekullit XX, grupimet dhe drejtimet letrare, autorët përfaqësues dhe veprat e tyre.
- analizon në rrafsh krahasues vlerat e letërsisë shqipe dhe asaj evropiane dhe botërore.
- analizon dy vepra letrare dhe përcakton të përbashkëtat dhe ndryshimet mes tyre.
- gjykon për vlerat njerëzore, etike dhe estetike që gjejnë shprehje në krijimtarinë letrare, si dhe shpjegon preferencat ose pëlqimet e tij në letërsi.

NJOHURI DHE KONCEPTE

- Natyra dhe funksioni i letërsisë.
- Shkenca për letërsinë.
- Lidhja e letërsisë me artet e tjera.
- Llojet e teksteve letrare (tekst në prozë, tekst poetik, tekst dramatik).
- Ndarja letërsisë sipas gjinive.
- Veçoritë e gjinisë epike (poema epike, miti, legjenda, romani).
- Veçoritë e gjinisë lirike (soneti, oda, elegji, himni etj.).
- Veçoritë e gjinisë dramatike (tragjedia, komedia, drama).
- Fabula dhe subjekti.
- Sistemi i personazheve dhe tipizimi i tyre.
- Tema dhe motivet e veprës letrare.
- Stili dhe gjuha.
- Konteksti i një vepre letrare.
- Figurat stilistike të kuptimit.



- Figurat stilistike tingullore dhe të intonacionit.
- Figurat stilistike të fjalëve dhe të shprehjeve.
- Figurat stilistike të sintaksës poetike.
- Folklori shqiptar.
- Letërsia antike dhe romake.
- Letërsia e Rilindjes.
- Klasicizmi, romantizmi, realizmi.
- Letërsia e shekullit XX dhe drejtimet kryesore letrare.
- Autorët përfaqësues të periudhave dhe të drejtimeve letrare.

QËNDRIME DHE VLERA

- Korrektësi në komunikim.
- Vëmendje gjatë të dëgjuarit, të lexuarit dhe të shkruarit.
- Pjesëmarrje në diskutime duke respektuar dhe pranuar mendimin ndryshe.
- Empati gjatë komunikimit.
- Bashkëpunim në grup.
- Motivim për të lexuar për kënaqësi dhe informacion.
- Respektim i etikës gjatë komunikimit personal dhe në grup.
- Vlerësim i kontributit të të tjerëve gjatë kryerjes së një detyre.
- Vetëbesim dhe vetëvlerësim gjatë kryerjes së detyrave të ndryshme.
- Vullnet gjatë kryerjes së detyrave.
- Tolerancë dhe respekt për kulturën, traditat dhe gjuhën e tjetrit.
- Imagjinatë dhe mendim krijues për zgjidhjen e problemeve.
- Vullnet dhe gatishmëri për punën individuale dhe atë në grup.
- Pavarësi dhe vetë-iniciativë në vendimmarrje dhe veprime.
- Kureshtje për hulumtim dhe kërkim.
- Kujdes për veten, të tjerët dhe mjedisin.
- Respektim dhe pranim i diversitetit gjuhësor dhe kulturor.
- Respektim për kulturën dhe traditat kombëtare dhe botërore.
- Ndërgjegjësim për rolin e gjuhëve në komunikimin e përditshëm.
- Etikë në përdorimin e burimeve gjuhësore dhe intelektuale.
- Ndërgjegjësim për ndikimin e teknologjisë në gjuhë dhe komunikim.
- Ndërgjegjësim për kontributin e gjuhëve në zhvillimin e mendimit kritik.

3.1.5 Lënda “Gjuhë angleze”

Lënda “Gjuhë angleze” synon në forcimin e kompetencës kyçe të komunikimit dhe të shprehurit në gjuhë të huaj.

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit në gjuhë të huaj e fuqizon nxënësin të veprojë duke përdorur specifikisht mjetet dhe mënyrat gjuhësore. Për të realizuar qëllimet komunikuese, nxënësi mobilizon të gjitha kapacitetet e tij dhe i kombinon ato me kompetencën e komunikimit në gjuhë të huaj. Kompetenca e komunikimit në gjuhë të huaj është një sintezë e njohurive të parimeve bazë gramatikore, e njohurive se si gjuha përdoret në mjedise shoqërore për të kryer funksionin komunikues dhe e njohurive se si funksionet komunikuese kombinohen me parimet e ligjëritimit.

Përshkrimi i kompetencave të lëndës “Gjuhë angleze”

<i>Kompetencat e lëndës</i>	<i>Përshkrimi i kompetencave</i>
Kompetenca gjuhësore	Kompetenca gjuhësore nënkupton përvetësimin e rregullave gramatikore, semantike, fonetike, ortografike, organizimin e fjalëve në fjali, si dhe pasurimin e fjalorit.
Kompetenca socio-gjuhësore	Kompetenca socio-gjuhësore ka të bëjë me dimensionin shoqëror të gjuhës dhe i referohet të mësuarit të akteve të ndryshme të ligjëritimit dhe komunikimit në kontekste të ndryshme shoqërore. Këto kontekste kanë të bëjnë me statusin shoqëror, gjininë, moshën e nxënësit si dhe me faktorë të tjerë që influencojnë në stilin dhe regjistrat e gjuhës. Zhvillimi i kësaj kompetence është shumë i rëndësishëm pasi në situata të ndryshme duhen përdorur lloje të ndryshme shprehjesh si edhe duhen mbajtur qëndrime, besime, vlera dhe pikëpamje të ndryshme.
Kompetenca pragmatike	Kompetenca pragmatike ka të bëjë me njohjen e rregullave dhe parimeve sipas të cilave mesazhi komunikues organizohet dhe strukturoret (zhvillimi i temës, lidhja logjike e ideve, koherenca e mendimeve) dhe realizimi i funksioneve komunikuese (kërkimi i informacionit, dhënia e këshillës, kërkimi për ndihmë, rënia dakord, përshëndetjet etj.).

3.1.6 Rezultatet e të nxënësit



Rezultatet e të nxënit janë hartuar mbi bazë të kompetencave të lëndës së gjuhës së huaj të parë dhe lëndës së gjuhës së huaj të dytë dhe përmbajnë kërkesat që nxënësi duhet t'i arrijë pas përfundimit të arsimit të mesëm të lartë.

Organizimi i rezultateve të të nxënit përmban njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat të cilat zhvillohen dhe thellohen gradualisht, duke pasur parasysh zhvillimin fizik dhe psiko-motor të nxënësve. Këto rezultate mundësojnë arritjen e tetë kompetencave kyçe të përcaktuara në kornizën kurrikulare.

Më poshtë janë dhënë rezultatet e të nxënit të gjuhës së huaj të parë për arsimin e mesëm të lartë, si dhe njohuritë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet e domosdoshme për arritjen e këtyre rezultateve.

Rezultatet e të nxënit në përfundim të klasës së 12-të
GJUHË ANGLEZE
1. Kompetenca gjuhësore
Nxënësi: - zotëron njohuri gjuhësore dhe fjalor të mjaftueshëm për të përshkruar qartë, për të shprehur këndvështrime të ndryshme dhe për të zhvilluar argumente, duke mos pasur vështirësi në gjetjen e fjalëve dhe përdorimin e fjalive të përbëra dhe komplekse; - shprehet qartë dhe pa vështirësi rreth temave të ndryshme që kanë të bëjnë me fushën e tij të interesit; - përdor sinonime dhe formulime të ndryshme fjalish për të shmangur përsëritjen e shpeshtë, por boshllëqet leksikore ende mund të shkaktojnë momente hezitimi në të folur; - shprehet me saktësi të lartë leksikore, megjithëse mund të vihen re momente konfuzioni dhe zgjedhje e gabuar e fjalëve të cilat nuk e pengojnë komunikimin; - zotëron dhe zbaton shumë mirë rregullat gramatikore, pavarësisht disa gabimeve të rralla dhe jo sistematike dhe të metave të vogla në strukturën e fjalisë të cilat arrin t'i korrigjojë vetë duke mos shkaktuar keqkuptime në të shprehurin e ideve; - shqipton me intonacion të qartë dhe të natyrshëm; - shkruan qartë dhe në mënyrë të kuptueshme tekste të gjatë duke ndjekur rregullat standarde të organizimit të paragrafëve dhe të gjithë tekstit letrar dhe jo letrar; - zbaton me saktësi rregullat e drejtshkrimit dhe shenjat e pikësimit, por ka raste kur mund të tregojë shenja të ndikimit të gjuhës amtare.
2. Kompetenca socio-gjuhësore
Nxënësi:

- shprehet në mënyrë të sigurt, të qartë dhe të sjellshme në situata të ndryshme formale ose jo formale;
- merr pjesë aktive në diskutimet në grup edhe kur bashkëfolësit flasin shpejt dhe përdorin shprehje frazeologjike;
- bisedon qartë dhe rrjedhshëm me folës vendas të gjuhës së huaj të cilën po mëson;
- shprehet në mënyrë të përshtatshme në situata të ndryshme duke shmangur gabimet e rënda në formulimin e ideve.

3. Kompetenca pragmatike

Nxënësi:

- përshtatet natyrshëm në një diskutim formal ose jo formal kur ndryshohet tema dhe stili i të folurit;
- përshtatet natyrshëm me bashkëfolësin kur ai ka stil ose theks tjetër në të folur;
- ndryshon pa vështirësi formulimin e të shprehurit të mendimit ose ideve të tij;
- ndërhyt natyrshëm në diskutim, duke përdorur formulimet e duhura gjuhësore;
- nis, vazhdon dhe përmbyll ligjërimin e tij në mënyrë të përshtatshme duke përdorur formulime të sakta gjuhësore;
- përdor fraza dhe struktura gjuhësore (p.sh.: “Kjo është një pyetje e vështirë për t’u përgjigjur”) për të fituar kohë dhe për të formuluar mirë atë që dëshiron të shprehë;
- përdor një shumëllojshmëri fjalësh lidhëse në mënyrë efektive për të treguar qartë lidhjen midis ideve dhe opinionëve që shpreh;
- tregon ose përshkruan në mënyrë të qartë, duke mbështetur argumentet me shpjegime dhe shembuj të detajuar.

NJOHURI DHE KONCEPTE

1. *Formimi kulturor*

- a) *Jeta e përditshme* (organizimi i një plani ditor dhe i kohës së studimit; kujtime të mrekullueshme; dita më e bukur e jetës sime; qëllimet afatshkurtër dhe afatgjatë; çfarë dua unë për të ardhmen time; etj.)
- b) *Bota e shkollës dhe e punës* (organizimi i një biznesi të vogël; shqetësimet e shoqërisë së sotme si papunësia etj.; studimet dhe universitetet në vend dhe në botë; jeta në shkollë; aktivitetet shkollore; profesionet e së ardhmes; etj.)
- c) *Jeta personale dhe shoqërore* (shanse dhe të drejta të barabarta për gratë dhe burrat; të rinjtë dhe të rriturit; vendlindja; personalitete në shoqëri; etj.)

- d) *Bota rreth nesh* (arti në shekuj; e ardhmja; flora dhe fauna; historia e filmit; programet televizive; zakonet dhe traditat në vendet ku flitet gjuha që po mësohet; momente të rëndësishme të historisë botërore; personalitete në fusha të ndryshme të jetës; ndryshimet klimaterike; zhvillimi i qëndrueshëm; etj.)
- e) *Bota e komunikimit* (bota e teknologjisë; rrjetet sociale; të shkruarit e letrave- letër kërkesë, letër ankesë, letër biznesi, ese; media dhe informacioni; inteligjenca artificiale; etj.)

2. *Formimi gjuhësor*

- a) *Gramatika* (ndajfoljet e mënyrës, kohës etj.; mbiemrat dhe strukturat e tyre; fjalitë e përbëra; format e përbëra të foljeve në kohë të tashme, të shkruar dhe të ardhme; ligjëratat e drejtë dhe të zhdrejtë në format e përbëra të foljeve; mënyra jo veprorë në format e përbëra të foljeve; foljet modale; fjalitë kushtore, nyjet, emrat; shprehjet frazeologjike; inversioni; etj.)
- b) *Funksionet gjuhësore* (dhënia e këshillave; të shprehurit e keqardhjes; theksimi i informacionit; të shprehurit e mendimit ose opinionit personal; vënia në diskutim ose të mos biesh dakord me dikë; sugjerime; ftesa; etj.)

AFTËSI DHE SHKATHTËSI

- Të dëgjuarit
- Të folurit prodhues dhe të folurit ndërveprues
- Të shkruarit prodhues dhe të shkruarit ndërveprues
- Të lexuarit
- Përpunimi i informacionit
- Të menduarit kritik dhe zgjidhja e problemeve
- Krahasimi
- Prezantimi
- Përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit
- Të kuptuarit dhe krijimi i medias dhe informacionit
- Ndërmjetësimi gjuhësor
- Ndërmjetësimi kulturor

QËNDRIME DHE VLERA

- Korrektësi në komunikim.
- Vëmendje gjatë të dëgjuarit, të lexuarit dhe të shkruarit.
- Pjesëmarrje në diskutime duke respektuar dhe pranuar mendimin ndryshe.

- Empati gjatë komunikimit.
- Bashkëpunim në grup.
- Motivim për të lexuar për kënaqësi dhe informacion.
- Respektim i etikës gjatë komunikimit personal dhe në grup.
- Vlerësim i kontributit të të tjerëve gjatë kryerjes së një detyre.
- Vetëbesim dhe vetëvlerësim gjatë kryerjes së detyrave të ndryshme.
- Vullnet gjatë kryerjes së detyrave.
- Tolerancë dhe respekt për kulturën, traditat dhe gjuhën e tjetrit.
- Imagjinatë dhe mendim krijues për zgjidhjen e problemeve.
- Vullnet dhe gatishmëri për punën individuale dhe atë në grup.
- Pavarësi dhe vetë-iniciativë në vendimmarrje dhe veprime.
- Kureshtje për hulumtim dhe kërkim.
- Kujdes për veten, të tjerët dhe mjedisin.
- Respektim dhe pranim i diversitetit gjuhësor dhe kulturor.
- Respektim për kulturën dhe traditat kombëtare dhe botërore.
- Ndërgjegjësim për rolin e gjuhëve në komunikimin e përditshëm.
- Etikë në përdorimin e burimeve gjuhësore dhe intelektuale.
- Ndërgjegjësim për ndikimin e teknologjisë në gjuhë dhe komunikim.
- Ndërgjegjësim për kontributin e gjuhëve në zhvillimin e mendimit kritik.

3.1.7 Ndarja e kohës

Në tabelën e mëposhtme është dhënë koha mësimore për klasat X-XII për fushën “Gjuhët dhe komunikimi”.

Kurrikula bërthamë

Lëndët e fushës “Gjuhët dhe komunikimi”	Klasat X-XII (orë mësimore në javë)
Gjuhë shqipe	6 (2+2+2)
Letërsi	6 (2+2+2)
Gjuhë e huaj e parë	9 (3+3+3)
Totali:	21

Kurrikula me zgjedhje

Lëndët e fushës “Gjuhët dhe komunikimi”	Klasat X-XII
---	--------------



	<i>(orë mësimore në javë)</i>
Gjuhë shqipe	2 (0+0+2)
Letërsi	2 (0+0+2)
Gjuhë e huaj e dytë	6 (2+2+2)
Totali:	10

3.1.8 Udhëzime metodologjike

Kurrikula e fushës “Gjuhët dhe komunikimi” bazohet në parimin se të gjithë nxënësit kanë mundësi që të arrijnë rezultate të mira dhe të jenë të suksesshëm. Një nga çelësat kryesorë për suksesin e tyre është cilësia e mësimdhënies. Për një mësimdhënie cilësore, mësuesit duhet të respektojnë pikat e forta të nxënësve, të identifikojnë nevojat e tyre gjatë të nxënësit, të përcaktojnë saktë qëllimet e vlerësimit dhe të planifikojnë mirë orën e mësimi. Mësuesit duhet të informojnë nxënësit për rezultatet e të nxënësit, duhet të ndihmojnë nxënësit që të aktivizojnë njohuritë e mëparshme, duhet të japin udhëzime të diferencuara sipas nevojave të tyre, duhet t’i orientojnë kur punojnë në grupe, si dhe duhet t’u mësojnë strategjitë e të nxënësit, në mënyrë që ata të ndërtojnë vetë njohuritë dhe dijet e tyre.

Metodat bashkëkohore të mësimdhënies i përfshijnë nxënësit në zhvillimin e aftësive të të menduarit kritik e krijues dhe i nxitin ata që shikojnë përtej kuptimit të fjalëpërfjalshëm të teksteve. Pjesë përbërëse e mësimi duhet të jetë edhe ngulitja e cilësive të tilla të nxënësit, si: gatishmëria dhe vendosmëria për të çuar një detyrë deri në fund, komunikimi i qartë dhe brenda rregullave të mirësjelljes, shpirti i iniciativës, dëshira për të marrë përgjegjësi etj.

Gjuhët dhe letërsia mësohen më mirë nëpërmjet situatave në të cilat paraqiten ide, çështje dhe diskutime që janë të rëndësishme dhe me interes për nxënësit. Nuk mund të diktohen metoda ose aktivitete mësimore, mësuesit janë të lirë të përzgjedhin ato metoda, teknika ose aktivitete që vendosin nxënësit në qendër, që e nxitin ata të ndërveprojnë me tekstin, që zhvillojnë mendimin kritik, që përkojnë me nivelin e nxënësve dhe që funksionojnë mirë në klasën e tyre. Metodatat e mësimdhënies janë mjaft të rëndësishme për të realizuar një mësimdhënie efektive. Përdorimi i tyre shërben për zhvillimin gjuhësor dhe letrar të nxënësve. Mësuesit duhet të përditësojnë çdo ditë njohuritë rreth metodave, teknikave dhe strategjive të mësimdhënies me qëllim që të zhvillojnë tek nxënësit dëshirën për dijen, virtytet njerëzore, ambicien për të qenë të suksesshëm dhe aktivë në jetën e përditshme. Metoda, strategji dhe teknika të tilla, si: diskutim për njohuritë paraprake, diagramë piramidale, lexim i drejtuar, imagjinata e drejtuar, parashikim me terma paraprake, harta e konceptit, loja me role, mendo individualisht - puno



në çift - ndaje në grup, rrjeti i diskutimit, pyetje autorit, ditarët e të nxënit, pyetja sjell pyetjen, debate, stuhi mendimesh, etj., shërbejnë si nxitje për nxënësit në procesin e të nxënit dhe si garanci për rezultate të mira në procesin e të nxënit.

Mësuesit e gjuhës së huaj, duke mos lënë mënjane metodat tradicionale të mësimdhënies, duhet të përdorin gjerësisht metodën komunikuese në mësimdhënie. Qëllimi i kësaj metode është që në orën e mësimi gjuha e përdorur të jetë sa më afër gjuhës që përdoret në jetën e përditshme. Kjo do të thotë që mësuesi duhet t'i mësojë nxënësit jo “si të flasin” por “çfarë të flasin” dhe “kur të flasin”.

Disa tipare të kësaj metode janë:

- mësuesi dhe nxënësit përdorin gjuhën që po mësojnë gjatë orës së mësimi;
- gjuha që nxënësit po mësojnë është një mjet për komunikimin në klasë rreth problemeve dhe çështjeve reale të jetës së përditshme;
- funksionet gjuhësore që mësohen përdoren në situata të nxëni të shumëllojshme dhe reale;
- veprimtari të përditshme janë puna në çift, puna me role dhe lojërat pasi ato ngjasojnë me botën reale (gjuha që përdoret duhet të ketë një qëllim);
- theksi vendoset në diskutimin e situatave reale, ku shprehjet dhe fjalori i ri që po jepet, është i përshtatshëm për këto situata;
- gabimet konsiderohen të natyrshme dhe të pranueshme.

Kjo metodë fokusohet në aftësimin e nxënësve për të komunikuar në mënyrë efektive dhe rrjedhshëm në situata të jetës reale duke i dhënë përparësi ndërveprimit si mjet dhe si qëllim përfundimtar i të nxënit. Aktivitetet në përfshijnë lojëra me role, diskutime në grup, detyra për zgjidhjen e problemeve dhe materiale autentike të cilat inkurajojnë përdorimin praktik të gjuhës. Gramatika dhe fjalori mësohen në kontekstin e komunikimit dhe rrjedhshmëria vlerësohet mbi saktësinë në fazat fillestare. Qëllimi është të zhvillohet një kompetencë funksionale në gjuhë.

Mësimdhënia duhet të karakterizohet nga kriteret e mëposhtme:

1. Mësimdhënie me në qendër nxënësin

Nxënësit janë në qendër të procesit të mësimdhënies. Ky proces ndërtohet në varësi të nevojave, aftësive dhe interesave të nxënësve. Nxënësit e një klase janë të ndryshëm dhe kanë stile të ndryshme për sa i përket mënyrës se si ata nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit, të pavarur, me anë të mjeteve konkrete etj. Përpos kësaj, lëndët e fushës “Gjuhët dhe komunikimi” kërkojnë që nxënësit të nxënë konceptet, të zotërojnë shprehjet dhe të zbatojnë njohuritë gjuhësore. Këto kushte diktojnë nevojën për strategji të ndryshme të mësimdhënies

të cilat përshtaten me rezultatet e të nxënësve dhe nevojat e nxënësve. Mësimdhënia me në qendër nxënësve fokusohet gjithashtu në strategjitë efektive të të nxënësve, ku të nxënësve njihet si një proces aktiv dhe dinamik dhe nxënësve ndërtojnë njohuritë e tyre për atë që po mësojnë. Shembuj të mësimdhënies me në qendër nxënësve përfshijnë diskutimin, lojërat, simulimet, zbulimin dhe zgjidhjen e problemeve.

2. *Të nxënësve bashkëpunues*

Të nxënësve bashkëpunues është një metodë e mësimdhënies dhe të nxënësve, ku nxënësve bashkohen për të eksploruar më tej konceptet e mësuara, për të krijuar projekte të ndryshme. Të nxënësve bashkëpunues inkurajon bashkëpunim midis grupeve të nxënësve, gjë që u sjell përfitime afat shkurtër që lidhen me rezultatet e tyre në mësim dhe përfitime afatgjatë që kanë të bëjnë me përgatitjen e tyre për botën e punës, ku suksesi në profesion varet gjithnjë e më shumë nga bashkëpunimi në grup. Puna në grup nxit tolerancën ndaj mendimit të tjetrit, si dhe ndikon në përdorimin e formave demokratike për të ndarë përgjegjësitë dhe punën.

Të mësuarit bashkëpunues ndihmon në zhvillimin e aftësive të komunikimit, zhvillon aftësitë sociale të nxënësve, promovon vetëvlerësimin e tyre dhe i bën ata nxënës autonomë.

3. *Mësimdhënia e diferencuar*

Mësimdhënia e diferencuar ndihmon mësuesit të angazhojnë në orën e mësimi çdo nxënës duke ju përshtatur stilit të tyre specifik të të nxënësve. Mësimdhënia e diferencuar ofron një mënyrë për të përmbushur të gjitha nevojat e nxënësve duke i inkurajuar ata të shprehin atë që kanë mësuar në mënyra të ndryshme. Për të identifikuar dallimet individuale, mësuesit mund të shikojnë dhe t'ju referohen shumë burimeve të ndryshme për të marrë informacion. Burimet mund të përfshijnë vëzhgime në klasë, modele të punës së nxënësve, opinione/komente nga mësues të tjerë, etj.

4. *Integrimi i aftësive gjuhësore*

Të katër aftësitë gjuhësore (të dëgjimit, të leximit, të folurit dhe të shkruarit) duhet të integrohen tërësisht në mësimdhënien dhe të nxënësve e gjuhës së huaj. Për shembull, një fragment leximi mund të çojë në një diskutim në grup të vogël, i cili mund të çojë më tej në një detyrë me shkrim. Duke përdorur një qasje të tillë, mësuesit bëjnë të mundur që nxënësve të zhvillojnë një aftësi të ekuilibruar në dëgjim, të folur, lexim dhe shkrim. Kjo metodologji holistike pasqyron natyrën komplekse të përdorimit të gjuhës në jetën reale dhe i përgatit më mirë nxënësve për komunikim efektiv në kontekste të ndryshme.

5. *Përdorimi i teknologjisë dhe Inteligjencës Artificiale (IA)*

Kjo metodologji përdor teknologjinë dhe inteligjencën artificiale për të krijuar përvoja të personalizuar dhe ndërvepruese të të nxënësve. Përfshirja e teknologjisë dhe IA në metodologjitë e mësimi të gjuhës së huaj ofron një përvojë dinamike, të personalizuar dhe tërheqëse që mund të plotësojë metodat tradicionale të mësimdhënies dhe të përgatisë më mirë nxënësit për komunikim në botën reale në gjuhën huaj që po mësojnë. Mjete të tilla si aplikacionet dhe platformat e mësimi të gjuhës së huaj, realiteti virtual dhe chatbot-et e fuqizuara nga IA u ofrojnë nxënësve mundësi të nxëni gjithëpërfshirëse dhe fleksibël. Aplikacionet e mësimi të gjuhës si Akelius, Duolingo etj. përdorin gamifikimin për ta bërë mësimin tërheqës dhe argëtues, ndërsa platforma të ndryshme të fuqizuara nga IA personalizojnë mësimet bazuar në përparimin dhe performancën e secilit nxënësi. Këto aplikacione shpesh përfshijnë teknologjinë e njohjes së zërit që i ndihmon nxënësit të praktikojnë shqiptimin dhe të marrin reagime të menjëhershme.

6. *Të nxënësve bazuar në projekt*

Të nxënësve bazuar në projekt përfshin një qasje dinamike në klasë dhe një metodë mësimdhënieje përmes së cilës nxënësit fitojnë njohuri më të thella duke eksploruar aktivisht sfidat dhe problemet e botës reale. Të nxënësve bazuar në projekt ndihmon nxënësit të zhvillojnë njohuri fleksibël, aftësi efektive për zgjidhjen e problemeve, të mësuarit e vetëdrejtuar, aftësi bashkëpunimi efektiv dhe motivim të brendshëm. Të nxënësve bazuar në projekt krijon praktika të reja mësimore, të cilat pasqyrojnë mjedisin aktual ku nxënësit jetojnë dhe mësojnë, vendos kërkesa të reja për nxënësit dhe mësuesit për të sfiduar praktikën tradicionale në mësimin e gjuhëve të huaja. Të nxënësve bazuar në projekt kërkon shkathtësi dhe planifikim nga nxënësi, forma të reja të përfaqësimit të njohurive në shkollë, mekanizma të zgjeruar për bashkëpunim dhe komunikim dhe mbështetje për reflektim dhe vlerësim autentik.

7. *Të nxënësve bazuar në detyra*

Mësuesi organizon mësimin rreth detyrave që nxënësit kryejnë duke përdorur gjuhën e huaj që po mësojnë. Këto detyra imitojnë aktivitetet e botës reale dhe kërkojnë që nxënësit të përdorin komunikim autentik. Shembuj të detyrave përfshijnë planifikimin e një udhëtimi, kryerjen e një interviste ose zgjidhjen e një problemi praktik. Fokusi është në arritjen e rezultateve të të nxënësve përmes përdorimit të gjuhës, gjë që i ndihmon nxënësit të zhvillojnë aftësitë e tyre gjuhësore në mënyrë natyrale.

8. *Të nxënësve social dhe emocional*

Kjo metodologji gërsheton parimet e të nxënësve social dhe emocional (vetëdija, vetë-menaxhimi, ndërgjegjësimi social, aftësitë e marrëdhënieve dhe vendimmarrja e përgjegjshme) në të nxënësin

e gjuhëve të huaja, duke theksuar zhvillimin e inteligjencës emocionale të nxënësve krahas aftësive gjuhësore. Aktivitetet zhvillohen jo vetëm për të zhvilluar aftësitë gjuhësore, por edhe për të promovuar kompetencat emocionale dhe sociale. Për shembull, diskutimet rreth normave dhe vlerave kulturore në gjuhë të huaj mund të rrisin ndërgjegjësimin shoqëror dhe kulturor të nxënësve. Lojërat me role dhe projektet në grup inkurajojnë aftësitë e marrëdhënieve dhe punën në grup, ndërsa ditari reflektues në gjuhë të huaj nxit vetëdijen tek nxënësit. Mësuesit krijojnë një mjedis të sigurt dhe gjithëpërfshirës ku nxënësit ndihen të sigurt kur përballen me, duke shprehur ndjenjat e tyre dhe duke mbështetur njëri-tjetrin.

9. Qëndrueshmëria mjedisore

Kjo metodologji përdor mjedisin fizik dhe atë social si një burim kyç për mësimin e gjuhës së huaj, duke i inkurajuar nxënësit të ndërveprojnë me mjedisin e tyre dhe ta përdorin gjuhën në mënyra autentike dhe kuptimplote. Përfshirja në orën e mësimin të ndryshimeve klimatike dhe çështjeve të tjera globale me të cilat po përballen shoqëria e bën mësimin e gjuhës së huaj më tërheqës, praktik dhe efektiv. Duke ju ofruar nxënësve situata reale dhe autentike mjedisore dhe duke inkurajuar ndërveprimin e tyre me mjedisin ku jetojnë, kjo metodologji promovon përvetësim më të thellë, më kuptimplotë të gjuhës së huaj dhe i ndihmon nxënësit të zhvillojnë kompetencën e të shprehurit në gjuhë të huaj.

10. Edukimi për Median dhe Informacionin (EMI)

Edukimi për median dhe informacionin është një metodologji që ndërthur mësimin e aftësive gjuhësore me zhvillimin e të menduarit kritik, vlerësimin e informacionit dhe konsumin e përgjegjshëm të medias. Duke u angazhuar me formate dhe burime të ndryshme mediatike, nxënësit rrisin aftësitë e tyre të të kuptuarit të përmbajtjeve të ndryshme mediatike, aftësitë analitike dhe aftësitë komunikuese në gjuhë të huaj. EMI jo vetëm që zhvillon aftësitë gjuhësore të nxënësve, por gjithashtu i pajis ata me aftësi për të lundruar dhe për t'u angazhuar në mënyrë aktive dhe kritike me sasinë e madhe të informacionit dhe medias që ata hasin çdo ditë. Integrimi i EMI në mësimdhënien e gjuhës së huaj krijon një mjedis mësimor dinamik që përgatit nxënësit për komunikim efektiv dhe pjesëmarrje aktive në shoqërinë e një epoke digjitale.

3.1.9 Udhëzime për vlerësimin

Vlerësimi korrekt dhe sistematik i nxënësve është pjesë e mësimdhënies dhe e të nxënësve. Vlerësimi i nxënësve nuk ka për synim vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj. Ai duhet të shërbejë për disa qëllime, si:



- të sigurojë informacion rreth nivelit të arritjeve të nxënësve;
- të motivojë nxënësit;
- të shënojë përparimin e nxënësve;
- të vlerësojë gatishmërinë e nxënësve për nxënie në të ardhmen.

Gjatë procesit mësimor, mësuesit:

- duhet të identifikojnë nevojat dhe mangësitë e nxënësve në procesin e të nxënës dhe duhet të ndjekin strategjitë dhe metodat e duhura për të përmirësuar nivelin e të nxënës;
- duhet t'u ofrojnë nxënësve mundësi, veprimtari dhe detyra të shumta e kuptimplote, në mënyrë që të zhvillojnë dhe të demonstrojnë aftësitë dhe progresin e tyre;
- duhet t'i udhëzojnë, t'i motivojnë dhe t'i nxitin nxënësit për të përmirësuar rezultatet e tyre;
- duhet t'i qartësojnë nxënësit për qëllimin dhe kriteret e vlerësimit;
- duhet t'i përfshijnë nxënësit në procesin e vlerësimit.

Vlerësimi mbështetet në rezultatet e të nxënës të programit mësimor. Gjatë zbatimit të programit, nxënësve duhet t'u jepet mundësia të punojnë edhe në grup, për kryerjen e detyrave, të cilat mund të zgjidhen me këtë metodë pune. Në këto raste, mësuesi parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit, në tërësi dhe të secilit nxënë, në veçanti.

Mësuesi nuk e ka të detyrueshëm, vlerësimin me notë të nxënësve në çdo orë mësimi dhe të vendosë nota në regjistër për secilën prej tyre. Si rregull, nxënësit dhe mësuesit duhet të bashkëbisedojnë lirshëm si partnerë rreth përvetësimit të njohurive të fituara të orëve të kaluara dhe mirëkryerjes së detyrave jashtë klase.

Komponentët e vlerësimit janë vlerësim i vazhdueshëm me gojë dhe me shkrim. Vlerësimi me shkrim shërben për aftësimin e komunikimit me shkrim. Mësuesi e vlerëson nxënësin me notë për parashtrimet ose prezantimet me gojë dhe punët me shkrim, të zhvilluara vetë ose në grup. Çrregullime të diagnostikuara, si: disleksia, vështirësi të veçanta gjuhësore të fëmijëve të ardhur rishtas nga emigracioni ose të fëmijëve të shtetasve të huaj, banues në vendin tonë, merren parasysh nga mësuesit, duke u mundësuar këtyre nxënësve të vlerësohen me mënyra të posaçme.

Mësuesi duhet t'u komunikojë prindërve, stafit pedagogjik të shkollës, organeve shtetërore dhe palëve të tjera të interesuara, herë pas here, rezultatet e përparimit të nxënësve. Ky komunikim është mirë të jetë me shkrim dhe të përmbajë disa aspekte kryesore të punës së nxënësve si: aftësitë, qëndrimi ndaj lëndës, pjesëmarrja në veprimtari, punët me shkrim, sugjerimet për përmirësimin e punës në të ardhmen etj.

Procesi i vlerësimit

Vlerësimi dhe mësimdhënia lidhen ngushtë në kurrikul. Për ta përdorur vlerësimin brenda mësimdhënies në mënyrë efektive kërkohet mbi të gjitha, të njihet fakti se instrumente të ndryshme të tij duhet të përdoren për qëllime të ndryshme. Vlerësimet e mëposhtme janë vendimtare për arritjen e rezultateve të të nxënës.

Vlerësimi diagnostikues, zakonisht, kryhet në fillim të vitit shkollor ose para zhvillimit të një grupi orësh, për të identifikuar njohuritë paraprake, interesat ose aftësitë që kanë nxënësit rreth asaj, për të cilën po kryhet vlerësimi. Ky informacion përdoret për të orientuar praktikën e mësimdhënies të mësuesit dhe të nxënësve, në mënyrë që të përcaktohen teknikat korrigjuese. Vlerësimi diagnostikues mund të jetë i shkurtër, i shpejtë, joformal dhe mund të bëhet me gojë dhe me shkrim.

Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm) është një proces, që ndodh gjatë gjithë kohës në klasë dhe informon nxënësit dhe mësuesit mbi progresin e nxënësve. Të dhënat dhe informacioni i mbledhur nga ky lloj vlerësimi përdoren për të përmirësuar proceset e mësimdhënies dhe të nxënës. Fokusi i vlerësimit nuk duhet të jetë vetëm vlerësimi me notë i nxënësit.

Vlerësimi i të nxënës (përmbledhës) kryhet më shpesh në fund të një grupi orësh, për të përcaktuar çfarë është mësuar mbas një periudhe kohe dhe shoqërohet me notë. Vlerësimet e të nxënës përdoren jo vetëm për të informuar nxënësit e prindërit për progresin e nxënësve, por edhe për të përmirësuar praktikën e mësimdhënies dhe të nxënës.

Gjatë zbatimit të programit nxënësve duhet t'u jepet mundësia të punojnë edhe në grup, për kryerjen e detyrave të cilat mund të zgjidhen me këtë formë pune. Në këto raste mësuesi parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit, në tërësi dhe të secilit nxënë, në veçanti.

Nxënësit vlerësohen për përdorimin e njohurive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve në situata të njohura dhe të panjohura. Nëse nxënësit i zotërojnë njohuritë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet në mënyrë të mjaftueshme, ata duhet t'i zbatojnë ato përtej materialeve të përdorura gjatë mësimdhënies. Vlerësimi i të nxënës nuk është thjesht një reflektim i njohurive të fituara, por është edhe një tregues i vlefshëm dhe i besueshëm i thellësisë së të kuptuarit dhe mënyrës se si ai transmetohet dhe përgjithësohet.

Të marra së bashku, të tria llojet e vlerësimeve formojnë një hartë të plotë për përmbushjen e rezultateve të të nxënës, e cila përfshin pikën e nisjes, rrugën që duhet ndjekur dhe pikëmbërritjen.

Roli kryesor i vlerësimit është të përmirësojë të nxënës. Informacioni i siguruar nga vlerësimi i ndihmon mësuesit të kuptojnë anët e dobëta dhe anët e forta të nxënësve në procesin e të nxënës dhe u jep mundësi të përmirësojnë mësimdhënien.

Vlerësimi i nxënësve për fushën “Gjuhët dhe komunikimi” ka për synim matjen e kompetencave të fushës të paraqitura nëpërmjet rezultateve të të nxënësve.

Komponentët e vlerësimit janë **vlerësim me gojë dhe vlerësim me shkrim**. Vlerësimi me shkrim shërben për aftësimin e të shprehurit dhe komunikimit me shkrim. Mësuesi e vlerëson nxënësin me notë për prezantimet me gojë, në testimet periodike me shkrim dhe në punët me shkrim, të zhvilluara individualisht ose në grup.

Një formë e vlerësimit me shkrim nga nxënësit janë edhe testimet.

Vlerësimi i punëve me shkrim është një mjet shumë i rëndësishëm i njohjes së kompetencave gjuhësore të nxënësve. Njohja e këtij niveli, tashmë, nuk mund të bëhet vetëm me rrugët praktike e tradicionalisht të njohura, siç janë qortimet nga mësuesi. Praktikantët e reja sot orientojnë vendosjen e kriterëve dhe të standardeve të përshtatshme dhe të arritshme nga nxënësit. Kështu, duhen kërkuar forma të larmishme vlerësimi, të cilat të pasqyrojnë nivelin real të arritjeve të nxënësve për marrjen e masave për përmirësimin e tij. Mësuesi duhet ta ndjekë gjithë procesin e të shkruarit që nga planifikimi dhe deri te rishikimi dhe redaktimi. Shënimet e mësuesit janë shumë të rëndësishme për vlerësimin e punëve me shkrim të nxënësve; ato duhet të jenë të tilla që t’i motivojnë ata.

Vlerësimi që nxënësit mund t’i bëjnë njëri-tjetrit, është një tjetër formë e rëndësishme që ndihmon mbarëvajtjen e punës në këtë drejtim.

Pjesë e vlerësimit është edhe informimi i nxënësve dhe prindërve për rezultatet e vlerësimit. Informacioni është përshkrues ose me notë.

Vetëvlerësimi është element i rëndësishëm në procesin e të nxënësve. Vënia e synimeve dhe rezultateve të të nxënësve të qarta në programin lëndor mundëson vetëvlerësimin nga nxënësit në vazhdimësi.

Nga vetëvlerësimi përfiton si nxënësi, ashtu edhe mësuesi. Njohja e nxënësit me vetëvlerësimin e ndërgjegjëson atë të kuptojë më mirë problemet e të nxënësve dhe i jep mundësi të caktojë objektiva për të ardhmen.

Vetëvlerësimi në lëndën e gjuhë së huaj realizohet gjatë punës me Portofolin Evropian të Gjuhëve (PEGJ).

Portofoli Evropian i Gjuhëve, (PEGJ), një dokument kurrikular i akredituar nga Këshilli i Evropës, është hartuar për tre qëllime kryesore: (a) të mbështesë dhe të zhvillojë autonominë e nxënësit; (b) të forcojë ndërgjegjësimin ndërkulturor të nxënësit; (c) të promovojë plurilingualizmin. Ai është hartuar si një mjet vetëvlerësimi dhe mund të përmbajë punë me shkrim, detyra tematike, projekte lëndore e ndër-lëndore etj.

3.1.10 Materialet dhe burimet mësimore

Në fushën “Gjuhët dhe komunikimi”, për ndërtimin dhe zhvillimin e kompetencave, është me rëndësi përdorimi i mjeteve dhe materialeve të shumta mësimore. Këto mjete krijojnë mundësi që nxënësit të ndërtojnë dijet e tyre, t’i konkretizojnë njohuritë e tyre, të nxënë në mënyrë të pavarur, t’i përdorin dijet në jetën praktike dhe në kontekste të reja, të zhvillojnë aftësitë e të menduarit kritik e krijues, të bashkëveprojnë me shokët e shoqet e klasës. Disa nga mjetet më të përdorshme didaktike janë: tekstet mësimore, fletoret e punës, revistat, atlaset, enciklopeditë, antologjitë, televizori, video-projektori, kompjuteri, smartboard, interneti, CD, radio, media, Podcastet, aplikacionet ose platformat për mësimin e gjuhës (Duolingo, Babbel, Rosetta Stone, Akelius etj.), materialet mësimore të hartuara ose të përshtatura nga mësuesi, vepra letrare dhe libra të tjerë në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaja që janë në bibliotekën e shkollës, etj.

3.1.11 Mjedisi i të nxënit

Pjesa më e madhe e orëve të mësimin zhvillohet në klasë, ku mundësohen puna në grupe, tryezat e rrumbullakëta etj. Gjithashtu, gjatë vitit mësimor nxënësit mund të shkojnë në biblioteka, të marrin pjesë në panaire të librit, të shkojnë në teatër ose kinema, të zhvillojnë takime me shkrimtarë dhe personalitete të fushave të ndryshme, të vënë në skenë një pjesë dramatike, të bëjnë vizita në muze etj.

3.1.12 Sugjerime për përdorimin e TIK-ut

- Përdorimi i postës elektronike për shkëmbim informacioni.
- Përdorimi i internetit për të shfrytëzuar faqet e web –it të rekomanduara nga mësuesi.
- Përdorimi i CD-ROM për ruajtjen e informacionit të dëshiruar.
- Përdorimi i platformave digjitale për mësimin e gjuhëve.
- Përdorimi i aplikacioneve të ndryshme për hartimin e testeve; pyetësorëve, etj.
- përdorimi i tabelave interaktive për të angazhuar nxënësit në aktivitete interaktive, prezantime multimediale dhe lojëra virtuale.
- përdorimi i përmbajtjeve multimediale si video, podkaste dhe filma për t’i ekspozuar nxënësit ndaj përdorimit autentik të gjuhëve dhe konteksteve kulturore.

3.2 Fusha e të nxënës: Matematika

3.2.1 1 Hyrje

Matematika në arsimin e mesëm të lartë është një lëndë kritike që përgatit nxënësit për rolet e tyre të ardhshme në shoqëri duke ofruar njohuri thelbësore matematikore, arsyetim logjik, aftësi për zgjidhjen e problemeve, komunikim efektiv, modelim dhe duke nxitur një mwnyrw të të mësuarit të pavarur gjatë gjithë jetës.

Matematika mësohet në të gjitha nivelet e kurrikulës dhe kurrikula bazohet në njohuritë e mëparshme, duke përfshirë integrimin e koncepteve nga numri, matja, gjeometria, algjebra dhe funksioni. Ai zgjeron më tej njohuritë e nxënësve në trigonometri, analizë matematikore, gjeometri analitike, statistikë dhe probabilitet. Kurrikula thekson gjithashtu zhvillimin e kompetencave matematikore dhe kyçe, të cilat u mundësojnë nxënësve të kuptojnë dhe zbatojnë matematikën në mënyrë efektive dhe në situata të botës reale.

Njohuritë matematikore fitojnë rëndësi dhe fuqi kur kontekstualizohen dhe zbatohen në skenarë praktikë. Fushat e tjera, duke përfshirë shkencat kompjuterike, biznesin, financat, turizmin, biologjinë, fizikën, teknologjinë, historinë, gjeografinë, shkencat sociale dhe artet, të gjitha përfitojnë nga njohuritë dhe kompetencat matematikore.

Matematika mundëson zhvillimin e personalitetit të nxënësit, zhvillimin e aftësive të tij për të menduar në mënyrë kritike dhe për të hulumtuar, duke nxitur kështu kërshërinë dhe inkurajimin për zbulime, vetëbesimin për zgjidhjen e situatave problemore në jetën e përditshme. Matematika zhvillon:

Të menduarit analitik që është aftësia për të zbërthyer problemet komplekse në komponentë më të vegjël, më të menaxhueshëm dhe për të identifikuar modelet dhe marrëdhëniet.

Të menduarit kritik që është aftësia për të vlerësuar informacionin, idetë dhe argumentet dhe për të bërë gjykime të arsyetuara bazuar në prova.

Zgjidhjen e problemeve që është aftësia për të aplikuar koncepte dhe teknika matematikore për të zgjidhur problemet e botës reale dhe për të krijuar zgjidhje krijuese kur metodat konvencionale rezultojnë të pamjaftueshme.

Bashkëpunimin që është aftësia për të punuar në mënyrë efektive në ekip, për të komunikuar qartë idetë dhe për të dhënë dhe marrë reagime konstruktive.

Në të njëjtën kohë, është e rëndësishme të pranohet se nxënësit mësojnë me ritme të ndryshme dhe në mënyra të ndryshme. Prandaj, të mësuarit e matematikës do të jetë fleksibël dhe i adaptueshëm, duke ofruar një sërë mënyrash mësimore dhe mundësish për nxënësit që të

kuptojnë dhe të ndërveprojnë me matematikën. Kjo mund të përfshijë aktivitete praktike, projekte në grup, mësim me përdorimin e teknologjisë dhe aplikacione të botës reale.

Matematika mësohet në të gjitha klasat e arsimit të mesëm të lartë. Matematika është fushë të nxëni, lëndë mësimore dhe kompetencë kyçe. Një nga aspektet më të rëndësishme në kurrikulën e matematikës është zhvillimi i kompetencave matematikore dhe kyçe, të cilat e ndihmojnë nxënësin të kuptojë përdorimin e matematikës në mënyrë efektive dhe në situata të jetës reale. Në arsimin e mesëm të lartë matematika është në funksion të përgatitjes së nxënësve për studime të mëtejshme në arsimin e lartë ose për në tregun e punës.

3.2.2 Qëllimi i fushës/lëndës së matematikës

Lënda e matematikës ka për qëllim të nxisë zhvillimin individual të nxënësve, duke i fuqizuar ata që të zbatojnë natyrshëm njohuritë, aftësitë dhe metodat matematikore nëpër disiplina të ndryshme. Ajo përfshin modele të të menduarit matematikor, ide themelore dhe struktura, së bashku me njohuritë dhe aftësitë thelbësore matematikore të nevojshme për jetën e përditshme dhe edukimin e ardhshëm.

Matematika kultivon fleksibilitetin intelektual, të menduarit kritik, përqendrimin, kreativitetin, imagjinatën dhe aftësitë vendimmarrëse, të cilat të gjitha janë jetike për një kontribut të angazhuar dhe të përgjegjshëm në shoqëri.

Puna dhe të menduarit matematikor karakterizohen nga përdorimi i saktë i gjuhës, zhvillimi i qartë i konceptit, arsyetimi logjik, argumentimi bindës dhe kuptimi i ndërvarësisë midis fenomeneve dhe proceseve.

Mësimi i matematikës në arsimin e mesëm të lartë synon që nxënësi, të:

- zhvillojë të menduarin logjik dhe kritik;
- përdorë matematikën si një mjet në jetën e përditshme dhe në veprimtaritë shoqërore;
- hulumtojë rreth koncepteve matematikore dhe të zbulojë ngjashmëritë, ndryshimet, rregullsitë dhe marrëdhëniet shkak - pasojë ndërmjet dukurive;
- besojë në aftësinë, shprehinë dhe gjykimin e tij, duke komunikuar qartë dhe saktë nëpërmjet fjalorit dhe simboleve matematike;
- zhvillojë imagjinatën dhe të zgjidhë situatat matematikore në mënyra të ndryshme;
- argumentojë veprimet dhe përfundimet e tij dhe t'ua paraqesë të tjerëve;
- përdorë teknologjinë për të lehtësuar zbatimet e matematikës;
- zhvillojë të menduarin kompjuterik;
- ofrojë aftësitë e nevojshme matematikore për studimet ose karrierën e tyre të ardhshme në fusha të tilla si inxhinieria, fizika, shkenca kompjuterike, ekonomia dhe financa;

- nxisë të nxënësit aftësinë për të analizuar dhe interpretuar të dhëna dhe informacione komplekse dhe për të përdorur modelimin matematikor për të marrë vendime të informuara;
- të tjera të studimit dhe inkurajoni mësimin dhe bashkëpunimin ndërdisiplinor.
- jetë i përkushtuar në punën në grup;
- jetë i motivuar për ta studiuar matematikën si fushë që ka rëndësi për jetën sociale dhe profesionale;
- ndihet i suksesshëm në matematikë.

3.2.3 *Tematikat e fushës dhe përshkrimi i tyre*

Fusha/lënda e matematikës në arsimin e mesëm të lartë, ashtu si në arsimin bazë, mbështetet në disa tematika kryesore. Secila tematikë ka të bëjë me njohuritë, shprehjet matematike dhe qëndrimet, të cilat përdoren për përmbushjen e kompetencave kryesore të fushës dhe të kompetencave kyçe.

Njohuria matematikore është aftësia e një individi për të arsyetuar matematikisht dhe për të formuluar, përdorur dhe interpretuar matematikën për të zgjidhur probleme në një sërë kontekstesh të botës reale. Ai përfshin koncepte, procedura, fakte dhe mjete për të përshkruar, shpjeguar dhe parashikuar fenomene. Ai i ndihmon individët të njohin rolin që luan matematika në botë dhe të marrin gjykimet dhe vendimet e bazuara mirë që u nevojiten qytetarëve konstruktivë, të angazhuar dhe reflektues të shekullit të 21-të.

Fusha/lënda e matematikës fokusohet në këto tematika kryesore:

Numri: Nxënësi përdor kuptimin e numrave, marrëdhëniet ndërmjet tyre dhe algoritmin e veprimeve me numra për të paraqitur zbatime në botën reale.

Matja: Nxënësi zbaton proceset e matjes, përzgjedh dhe teknika dhe formula të përshtatshme për të kryer matje të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta në situata reale.

Gjeometria: Nxënësi përdor arsyetimin dhe vërtetimin për të zgjeruar përfytyrimin rreth marrëdhënieve gjeometrike, si dhe për lidhjen ndërmjet algjebrës dhe gjeometrisë.

Algjebra dhe funksioni (Njehsimi diferencial dhe integral): Nxënësi zbulon ligjësi, përdor gjuhën e simboleve për të interpretuar dhe analizuar lidhjen e ligjësive me njëra-tjetrën duke modeluar marrëdhënie dhe situata matematikore.

Statistika dhe probabiliteti: Nxënësi, në botën e sotme të mbushur me informacion, lexon, kupton, interpreton dhe analizon informacionin në mënyrë që të marrë vendimet e duhura.

3.2.4 *Përshkrimi i kompetencave që zhvillon fusha*

Në mënyrë që nxënësit të jenë të arsimuar matematikisht, ata duhet të jenë në gjendje që fillimisht të përdorin njohuritë e tyre për përmbajtjen e matematikës për të njohur natyrën



matematikore të një situate (probleme) veçanërisht të atyre situatave që hasen në botën reale dhe më pas ta formulojnë atë në terma matematikorë. Ky transformim - nga një situatë e paqartë, e çrregullt, e botës reale në një problem matematikore të përcaktuar mirë - kërkon arsyetim matematikor. Pasi transformimi të bëhet me sukses, problemi matematikor që rezulton duhet të zgjidhet duke përdorur konceptet, algoritmet dhe procedurat e matematikës që mësohen në shkollë. Megjithatë, mund të kërkojë marrjen e vendimeve për përzgjedhjen e mjeteve dhe renditjen e zbatimit të tyre – kjo është gjithashtu një manifestim i modelimit dhe arsyetimit matematikor. Së fundi, nxënësit vlerësojnë zgjidhjen matematikore duke interpretuar rezultatet brenda situatës origjinale të botës reale. Përveç kësaj, nxënësit duhet gjithashtu të zotërojnë dhe të jenë në gjendje të demonstrojnë aftësi të menduarit kompjuterik si pjesë e praktikës së tyre të zgjidhjes së problemeve. Këto aftësi të menduarit kompjuterik të cilat aplikohen në formulimin, përdorimin, vlerësimin dhe arsyetimin përfshijnë njohjen e modelit, zbërthimin, përcaktimin se cilat mjete kompjuterike (nëse ka) mund të përdoren në analizimin ose zgjidhjen e problemit dhe përcaktimin e algoritmeve si pjesë e një zgjidhjeje të detajuar. Sipas Kornizës Kurrikulare të Shqipërisë, të mësuarit është e bazuar në kompetenca. Kompetencat përcaktohen si njohuri, shkathtësi dhe qëndrime që një nxënës duhet t'i fitojë gjatë procesi të mësimdhënie - nxënies. Kompetenca demonstrohet nga nxënësi (njohuri), bazohet në performacën e tij (aftësi) si dhe në perspektivën e sjelljes (qëndrim). Organizimi i mësimi të matematikës me bazë kompetenca përqëndrohet në atë që duhet të bëjë dhe që duhet të jetë i gatshëm të bëjë nxënësi.

Bazuar në këtë kurrikulë, fusha/ lënda e matematikës synon të përmbushë 6 kompetenca kryesore të fushës/lëndës, të cilat lidhen me kompetencat kyç që një nxënës duhet të zotërojë gjatë jetës së tij.

Kompetencat e fushës së matematikës	Përshkrimi i tyre
Zgjidhja problemore në matematikë	<i>Nxënësi përshkruan dhe zgjidh situata problemore të nivelit praktik të marra nga përvojat e përbashkëta të jetës së përditshme dhe të nivelit abstrakt, duke zhvilluar kapacitetin intelektual dhe intuitën krijuese. Zgjidhja problemore shpesh përfshin bashkëpunim dhe punë në ekip, pasi individët punojnë së bashku për të zhvilluar dhe zbatuar zgjidhje efektive. Kjo kërkon aftësinë për të punuar në mënyrë efektive me të tjerët, për të shkëmbyer ide dhe për të ofruar dhe marrë reagime konstruktive.</i>



	<i>Në përgjithësi, kompetenca e zgjidhjes problemore është thelbësore për suksesin në matematikë dhe në shumë fusha të tjera, pasi u mundëson individëve të trajtojnë probleme komplekse dhe të zhvillojnë zgjidhje novatore.</i>
Arsyetimi dhe vërtetimi matematik	<i>Nxënësi përdor arsyetimin, argumentimin dhe vërtetimin si aspekte themelore të matematikës. Arsyetimi ka të bëjë me organizimin logjik të fakteve, ideve ose koncepteve në mënyrë që të arrijë në një rezultat më të besueshëm se intuita. Kjo përfshin përdorimin e deduksionit dhe induksionit logjik për të nxjerrë përfundime bazuar në vetitë dhe marrëdhëniet matematikore.</i> <i>Vërtetimi, nga ana tjetër, përfshin ofrimin e një argumenti logjik dhe rigoroz për të demonstruar vërtetësinë e një pohimi ose pretendimi matematikor. Kjo përfshin përdorimin e aksiomave, përkufizimeve dhe teknikave matematikore të vendosura për të nxjerrë rezultate të reja dhe për të justifikuar vlefshmërinë e pretendimeve matematikore.</i> <i>Arsyetimi dhe prova matematikore janë kompetenca thelbësore për suksesin në matematikë dhe në shumë fusha të tjera, pasi u mundësojnë individëve të zhvillojnë dhe komunikojnë ide dhe zgjidhje novatore dhe të vlerësojnë në mënyrë kritike vlefshmërinë e pretendimeve dhe argumenteve të tyre.</i>
Të menduarit dhe komunikimi matematik	<i>Nxënësi përdor komunikimin nëpërmjet të lexuarit, të shkruarit, diskutimit, të dëgjuarit, të pyeturit për të organizuar dhe qartësuar të menduarin matematik. Gjatë komunikimit në gjuhën matematikore mësohen koncepte, procese dhe përforcohet të kuptuarit e tyre. Gjuha matematike përdoret jo vetëm në lëndë të tjera, por edhe në jetën e përditshme.</i> <i>Kjo kompetencë përfshin aftësinë për të menduar në mënyrë krijuese dhe abstrakte rreth koncepteve matematikore dhe për të komunikuar idetë dhe zgjidhjet matematikore në mënyrë të qartë dhe efektive.</i> <i>Mendimi dhe komunikimi matematikor janë thelbësore për suksesin në matematikë dhe në shumë fusha të tjera, pasi u</i>



	<i>mundësojnë individëve të zgjidhin probleme komplekse, të zhvillojnë koncepte dhe teknika të reja matematikore dhe t'ua komunikojnë idetë e tyre të tjerëve. Të menduarit dhe komunikimi efektiv matematik kërkon aftësinë për të punuar në bashkëpunim me të tjerët, për të shkëmbyer ide dhe për të ofruar dhe marrë reagime konstruktive. Ai gjithashtu përfshin njohjen dhe respektimin e këndvështrimeve dhe qasjeve të ndryshme ndaj problemeve dhe zgjidhjeve matematikore, si dhe të qenit i hapur ndaj zgjidhjeve dhe ideve alternative.</i>
Lidhja konceptuale	<i>Nxënësi kupton ndërtimin e koncepteve matematikore për të formuar një të tërë dhe përdorur varësitë ndërmjet këtyre koncepteve. Kjo kompetencë është e rëndësishme sepse matematika është një lëndë shumë e ndërlidhur, ku koncepte dhe ide të ndryshme shpesh ndërlidhen dhe ndërtohen mbi njëra-tjetrën.</i> <i>Aftësia për të krijuar lidhje konceptuale përfshin njohjen e ngjashmërive dhe dallimeve ndërmjet koncepteve matematikore dhe të kuptuarit sesi konceptet e ndryshme lidhen me njëri-tjetrin. Ajo gjithashtu përfshin aftësinë për të transferuar njohuri dhe aftësi nga një kontekst në tjetrin, dhe për të zbatuar koncepte dhe teknika matematikore për të zgjidhur probleme në fusha të ndryshme. Lidhja konceptuale efektive kërkon gjithashtu aftësinë për të vizualizuar dhe paraqitur idetë matematikore në mënyra të ndryshme, si përmes diagrameve, grafikëve dhe paraqitjeve simbolike.</i>
Modelimi matematik	<i>Nxënësi përshkruan dhe krijon modele duke përdor veprimet themelore matematikore në situatë të jetës së përditshme. Nëpërmjet përdorimit të teknikave përkatëse, gjendet zgjidhja matematikore e cila më pas interpretohet në jetën reale. Kjo kompetencë është e rëndësishme sepse modelet matematikore përdoren në shumë fusha, duke përfshirë inxhinierinë, fizikën, biologjinë, ekonominë, mjekësinë, shkencat sociale, për të kuptuar sistemet komplekse, për të bërë parashikime dhe për të</i>

	<i>projektuar zgjidhje. Modelimi efektiv matematik kërkon gjithashtu aftësinë për të analizuar dhe interpretuar modelet matematikore dhe për t'i përdorur ato për të bërë parashikime dhe për të projektuar zgjidhje.</i>
Të menduarit kompjuterik dhe përdorimi i teknologjisë	<i>Nxënësi zhvillon aftësinë e të menduarit kompjuterik për njohjen e modelit, dizenjimin dhe përdorimin e abstraksionit, zbërthimin e modelit, përcaktimin se cilat (nëse ka) mjete kompjuterike mund të përdoren në analizimin ose zgjidhjen e një problemi dhe përcaktimin e algoritmeve si pjesë e një zgjidhjeje të detajuar. Përdor teknologjinë si mjet për të zgjidhur apo verifikuar zgjidhjet si dhe për të mbledhur, komunikuar e zbuluar informacione. Kjo kompetencë u ofron nxënësve mjete për të eksploruar, vizualizuar dhe zgjidhur problemet matematikore në mënyrë më efikase. Disa aftësi kryesore që lidhin përdorimin e teknologjisë në matematikë janë: aftësi me softuer matematikor: analiza dhe vizualizimi i të dhënave, ndërtimi dhe vizualizimi gjeometrik, programimi dhe kodimi kompjuterik: burimet në internet dhe platformat arsimore: bashkëpunimi dixhital, vlerësimi kritik i teknologjisë, përdorimi etik dhe i përgjegjshëm i teknologjisë.</i>

3.2.5 Rezultatet e të nxënit

Rezultatet thelbësore mësimore në matematikë bazohen në gjashtë kompetenca matematikore. Më poshtë paraqiten rezultatet e të nxënit për secilën kompetencë matematikore, për arsimin e mesëm të lartë.

Rezultatet e të nxënit në përfundim të klasës së 12-të
1. Zgjidhja problemore në matematikë
Nxënësi: - përcakton të dhënat e situatës problemore, modelon një situatw problemore; - zbaton hapat për zgjidhjen e situatës problemore dhe vlerwson vlefshmërinw e zgjidhjes së situatës problemore; - paraqet zgjidhjen e situatës problemore dhe e interpreton ate; - zbaton simbolet matematikore për të përshkruar situata praktike, duke përfshirë edhe njehsimin diferencial dhe integral;



- modelon dhe zgjidh situata problemore, jo të ndërlikuara, me ndihmën ose jo të teknologjisë;
- hulumton dhe zbaton strategji të përshtatshme për zgjidhjen e problemave të simuluar nga jeta reale dhe me shembuj nga shkencat e tjera;
- zbaton simbolet gjeometrike për të përshkruar situata praktike;
- analizon vrojtime dhe interpreton tabela dhe diagrame të gatshme;
- krijon tabela dhe diagrame që shprehin zgjidhjen e një situatë problemore.

2. Arsyetimi dhe vërtetimi matematik

Nxënësi:

- identifikon elementet e situatës matematikore, përdor koncepte matematikore dhe procese të përshtatshme për situatën e dhënë;
- arsyeton për zbatimin e koncepteve dhe proceseve në situatën e dhënë, vlerëson vlefshmërinë e argumenteve dhe pretendimeve matematikore;
- argumenton dhe përligj një përfundim;
- vërteton teorema, me silogjizëm dhe nga e kundërta;
- përdor logjikën, arsyetimin, veprimet me mend ose parashikimin për të gjetur dhe gjykuar zgjidhjen e një problemi matematik;
- gjykon në vërtetësinë e një rezultati të dhënë, i cili mund të jetë gjetur me llogaritje, me zbatimin e formulave të njohura ose me përdorimin e teknologjisë;
- përdor drejt disa rregulla elementare të logjikës e të arsyetimit;
- përdor kundërshebullin për të kundërshtuar, kur është rasti, fjali të jetës së përditshme ose fjali me ndryshore;
- zbaton rregullat bazë të statistikës dhe probabilitetit.

3. Të menduarit dhe komunikimi matematik

Nxënësi:

- familjarizohet me gjuhën e matematikës, lidh gjuhën e matematikës me gjuhën e përditshme;
- interpreton konceptet matematikore, komunikon me të tjerët nëpërmjet të lexuarit, të shkruarit dhe diskutimit;
- shkëmben ide duket ofruar dhe marrë reflektive konstruktive;
- shpjegon me gojë dhe me shkrim, veprimtaritë praktike, hamendjet dhe procesin e zgjidhjes;
- përdor simbolet matematikore (përfshirë edhe logaritmin) për të përshkruar situata të

ndryshme nga matematika dhe nga jeta e përditshme;

- komunikon të menduarin e tij matematikor (nëpërmjet diskutimit, të pyeturit, komenteve) duke përdorur gjuhën e përditshme, fjalorin matematik, paraqitje të ndryshme;
- merr informacion nga figura gjeometrike të thjeshta, grafikë, tabela, diagrame dhe jep informacion me to;
- shkëmben informacion nga figura gjeometrike të thjeshta, dydimensionale në tredimensionale;
- përshkruan, shpjegon dhe diskuton, me gojë dhe me shkrim, veprimtaritë praktike, hamendjet dhe procesin e zgjidhjes;
- shkëmben informacion nga formula, grafikë, tabela, diagrame.

4. Lidhja konceptuale

Nxënësi:

- interpreton koncepte në varësi të njëra – tjetres dhe kupton ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet koncepteve matematikore;
- lidh koncepte dhe modele të reja matematike me ato të përvetësuara më parë nga fusha e matematikës dhe fushat e tjera dhe kupton formimin e tyre;
- përdor varësitë ndërmjet koncepteve matematike mbi njëri- tjetrin, për të formuar një të tërë;
- bën lidhjen ndërmjet koncepteve gjeometrike;
- integron njohuritë e shprehjetë matematikore me situata ose dukuri të marra nga kontekste të tjera (jeta e përditshme, lëndët e tjera, sportet etj.);
- demonstron lidhjen ndërmjet koncepteve të njehsimit diferencial dhe integral;
- bën lidhjen ndërmjet koncepteve e procedurave statistikore;
- e mendon matematikën si pjesë e kulturës njerëzore.

5. Modelimi matematik

Nxënësi:

- krijon modele që përmbajnë konceptet kyçe dhe modelon në gjuhën matematike, një situatë problemore nga jeta reale;
- parashikon dhe gjen zgjidhjen matematikore duke përdorur parimin e modelimit matematikor për zgjidhjen e problemeve nga jeta e përditshme;
- interpreton zgjidhjen matematikore në zgjidhje të situatës nga jeta reale;
- analizon modelet matematikore për të projektuar zgjidhje;



- përdor shkathtësi argumentuese lidhur me modelimin dhe zbatimin e formulave në gjeometrinë analitike;
- krijon modele që përmbajnë konceptet kyçe për njehsimin diferencial dhe integral;
- përdor shkathtësi argumentuese lidhur me modelimin dhe zbatimin e formulave në analizën matematikore;
- krijon modele që përmbajnë konceptet themelore të algjebërës dhe të funksionit (ekuacioni, inekuacioni, sistemi, funksionet, vargjet etj.);
- përdor figurat simbolike përmes vijave dhe grafikëve, për përshkrimin dhe zgjidhjen e problemeve të ndryshme në matematikë, në fushat e tjera dhe në jetën e përditshme.

6. Të menduarit kompjuterik dhe përdorimi i teknologjisë

Nxënësi:

- përdor abstraksionin, të menduarin algoritmik, kompjuterizimin, zbërthimin dhe përgjithësimin për proceset e zgjidhjes problemore;
- përdor makina llogaritëse të avancuara për verifikimin dhe zgjidhjen e problemeve të ndërlikuara matematikore;
- zgjidh detyra matematike, duke përdorur aftësitë e fituara në fushën e Teknologjisë dhe TIK-ut;
- verifikon rezultatet e problemeve të ndryshme duke përdorur TIK dhe programe kompjuterike;
- zgjidh detyra matematikore duke përdorur aftësitë e fituara në fushën e teknologjisë dhe të TIK-ut;
- përdor teknologjinë për të analizuar, komunikuar dhe zbuluar informacion matematik rreth njehsimit diferencial dhe integral;
- përdor teknologjinë për zbatime të matematikës në shkencat e tjera.

NJOHURI DHE KONCEPTE	AFTËSI DHE SHKATHTËSI	QËNDRIME DHE VLERA
- Bashkësitë - Numrat realë - Veprime me numra realë - Raporti dhe përpjesëtimi - Fuqia, rrënja, logaritmi - Matematika dhe financa në jetën e përditshme	- Analiza - Klasifikimi - Krahasoni - Identifikimi - Hulumtimi - Përshkrimi - Formulimi	- Prezantimi dhe komunikimi lirshëm i mendimeve. - Krijimi dhe paraqitja e ideve të reja. - Hulumtimi dhe kërkimi për njohuritë



- Figurat, gjeometria në plan - Formulat e syprinës dhe të vëllimit të trupave tredimensionalë - Shndërrimet gjeometrike dhe sistemi koordinativ - Trigonometria, funksionet trigonometrike - Formulat trigonometrike për zgjidhjen e trekëndëshit - Vektori - Shprehjet shkronjore dhe shndërrimet e tyre - Ekuacionet, inekuacionet, sisteme të ekuacioneve dhe zgjidhja e tyre - Funksioni, vargu numerik - Grafikët - Njehsimi diferencial dhe integral - Logjikë matematike - Statistika - Probabiliteti	- Prezantimi - Arsyetimi - Zbatimi - Njehsimi - Matja - Vrojtimi - Skicimi - Krijim modelesh - Interpretimi - Ndërtimi - Vlerësimi - Komunikimi - Përdorimi i burimeve dhe i mjeteve	- matematikore. - Organizimi i lidhjeve konceptuale të njohurive. - Demonstrimi i shpirtit të objektivitetit dhe të paanësisë. - Përdorimi i imagjinatës dhe i kreativitetit për zgjidhjen e problemeve. - Vetëvlerësimi dhe përdorimi i mendimit kritik në situata të ndryshme. - Demonstrimi i vetbesimit në realizimin e detyrës apo projektit. - Përdorimi i arsytimit dhe argumentimit në vërtetësinë e pohimeve. - Demonstrimi i pavarësisë në mendime dhe veprime. - Demonstrimi i përdorimit të teknologjisë në projekte dhe në detyra. - Pjesëmarrja në debate dhe pranimi i opinioneve të tjera (madje edhe të kundërta) duke treguar tolerancë. - Respektimi i përpjekjeve personale dhe atyre në
--	--	--

		grup. - Motivimi për studimin e matematikës. - Qëndrimi ndaj pyetjeve. Pavarësia në mendime dhe veprime. - Qëndrimi ndaj pyetjeve
--	--	--

3.2.6 Ndarja e kohës

Në tabelën e mëposhtme është dhënë koha mësimore për klasat X-XII për fushën “Matematikë”.

Kurrikula bërthamë

Fusha e të nxënit / Lënda	Klasat X, XI	Klasa XII
MATEMATIKË (orë mësimore/javë)	8	4 (Niveli bazë) 6 (Niveli i avancuar)

3.2.7 Udhëzime metodologjike

Metodologjia e mësimdhënies dhe të nxënit në matematikë përfshin strategji dhe qasje që synojnë të rrisin të kuptuarit e nxënësve, aftësitë për zgjidhjen e problemeve dhe arsyetimin matematikor. Nxënësit e një klase janë të ndryshëm, për sa i përket mënyrës se si ata nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit, të pavarur, me anë të mjeteve konkrete apo kompjuterike etj. Përpos kësaj, që nxënësit të zotërojnë kompetencat matematikore, duhet të përvetësojnë konceptet dhe të zotërojnë shprehitë. Të dy këto kushte diktojnë nevojën për strategji të ndryshme të mësimdhënies, të cilat përshtaten me objektin e të nxënit dhe nevojat e nxënësve. Metodologjia e mësimdhënies –nxënies në lëndën e matematikës duhet të bazohet te:

- *Të nxënit aktiv*: Inkurajimi i angazhimit aktiv të nxënësve në procesin e të mësuarit përmes

aktiviteteve praktike, detyrave për zgjidhjen e problemeve, diskutimeve në grup dhe hulumtimeve..

- *Kuptimi konceptual*: Fuqizimi i zhvillimit të të kuptuarit konceptual në vend të memorizimit përmendësh duke i lidhur ato me situata të jetës reale.
- *Të mësuarit e bazuar në problem*: Përdorimi i zgjidhjeve problemore si një qasje qendrore për të mësuarit e matematikës. Paraqitja e problemeve të hapura dhe sfiduese që kërkojnë mendim kritik, arsyetim dhe kreativitet.
- *Përdorimi i manipulimeve dhe paraqitjeve vizuale*: Përdorimi manipulues konkretë, si blloqe, numërues ose forma gjeometrike, për t'i ndihmuar nxënësit të përfytyrojnë dhe manipulojnë konceptet matematikore.
- *Mësim i diferencuar*: Njohja e nevojave të ndryshme të të nxënësve duke ofruar udhëzime të diferencuara dhe përdorimi i stileve të të nxënësve.
- *Integrimi i teknologjisë*: Përdorimi i mjeteve teknologjike, të tilla si kalkulatorë grafikë, softuer matematikor ose simulime në internet, për të zhvilluar mendimin kompjuterik, për të përmirësuar përvojat e të mësuarit, për të lehtësuar vizualizimin, eksplorimin dhe zgjidhjen e problemeve.
- *Të mësuarit në bashkëpunim*: Nxitja e bashkëpunimit dhe ndërveprimit me bashkëmoshatarët përmes strategjive të të nxënësve bashkëpunues. Caktimi i detyrave në grup, projekte ose diskutime që nxisin ndarjen e ideve, zgjidhjen bashkëpunuese të problemeve.
- *Të mësuarit e personalizuar*. Një fokus i shtuar për nxënësit me vështirësi në të nxënë duke i mbështetur në përmirësimin e rezultateve të të nxënësve.
- *Puna e diferencuar në nxënësit të talentuar dhe pasionuar në matematikë*. Është e rëndësishme që mësuesit të krijojnë mjedis dhe kushte që nxënësit të shfaqin dhe të zhvillojnë talentet e tyre në këtë lëndë.
- *Vlerësimi formues si metodologji të nxënësve*: Përdorimi i teknikave të vlerësimit formues, të tilla si pyetja, vëzhgimet ose kuizet e shkurtra, për të monitoruar përparimin dhe të kuptuarit e nxënësve gjatë mësimit.
- *Lidhjet me botën reale*: Nxitja e nxënësve për të krijuar lidhje midis koncepteve matematikore dhe zbatimit të tyre në kontekstet e jetës reale.
- *Reflektimi dhe metanjohtja*: Inkurajimi i nxënësve të reflektojnë mbi të nxënësve të tyre, të artikulojnë proceset e tyre të të menduarit dhe të bëhen nxënësit metakognitiv.
- *Nevoja e individit për të nxënë gjatë gjithë jetës*. Rëndësinë e qëndrimit pozitiv ndaj lëndës së matematikës dhe vlerësimit të përdorimit të gjithanshëm të saj.
- *Nxitja e bashkëveprimit mësues-nxënë* në kuptimin që në procesin mësimor mësuesi

dhe nxënësi janë komplementarë të njëri-tjetrit.

Duke përdorur këto parime në metodologji të mësimdhënies në lëndën e matematikës, mësuesit mund të krijojnë një mjedis mësimor tërheqës dhe mbështetës që promovon të nxënësit aktiv, të kuptuarit konceptual, të menduarit kritik dhe aftësitë e zgjidhjes së problemeve në matematikë. Këto qasje synojnë të kultivojnë një vlerësim më të thellë për matematikën duke e bërë një lëndë të dashur dhe të zhvillojnë kompetencat matematikore të nxënësve.

Kompetencat matematikore janë të ndërlidhura, me sinergji dhe zhvillohen nëpërmjet situatave të të nxënësit që kanë në qendër pjesëmarrjen aktive të nxënësve. ***Nxënësit janë aktivë kur përfshihen në veprimtari, eksplorime, ndërtime ose simulime të njohurive, aftësive, krahasime të rezultateve apo nxjerrje konkluzionesh.*** Për të siguruar këtë pjesëmarrje aktive të nxënësve, mësuesi duhet të krijojë një atmosferë që i bën ata të ndihen të lirshëm dhe të zhdërvjellët për të zhvilluar njohuritë e tyre në matematikë.

3.2.8 Udhëzime për vlerësimin

Roli parësor i vlerësimit është të përmirësojë të nxënësit. Informacioni i siguruar nga vlerësimi i ndihmon mësuesit të kuptojnë anë të dobëta dhe anë të forta të nxënësve në përmbushjen e rezultateve të të nxënësit për secilën kompetencë matematikore, u jep mundësi të përmirësojnë mësimdhënien dhe të bëjnë propozime për përmirësimin e programeve.

Në zgjedhjen e praktikave dhe teknikave të vlerësimit, në përcaktimin e kohës së përshtatshme, në përzgjedhjen e materialeve, duhen pasur parasysh:

- përcaktimi i qëllimit dhe i llojit të vlerësimit;
- përzgjedhja e veprimtarive që mundësojnë demonstrimin e arritjes së kompetencave;
- përdorimi i vlerësimit për të verifikuar çfarë dinë aktualisht nxënësit;
- dallimi qartë i qëllimit të detyrës së zgjedhur për vlerësim;
- adresimi i vlerësimit të njohuritë, shprehitë e aftësitë;
- reflektimi i besimit që të gjithë nxënësit mund t'i përmirësojnë arritjet;
- informacioni për rezultatet e vlerësimit duhet të motivojë nxënësin, të ndikojë që nxënësi të pranojë se gabimi është pjesë e të nxënësit dhe të ndihmojë progresin e mëtejshëm;
- vlerësimi duhet të konsiderohet si pjesë e procesit mësimdhënie-nxënie dhe jo si veprimtari më vetë;
- vlerësimi ndihmon nxënësit të marrin përgjegjësi për veten e tyre, duke përfshirë strategji të vetëvlerësimit, të vlerësimit të shokut me shokun;
- vlerësimi të jetë gjithëpërfshirës në kuptimin që t'u sigurojë mundësinë të gjithë nxënësve

të demonstrojnë arritjet e tyre dhe të arrijnë më të mirën e mundshme.

Vlerësimi i nxënësve ndahet në tre lloje kryesorë:

- ✎ *Diagnostikues*, që zakonisht kryhet në fillim të kapitulli, klasës apo vitit shkollor, për të identifikuar njohuritë paraprake, interesat ose aftësitë që kanë nxënësit rreth asaj për të cilën po kryhet vlerësimi. Ky informacion përdoret për të orientuar praktikën e mësimdhënies të mësuesit dhe të nxënësve, në mënyrë që të përcaktohen teknikat korrigjuese. Vlerësimi diagnostikues mund të jetë i shkurtër, i shpejtë, jo formal dhe mund të bëhet me shkrim, me gojë ose në formë digjitale.
- ✎ *Formues*, një proces që ndodh vazhdimisht, gjatë gjithë kohës në klasë dhe informon nxënësit dhe prindërit mbi progresin e nxënësve. Të dhënat dhe informacioni i mbledhur nga vlerësimi formues përdoren për të përmirësuar procesin e mësimdhënies - nxënies. Fokusi i vlerësimit formues nuk duhet të jetë matja e arritjeve të nxënësit, por rezultatet dhe progresi i tyre.
- ✎ *Përmbledhës*, që kryhet për të përcaktuar çfarë është mësuar pas një kapitulli, periudhe mësimore, në fund të një klase dhe shoqërohet me notë. Vlerësimet përmbledhëse përdoren jo vetëm për të informuar nxënësit e prindërit për arritjet e nxënësve, por edhe për të përmirësuar praktikën e mësimdhënies dhe të nxënësve.

Gjatë vlerësimit mësuesi duhet të mbështetet në një sasi të konsiderueshme të dhënash që përfshihen në këto teknika:

- vlerësimi i përgjigjeve me gojë;
- vlerësimi i punës në grup;
- vlerësimi i aktivitetit gjatë debateve në klasë;
- diskutimet në klasë;
- vetëvlerësimet;
- vlerësimi i detyrave në grup;
- vlerësimi i projekteve;
- vlerësimi i detyrave të shtëpisë;
- testet për një grup temash të caktuara;
- testet në përfundim të një periudhe mësimore;
- testet në përfundim të vitit mësimor.

Detaje që kanë lidhje me vlerësimin në arsimin bazë gjenden në dokumente zyrtare të posaçme për këtë qëllim.

3.2.9 Matematika dhe teknologjia

Përdorimi i teknologjisë në matematikë po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm pasi rrit përvojën e të mësuarit dhe u ofron nxënësve mjete për të eksploruar, vizualizuar dhe zgjidhur problemet matematikore në mënyrë më efikase. **Aftësitë kryesore që lidhin përdorimin e teknologjisë në matematikë** përmbledhen:

- **Aftësi me softuer matematikor:** Nxënësit janë të aftë të përdorin mjeteve softuerike matematikore për ndërtimin e grafikëve, tabelat dhe softuerët e modelimit matematik për të kryer llogaritje të ndryshme, të ndërtojnë grafikë të funksioneve, të zgjidhin ekuacione, të vizualizojnë konceptet matematikore etj.
- **Analiza dhe vizualizimi i të dhënave:** Teknologjia i lejon nxënësit të mbledhin, të organizojnë, të analizojnë dhe interpretojnë të dhënat në mënyrë më efektive, për të ndërtuar grafikët, për të kryer llogaritjet statistikore dhe për të nxjerrë përfundime domethënëse në zbatime në botën reale të matematikës.
- **Ndërtimi dhe vizualizimi gjeometrik:** Nxënësit janë në gjendje të përdorin softuer dhe mjete gjeometrike për të ndërtuar dhe manipuluar me saktësi figurat gjeometrike. Mjetet si softueri i gjeometrisë mundëson eksplorimin interaktiv të koncepteve gjeometrike, ndërtimin e formave dhe hetimin e marrëdhënieve gjeometrike.
- **Programimi dhe kodimi kompjuterik:** Nxënësit mund të përfitojnë shumë në matematikë nga aftësia në programimin kompjuterik. Gjuhët e programimit mund të përdoren për të zgjidhur probleme matematikore, për të krijuar simulime, për të kryer llogaritjet të ndryshme dhe për të zbatuar algoritme. Të kuptuarit e koncepteve të kodimit rrit të menduarit logjik dhe aftësitë për zgjidhjen e problemeve.
- **Burimet në internet dhe platformat arsimore:** Nxënësit duhet të njihen me aksesin dhe përdorimin e burimeve online dhe platformave arsimore që lidhen me matematikën. Këto platforma ofrojnë mësimë interaktive, probleme praktike dhe akses në një gamë të gjerë mjetesesh dhe simulimesh matematikore.
- **Bashkëpunimi dixhital:** Teknologjia u mundëson nxënësve të bashkëpunojnë me kolegët dhe mësuesit e tyre në distancë. Ata duhet të jenë në gjendje të përdorin mjete komunikimi digjitale, të tilla si forume në internet ose platforma video-konferencash, për të diskutuar konceptet matematikore, për të punuar në projekte së bashku dhe për të marrë reagime nga të tjerët.
- **Vlerësimi kritik i teknologjisë:** Nxënësit duhet të zhvillojnë aftësinë për të vlerësuar në mënyrë kritike softuerin matematikor, burimet online dhe mjetet digjitale për saktësinë, besueshmërinë dhe përshtatshmërinë. Ata duhet të jenë në gjendje të vlerësojnë pikat e forta dhe kufizimet e teknologjive të ndryshme dhe të zgjedhin mjetin më të përshtatshëm për

një detyrë të caktuar matematikore.

- ***Përdorimi etik dhe i përgjegjshëm i teknologjisë:*** Nxënësit duhet të kuptojnë konsideratat etike që lidhen me përdorimin e teknologjisë në matematikë. Kjo përfshin respektimin e të drejtave të autorit dhe të pronësisë intelektuale gjatë përdorimit të burimeve digjitale, të qenit të vetëdijshëm për çështjet e privatësisë dhe sigurisë së të dhënave, si dhe respektimin e sjelljes dhe etikës së duhur në internet.

3.2.10 Materialet dhe burimet mësimore

Gjatë mëimit të matematikës, mësuesi përdor mjete didaktike dhe burime të cilat nxënësi i prek, i shikon, i përdor, i dëgjon etj. Ai/ajo përdor mjete vizuale, teknologji të nevojshme, bën vizatime, modelime, jep ndihma të veçanta, përshtat shembuj të ndryshëm, krijon mjedise për aktivitete alternative etj.

Në lëndën e matematikës mësuesi përdor burime të përkthyer cilësisht nga origjinali si: tekstin/et shkollor të nxënësit testet për grup temash, librin e mësuesit si dhe platforma apo burime digjitale për zhvillimin temave dhe koncepteve të caktuara, laboratorët smart, kompjuter, laptop, teste për provimet kombëtare etj.

Mësuesi përdor fjalë dhe fjali të qarta, të sakta, një kuptimore dhe me një fjalor të pastër të gjuhës. Mësuesi siguron qasje përmes përdorimit të teksteve dhe materialeve të përshtatshme me moshën dhe mundësinë e nivelit të të mësuarit. Ai/ajo u prezanton/sqaron nxënësve përmbajtje të caktuara ose shkathtësitë që ata duhet të performojnë.

Mësuesi u krijon mundësi nxënësve të demonstrojnë apo prezantojnë me anë të medieve detyra dhe projekte të ndryshme.

Sugjerohet që lënda e matematikës për rëndësinë që ka në formimin e nxënësve si lëndë dhe si kompetencë kyçe të zhvillohet në klasa të dedikuara për këtë lëndë, të pajisura me Laboratorë Smart dhe platforma interaktive digjitale të dedikuara për këtë lëndë.

3.3 Fusha e të nxënit: Shkencat e natyrës

3.3.1 Hyrje

Shkenca është veprimtari intelektual dhe praktike që përfshin studimin sistematik të strukturës dhe sjelljes së botës fizike dhe natyrore përmes vëzhgimeve dhe eksperimenteve.

Shkenca është e lidhur ngushtë me teknologjinë. Njohja e shkencave natyrore kontribuon në zhvillimin e teknologjive të reja. Po kështu, teknologjitë e reja mund të çojnë në zhvillimin e njohurive të reja shkencore. Evoluimi si dhe dinamika e tyre e brendshme pasqyrojnë marrëdhëniet e tyre sinergjike prandaj, projektimi ose ndërtimi i objekteve të caktuara teknike,

ose paraqitja e dukurive shkencore janë të gjitha produkt i lidhjeve midis shkencës dhe teknologjisë. Njohuritë dhe kompetencat që zhvillohen përmes fushës së shkencave të natyrës dhe teknologjisë kontribuojnë në formimin e përgjithshëm të nxënësve.

Ato u shërbejnë individëve në aspektin personal, social dhe ekonomik.

Kurrikula bërthamë e shkencave të natyrës është e detyrueshme për klasat (10-12) të AML-së. ***Në arsimin e mesëm të lartë***, fusha e shkencave natyrore integron njohuri, shkathtësi, qëndrime e vlera nëpërmjet lëndëve: fizikë, kimi, biologji. Nxënësit zgjerojnë fushën e njohjes për dukuritë më të zakonshme në jetën dhe veprimtaritë e përditshme, zhvillojnë aftësitë, strategjitë dhe shprehitë e të menduarit që janë të nevojshme për hulumtimin shkencor dhe skicimin teknologjik, lidhin njohuritë shkencore dhe teknologjike me njëra-tjetrën dhe me jetën, përdorin gjuhën dhe terminologjinë shkencore, si dhe krijojnë bazat konceptuale për të nxënit e mëtejshëm të shkencës.

3.3.2 *Qëllimet e fushës*

Qëllimet e fushës së shkencave të natyrës janë konceptuar në funksion të të nxënit gjatë gjithë jetës.

Përmes kësaj fushe nxënësit:

- zhvillojnë njohuritë dhe konceptet bazë për formimin shkencor në shkencat e natyrës;
- zbulojnë lidhjet e varësisë ndërmjet botës së gjallë dhe mjedisit;
- zhvillojnë aftësitë shkencore, të të menduarit kritik dhe krijues;
- zbatojnë njohuritë dhe aftësitë shkencore në mënyrë analitike, kritike dhe krijuese në problemet që kërkojnë zgjidhje dhe marrje vendimesh;
- vlerësojnë kontributin e shkencës dhe teknologjisë për mirëqenien e njeriut dhe shoqërisë;
- ndërgjegjësohen për të bashkëvepruar me mjedisin në mënyrë të përgjegjshme dhe konsensuale;
- përdorin teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit, si mjet për sigurimin dhe komunikimin e informacionit;
- shpjegojnë rolin e shkencës në zhvillimin e qëndrueshëm, si edhe në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit.

3.3.3 *Qasja e bazuar në kompetenca*

I gjithë procesi i të nxënit në fushën e shkencave të natyrës ka në fokus zhvillimin e **kërkimit shkencor**.

Ai organizohet rreth tri kompetencave:



Kompetenca 1: Kërkimi i përgjigjeve ose i zgjidhjeve të problemeve shkencore

a) Nxënësi përcakton problemin.

- Merr parasysh kontekstin e situatës.
- Paraqet problemin.
- Identifikon të dhënat fillestare.
- Identifikon elementët që lidhen me situatën dhe me njëri-tjetrin.
- Riformulon problemin duke përdorur koncepte shkencore dhe teknologjike.
- Propozon një shpjegim ose zgjidhje të mundshme.

b) Nxënësi zhvillon një plan veprimi.

- Eksploron disa nga shpjegimet ose zgjidhjet fillestare.
- Zgjedh shpjegimin ose zgjidhjen.
- Identifikon burimet e nevojshme.
- Planifikon hapat e zbatimit.

c) Nxënësi analizon rezultatet.

- Kërkon modelet ose marrëdhëniet domethënëse.
- Gjykon përshtatshmërinë e përgjigjes ose zgjidhjes së gjetur.
- Lidh rezultatet dhe konceptet shkencore dhe teknologjike.
- Sugjeron përmirësime, nëse është e nevojshme.
- Nxjerr përfundime.

d) Nxënësi zbaton planin e veprimit.

- Ndjek hapat e planit të vet.
- Përdor teknikat dhe burimet e përshtatshme.
- Bën teste, nëse është e mundur.
- Mbledh të gjitha të dhënat e dobishme dhe mban shënime për vërtetimet bëra.
- Nëse është e nevojshme, përshtat planin e veprimeve ose zbatimin e tij.
- Zbaton të gjithë planin e veprimeve.

Kompetenca 2: Përdorimi i mjeteve, objekteve dhe procedurave shkencore

a) Nxënësi vendos çështjet shkencore në kontekstin e duhur.

- Identifikon aspekte të kontekstit (p.sh., social, mjedisor, historik).
- Bën lidhjen ndërmjet këtyre aspekteve.
- Identifikon ndonjë çështje etike që lidhet me problemin.
- Parashikon pasojat afatgjata.



b) *Nxënësi kupton parimet shkencore mbi të cilat ngrihet çështja.*

- Njeh parimet shkencore.
- I përshkruan parimet në mënyrë sasiore dhe cilësore.
- Vendos lidhjet mes parimeve duke përdorur konceptet, ligjet ose modelet.

c) *Nxënësi formon një opinion për çështjen.*

- Kërkon burime të ndryshme dhe merr parasysh këndvështrime të ndryshme.
- Përcakton elementet që mund ta ndihmojnë për të formuar opinionin.
- Mbështet opinionin e vet me elementët që ka marrë parasysh.
- Vlerëson opinionin e vet duke marrë parasysh edhe opinionet e të tjerëve.

d) *Nxënësi vendos lidhjen mes shkencës dhe teknologjisë.*

- Identifikon funksionet e përgjithshme të një objekti, sistemi ose procesi.
- Identifikon elementet përbërës dhe funksionet e tyre.
- Përshkruan parimet e ndërtimit dhe funksionimit të një objekti, sistemi, produkti ose procesi.
- Vendos lidhjet mes parimeve shkencore dhe teknologjike duke përdorur konceptet, ligjet ose modelet.
- Paraqet skematikisht parimet sipas të cilave funksionon objekti, sistemi, produkti ose procesi.

Kompetenca 3: Komunikimi me gjuhën dhe terminologjinë e shkencës

a) *Nxënësi shkëmben informacionin shkencor dhe teknologjik.*

- Është i hapur ndaj këndvështrimeve të të tjerëve.
- Vlerëson këndvështrimin e vet duke e krahasuar me atë të të tjerëve.
- Integron termat shkencorë dhe teknologjikë në fjalorin e gjuhës së shkruar dhe të folur.

b) *Nxënësi interpreton mesazhet shkencore dhe teknologjike.*

- Vërteton besueshmërinë e burimeve që shfrytëzon.
- Identifikon informacionin që ka të bëjë me çështjen dhe shpjegimin ose zgjidhjen e saj.
- Kupton dhe formulon saktë konceptet dhe përkufizimet e tyre.
- Paraqet grafikisht lidhjen ndërmjet madhësive, konceptet e të cilave shprehen simbolikisht në formula.
- Zgjedh elementët domethënës.

c) *Nxënësi krijon dhe ndan mesazhe shkencore dhe teknologjike.*

- Merr parasysh audiencën dhe kontekstin e grupit që merr mesazhin.

- Strukturon mesazhin e tij.
- Përdor tipat e përshtatshëm të gjuhës sipas standardeve dhe marrëveshjeve të vendosura.
- Përdor forma të përshtatshme të prezantimit.
- Demonstron rigorozitet dhe koherencë.

Të tria kompetencat e fushës lidhen me njëra-tjetrën. Nëse kompetenca e parë ka të bëjë me mënyrat e të arsyetuarit, që i mundësojnë nxënësit të merren me probleme shkencore, dy kompetencat e tjera i mësojnë ata se si të përdorin instrumentet dhe procedurat e duhura dhe

si të komunikojnë në gjuhën e shkencës dhe të teknologjisë për të zgjidhur problemet. Duke zbatuar mënyrat e të arsyetuarit shkencor, nxënësit kuptojnë natyrën e mjeteve, objekteve dhe procedurave të përdorura në këtë fushë dhe janë të aftë të vlerësojnë ndikimin pozitiv apo negativ të shkencës dhe teknologjisë në mjedis dhe shoqëri. Përveç kësaj, në prezantimin e shpjegimeve ose sqarimin e zgjidhjeve të tyre, ata ndërgjegjësohen për rëndësinë e përdorimit të saktë të gjuhës dhe terminologjisë në shkencë dhe teknologji.

Këto kompetenca zhvillohen së bashku dhe jo veçmas apo njëra pas tjetrës. Për të realizuar metodat dhe procedurat specifike shkencore, nxënësit njohin konceptet dhe gjuhët që lidhen me to, si dhe aftësohen në përdorimin e tyre. Ata familjarizohen me këto metoda dhe procedura, të cilat kanë kuptim dhe rëndësi sipas konteksteve ku zbatohen.

Kompetencat e fushës së shkencave lidhen dukshëm dhe në mënyrë logjike e metodike me kompetencat kyçe. Ato janë të lidhura ngushtë, gjithashtu, me tematikat e fushës dhe zhvillohen nëpërmjet tyre.

3.3.4 Rezultatet e të nxënës

Rezultatet e të nxënës në përfundim të klasës së 12-të
Kërkimi i përgjigjeve ose i zgjidhjeve të problemeve shkencore
Nxënësi: - përcakton problemin në mënyrë të pavarur; - përdor konceptet si në aspektin cilësor, ashtu edhe sasior; - kërkon burime ndihmëse për zgjidhjen e problemit; - justifikon zgjedhjen e metodave, strategjive ose teknikave; - kontrollon ndryshoret në mënyrë të pavarur; - reflekton mbi zgjidhjet duke punuar në mënyrë individuale ose në grup.
Përdorimi i mjeteve, objekteve dhe procedurave shkencore

Nxënësi:

- formulon pyetje, jep shpjegim, zgjidhje ose opinion duke u bazuar në aspektet e çështjes ose të kontekstit të saj;
- zhvillon strategjitë e veta të problemzgjdhjes bazuar në njohuritë që ka;
- identifikon elementët kryesorë të një objekti, sistemi ose produkti;
- përdor konceptet e kërkuara dhe zbaton ligjet që lidhen me këto koncepte në mënyrë të përshtatshme;
- përshkruan parimet e ndërtimit dhe të funksionimit të një objekti ose sistemi;
- përdor formulime matematikore në përputhje me situatën;
- jep shpjegime ose zgjidhje të përshtatshme duke përdorur konceptet, ligjet, teoritë dhe modelet e shkencës dhe të teknologjisë;
- argumenton shpjegimet, zgjidhjet ose opinionet mbi bazën e parimeve shkencore dhe teknologjike, të marra prej burimeve të besueshme të informacionit;
- identifikon në mënyrë realiste pasojat që lidhen me çështjen në studim.

Komunikimi në gjuhën dhe terminologjinë e shkencës

Nxënësi:

- zgjedh elemente të përshtatshme për përfundimin e detyrës;
- zgjedh dhe përdor burime të ndryshme dhe të besueshme të informacionit;
- organizon korrektësisht elementet e mesazhit të vet, e përshtat atë me audiencën dhe e transmeton qartësisht;
- përdor terminologjinë në përputhje me rregullat dhe konvencionet e pranuar;
- zgjedh dhe përdor mënyra të përshtatshme të prezantimit, skicimit të informacionit dhe të teknologjive të komunikimit dhe të shfaqjes së të dhënave në tabela, grafikë ose diagrame.

3.3.5 Rezultatet e të nxënit sipas tematikave lëndore

Në tabelën e mëposhtme, përshkruhen rezultatet e të nxënit, të cilat nxënësit duhet t'i arrijnë në fund të klasës së 12-të sipas secilës tematikë lëndore.

BIOLOGJI

SHUMËLLOJSHMËRIA DHE KLASIFIKIMI I GJALLESAVE
Nxënësi: - përdor sistemin e klasifikimit hierarkik të organizmave të gjallë; - vlerëson rolin e komunitetit shkencor në vërtetimin e provave që mbështesin modelin e supermbretërive; - vlerëson informacionet për përdorimin e ADN dhe bioinformatikës për të dalluar llojet me qëllim përcatimin e lidhjeve evolutive; - demonstron me anë të provave se si mund të vlerësohet biodiversiteti; - diskuton çështje etike dhe ekonomike për ruajtjen e biodiversitetit.
NDËRVARËSIA
Nxënësi: - shpjegon përmes shembujve ciklin e lëndës dhe rrjedhën e energjisë në kushte aerobe dhe anaerobe. - përdor modele matematikore të energjisë së ruajtur në biomasë për të përshkruar transferimin e energjisë nga një nivel trofik në tjetrin dhe se si lënda dhe energjia ruhen nëpër ekosisteme. - ndërton modele për të ilustruar rolin e fotosintezës dhe frymëmarrjes qelizore në ciklin e karbonit midis biosferës, atmosferës, hidrosferës dhe gjeosferës. - përdor analizën sasiore për të mbështetur shpjegimet e faktorëve (duke përfshirë kufijtë, burimet, klimën dhe konkurrencën) që ndikojnë në kapacitetin mbajtës të ekosistemeve në shkallë të ndryshme. - shpjegon përmes shembujve faktorët që ndikojnë në biodiversitetin dhe popullatat në ekosisteme të ndryshme. - vlerëson dëshmitë se ndërveprimet komplekse në ekosisteme mbajnë numra dhe lloje relativisht të qëndrueshme të organizmave në kushte të qëndrueshme, por ndryshimi i kushteve mund të rezultojë në formimin e një ekosistemi të ri. - vlerëson dhe ofron zgjidhje për reduktimin e ndikimeve të aktivitetit njerëzor në mjedis dhe biodiversitet. - krijon ose përdor një simulim për të testuar një zgjidhje për të zbutur ndikimet negative të aktivitetit njerëzor në biodiversitet.
STRUKTURA DHE FUNKSIONIMI I ORGANIZMAVE TË GJALLË

Nxënësi:

- shpjegon me anë të shëmbujve se si struktura e ADN-së përcakton strukturën e proteinave të cilat kryejnë funksionet thelbësore të jetës përmes sistemeve qelizore të specializuara.
- përdor modele për të ilustruar se si fotosinteza transformon energjinë diellore (gjatë fazës dritore) në energji kimike për të prodhuar molekula organike komplekse (gjatë fazës jodritore).
- shpjegon me anë të shëmbujve se si karboni, hidrogjeni dhe oksigjeni nga molekulat e sheqerit mund të kombinohen me elementë të tjerë për të formuar aminoacide dhe/ose molekula të tjera të mëdha me bazë karboni (përfshirë reaksione kimike specifike për identifikimin e makromolekulave).
- përdor modele për të ilustruar se frymëmarrja qelizore është një proces kimik ku energjia e lidhjeve kimike të molekulave organike të ushqimit transferohen në molekulën e ATP-së duke rezultuar në një transferim neto të energjisë.
- zhvillon dhe përdor modele për të ilustruar organizimin hierarkik dhe funksionimin e sistemeve ndërvepruese brenda organizmave shumëqelizorë.
- planifikon dhe kryen një hetim për të siguruar prova se si ruhet homeostaza.

TRASHËGIMIA DHE EVOLUCIONI

Nxënësi:

- përdor modele për të ilustruar rolin e ndarjes qelizore (mitozës) dhe diferencimit në prodhimin dhe mirëmbajtjen e organizmave komplekse (përfshihen mekanizmat e kontrollit të shprehjes së gjeneve).
- formulon pyetje për të sqaruar marrëdhëniet rreth rolit të ADN-së dhe kromozomeve në kodimin e udhëzimeve për tiparet karakteristike të transmetuara nga prindërit te pasardhësit (përfshihen fazat e mejozës).
- përdor të dhëna për të mbështetur argumentet për mënyrën se si ndodhin variacionet gjenetike të trashëgueshme.
- zbaton koncepte statistikore dhe probabilitetit për të shpjeguar ndryshimin dhe shpërndarjen e tipareve të shprehura në një popullatë (përfshihet ligji Hardy-Weinberg).
- komunikon informacion shkencor se prejardhja e përbashkët dhe evolucioni biologjik mbështeten në prova empirike.
- jep shpjegime bazuar në prova se procesi i evolucionit kryesisht rezulton nga katër

faktorë: 1) potenciali që një lloj të rritet në numër 2) variacioni gjenetik i trashëgueshëm i individëve në një lloj për shkak të mutacioneve dhe riprodhimit seksual 3) konkurrenca për burime të kufizuara dhe 4) përhapja e atyre organizmave që janë më të aftë të mbijetojnë dhe të riprodhohen në mjedis.

- zbaton koncepte statistikore dhe të probabilitetit për të mbështetur shpjegimet se organizmat me një tipar të favorshëm të trashëgueshëm priren të rriten në numër në raport me organizmat që ju mungon kjo veçori.
- analizon bazuar në dëshmi se si përzgjedhja natyrore çon në përshtatjen e popullatave.
- vlerëson provat që mbështesin pretendimet se ndryshimet në kushtet mjedisore mund të rezultojnë në: 1) rritje të numrit të individëve të disa llojeve 2) shfaqjen e llojeve të reja me kalimin e kohës dhe 3) zhdukjen e llojeve të tjera.

FIZIKË

LËVIZJA, FORCAT DHE ENERGJIA

Nxënësi:

- shpjegon konceptet e vendndodhjes, shpejtësisë, dhe nxitimit të pikës materiale/ dhe të trupit të ngurtë në intervale të ndryshme të kohës;
- dallon madhësitë fizike skalare nga ato vektoriale;
- përshkruan efektet e forcave gravitacionale, elektromagnetike, bërthamore dhe të dobëta në situata të jetës reale;
- shpjegon lëvizjen e trupit në plan dhe hapësirë në çdo çast të kohës, duke e interpretuar me shembuj konkretë;
- shpjegon konceptin e forcës, llojet e saj dhe zbatimet e ligjeve të dinamikës në situata reale;
- shpjegon dukurinë e inercisë, momentet e inercisë, momentin e forcës dhe momentin e çiftit të forcave, forcat dhe çiftet e forcave ,që zbatohen respektivisht në lëvizjet drejtvizore dhe rrotulluese;
- përdor ligjet e ruajtjes dhe i zbaton ato në situata reale të jetës së përditshme;
- parashikon lëvizjen e trupit në çdo çast të kohës kur njihen kushtet fillestare të lëvizjes së tij;
- përdor konceptin e forcës së rëndësës në problemet që lidhen me ligjin e tërheqjes së gjithësishe, rënien e lirë të trupave dhe lëvizjen e projektuar;
- zbaton ligjet e Njutonit për një trup, lëvizja e të cilit shkaktohet nga një forcë ose nga një

rezultante forcash që veprojnë mbi të;

- zbaton ligjet e ruajtjes për një trup kur mbi të nuk veprojnë forcat e jashtme;
- përdor lidhjen ndërmjet punës dhe energjisë për të analizuar lëvizjen e trupave, të cilët janë nën veprimin e forcave konservative ose jo konservative.

- përshkruan burimet e ripërtërishme dhe të paripërtërishme të energjisë;
- liston format e ndryshme të energjisë dhe i përshkruan ato nëpërmjet shembujve konkretë (kinetike, potenciale, mekanike, potenciale elasticitetit, kimike, elektrike, bërthamore, termike, radioaktive);
- shpjegon lidhjen e punës me energjinë;
- shpjegon ligjin e ruajtjes dhe shndërrimit të energjisë mekanike;
- tregon si e shfrytëzon njeriu energjinë për nevojat e jetës së përditshme.
- shpjegon konceptet bazë të nxehtësisë dhe temperaturës, dhe si ndryshon temperatura nga vetitë e lëndës;
- zbaton ligjet e termodinamikës duke analizuar lidhjet e temperaturës, punës, energjisë dhe entropisë;
- përdor formulën që shpreh lidhjen përmes nxehtësisë dhe punës për sistemet termodinamike;
- analizon teorinë molekulare-kinetike të lëndës;
- identifikon proceset e kthyeshme dhe të pakthyeshme duke zbatuar ligjet e termodinamikës;
- njehson madhësitë termodinamike gjatë zbatimit të ligjeve të gazeve;
- analizon lidhjen mes nxehtësisë, punës dhe rendimentit në motorët termikë.

ELEKTRICITETI, MAGNETIZMI DHE INDUKSIONI ELEKTROMAGNETIK

Nxënësi:

- shpjegon karakteristikat dhe natyrën e ngarkesës elektrike, fushës elektrike dhe potencialit elektrik;
- ndërton skemat e qarqeve në seri dhe në paralel, dhe përshkruan elementet e një qarku elektrik;
- tregon si ndikon fusha magnetike mbi një ngarkesë elektrike apo mbi një përcjellës me rrymë;
- tregon si ndikon rryma që kalon në përcjellësin drejtvizor ose te një solenoid për lindjen e fushës magnetike;
- demonstroi dukurinë e induksionit elektromagnetik;
- analizon përdorimet e magnetëve dhe fushave magnetike në jetën e përditshme;
- ilustron nëpërmjet demonstrimeve vizuale apo simulimeve ngarkesat elektrike, fushën elektrike, potencialin elektrik, dhe intensitetin e rrymës elektrike;
- analizon ndërtimin dhe funksionimin e elektromagnetëve, elektromotorëve dhe gjeneratorëve.

VALËT MEKANIKE DHE ELEKTROMAGNETIKE

Nxënësi:

- identifikon llojet e valëve dhe shpjegon vetitë dhe karakteristikat e tyre;
- identifikon madhësitë fizike që karakterizojnë valët mekanike dhe elektromagnetike;
- analizon shpejtësinë e valës dhe varësinë e saj nga mjedisi ku përhapet;
- shpjegon karakteristikat e tingullit dhe kushtet e përhapjes së tij në mjedise të ndryshme;
- bën dallimin mes vetive fizike dhe fiziologjike të tingullit;
- interpreton parimet bazë të optikës gjeometrike dhe optikës fizike;
- analizon me shembuj përdorimin e ligjeve të optikës gjeometrike në ndërtimin e sistemeve optikë si: syri, mikroskopi, teleskopi;
- analizon dualizmin valë-thërrmijë dhe relacionin e papërcaktueshmërisë.

FIZIKA ATOMIKE, BËRTHAMORE DHE GRIMCAT ELEMENTARE

Nxënësi:

- shpjegon modelin e strukturës së atomit;
- analizon formulën që shpreh lidhjen e energjisë së elektronit në nivele të ndryshme energjetike me frekuencën, që i përgjigjet vijave spektrale të atomeve të ndryshme;

- tregon karakteristikat e grimcave elementare;
- shpjegon ligjet e rrezatimit termik dhe dukurinë e fotoefektit;
- analizon reaksionet bërthamore, duke u mbështetur në ligjin e ruajtjes së ngarkesave dhe përdorimet e tyre;
- identifikon përdorimet e radioaktivitetit në shkencë dhe teknologji;
- shpjegon si përftohen dhe transmetohen rrezatimet radioaktive;
- analizon bashkëveprimin e rrezatimeve me lëndën dhe organizmat e gjalla.

FIZIKA HAPËSINORE

Nxënësi:

- përshkruan trupat qiellorë si yjet, galaktikat dhe objektet e tjera të universit dhe shpjegon se si ato formohen përmes grumbullimit të materiesë dhe gravitetit, si dhe diskuton përbërjen e tyre kimike dhe fizike;
- identifikon dhe përshkruan metoda për të matur largësitë në astronomi, duke përfshirë përdorimin e njësisë astronomike të distancës së dritës (vit-dritë) dhe metoda tjera të përdorura për të përcaktuar distancat e mëdha në hapësirë.
- shpjegon procesin e evolucionit të yjeve, duke përfshirë fazat e ndryshme dhe transformimin nga yll në vrime të zeza;
- diskuton modelin e Big-Bangut, duke përfshirë origjinën dhe evoluimin e universit, si dhe vëzhgimet që e konfirmuan këtë model teorik të universit.

KIMI

STEKIOMETRIA

Nxënësi:

- përdor të dhëna eksperimentale për të njehsuar, formulën empirike dhe formulën molekulare duke përdorur formulën $pV = nRT$ për gazet dhe avujt.
- kryen llogaritjet, duke përdorur konceptin e molit në masën e substancave vepruese, vëllimin e gazeve dhe vëllimin dhe përqendrimin e tretësirave.
- përzgjedhin dhe integrojnë përfundime nga kimia dhe zbatimet e saj praktike me aspektet e situatave konkrete jetësore.

STRUKTURA E ATOMIT

Nxënësi:

- demonstroi njohuri, aftësi, qëndrim për objektin e studimit të kimisë dhe metodën shkencore të njohjes së vendodhjes së grimcave të atomit, ndërtimin e bërthamës së atomit, izotopet, masën atomike relative, numrat kuantike, orbitalet atomike, shpërndarja e elektroneve në atom etj.
- tregon dhe paraqet si shpërndahen elektronet në një atom, në përputhje me: parimin e qëndrueshmërisë (aufbaut), parimin e përjashtimit të Paulit, rregullën e Hundit.

PERIODICITETI I ELEMENTËVE

Nxënësi:

- analizon strukturën atomike, periodat dhe grupet a dhe b në tabelën periodike duke parashikuar vendosjen e elementeve në tabelën periodike dhe vetitë e tyre, konfigurimin elektronik.
- argumenton marrëdhëniet ndërmjet rrezes atomike, potencialit të jonizimit, afërsisë për elektronin, dhe elektronegativitetit.
- interpreton ndryshimet e vetive fizike në lidhje me temperaturën e shkrirjes dhe përcjellshmërisë elektrike për molekulat e thjeshta, makromolekulat ose lidhjet metalike në elementet.

LIDHJET KIMIKE

Nxënësi:

- përshkruan, interpreton dhe parashikon efektin e llojeve të ndryshme të lidhjeve (si: lidhje jonike, lidhje kovalente, lidhje hidrogjenore, forcat e bashkëveprimit ndërmolekular, lidhje metalike) në vetitë fizike të substancave;
- shpjegon formën gjeometrike dhe këndin e lidhjes në molekulat, me anë të teorisë së VSEPR-it (teoria e shtytjes së çifteve elektronike të shtresës valentore), në rastet kur atomi qendror ka 2-4 çifte elektronike;
- përshkruan lidhjen metalike si një rrjetë kristalore të joneve pozitive në një "det elektronesh" dhe e përdor këtë për të përshkruar vetitë e metaleve.

TERMOKIMIA

Nxënësi:

- argumenton lidhur me përdorimin e entalpisë së një reaksioni duke u bazuar në ligjin e Hesit dhe rrjedhimet e tij duke u nisur nga entalpitë standarde të formimit dhe duke ditur ΔH e stadeve të një reaksioni.

KINETIKA KIMIKE DHE EKUILIBRI KIMIK

Nxënësi:

- interpreton në grafikë ecurinë e një reaksioni përmes parametrave si energjia e reaktantëve, energjia e aktivizimi, kompleksi aktiv, energjia e produkteve, reaksion ekzotermik, reaksion endotermik;
- argumenton nëse ndryshimi i temperaturës, përqendrimit ose trysnisë ose prania e një katalizatori ndikon në vlerën e konstantes së ekuilibrit të reaksionit;
- llogarit vlerën e konstantes së ekuilibrit duke përdorur përqendrime të substancave në ekuilibër;
- interpreton acidet dhe bazat sipas teorisë Bronshtet-Lourit duke përfshirë përdorimin e koncepteve acid-I bazë-I, acid-II bazë-II;
- shpjegon dallimet në sjelljen midis acideve dhe bazave, të forta dhe të dobëta dhe vlerën e pH në tretësirat e tyre ujore;
- tregon marrëdhëniet pH me pOH, $[H^+]$, $[OH^-]$ dhe llogarit pH e një tretësire;
- acid/bazë e fortë;
- acid/ bazë e dobët duke u nisur nga Ka, Kb.

ELEKTROKIMIKA

Nxënësi:

- Identifikon tretësirat tampone duke treguar vetitë e tyre dhe rëndësinë që ka njohja e këtyre vetive në funksionimin e organizmit të njeriut.
- përshkruan barazimin e përgjithshëm të elektrolizës, si dhe përcakton produktet që çlirohen gjatë elektrolizës së elektrolitëve në gjendje të shkrirë apo të tretur.

NJOHURI TË KIMISË ORGANIKE

Nxënësi:

- përdor numenkaturën e IUPAC për të shkruar dhe emërtua përbërjet organike si hidrokarburet alifatike dhe aromatike, alkoolët, aldehidet, ketonet, acidet karboksilike dhe esteret.
- përkufizon grupin funksionar ($-OH$, $-CHO$, $-CO-$, $-COOH$, $-COO-$) si përcaktues të vetive të substancave organike si dhe nga pikëpamja e lidhjes kimike dhe veçorive që sjell ky grup në vetitë e përbërjeve organike.
- demonstron se si zhvillohet reaksioni i adicionit, eliminimit, zëvendësimit radikal, ...

zëvendësimin elektrofilik, zëvendësimin nukleofilik.

- argumenton lidhur me përdorimet praktike të polimerëve polieten, polipropen, pvc dhe rolin e tyre në mjedis.
- heton në rrugë eksperimentale alkoolet, aldehidet, acidet karboksilike.
- përshkruan reaksionet redoks në kalimet nga alkoolet në aldehidet (ketonet) deri tek acidet karboksilike dhe anasjellas, me anë të hidrogjenimit dhe dehidrogjenimit etj.
- realizon modelime dhe simulime përmes kompjuterit për strukturat kimike të alkooleve, aldehideve, ketoneve, acideve karboksilike, estereve.

3.3.6 Ndarja e kohës

Në tabelën e mëposhtme është dhënë koha mësimore për klasat X-XII për fushën “Shkencat e natyrës”.

Kurrikula bërthamë

Lëndët e fushës “Shkencat e natyrës”	Klasat X-XII
Fizikë	4 (2+2+0)
Biologji	4 (2+2+0)
Kimi	4 (2+2+0)
Totali:	12

Kurrikula me zgjedhje

Lëndët e fushës “Shkencat e natyrës”	Klasat X-XII
Fizikë	4 (0+0+4)
Biologji	4 (0+0+4)
Kimi	4 (0+0+4)
Totali:	12

3.3.7 Udhëzime metodologjike

Metodat, teknikat, strategjitë e mësimdhënies në fushën e shkencave natyrore janë faktorë të rëndësishëm për një mësimdhënie të suksesshme që nxit gjithëpërfshirjen, ndërveprimin, mendimin e pavarur, kritik dhe krijues dhe një element shumë i rëndësishëm në zhvillimin e kompetencave.

Përzgjedhja e tyre është kompetencë e mësuesit dhe bëhet në funksion të zhvillimit të kompetencave të nxënësve, në përshtatje me nevojat e nxënësve, me përmbajtjen e temave mësimore, me nivelin e nxënësve, si dhe me stilet e ndryshme të të nxënës.

Metodat, teknikat, strategjitë e mësimdhënies duhet t'i shërbejnë nxënësit për të përvetësuar lehtë njohuritë, shprehjet, shkathësitë, qëndrimet dhe vlerat për të përballuar sfidat e jetës.

Mësimdhënia dhe të nxënës që bazohet në kompetenca, kërkon që në përzgjedhjen dhe në përdorimin e strategjive, teknikave dhe metodave të mësimdhënies, mësuesit e fushës së shkencave natyrore të marrin parasysh njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet paraprake të nxënësve, që nënkupton përvojat individuale të tyre dhe, mbi këtë bazë, të mbështesin e orientojnë të nxënës të tyre. Për një nxënie cilësore sugjerohen metoda, forma dhe teknika të ndryshme:

- Mësimdhënie e drejtpërdrejtë (shpjegim, ushtrime praktike, ilustrime me shembuj).
- Mësimdhënie jo e drejtpërdrejtë (shqyrtim, zbulim, zgjidhje problemesh).
- Mësimdhënie me anë të pyetjeve.
- Mësimdhënie që nxit të menduarin kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve.
- Mësimdhënie dhe mësimnxënie nëpërmjet projekteve dhe punës kërkimore në terren.
- Mësimdhënie përmes vëzhgimit, demonstrimit, modelimit, eksperimentit, metodës empirike.
- Mësimdhënie dhe mësimnxënie përmes mjeteve multimediale dhe kompjuterit.
- Mësimdhënia që nxit hulumtimin.
- Mësimdhënia duke përdorur TIK.

Këto metoda nuk zbatohen në mënyrë të izoluar, por në situata të të nxënës dhe të vlerësimit të integruara njëra me tjetrën. Në të gjitha rastet zbatimi i metodave apo i teknikave shoqërohet me përdorimin e mjeteve dhe materialeve didaktike, pa të cilat nuk mund të arrihen rezultatet e pritshme.

Të nxënës me situata kontekstuale si metodologji mësimore

Të nxënës me situata si metodologji mësimore vë më shumë theksin tek konteksti dhe zbatimi i njohurive se sa te memorizimi i fakteve. Të nxënës në shkencat e natyrës fillon kur nxënës përpiqen të zgjidhin probleme dhe të eksplorojnë situata të jetës reale për të gjetur përgjigjet e pyetjeve që lindin.

Pikënisje për planifikimin e situatave të nxënës nga mësuesit janë rezultatet e të nxënës që synojnë kompetencat. Mësuesi saktëson rezultatet e pritshme të nxënësve të tij mbi bazën e kërkesave të kurrikulës së shkencave të natyrës. Për planifikimin e situatave mësuesi duhet të

marrë gjithashtu parasysh njohuritë paraprake të nxënësve. Këto janë kusht jo vetëm për përvetësimin e njohurive të reja, por dhe për të aftësuar nxënësit të përdorin njohuritë. Për këtë mësuesi ndërton situata duke u mbështetur në situata të nxëni reale ose të ngjashme me realitetin për çështje specifike globale, lokale ose personale të lidhur me shkencën.

Të nxënit sipas qasjes STEM

Qasja STEM si metodologji mësimore bazohet në një qasje praktike që nxit integrimin dhe zhvillimin e lëndëve shkencore dhe teknologjike në një kuadër të vetëm ndërdisiplinor me një qasje didaktike që garanton transversalitetin e procesit të mësimdhënies- nxënies përmes shkencës, teknologjisë, inxhinierisë dhe matematikës.

Zbatimi i qasjes STEM kërkon një lidhje të qëllimshme midis rezultateve të të nxënit të kurrikulës, standardeve, vlerësimeve, planifikimit dhe zbatimit të kurrikulës.

Objektivi kryesor i kësaj metodologjie është t'u sigurojë nxënësve kompetenca për të mësuarit eksperimental duke zhvilluar të menduarit kritik, zgjidhjen e problemeve, bashkëpunimin dhe inovacionin.

Zbatimi i qasjes STEM në mësimin e shkencave dhe teknologjisë gjithashtu i pajis individët me një sërë aftësish që i bën ata më të përgatitur për kërkesat e sotme të tregut të punës.

STEM si metodologji mësimore thekson:

- Punën në ekip për të zgjidhur problemet të botës reale përmes aktiviteteve mësimore praktike.
- Të mësuarit përmes kërkimit dhe eksperimentimit që nxit motivimin.
- Mësimdhënien kontekstuale për shkak të natyrës së saj shumëdisiplinore.
- Promovimin e kreativitetit me të cilin mund të zgjidhen problemet nga një këndvështrim kritik.

Siguria

Mësuesit janë përgjegjës për sigurinë e nxënësve gjatë veprimtarive në klasë, për nxitjen dhe motivimin e tyre për rregullat dhe përgjegjësitë e sigurisë. Ata planifikojnë gjithmonë veprimtari praktike të sigurta dhe u tregojnë nxënësve kushtet e sigurisë në përputhje me ato të bordit të shkollës dhe politikave të Ministrisë së Arsimit dhe të Sportit.

Gjatë veprimtarive në fushën e shkencës, nxënësit zbatojnë gjithmonë dhe në mënyrë të ndërgjegjshme rregullat e sigurisë në shkollë, klasë dhe jashtë tyre; identifikojnë paraprakisht kushtet në të cilat veprimtaria mund të mos jetë e sigurt dhe tregojnë se si mund të parandalohen

aksidentet në të gjitha rastet e mundshme; përdorin pajisjet laboratorike dhe instrumentet matëse sipas udhëzimeve; tregojnë vazhdimisht shqetësim për sigurinë e tyre dhe të tjerëve.

3.3.8 Udhëzime për vlerësimin

Vlerësimi është pjesë integrale e procesit të mësimdhënies dhe e të nxënit. Ai përfshin mbledhjen e informacioneve me anë të teknikave të ndryshme të vlerësimit për arritjen e rezultateve të pritshme të të nxënit të nxënësve në nivel klase. Me këtë informacion, mësuesi merr vendime për vlerësimin përfundimtar të nxënësve, bazuar në gjykimin e tij për nivelin e zotërimit të kompetencave të fushës së shkencave të natyrës nga ana e nxënësve. Vlerësimi u shërben mësuesve për të përmirësuar metodat e mësimdhënies, nxënësve për të përmirësuar të nxënit, si dhe prindërve për të monitoruar progresin e fëmijëvetë tyre në shkollë.

Vlerësimi mat shkallën e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve të dëshiruara. Ndërsa vlerësimi u shërben shumë qëllimeve, është e rëndësishme që mësuesi t'ia përshtatë llojin e vlerësimit, qëllimit specifik të synuar.

Është thelbësore që vlerësimi të jetë pjesë e procesit të mësimdhënies dhe e të nxënit. I gjithë procesi i të nxënit në shkencat e natyrës mbështetet në kërkimin shkencor, si i tillë edhe vlerësimi merr shumë forma.

Për vlerësimet me shkrim mësuesit duhet të përdorin situata të jetës reale që përfshijnë shkencën në jetën e përditshme, shoqëri dhe mjedis, si pikënisje për ndërtimin e pyetjeve në mënyrë që të pasqyrojnë zbatimin e njohurive shkencore në kontekste të jetës reale. Situatat e zgjedhura duhet të jenë domethënëse dhe tërheqëse. Përveç testeve me shkrim, mësuesit mund të kryejnë vlerësime të bazuara në performancën e nxënësve duke përdorur mënyrat e mëposhtme si:

- punët praktike;
- modelet dhe maketet;
- punët laboratorike;
- posterat;
- projektet kurrikulare dhe ndërlëndore;
- detyrat individuale;
- vrojtimit e mësuesve;
- lista e kontrollit;
- esetë.

Vlerësimi në bazë shkolle, si vlerësimi formues dhe vlerësimi përmbledhës duhet të përdoret për të siguruar një tablo të plotë të performancës dhe progresit të nxënësve, si dhe të efektivitetit të procesit të mësimdhënies dhe të të nxënës.

3.3.8 Materiale dhe burime mësimore

Një rol të rëndësishëm në procesin e të nxënës në shkencat e natyrës zënë mjetet mësimore. Ato kanë funksione të ndryshme si: informimi, motivimi, konkretizimi, demonstrimi, ilustrimi, plotësimi i të dhënave, shpjegimi i përmbajtjes mësimore, nxitja e aftësive të të menduarit kritik dhe krijues, zhvillimi dhe përsosja e aftësive, racionalizimi i kohës, bashkëveprimi nxënës - mësues etj. Ato duhet të sigurohen dhe të zgjidhen në sasinë dhe cilësinë e duhur. Në planin mësimor ditor ato planifikohen për çdo temë, vetëm se mësuesi duhet të njohë mirë metodikën e demonstrimit dhe të aktivizimit të nxënësve nëpërmjet tyre. Që këto mjete të jenë sa më funksionale në orën e mësimi, *duhet të plotësojnë disa kërkesa metodike, shkencore, psikologjike, estetike, teknike dhe ekonomike.*

Më poshtë janë dhënë disa nga mjetet më të përdorshme.

Materiale tekstuale: teksti shkollor, fletorja e punës, libri i mësuesit, udhëzuesi profesional, fjalorët, gazetatat, revistat, atlaset, materialet psikopedagogjike, enciklopeditë etj.

Mjetet pamore-dëgjimore: televizor, film, video, video-projektor, videokasetë, kompjuter, internet, teletekst, CD, email.

Mjedisi mësimor: klasa, laborator, kabinetet e punës, natyra, ferma etj.

Këto burime duhet të diskutohen dhe të vlerësohen nga mësuesit e departamentit të fushës së shkencave natyrore si një pjesë e planit të tyre për shkencën. Plani duhet të jetë i rëndësishëm për të përzgjedhur burimet e dyta, të cilat ndihmojnë për të mbështetur nxënësin në veprimtarinë e tij gjatë hulumtimit të kësaj fushe.

Integrimi i TIK-ut në kurrikul

TIK-u përdoret në mësimdhënie si metodologji dhe si mjet në procesin mësimor, me qëllim rritjen e efikasitetit të orës mësimore. Nxënësit përdorin TIK-un për të gjetur, prodhuar, krijuar, prezantuar, analizuar dhe shkëmbyer informacione nëpërmjet kompjuterit dhe internetit. Integrimi i teknologjisë dhe përdorimi i burimeve të reja digjitale inkurajon shkëmbimin e ideve, krijimin e projekteve, zgjidhjen e problemeve, si dhe ndihmon përmirësimin e aftësive

të mendimit krijues nëpërmjet një qasjeje më moderne dhe inovatore gjatë mësimdhënies. Përmes përdorimit të pajisjeve digjitale nxënësit mund të eksplorojnë dhe të perceptojnë konceptet abstrakte si dhe zbulojnë marrëdhënien ndërmjet koncepteve, dukurive dhe ligjeve.

Platformat interaktive në shkencat e natyrës

Platformat interaktive në mësimdhënien dhe nxënien e shkencave të natyrës ofrojnë mjedise digjitale me aplikacione, software, video-lojëra, simulime interaktive, dhe materiale multimediale. Këto mjedise ndihmojnë në lehtësimin e procesit të nxënësve, duke rritur aftësinë e nxënësve për të eksploruar dhe perceptuar saktë konceptet abstrakte.

Platformat interaktive gjithashtu nxisin interesin e nxënësve dhe inkurajojnë gjithëpërfshirjen, ndërveprimin, të menduarin kritik dhe krijues, si dhe promovojnë punën kërkimore shkencore. Qëllimi është që nxënësit të kuptojnë thellësisht kontekstin e konceptit, duke hulumtuar dhe zbuluar dukuritë natyrore, duke bërë të padukshmen të dukshme. Kjo qasje inkurajon nxënësit të mësojnë në një mënyrë më të pavarur dhe të angazhohen në një mësim më efektiv dhe produktiv.

3.4 Fusha e të nxënësve: Shkencat shoqërore

3.4.1 Hyrje

Fusha “Shkenca shoqërore” u krijon nxënësve mundësitë të zhvillojnë kompetencat e nevojshme për të përmbushur rolin e tyre si anëtarë të një shoqërie shumë kulturore dhe demokratike në një botë gjithnjë e më të ndërvarur.

Përmes kësaj fushe nxënësit zhvillojnë bazat e qytetarisë duke siguruar kuptimin e ligjshmërisë, të proceseve ekonomike, shoqërore, kulturore dhe të çështjeve që lidhen me to; zhvillojnë konceptin e kohës, të vazhdimësisë dhe të ndryshimit në këndvështrimin e marrëdhënieve historike dhe zbatojnë këtë kuptim në analizën e pasojave të veprimeve individuale dhe kolektive në shoqëri, në të kaluarën dhe sot; zhvillojnë këndvështrimin e tyre hapësinor për botën, për kompleksitetin dhe ndërvarësinë e vendeve dhe të rajoneve në botë.

Fusha “Shkenca shoqërore” integron njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera nëpërmjet lëndëve të tilla, si: Histori, Gjeografi, Shkenca sociale (*Qytetari, Sociologji, Psikologji, Filozofi*) dhe Ekonomi. Format e integritit ndryshojnë në varësi të niveleve moshore, tematikave dhe çështjeve të ndryshme.

Lëndët e fushës “Shkenca shoqërore” i aftësojnë nxënësit të luajnë rolin e tyre në jetë dhe në shoqëri, si ruajtës të parimeve të një shoqërie demokratike, si trashëgimtarë të shumë kulturave

dhe si anëtarë të një bote ekonomikisht të ndërruar dhe me kultura të ndryshme që jetojnë në harmoni, duke respektuar identitetin e njëra-tjetrës. Zhvillimi i një sërë konceptesh të kësaj fushe u krijon nxënësve mundësi të analizojnë informacionin në mënyrë kritike, të shpjegojnë lidhjet shkak-pasojë, të përdorin burimet për të dhënë shpjegime të arsyetuara dhe të argumentuara. Nëpërmjet kësaj fushe nxënësit aftësohen gjithashtu të vlerësojnë pasojat e ndërveprimit të shoqërisë me mjedisin për të ndërmarrë veprime që mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm.

Përvojat mësimore të kësaj fushe të nxëni në arsimin e mesëm të lartë i shërbejnë formësimit të identitetit personal, shoqëror, kombëtar e kulturor, nëpërmjet përmbushjes së kompetencave lëndore dhe kompetencave kyçe evropiane për të nxënit gjatë gjithë jetës.

3.4.2 Qëllimet e fushës

Fusha “Shkenca shoqërore” synon që nxënësit:

- të aftësohen për t’u bërë qytetarë aktivë dhe të përgjegjshëm në dimension lokal, kombëtar, rajonal, evropian e global, duke ndërtuar identitetin individual dhe kolektiv përmes njohjes së trashëgimisë së tyre historike të përbashkët;
- të zhvillojnë vlerat themelore të qytetarisë si tolerancën, mirëkuptimin, të drejtat e njeriut dhe demokracinë;
- të zhvillojnë bazat e qytetarisë duke siguruar kuptimin e ligjshmërisë, të proceseve politike, ekonomike, shoqërore, kulturore dhe të çështjeve që lidhen me to, përmes studimit të gjithë përvojës njerëzore;
- të aftësohen për të ndërvepruar me individë dhe grupe individësh të kulturave të ndryshme, për të njohur të kaluarën, për të kuptuar ndërveprimin e saj me të sotmen dhe me perspektivat e së ardhmes, duke nxënë, analizuar dhe menduar në mënyrë kritike;
- të kuptojnë zhvillimin e personalitetit të tyre, mënyrën si ngjasojnë dhe diferencohen nga të tjerët në raport me kohën dhe me hapësirën, të dallojnë diferencën midis supozimit dhe faktit, të kuptojnë kompleksitetin e çështjes historike, të mos besojnë në përgjigjen e paargumentuar dhe të respektojnë përpikmërinë e burimeve historike;
- të zhvillojnë këndvështrimin e tyre hapësinor për botën, për kompleksitetin dhe ndërrarësinë ndërmjet aspekteve fizike dhe humane të rajoneve e vendeve në botë;
- të vlerësojnë pasojat e ndërveprimit të shoqërisë me mjedisin për të ndërmarrë veprime që mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm;
- të zotërojnë shkathtësinë e kërkimit, interpretimit, organizimit të njohurive dhe të

komunikimit të tyre në mënyra të ndryshme;

- të përdorin TIK-un, për të kërkuar informacion për të shkuarën në lidhje me datat, personazhet, objektet, ngjarjet dhe proceset historike, si dhe për të përzgjedhur, klasifikuar, organizuar dhe paraqitur gjetjet;
- të zotërojnë aftësitë e arsytimit filozofik dhe t'i përdorin ato për të marrë vendimet e jetës së përditshme në fushat e veprimtarisë jetësore.

3.4.3 Tematikat e fushës dhe përshkrimi i tyre

Tematikat e përbashkëta të fushës shërbejnë si instrument i fuqishëm integruar në funksion të zhvillimit të kompetencave të fushës. Ndonëse secila prej tyre përshkruhet veçmas, ato shpesh kanë elemente të ndërthurura në funksion të zhvillimit të kompetencave.

Proceset shoqërore

Proceset shoqërore përfshijnë zhvillimet dhe ndryshimet që ndodhin në jetën shoqërore në mjedisin ku jeton, në nivel vendor, rajonal dhe global. Këto procese ndodhin në të gjitha fushat e jetës dhe të veprimtarisë shoqërore (fusha ekonomike, politike, shoqërore, ligjore, kulturore etj.) dhe, në korrelacion me njëra-tjetrën, ndikojnë jetën tonë dhe të shoqërisë. Njohja e këtyre proceseve, e ligjshmërisë dhe e lidhjeve shkak-pasojë është domosdoshmëri për vendimmarrjet tona dhe për shkallën tonë të lirisë në këtë proces vendimmarrjeje. Vetëm në këtë bazë, pjesëmarrja qytetare do të jetë e përgjegjshme, e vetëdijshme, aktive dhe orientuar nga e ardhmja dhe zhvillimi i qëndrueshëm.

Tematika, e emërtuar “Proceset natyrore dhe shoqërore” në lëndën e gjeografisë, zhvillon te nxënësit njohuri, shkathtësi dhe qëndrime në lidhje me kompleksitetin dhe dinamikën e proceseve dhe dukurive fiziko-gjeografike që ndodhin në Tokë. Nxënësi aftësohet të zbulojë dhe argumentojë lidhjet shkak-pasojë të dukurive dhe proceseve që ndodhin në sistemet natyrore të planetit tonë, të zhvillojë aftësi të kërkimit gjeografik përmes hulumtimit të tipareve dhe veçorive të sistemeve të Tokës, si dhe të bëjë gjykime e zhvillojë qëndrime në lidhje me perspektivat mjedisore.

Kronologjia, ndryshimi dhe vazhdimësia

Duke studiuar të kaluarën dhe trashëgiminë e saj nxënësit kuptojnë konceptet kyçe historike, si kronologjia, ndryshimi dhe vazhdimësia, lidhjet shkak- pasojë, shumëllojshmëria kulturore etnike dhe fetare, rëndësinë dhe perspektivat, në lidhje me historinë e Shqipërisë dhe historinë e qytetërimeve botërore. Kuptimi i kronologjisë i aftëson nxënësit të kuptojnë vijimësinë e ngjarjeve në të kaluarën dhe marrëdhënien shkak-pasojë. Nxënësit kuptojnë rolin e kohës në

ndryshueshmërinë e njerëzve, shoqërisë dhe mjedisit, njohin disa nga ndryshimet më të rëndësishme, që kanë ndodhur, duke filluar nga elementet e jetës së përditshme e deri në ndryshimet shoqërore, ekonomike, kulturore që kanë formësuar botën.

Ndërvarësia midis njerëzve, vendeve dhe mjediseve

Përmes kësaj tematike nxënësit zhvillojnë këndvështrimin e tyre hapësinor për botën, kuptojnë vendndodhjen e njerëzve, të vendeve, rajoneve dhe burimeve, si dhe përshkruajnë arsytet e kësaj vendndodhjeje. Nxënësit eksplorojnë si kanë ndikuar dhe ndikojnë ngjarjet historike, faktorët fizikë dhe humanë në zhvillimin vendor, rajonal, kombëtar dhe global. Ato vëzhgojnë dhe debatojnë rreth pasojave sociale dhe ekonomike të ndryshimeve mjedisore dhe propozojnë krahasojnë e vlerësojnë alternativat e përdorimit të burimeve natyrore në komunitete, rajone, kombe dhe në botë.

Tematika “Ndërvarësia midis njerëzve, vendeve, rajoneve dhe mjediseve” ka në fokusin e saj studimin e aspekteve të ndryshme gjeografike, sociale, ekonomike, kulturore, mjedisore të rajoneve, duke identifikuar marrëdhëniet komplekse mes këtyre elementeve. Përmes analizës së shpërndarjes hapësinore të dukurive, nxënësit aftësohen të kuptojnë marrëdhëniet komplekse dhe ndërvarësinë ndërmjet rajoneve, në nivel lokal dhe global. Me fokus dimensionin hapësinor të zhvillimeve globale, tematika ofron një perspektivë të gjerë dhe një kuptim më të thellë të ndryshimeve dhe sfidave që përfshijnë rajonet e botës, të tilla, si ndryshimet klimatike, urbanizimi, lëvizjet migruese, shfrytëzimi i burimeve natyrore etj., duke ndihmuar nxënësit të përgatiten për të kuptuar dhe për të kontribuar në zgjidhjen e sfidave komplekse globale dhe lokale. Kjo i ndihmon ata të mësojnë se si të kontribuojnë në zgjidhjen e këtyre sfidave në komunitetin e tyre dhe në nivel më të gjerë. Grumbullimi dhe përpunimi i fakteve, përmes shfrytëzimit të burimeve të ndryshme, përdorimit të teknologjisë, përdorimit të metodave statistikore, prezantimit grafik të tyre dhe interpretimit, mund të kthehen në një burim të vlefshëm të të mësuarit përgjatë tematikës.

Individët, grupet, shoqëria

Nxënësit kuptojnë mënyrën si formohen, ruhen dhe ndryshojnë marrëdhëniet shoqërore. Nxënësit njihen me shumëllojshmërinë kulturore, etnike dhe fetare të shoqërive të ndryshme dhe kuptojnë se si përvojat, idetë, vlerat dhe besimit e ndryshme të njerëzve dhe të shoqërive në të shkuarën kanë formësuar botën ku ne jetojmë. Ata dallojnë dhe shpjegojnë rolin dhe ndikimin e ndryshëm që kanë në shoqëri lloje dhe forma të caktuara institucionesh socializuese

si: familja, shkolla, organizatat qytetare, arsimore, qeveritare dhe fetare dhe shqyrtojnë ndikimin e tyre në jetën e njerëzve. Ata studiojnë larminë e marrëdhënieve midis individëve dhe grupeve në shoqëri, eksplorojnë faktorët që qëndrojnë në themel të tyre, mënyrën si funksionojnë dhe ndryshojnë.

Nxënësit marrin vendime mbi bazën e njohurive të fituara në nivele të ndryshme shkollimi, për qëndrime e sjellje të ndryshme që kanë lidhje me jetën dhe bashkëjetesën paqësore në shoqëri.

Kultura

Nxënësit kuptojnë si qeniet njerëzore krijojnë, mësojnë, ndajnë së bashku dhe përshtaten ndaj kulturës. Njohja e historisë, kulturave dhe grupeve të ndryshme shoqërore i ndihmon nxënësit të vlerësojnë dhe të respektojnë pakicat kombëtare dhe diversitetin shoqëror. Ata vlerësojnë rolin e kulturës në formimin e jetës dhe të shoqërisë ku jetojnë, si dhe jetës dhe shoqërisë së të tjerëve, si dhe marrin vendime mbi bazën e njohurive për kulturën në faza të ndryshme të shkollimit të tyre në emër të respektimit të diversitetit kulturor dhe të bashkëjetesës paqësore ndërmjet njerëzve dhe kulturave.

Prodhimi, shpërndarja dhe konsumi

Përmes kësaj tematike nxënësit fitojnë njohuri për mënyrën si njerëzit organizojnë prodhimin, shpërndarjen dhe konsumin e të mirave dhe të shërbimeve dhe njihen e kuptojnë çështjet themelore që lidhen me vendimet në fushën e veprimtarisë ekonomike. Ata njihen, në përputhje me nivelin e shkollimit dhe të kurrikulës, me konceptet kryesore ekonomike dhe rëndësinë që ka njohja e tyre për jetën e tyre dhe të shoqërisë, si dhe si ka ndryshuar ekonomia e shteteve përgjatë periudhave historike, krizat ekonomike etj. Në këtë mënyrë, mundësohet edhe realizimi i kompetencës ekonomike, që nënkupton njohuri për funksionimin e botës ekonomike dhe aftësi për të vepruar me mençuri në këtë botë.

Pushteti, autoriteti, qeverisja

Përmes kësaj tematike, nxënësit fitojnë dije dhe ndërtojnë njohuri për rregullat e jetës kolektive e kushtet demokratike për zbatimin e tyre, si dhe për mundësitë që ekzistojnë në një shoqëri demokratike në të gjitha nivelet e jetës politike. Nxënësit vlerësojnë ndryshimet që kanë pësuar në kohë institucionet fetare, ligjore, drejtuese dhe qeverisëse. Ata ndërtojnë njohuri për institucionet publike demokratike dhe për rregullat e lirisë dhe të vepruarit, si dhe ndërgjegjësohen për faktin se ndërtimi i institucioneve demokratike dhe gëzimi i këtyre lirive është përgjegjësi e të gjithë qytetarëve.

Idealet dhe praktikat e qytetarisë

Përmes kësaj tematike nxënësit kuptojnë idealet dhe praktikat e qytetarisë dhe rëndësinë e tyre për pjesëmarrjen e plotë dhe aktive në shoqëri, si një ndër objektivat qendrorë të edukimit për qytetari demokratike. Përmes kësaj tematike, nxënësve duhet t'u jepet mundësia t'u përgjigjen pyetjeve të tilla, si: Çdo të thotë pjesëmarrje dhe si mund të përfshihem në të? Si është zhvilluar koncepti i qytetarisë? Cili është raporti ndërmjet të drejtave dhe përgjegjësi? Cili është roli i qytetarëve në komunitetin dhe vendin ku jetojnë dhe si pjesëtar i komunitetit botëror? A mundem unë të ndryshoj diçka në botën ku jetojmë dhe si mund ta realizoj atë? Si të arrij që ndryshimet e mia të jenë pozitive?

Arsyetimi filozofik

Përmes kësaj tematike synohet që nxënësit të zotërojnë aftësitë e arsyetimit filozofik dhe t'i përdorin ato për të marrë vendimet e jetës së përditshme në fushat e veprimtarisë jetësore. Kjo tematikë do t'i ndihmojë ata të kuptojnë lidhjen e pikëpamjeve filozofike, etike, politike etj. me realitetet e ndryshme ekonomike, shoqërore, kulturore e shkencore dhe t'i përdorin këtë të kuptuar tablonë e jetës reale përtej dukjes së saj dhe për procesin e vendimmarrjes e tyre në jetën e përditshme; të dallojnë dhe të respektojnë pikëpamjet e kundërta ose të ndryshme në historinë e mendimit filozofik, fetar, politik etj.; të vlerësojnë kufizimet dhe vlerat e filozofëve, mendimtarëve, rrymave, pikëpamjeve në kuadrin e kohës dhe të hapësirës etj.

Sjellja e shëndetshme

Përmes kësaj tematike nxënësi, duke u mbështetur në të dhënat e shkencave të tjera, kryesisht të biologjisë, studion ndryshimet kryesore psikologjike, intelektuale dhe shoqërore që e shoqërojnë atë nga fëmijëria deri në jetën e rritur. Kjo tematikë i jep atij mundësinë të njohë dhe të dallojë trysninë e mjediseve të ndryshme për të vepruar në mënyrë të rrezikshme ose të paligjshme dhe kërkon ndihmë për t'i rezistuar kësaj trysnie. Ai aftësohet të bëjë zgjedhjet e duhura dhe të marrë vendimet e duhura jo vetëm në interes të tij por edhe të shëndetshme për të tjerët.

Përshkrimi i kompetencave që zhvillon fusha

Procesi i të nxënit në fushën “Shkencat shoqërore”, ka në fokus zhvillimin e kompetencave kyç evropiane për të nxënit gjatë gjithë jetës të mëposhtme:

- *Kompetenca e komunikimit në gjuhën amtare;*
- *Kompetenca e komunikimit në gjuhë të huaja;*
- *Kompetenca në matematikë, shkencë, teknologji dhe inxhinieri;*
- *Kompetenca digjitale;*
- *Kompetenca personale, shoqërore dhe e të nxënit;*

- *Kompetenca qytetare;*
- *Kompetenca e sipërmarrjes;*
- *Kompetenca për vetëdijen dhe shprehjen kulturore.*

Këto kompetenca i përgatitësin ata për të zhvilluar aftësitë që i nevojiten qytetarit të shekullit XXI, për t'u përshtatur me ndryshimet, risitë teknologjike, nevojat dhe marrëdhëniet e reja në tregun e punës, për të jetuar, për të punuar dhe për të marrë pjesë në mënyrë të efektshme dhe konstruktive në një shoqëri globale gjithnjë e më komplekse.

Kompetenca personale, shoqërore dhe e të nxëniet, kompetenca për vetëdijen dhe shprehjen kulturore, kompetenca e sipërmarrjes dhe kompetenca qytetare, të cilat zhvillohen më së shumti në këtë fushë i përgatit individët për të kuptuar vlerat e përbashkëta Evropiane, vetëdijen për diversitetin dhe identitetet kulturore, vetëdijen për politikën lëvizjet shoqërore dhe për sistemet e qëndrueshme, në mënyrë të veçantë, krizat ekonomike, politike, ndryshimet klimatike dhe demografike në nivel global dhe shkaqet e tyre.

Nxënësi vlerëson rëndësinë që kanë këto kompetenca për të motivuar pjesëmarrjen e efektshme me të tjerët në jetën publike dhe për t'u solidarizuar në zgjidhjen e problemeve që lidhen me komunitetin lokal dhe më gjerë. Ai kupton që kompetenca qytetare bazohet në njohuritë historike për ngjarjet dhe prirjet themelore të zhvillimit të historisë së njerëzimit dhe asaj kombëtare, zhvillohet në njohuritë, në ligjësitë dhe konceptet themelore të demokracisë, të drejtësisë, të barazisë, të respektimit të parimeve të qytetarisë digjitale dhe të të drejtave të njeriut.

Nxënësi përdor konceptin e kohës dhe të hapësirës në të gjitha gjykimet dhe vendimmarrjet e tij në fushën e historisë, shoqërisë, filozofisë etj. Nxënësi zhvillon këndvështrimin e tij hapësinor për botën, kupton vendndodhjen e njerëzve, të rajoneve, të vendeve si dhe të burimeve dhe shpjegon arsyen e kësaj vendndodhjeje. Nxënësi eksploron konceptet themelore gjeografike dhe marrëdhëniet ndërmjet qenieve njerëzore me mjedisin. Nxënësi pranon rëndësinë që ka kompetenca qytetare për reflektimin kritik e krijues dhe për pjesëmarrjen konstruktive në veprimtaritë e komunitetit ose të fqinjësisë si dhe në proceset e vendimmarrjes, veçanërisht përmes votimit, në nivel vendor, kombëtar dhe Evropian.

Nxënësi kupton mënyrën si individët mund të sigurojnë shëndetin e tyre më të mirë mendor, intelektual e fizik, në shërbim të vetes, të familjes dhe të mjedisit të tyre shoqëror. Ata njohin lidhjen e mënyrës së shëndetshme të jetesës me zhvillimin e tyre tërësor dhe veprojnë për të realizuar atë. Nxënësi njeh konceptet themelore që lidhen me individët, grupet etj. me

barazinë dhe mos diskriminimin gjinor, me shoqërinë dhe kulturën. Ai kupton dhe merr vendime mbi bazën e të kuptuarit të dimensioneve shumë kulturorë, ekonomike, ligjore, politike e shoqërore të shoqërisë Evropiane si dhe të ndërveprimit të identitetit kulturor kombëtar me atë Evropian e më gjerë.

Nxënësi komunikon në mënyrë konstruktive në mjedise të ndryshme dhe shfaq aftësinë për tolerancë, për të shprehur dhe kuptuar këndvështrimet e ndryshme, për të negociuar, për të krijuar besim dhe për të kuptuar ndjenjat dhe qëndrimet e të tjerë.

Nxënësi është i vetëdijshëm që kompetenca bazohet në ndjenjën e integritetit, të bashkëpunimit, të pohimit të vetvetes pa përjashtuar tjetrin. Ai vlerëson diversitetin, respekton të tjerët dhe përgatitet për të kapërcyer paragjykimet dhe për të arritur kompromise.

Zhvillimit i kompetencave kyçe evropiane nëpërmjet lëndës së qytetarisë, historisë dhe gjeografisë u krijojnë mundësi nxënësve të zhvillojnë aftësitë e mendimit kritik dhe krijues, zgjidhjes së problemit duke u bërë individë të ditur, të logjikshëm, të organizuar, kureshtarë, të balancuar, të ndjeshëm, sipërmarrës dhe të aftë për të dhënë argumente dhe për të marrë vendime të arsyetuara.

Procesi i të nxënit në fushën “Shkenca shoqërore”, ka në fokus kryesisht zhvillimin e kompetencës shoqërore dhe qytetare, si një ndër kompetencat kyçe, si dhe të kompetencave të tjera.

Kjo kompetencë përbëhet nga kompetencat personale, ndërpersonale dhe ndërkulturore që përfshijnë dhe lidhen me të gjitha qëndrimet që përgatitin individët për të marrë pjesë në mënyrë të efektshme dhe konstruktive në jetën dhe punën shoqërore dhe, në mënyrë të veçantë, në shoqëritë gjithnjë e më të larmishme, për të zgjidhur konfliktet, kur kjo është e nevojshme.

Kompetenca shoqërore dhe qytetare i përgatit individët për të marrë pjesë plotësisht në jetën qytetare, duke u bazuar në njohuritë për konceptet dhe strukturat shoqërore, ekonomike, politike etj., dhe për t’iu përkushtuar pjesëmarrjes aktive e demokratike.

- Nxënësi njeh dhe pranon rëndësinë që ka zhvillimi i kompetencave të qytetarisë për t’u përgatitur që të marrë pjesë plotësisht në jetën qytetare, duke u bazuar në njohuritë për konceptet dhe strukturat shoqërore dhe politike dhe për t’iu përkushtuar pjesëmarrjes aktive e demokratike.
- Nxënësi argumenton rëndësinë që ka kompetenca shoqërore dhe qytetare për të motivuar pjesëmarrjen e efektshme me të tjerët në jetën publike dhe për t’u solidarizuar në zgjidhjen

e problemeve që lidhen me komunitetin lokal dhe më gjerë.

- Nxënësi argumenton që kompetenca shoqërore dhe qytetare zhvillohet duke bazuar në njohuritë për ligjësitë dhe konceptet themelore të demokracisë, të drejtësisë, të barazisë, të qytetarisë dhe të të drejtave të njeriut.
- Nxënësi argumenton që kompetenca shoqërore dhe qytetare bazohet në njohuritë historike për ngjarjet dhe prirjet themelore të zhvillimit të historisë së njerëzimit dhe asaj kombëtare, në njohuritë për ligjësitë dhe ngjarjet bashkëkohore dhe në prirjet për të ardhmen.
- Nxënësi përdor konceptin e kohës dhe të hapësirës në të gjitha gjykimet dhe vendimmarrjet e tij në fushën e historisë, shoqërisë, filozofisë etj.
- Nxënësi zhvillon këndvështrimin e tij hapësinor për botën, kupton vendndodhjen e njerëzve, të rajoneve e të vendeve, si dhe të burimeve dhe shpjegon arsyen e kësaj vendndodhjeje. Nxënësi zhvillon shkathtësitë gjeografike dhe eksploron konceptet themelore gjeografike, si dhe marrëdhëniet ndërmjet qenieve njerëzore me mjedisin.
- Nxënësi pranon rëndësinë që ka kompetenca shoqërore dhe qytetare për reflektimin kritik e krijues dhe për pjesëmarrjen konstruktive në veprimtaritë e komunitetit ose të fqinjësisë, si dhe në proceset e vendimmarrjes, veçanërisht përmes votimit, në nivel vendor, kombëtar dhe evropian.
- Nxënësi kupton mënyrën si individët mund të sigurojnë shëndetin e tyre më të mirë mendor, intelektual e fizik, në shërbim të vetes, të familjes dhe të mjedisit të tyre shoqëror. Ata njohin lidhjen e mënyrës së shëndetshme të jetesës me zhvillimin e tyre tërësor dhe veprojnë për të realizuar atë.
- Nxënësi njeh konceptet themelore që lidhen me individët, grupet etj., me barazinë dhe mosdiskriminimin gjinor, me shoqërinë dhe kulturën. Ai kupton dhe merr vendime mbi bazën e të kuptuarit të dimensioneve shumëkulturore, ekonomike, ligjore, politike e shoqërore të shoqërisë evropiane, si dhe të ndërveprimit të identitetit kulturor kombëtar me atë evropian e më gjerë.
- Nxënësi komunikon në mënyrë konstruktive në mjedise të ndryshme dhe shfaq aftësinë për tolerancë, për të shprehur dhe kuptuar këndvështrimet e ndryshme, për të negociuar, për të krijuar besim dhe për të kuptuar ndjenjat dhe qëndrimet e të tjerëve.
- Nxënësi zhvillon vetëdijen për qëllimet, vlerat dhe lëvizjet politike në nivel kombëtar dhe evropian, si dhe vetëdijen për diversitetin dhe identitetet kulturore në Evropë.

3.4.4 Rezultatet e të nxënës

Në tabelën e mëposhtme, përshkruhen rezultatet e të nxënës, të cilat nxënës duhet t'i arrijnë në mënyre progresive dhe të vazhdueshme, gjatë arsimit të mesëm të lartë, sipas secilës tematikë.

Rezultatet e të nxënës në përfundim të klasës së 12-të
1. Proceset shoqërore
Nxënësi: - Vlerëson që historia e qytetërimit është një tërësi ngjarjesh e personazhesh, që merr vlerën e shkencës humane kur ndërtohet mbi bazën e shumëllojshmërisë së burimeve historike, duke ruajtur linjën kronologjike. - Analizon ligjësitë themelore të organizimit, të funksionimit dhe të zhvillimit të shoqërisë shqiptare. - Analizon ngjarjet dhe personalitetet që i dhanë tiparet kryesore, përshpejtuan dhe thelluan proceset politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore në periudha të ndryshme historike të popullit shqiptar. - Vlerëson ndikimin e ndërsjellë të kulturave dhe të ngjarjeve historike të popullit shqiptar me ato të popujve të tjerë rajonalë dhe më tej. - Shfrytëzon rolin pragmatik të historisë për të shpjeguar zhvillimet e sotme dhe për të bërë prognoza për zhvillimet e ardhshme të shoqërisë shqiptare. - Respekton dhe vlerëson identitetin dhe rrënjët historike, të cilave iu përket. - Analizon dhe vlerëson kushtet, etapat dhe tiparet themelore të zhvillimit të qytetërimit antik ilir si dhe ndërveprimin e tij me qytetërimet e njëkohshme fqinje. - Analizon dhe vlerëson kushtet, etapat dhe tiparet themelore të zhvillimit të qytetërimit mesjetar arbëror. - Dëshmon vazhdimësinë dhe ndikimin e qytetërimit Ilir në qytetërimin Arbëror, si dhe ndërveprimin me qytetërimin Bizantin. - Analizon ndryshimet ekonomike, politike, shoqërore dhe fetare të shqiptarëve nën sundimin osman dhe do të evidentojë qëndrimin e shqiptarëve ndaj tij. - Analizon Rilindjen Kombëtare shqiptare si një lëvizje me karakter kulturor, arsimor dhe politik, e cila solli zgjimin kombëtar të shqiptarëve, si parakusht i domosdoshëm për shpalljen e pavarësisë. - Vlerëson ngjashmëritë dhe ndryshimet e etapave, përmes të cilave kaluan shteti dhe

shoqëria shqiptare në periudhën bashkëkohore 1912 – sot dhe do të gjykojë për perspektivat e shtetit dhe të shoqërisë shqiptare në të ardhmen.

- Shpjegon gjendjen ekonomike, politike e shoqërore të shqiptarëve në ish-Jugosllavi e në Greqi, duke analizuar të përbashkëtat dhe ndryshimet në politikat e shteteve përkatëse ndaj tyre dhe vlerëson krijimin e shtetit të pavarur të Kosovës.
- Shpjegon mënyrën e organizimit shoqëror, ekonomik, politik dhe kulturor të qytetërimeve në periudhën antike, mesjetare, moderne dhe bashkëkohore, duke evidentuar tiparet e përbashkëta, veçantitë e tyre, rëndësinë dhe rolin që ato kanë në zhvillimet e mëvonshme historike.
- Vlerëson ngjarjet në historinë e qytetërimit botëror, në mënyrë që të kuptojë jetën dhe ngjarjet e së shkuarës, si dhe lidhjen e tyre me të tashmen dhe me të ardhmen.
- Analizon ngjarjet, personalitetet, proceset politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore në periudha të ndryshme të historisë së qytetërimeve botërore.
- Analizon kushtet, etapat dhe tiparet themelore të zhvillimit të qytetërimit antik dhe vlerëson trashëgiminë e këtyre qytetërimeve sot.
- Vlerëson ndryshimet rrënjësore, që shkaktuan revolucionet politike, industriale dhe ideologjike në qytetërimin evropian dhe botëror dhe gjykon për ndikimin e këtyre ndryshimeve në qytetërimin e mëvonshëm.
- Analizon dhe vlerëson ndryshimet rrënjësore në jetën ekonomike, politike, shoqërore, humane, kulturore, shkencore dhe fetare që sollën fillimin e botës moderne dhe argumenton ndikimin e këtyre arritjeve në qytetërimin bashkëkohor.
- Analizon shkaqet e fillimit të Luftërave Botërore, do të gjykojë për pasojat e paqes së gabuar të arritur në përfundim të luftës së parë botërore dhe vlerëson trashëgiminë e luftërave botërore në jetën ekonomike, politike dhe shoqërore të qytetërimit botëror.
- Shpjegon natyrën dhe shkaqet e konflikteve si dhe rrugët e bashkëpunimit ndërmjet vendeve dhe popujve, si faktorë me ndikim në çështjet kombëtare, etnike, racore, kulturore apo fetare, duke përfshirë ndikimin e këtyre faktorëve në dy luftërat botërore, holokaustin dhe rolin e institucioneve ndërkombëtare në zgjidhjen e konflikteve.
- Analizon arsyet e bipolarizimit të botës në përfundim të Luftës së Dytë Botërore, pasojat e tij në zhvillimet politike, ekonomike e shoqërore dhe në prirjet e zhvillimeve të mëvonshme.
- Analizon proceset dhe ndryshimet e mëdha që ndodhën pas Luftës së Dytë Botërore deri

në ditët e sotme.

- Vlerëson dhe gjykon mbi revolucionin teknologjik sot në botë.
- Shpjegon si proceset ekonomike, shoqërore, kulturore dhe politike ndikojnë ndërvarësinë dhe bashkëpunimet në nivel rajonal dhe global.
- Shpjegon lidhjet mes periudhave e shoqërive të ndryshme, respekton origjinën historike dhe vlerëson dobinë e larmisë etnike dhe kulturore të shoqërisë.
- Respekton ndërvarësinë shoqërore, politike, ekonomike e kulturore në shoqërinë globale, duke vlerësuar njëkohësisht trashëgiminë materiale, kulturore e shpirtërore të tyre.
- Interpretin pasojat e ndërveprimeve midis sistemeve fizike dhe humane.
- Interpretin marrëdhëniet ndërmjet komponentëve të gjeosistemeve, ndërveprimin e tyre me aktivitetin njerëzor dhe rrjedhojat e këtij ndërveprimi.

2. Kronologjia, ndryshimi dhe vazhdimësia

Nxënësi:

- vendos në kohë dhe në hapësirë ngjarjet, proceset dhe figurat historike;
- rendit dhe krahason veçoritë e ngjarjeve historike brenda të njëjtës periudhë apo periudhave të ndryshme historike;
- shpjegon e analizon jetën dhe ngjarjet e së shkuarës, lidhjen e tyre me të tashmen dhe me të ardhmen, si dhe ndërvarësinë ndërmjet tyre sipas kronologjike;
- argumenton opinion dhe qëndrimin e vet mbi një ngjarje, proces apo figurë historike;
- analizon arsyet dhe rezultatet e ngjarjeve dhe ndryshimeve historike duke shpjeguar pasojat në përfundimin e ngjarjeve;
- analizon ngjarjen, fenomenin ose personazhin historik për të përcaktuar ose për të përkufizuar konceptin historik;
- argumenton vlerat e trashëgimisë historike, duke e vlerësuar këtë trashëgimi si pjesë e përcaktimit të identitetit të një populli;
- bën punë kërkimore për studimin e ngjarjeve të ndryshme të historisë, duke u bazuar në burime alternative historike;
- përgatit, prezanton dhe komunikon një çështje historike nëpërmjet medieve të ndryshme mësimore si: flipchart, ëallchart, poëer point, albume, postera, referate, ese, video projektor, CD, DVD etj.;
- përdor saktë datat, termat dhe fjalorin kronologjik për ndërtimin dhe shpjegimin e ngjarjeve historike;

- ndërton linjën e kohës duke vendosur në të, periudhat dhe ngjarjet e rëndësishme historike;
- krijon një tabelë kronologjike të periudhave historike, duke e pasuruar atë në vazhdimësi me informacionin e ri;
- vlerëson si përvojat e paraardhësve kanë ndikuar në botën e pasardhësve, si dhe shpjegojnë si historia e Shqipërisë ose e çështjeve të ndryshme të saj, lidhen ose qëndrojnë në kontekstin e historisë rajonale dhe botërore (konteksti ballkanik, evropian, botëror, diaspora);
- shpjegon si njerëzit dhe shoqëritë e përfshira në të njëjtën ngjarje historike mund të kenë përvoja dhe pikëpamje të ndryshme për të njëjtën ngjarje historike;
- analizon jetën dhe ngjarjet e së shkuarës, lidhjen e tyre me të tashmen dhe me të ardhmen, si dhe ndërvlerësinë ndërmjet tyre, duke përfshirë historinë e shqiptarëve, historinë evropiane dhe atë botërore sipas linjës kronologjike;
- mban qëndrim të pavarur dhe argumentues ndaj informacioneve në përgjithësi dhe atyre mediatike në veçanti;
- ndërton hipotezën e tij (mban qëndrim) për argumentimin e një ngjarjeje historike, duke u bazuar në burime historike;
- mbledh dhe përzgjedh informacionin nga burime alternative historike, burime specifike nga tekste të ndryshme, burime dhe informacion nga teknologji të ndryshme të komunikimit dhe medies (p.sh.: të dhëna kompjuterike nga faqe të ndryshme interneti, programe TV dhe radio, burime audio dhe digjitale);
- përdor teknologjinë e informacionit si mjet burimor dhe si mjet komunikimi për të prezantuar informacionin historik.

3. Ndërvlerësia midis njerëzve, vendeve dhe mjediseve

Nxënësi:

- analizon rajonizimin gjeografik të Shqipërisë dhe veçoritë gjeografike të rajoneve në botë duke vlerësuar kompleksitetin dhe ndërvlerësinë;
- interpreton rolin e mjedisit fizik në jetën e rajoneve të ndryshme (popullsinë, vendbanimet, ekonominë, turizmin etj.);
- analizon ndikimin e shoqërisë njerëzore në cilësinë e mjediseve gjeografike të vendit tonë dhe në shfrytëzimin e burimeve natyrore;
- analizon dhe krahason tiparet fizike dhe humane të vendeve dhe rajoneve;

- interpreton veçoritë dalluese të popullsisë, ekonomisë, trashëgimisë natyrore dhe kulturore të vendeve dhe rajoneve, në nivel lokal dhe global;
- interpreton ngjarjet aktuale që ndodhin, duke i kuptuar ato në mënyrë kritike, për të bërë lidhjen e së sotmes me të shkuarën historike dhe me perspektivat e së ardhmes;
- dallon veçoritë e prirjeve historike sipas periudhave, të cilat sollën progresin e shoqërisë në shkallë kombëtare, evropiane dhe botërore;
- vlerëson lëvizjet e popullsisë dhe ndryshime që ato sollën në zhvillimet historike;
- përdor hartat, prezantimet grafike, mjetet gjeografike dhe teknologjinë për të gjetur dhe interpretuar informacionin rreth vendeve, shoqërisë dhe mjediseve të ndryshme;
- vlerëson ndikimin e shoqërisë njerëzore në përdorimin e burimeve natyrore, në ndryshimet klimatike dhe çështje të tjera të ndërlidhura me zhvillimin e qëndrueshëm;
- vlerëson mundësi dhe propozon alternativa të zgjidhjeve të qëndrueshme të sfidave mjedisore.

4. Pushteti, autoriteti, qeverisja

Nxënësi:

- shpjegon qëllimin e qeverisjes;
- analizon rrugën se si fitohet, ushtrohet dhe justifikohet pushteti;
- shpjegon idetë dhe mekanizmin që duhet për plotësimin e nevojave dhe dëshirave të qytetarëve, për të rregulluar territorin, për të menaxhuar konfliktet, për të vendosur rendin dhe sigurinë dhe balancën e koncepteve për një shoqëri të drejtë;
- vlerëson ndryshimet që kanë pësuar në kohë institucionet fetare, ligjore, drejtuese dhe qeverisëse;
- analizon mënyrën se si kombet dhe organizatat e ndryshme u përgjigjen konflikteve ndërmjet forcës së unitetit dhe të diversitetit;
- krahason sistemet e ndryshme politike (ideologjitë, strukturën, institucionet, proceset dhe kulturat politike) me sistemin shqiptar, referuar periudhave të ndryshme historike;
- analizon dhe vlerëson kushtet, veprimet dhe motivimet që ndihmojnë në konfliktet dhe bashkëpunimin brenda dhe ndërmjet kombeve;
- shpjegon dhe zbaton sistematikisht ide, teori dhe mënyra të hulumtimit të shkencave politike për shqyrtimin e çështjeve të rëndësishme dhe të problemeve shoqërore.

5. Prodhimi, konsumi dhe shpërndarja

Nxënësi:

- shpjegon pse pamjaftueshmëria e burimeve prodhuese (njerëzore, kapitale, teknologjike dhe natyrore) kërkon zhvillimin e sistemeve ekonomike që marrin vendimet për prodhimin dhe shpërndarjen e të mirave dhe shërbimeve;
- analizon rolin që luajnë kërkesa, oferta, çmimi, shpërblimi dhe fitimi, kosto etj., në prodhimin dhe shpërndarjen e të mirave dhe shërbimeve në një sistem konkurrues tregu e shpjegon marrëdhëniet ndërmjet tyre;
- shpjegon rëndësinë që ka kosto dhe fitimi për shpërndarjen e të mirave dhe shërbimeve në sektorin privat dhe atë publik;
- analizon dhe shpjegon marrëdhëniet ndërmjet institucioneve të ndryshme ekonomike që përbëjnë sistemet ekonomike, si prodhimi i vogël (edhe ai familjar), firmat prodhuese, bankat, institucionet qeveritare, sindikatat dhe korporatat;
- zbaton sistematikisht konceptet dhe arsyetimet ekonomike për vlerësimin e zhvillimeve dhe të çështjeve shoqërore aktuale dhe historike;
- shpjegon sistemet ekonomike të brendshme dhe ato globale dhe bashkëveprimin ndërmjet tyre, përgjatë periudhave historike;
- zbaton vazhdimisht njohuritë për prodhimin, shpërndarjen dhe konsumin në analizën e çështjeve shoqërore;
- përshkruan tiparet ekonomike të qytetërimeve përgjatë periudhave historike, indentifikon krizat ekonomike dhe pasojat e tyre në shoqëri;
- harton një plan për plotësimin e kërkesave shoqërore të dëshirueshme që lidhen me to.

6. Individët, grupet, shoqëria

Nxënësi:

- Analizon arsyet dhe rezultatet e ngjarjeve, situatave dhe ndryshimeve historike duke shpjeguar pasojat në përfundimin e ngjarjeve;
- Kupton se njerëzit dhe shoqëritë e përfshira në të njëjtën ngjarje historike mund të kenë përvoja dhe pikëpamje të ndryshme për të njëjtën ngjarje historike;
- Shpjegon lidhjet si brenda ashtu dhe ndër periudha e shoqëri të ndryshme, respekton origjinën historike dhe vlerëson dobinë e larmisë etnike dhe kulturore të shoqërisë;
- zbaton sistematikisht koncepte të tilla, si roli, statusi dhe klasa shoqërore për të përshkruar lidhjet dhe ndërveprimin e individëve, grupeve dhe institucioneve në shoqëri;
- analizon ndikimin e grupeve dhe të institucioneve te njerëzit, ngjarjet dhe elementet e ndryshme kulturore në të kaluarën dhe sot;

- shpjegon zhvillimin e institucioneve në kohë dhe hapësirë;
- analizon shembuj të kontradiktave ndërmjet shprehjes së individualitetit dhe përpjekjeve që bëhen për të nxitur konformizmin shoqëror nga grupet dhe institucionet;
- shqyrton sistemet e besimeve që qëndrojnë në themel të traditave dhe ligjeve në shoqërinë e sotme dhe gjatë historisë;
- vlerëson rolin e institucioneve si në drejtim të trashëgimisë dhe vazhdimësisë, ashtu edhe në drejtim të ndryshimit;
- analizon shkallën në të cilën grupe dhe institucione plotësojnë interesat e individëve dhe interesat e përbashkëta në shoqërinë e sotme dhe në atë të së kaluarës.

7. Arsyetimi filozofik

Nxënësi:

- përshkruan evoluimin e mendimit filozofik, sipas periudhave historike;
- dallon periudhat kryesore të zhvillimit të mendimit filozofik;
- përshkruan karakteristikat kryesore të periudhës që lidhen me zhvillimin e filozofisë;
- përshkruan historinë e mendimit filozofik përmes përfaqësuesve të saj;
- dallon e argumenton lidhjen e disa prej koncepteve dhe problemeve kryesore të filozofisë me periudhat kryesore të mendimit filozofik në shekuj etj.;
- dallon pikëpamjet e kundërta ose të ndryshme në historinë e mendimit filozofik dhe të përshkruan dallimet dhe pikat e përbashkëta;
- dallon tiparet thelbësore të periudhës historike të cilës i përket një pikëpamje ose qëndrim filozofik;
- shpjegon lidhjen e një rryme, të një pikëpamjeje ose të një qëndrimi filozofik me faktorë historikë (ekonomikë, shoqërorë, politikë, kulturorë, fetarë etj.);
- vlerëson kufizimet ose vlerat e filozofëve, të mendimtarëve, të historianëve etj., në kohë dhe në hapësirë;
- tregon dhe argumenton rolin e filozofisë në përparimin e fushave ose aspekteve të ndryshme të jetës shoqërore e shkencore;
- dallon dhe përshkruan ndikimin e mendimit të përparuar botëror në mendimin filozofik në Shqipëri në periudha të ndryshme historike;
- formulon hipoteza, për të bërë hulumtime, për të parashtruar probleme në mënyrë që të mundësohet zgjidhja e tyre;
- ushtron aftësinë e përjetshme të kërkimit, të kuptimit dhe të përballimit të të gjitha

problemeve të rëndësishme të jetës;

- kërkon lidhjen e filozofisë me dijet dhe aktivitetet e tjera njerëzore, duke përdorur metodologjinë e përshtatshme për trajtimin e çështjeve filozofike, në situata të ndryshme;
- përdor dijet filozofike për të marrë pjesë në zgjidhjen në praktikë të problemeve të ndryshme jetësore filozofike;
- përdor përfundimet e hulumtimeve për të krijuar qëndrimin e tij filozofik e moral në funksion të angazhimit të tij në jetën shoqërore.

8. Kultura

Nxënësi:

- kupton vlerat e përbashkëta evropiane, vetëdijen për diversitetin dhe identitetet kulturore, vetëdijen për politikat lëvizjet shoqërore dhe për sistemet e qëndrueshme, në mënyrë të veçantë, krizat ekonomike, politike, ndryshimet klimatike dhe demografike në nivel global dhe shkaqet e tyre;
- vlerëson diversitetin shoqëror, respekton të tjerët, pakicat kombëtare dhe përgatitet për të kapërcyer paragjykimet dhe për të arritur kompromise;
- analizon dhe shpjegon mënyrat, në të cilat grupet shoqëritë dhe kulturat trajtojnë nevojat dhe interesat njerëzore;
- parashikon se si mund të interpretohen përvojat dhe të dhënat nga njerëz dhe këndvështrime të ndryshme kulturore dhe sisteme të ndryshme referimi;
- analizon modelet shoqërore për ruajtjen dhe për transmetimin e kulturave, krahas përshtatjes së tyre ndaj ndryshimeve mjedisore dhe shoqërore;
- interpreton modelet e sjelljeve që reflektojnë vlerat dhe qëndrimet që ndihmojnë ose pengojnë mirëkuptimin ndërkulturor;
- argumenton vlerën e larmisë kulturore, si dhe të kohezionit brenda dhe ndërmjet grupeve;
- parashikon reagime të mundshme të kulturave ndaj çështjeve njerëzore;
- shpjegon dhe zbaton ide, teori dhe mënyra të kërkimit në shqyrtimin e çështjeve të problemeve shoqërore;
- analizon dhe interpreton këndvështrimet e ndryshme aktuale dhe historike brenda njëkulture dhe ndërmjet kulturave për çështje të ndryshme shoqërore;
- shpjegon lidhjet e tyre personale me sistemet shoqërore dhe kulturore në kohë dhe hapësirë;
- vlerëson ndikimet që kulturat e ndryshme historike dhe bashkëkohore kanë në jetën

epërditshme të individit; - shqyrton ndërveprimin e ndikimeve kulturore, kombëtare dhe etnike në ngjarje dhe situata të veçanta jetësore.
9. Idealet dhe praktikat e qytetarisë
Nxënësi: - shpjegon origjinën dhe interpreton ndikimin e vazhdueshëm të idealeve themelore demokratike, si dinjiteti njerëzor, liria, drejtësia, barazia dhe shteti i së drejtës në jetën e përditshme; - analizon, interpreton dhe vlerëson burimet dhe shembujt e të drejtave dhe përgjegjësi të qytetarëve; - vlerëson larminë e këndvështrimeve të ndryshme; - ushtron në praktikë dhe drejton forma të diskutimit dhe të pjesëmarrjes qytetare në përputhje me idealet e qytetarisë demokratike; - analizon dhe vlerëson ndikimin e formave të ndryshme të veprimit qytetar në politikën publike; - analizon larminë e madhe të politikave dhe të çështjeve publike nga këndvështrimi aktorëve të ndryshëm që ndikojnë në politikën kombëtare dhe krijon qëndrimin e tij për to; - vlerëson shkallën në të cilën politikat publike dhe sjelljet qytetare pasqyrojnë ose ndihmojnë në formimin e idealeve të shpallura të qytetarisë demokratike.
10. Qytetaria aktive
Nxënësi: - bën kërkime të pavarura, diskuton dhe debaton për çështje, probleme dhe ngjarje të rëndësishme për vete dhe shoqërinë; - shpjegon rëndësinë e hartimit dhe zbatimit të ligjit dhe të rregullave në fusha të ndryshme të jetës dhe të veprimtarisë njerëzore dhe mënyrën e pjesëmarrjes në procesin e bërjes dhe të ndryshimit të ligjeve; - shpjegon pasojat e sjelljeve të dhunshme e diskriminuese të individit dhe shoqëria; - përshkruan dhe të shpjegojë llojet e ndryshme të përgjegjësisë, të të drejtave dhe detyrimeve të individit në shtëpi, shkollë, shoqëri dhe si këto shpeshherë hyjnë në konflikt me njëra-tjetrën; - reflekton për vlerat shoqërore, morale, shpirtërore dhe kulturore vetjake dhe të të tjerëve;

- zgjidh konfliktet duke shqyrtuar alternativat, duke marrë vendim dhe duke shpjeguar zgjedhjet e bëra;
- shpjegon thelbin dhe natyrën e demokracisë dhe institucionet që e mbështesin atë në nivell vendor dhe qendror;
- përshkruan rolin e grupeve të ndryshme vullnetare dhe atyre të presionit në mbarëvajtjen e demokracisë;
- vlerëson grupet dhe identitetet e ndryshme etnike, kulturore, fetare etj., në bashkësinë ku jeton dhe më gjerë;
- shpjegon mbledhjet dhe mënyrat e ndryshme të shpërndarjes së burimeve dhe ndikimin që zgjedhjet ekonomike kanë te individët, bashkësitë dhe te zhvillimi i qëndrueshëm i mjedisit;
- zbulon dhe shqyrton mënyrën sesi media e përpunon dhe e paraqet informacionin.

11. Sjellja e shëndetshme dhe e sigurt shoqërore

Nxënësi:

- përshkruan, duke u mbështetur në të dhënat e shkencave të tjera, sjelljet e shëndetshme në fushat kryesore të jetës dhe të veprimtarisë njerëzore dhe përfitimet e gjithanshme për veten dhe shoqërinë, për të bërë zgjedhjet e duhura shoqërore, morale e ligjore;
- përshkruan ndryshimet kryesore psikologjike, intelektuale dhe shoqërore që shoqërojnë fëmijërinë;
- përshkruan disa prej substancave të paligjshme që përdoren sot nga njerëzit dhe pasojat e tyre negative për individin dhe për shoqërinë;
- dallon dhe përshkruan rreziqet e ndryshme që ndeshen në mjedise e në fusha të caktuara të veprimtarisë njerëzore (si shtëpia, rruga, shkolla, vendi i punës etj.), merr vendime të drejta për t'i parandaluar ose për t'i shmangur ato;
- dallon trysninë e mjediseve të ndryshme për të vepruar në mënyrë të rrezikshme ose të paligjshme dhe kërkon ndihmë për t'i rezistuar kësaj trysnie;
- merr pjesë në hartimin e rregullave të ndryshme në shkollë, bashkësi ose në vende të tjera për të rritur sigurinë dhe shëndetin.

KONCEPTE KYÇ

Histori	Gjeografi	Qytetari
- Kohë - Kronologji	- Gjeosistemi - Atmosfera	- Ligj - Të drejta themelore

- Burime historike - Ndryshimi dhe vazhdimësia - Shkaku dhe pasoja - Rëndësia historike - Interpretim historik - Kërkimi historikë - Perspektiva - Këndvështrim - Shumëllojshmëri kulturore dhe etnike, fetare - Diversitet kulturor, gjuhësor, etnik, fetar - Epokë - Periudhë historike - Shtet - Lëvizje e popujve - Dyndje barbare - Proces historik - Periudha antike - Periudha mesjetare - Periudha moderne - Periudha bashkëkohore - Krizë ekonomike - Krizë politike - Qytetërim - Hipotezë - Përfundim - Filozofi - Rrymë filozofike	- Hidrosfera - Litosfera - Biosfera - Sistemi diellor - Rrjeti gjeografik - Rajoni gjeografik - Rajonizimi gjeografik - Model zhvillimi - Globalizimi - Urbanizimi - Sisteme humane - Ndërvarësia - Zhvillime gjeopolitike - Diversitet - Lëvizje - Ndryshime klimatike - Zhvillimi i qëndrueshëm	- Përgjegjësi - Barazi trajtimi - Diskriminim - Paragjykim - Stereotip - Rregulla - Mjedisi - Ndotje mjedisore - Shëndeti - Zhvillimi i qëndrueshëm - Kultura - Trashëgimi kulturore - Ndërkultura - Edukim ndërkulturor - Vetëdije kulturore - Feja - Globalizim - Burime natyrore - Bashkëjetesë - Ndërvarësi - Këshilli i Evropës - Familje - Komunitet - Qytet - Rajon - Burime - Kosto oportune - Të mira dhe shërbime - Integritet moral - Korrupsion - Ndershmëria - Transparenca
--	---	---



		- Respekti - Empatia - Ndërgjegje - Besueshmëria - Konflikti - Dhuna - Guxim - Vetbesimi - Demokraci - Karakteristika shoqërore e individuale - Institucion - Vendimmarrje - Partitë politike - Politikë publike - Dëgjim aktiv - Interes publik - Zgjedhje - Votim - Informim - Burim informacioni - Dyshim - Media - Keqinformi - Dizinformim - Gjuhë urrejtje - Resiliencë - Reklama - Nevoja - Dëshira - Profesion - Puna
--	--	---

		- Karrierë - Kursim - Hua - Interes - Planifikim financiar - Para - Buxhet - Plan biznesi - Konsumator - Sipërmarrës
AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË		
- Përdorimi dhe interpretimi i hartave, fotografive ajrore, imazheve satelitore. - Ndërtimi dhe interpretimi i grafikëve, diagrameve, të dhënave statistikore. - Vëzhgime në terren. - Krijimi i modeleve. - Përdorimi i burimeve historike. - Kërkimi historik. - Kërkimi gjeografik - Komunikimi për të kaluarën. - Këndvështrimi dhe interpretimi. - Analiza shkak –pasojë. - Përdorim i TIK-ut. - Përdorimi i inteligjencës artificiale. - Aftësia e të menduarit kritik e krijues. - Aftësia për të zgjidhur problemet. - Aftësia për të vlerësuar. - Aftësia për të transferuar dhe zbatuar njohuritë në një kontekst të caktuar. - Aftësia pjesëmarrëse. - Përdorimi i fjalorit historik, gjeografik. - Aftësia për të vendosur në kohë dhe në hapësirë ngjarjet historike. - Aftësia për të kuptuar, analizuar dhe argumentuar lidhjet shkak-pasojë. - Aftësia për të hetuar, për të interpretuar dhe për të parashikuar ngjarje historike.		

- Aftësia për të identifikuar dhe për të zgjidhur probleme të ndryshme duke përdorur teknologjinë dhe mjediset digjitale.
- Aftësia për të menaxhuar dhe mbrojtur informacionin, përmbajtjen, të dhënat dhe identitetet digjitale.
- Aftësia për punë kërkimore.
- Aftësia komunikuese.
- Aftësia për të bashkëpunuar dhe për të punuar në grupe.
- Aftësia për të debatuar dhe për të arritur të bëjnë marrëveshje.
- Aftësia ndërkulturore.
- Aftësia për të parandaluar dhe për të zgjidhur konfliktet.
- Aftësia për të ndërmjetësuar.
- Aftësia për të menaxhuar situata të ndryshme si: ndryshimet teknologjike, fatkeqësitë natyrore, krizat ekonomike, pandemitë etj.

QËNDRIME DHE VLERA

- Vlerësimi i dinjitetit njerëzor dhe i të drejtave të njeriut
- Vlerësimi i larmisë kulturore
- Vlerësimi i demokracisë, i drejtësisë, i ndershmërisë, i barazisë dhe i shtetit të së drejtës
- Përkushtimi ndaj parimit të gjithësisë, të ndërvlerësisë dhe të pandashmërisë së të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore.
- Bindja për vlerën, dinjitetin dhe lirinë e individit.
- Respekti
- Mendësia qytetare
- Efektshmëria e veprimeve
- Toleranca ndaj paqartësisë
- Përkushtimi ndaj shtetit të së drejtës, drejtësisë, barazisë dhe paanësisë.
- Përkushtimi ndaj paqes dhe zgjidhjes pjesëmarrëse, paqësore dhe konstruktive të problemeve shoqërore.
- Bindja për vlerën dhe domosdoshmërinë e parimeve, institucioneve dhe procedurave demokratike, si dhe për rëndësinë e veprimit qytetar.
- Respektimi i kulturave të tjera; pranimi i parimit të pluralizmit në jetën e përditshme;
- Përkushtimi ndaj vlerës së mirëkuptimit të ndërsjellë, të bashkëpunimit, të mirëbesimit dhe të solidaritetit, si dhe ndaj luftës kundër racizmit, paragjyqimeve dhe çdo forme të

diskriminimit.

- Bindja në rëndësinë e përgjegjësisë dhe përgjegjshmërisë personale.
- Përkushtimi ndaj parimit të zhvillimit njerëzor të qëndrueshëm, që mban parasysh ekuilibrin ndërmjet zhvillimit ekonomik, shoqëror dhe mjedisor.
- Prirja për të qenë anëtar i pavarur i shoqërisë.
- Prirja për të respektuar vlerat individuale dhe dinjitetin njerëzor.
- Prirja për të marrë përsipër përgjegjësitë personale, politike dhe ekonomike të qytetarit.
- Prirja për t'iu bindur “rregullave të lojës” së demokracisë, si pranimi i vendimit të ligjshëm të shumicës dhe respektimi i të drejtave të minoriteteve.
- Prirja për të marrë pjesë në çështjet qytetare në mënyrë të mirinformuar, të arsyeshme dhe të efektshme.
- Respektimi i kulturës së tij si dhe çmimi i vlerave, i besimeve dhe i kulturave të tjera.
- Prirja për të demonstruar krenari për vendin e tij.
- Prirja për të treguar integritet në përdorimin etik të informacionit dhe TIK-ut.
- Bindja për të vlerësuar diversitetin dhe për të demonstruar tolerancë, mirëkuptim, respekt dhe qëndrim të hapur ndaj dallimeve.
- Prirja për të përdorur një gjerësi burimesh historike dhe informacioni të duhur, duke përfshirë dokumentet, burimet e shtypura, historitë gojore, medien, pikturat, muzetë, galeritë, fotografitë, muzikën dhe internetin, si bazë hetimi vetjak, për ndërtimin dhe për argumentimin e një ngjarjeje historike”.
- Vlerësimi i pozitës e qytetërimit shqiptar brenda qytetërimit botëror.
- Prirja për të vlerësuar natyrën dhe larminë e provave historike.
- Prirja për të nxitur dhe për të mbështetur funksionimin e shëndetshëm të demokracisë në vend.

3.4.5 Ndarja e kohës

Në tabelën e mëposhtme është dhënë koha mësimore për klasat X-XII për fushën “Shkencat shoqërore”.

Kurrikula bërthamë

Lëndët e fushës “Shkencat shoqërore”	Klasa X-XII (orë mësimore në javë)
Qytetari	2 (2+0+0)

Filozofi	2 (0+2+0)
Ekonomi	3 (0+0+3)
Histori	4 (2+2+0)
Gjeografi	4 (2+2+0)
Totali:	15

Kurrikula me zgjedhje

Lëndët e fushës “Shkencat shoqërore”	Klasa X-XII (orë mësimore në javë)
Sociologji	2 (0+0+2)
Psikologji	2 (0+0+2)
Histori	4 (0+0+4)
Gjeografi	4 (0+0+4)
Totali:	12

3.4.6 Udhëzime metodologjike

Metodologjia e zbatimit të kurrikulës luan rol thelbësor për përmbushjen e qëllimeve të fushës “Shkenca shoqërore”. Të nxënësve përmes kësaj fushe mund të realizohet vetëm me anë të pjesëmarrjes aktive të nxënësve, në mënyrë që ata të kuptojnë, të brendësojnë, të vlerësojnë e të përdorin përmbajtjen e synuar për të ndërtuar njohuri, aftësi, shkathtësi e qëndrime të reja në situata të ndryshme me të cilat do të përballen në të ardhmen.

Mësuesi angazhon nxënësit në një proces në të cilin ata parashtrojnë pyetje dhe formulojnë përgjigje, inkurajon frymën e mendimit krijues dhe kritik duke nxitur diskutimin ndërmjet tyre, duke inkurajuar pavarësinë e nxënësve, iniciativën e tyre, ndërveprimin. Në këtë qasje mësuesi nxit shpirtin udhëheqës të nxënësve, bashkëpunimin, tolerancën, vetëbesimin dhe shpirtin sipërmarrës të cilat reflektohen në rezultatet e të nxënësve.

Mjaft rezultate janë edhe metodat që përfshihen në spektrin e metodave problemore e kërkimore, si: mësimi zbulues, veprimtaritë praktike, ekskursionet, projekti mësimor etj. Këto metoda mund të përdoren në ato raste kur nxënësit, në mënyrë individuale ose të organizuar në grupe, ndërmarrin, me ndihmën dhe drejtimin e mësuesit, veprimtari që synojnë zgjidhjen e problemeve të thjeshta etj.

Veprimtaritë praktike dhe projektet kurrikulare janë modele të veprimtarisë mësimore, realizimi i të cilëve kërkon zbatimin e më shumë se një metode dhe teknike, si: kërkimi,

përdorimi i burimeve, intervista, vrojtimi, studimi i rastit, ndërthurjen e të gjitha këtyre teknikave së bashku. Përdorimi i strukturuar i burimeve dhe dokumenteve historike ndihmon nxënësit të zhvillojë përvojën për vlerësimin e fakteve dhe aftësinë për të formuluar gjykime të arsyeshme. Këto metoda e vënë theksin në zhvillimin e aftësive dhe qëndrimeve.

Mësimdhënia e bazuar në kompetenca kërkon që mësuesit të përzgjedhin strategji, metoda, teknika dhe forma të ndryshme të punës me nxënës, si dhe të organizojnë përvojat mësimore të nxënësve që integrojnë njohuritë përkatëse me shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet. Disa nga metodat, teknikat dhe strategjitë e sugjeruara në këtë fushë janë:

- diskutimet;
- debatet;
- vrojtimet;
- intervistat;
- ekskursionet;
- vizitat në muze ose vendngjarje historike;
- konkurset;
- projektet kurrikulare dhe ndërkurrikulare etj.

Mësuesi duhet të jetë i kujdesshëm në përzgjedhjen e metodave dhe strategjive që nxisin punën me nxënësit e talentuar dhe ata që kanë vështirësi në të nxënë.

Nxënësit me vështirësi në të nxënë

Shumë nxënës me vështirësi në të nxënë arrijnë rezultatet e pritshme të të nxënit njësoj si nxënësit e tjerë, nëse bëhen përshtatje në mënyrën e mësimdhënies. Për të arritur nivelin më të lartë të mundshëm të realizimit të kompetencave, mësuesi përzgjedh teknikat dhe metodat më të përshtatshme që u japin mundësi këtyre nxënësve të përmbushin rezultatet e të nxënit.

Nxënësit e talentuar

Mësuesit duhet të krijojnë kushte dhe situata të tilla që nxënësit të shfaqin dhe të zhvillojnë talentet e tyre në këtë fushë. Kjo arrihet nëse nxënësve u krijohen mundësi të punojnë me një përmbajtje më të thelluar dhe zgjeruar, të zhvillojnë në mënyrë të vazhdueshme kompetencat, të fokusohen në çështjet kroskurrikulare, të zgjerojnë mjediset dhe materialet e të nxënit brenda dhe jashtë shkollës. Për të mundësuar këtë, mësuesit përzgjedhin dhe përdorin metoda dhe teknika që zhvillojnë kuriozitetin, nxisin kërkimin, zhvillojnë rrahjen e mendimeve dhe aftësitë konkurruese etj., si debati, konkursi, kuizet etj.

Përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit

Teknologjia e informacionit dhe komunikimit (TIK) është mjeti i informacionit dhe komunikimit që luan një rol kyç në pothuajse çdo aspekt të jetës. Përdorimi i saj në një mjedis të nxëni mbështet nxënësin duke e bërë më tërheqës dhe më efektiv procesin e të mësuarit.

TIK-u ka vlera të domosdoshme dhe të patjetërsueshme për të transformuar mjedisin profesional të mësimdhënie-nxënies. Nxënësit mund të përfitojnë shumë nga përdorimi i duhur i TIK-ut që mbështet të menduarit gjeografik dhe gjithashtu e bën zhvillimin e njohurive dhe aftësive më efikas dhe tërheqës. Tërësia e mjeteve softuerike mund të përfshijë përdorimin e aplikacioneve, programeve dhe platformave të ndryshme, si Word për hartimin e materialeve të ndryshme, Excel për përpunimin e të dhënave të ndryshme statistikore dhe krijimin e databazave, Powerpoint për zhvillimin e prezantimeve, Google Maps dhe Google Earth si platforma që ofrojnë imazhe satelitore, fotografi ajrore, harta etj.

3.4.7 Udhëzime për vlerësimin

Vlerësimi është pjesë integrale e procesit të mësimdhënies dhe të nxënit. Ai përfshin mbledhjen e informacioneve me anë të teknikave të ndryshme të vlerësimit për arritjen e rezultateve të pritshme të të nxënit në nivel klase. Me këtë informacion, mësuesi merr vendime për vlerësimin përfundimtar të nxënësve, bazuar në gjykimin e tij për nivelin e zotërimit nga nxënësit të kompetencave të fushës “Shkenca shoqërore”.

Mësuesit duhet të përdorin situata të jetës reale që përfshijnë shoqërinë dhe mjedisin si pikënisje për vlerësimin e nxënësve. Nxënësve duhet t’u krijohej mundësia të realizojnë detyra tematike, veprimtari praktike e projekte kurikulare, të zgjidhin situata problemore nga jeta etj. dhe të vlerësohen ndërsa demonstrojnë arritjet e tyre nëpërmjet veprimtarive dhe produkteve të tjera, si: veprimtari praktike, raste studimore, shkrimi i një eseje, prodhimi i një CD-je, hartimi i një maketi për një ngjarje ose figurë të caktuar historike, projekte etj.

Format e ndryshme të vlerësimit duhet t’u krijojnë mundësi të gjithë nxënësve të vlerësohen në atë mënyrë që është më e përshtatshme për to.

Vlerësimi i nxënësve përmes projekteve kurikulare ndihmon në krijimin e një mjedisi më dinamik dhe të angazhuar për nxënësit, duke u mundësuar të zbatojnë e të thellojnë njohuritë dhe të zhvillojnë aftësitë në mënyrë krijuese.

3.4.8 Materialet dhe burimet mësimore

Përdorimi i mjeteve mësimore në mësimdhënien dhe procesin e të nxënit në fushën “Shkenca shoqërore” ndihmon në konkretizimin e ideve dhe dukurive, në aplikimin e metodave dhe strategjive të mësimdhënies, si dhe e bën mësimin më interesant dhe më argëtues për nxënësit.

Përdorimi i suksesshëm i metodave dhe i teknikave të lartpërmendura, nuk mund të realizohet pa mjetet e nevojshme didaktike, të cilat mund të jenë të llojeve të ndryshme, si: harta të përgjithshme ose tematike, atlase, albume, foto, skica, filma mësimorë, videokaseta, kompjuter, aparat projektimi, CD, DVD. Mjetet e teknologjisë, burimet digjitale dhe prezantimet multimediale lehtësojnë përvojat interaktive të të nxënit dhe mbështesin nevoja të ndryshme mësimore. Komunikimi, bashkëpunimi dhe aksesimi në informacion mund të ndodhin pavarësisht nga koha dhe vendi. Përdorimi i softuerëve arsimor, burimeve multimediale, platformave online dhe i mjeteve digjitale në mësim zhvillon mundësi të reja didaktike dhe metodologjike. Ato mbështesin lloje të ndryshme të nxënies, promovojnë nxënësit me talente dhe mbështesin nxënësit me aftësi ndryshe. Këto mjete po zënë gjithnjë e më shumë vendin që u takon për konkretizimin e një sërë veprimtarish mësimore, të cilat kuptohen dhe përvetësohen më lehtë me përdorimin e teknologjisë.

3.5 Fusha e të nxënit: Arte

3.5.1 Hyrje

Fusha e arteve është pjesë e rëndësishme e kurrikulës dhe pjesë integrale e jetës sonë të përditshme. Në të përfshihen aspekte të kulturës materiale, shpirtërore, artistike, intelektuale dhe emocionale, në të cilën ndërveprojnë kultura dhe shoqëria. Artet dhe studimi i tyre zhvillon njohuri, shkathtësi, qëndrime e vlera nëpërmjet lëndëve: Art pamor, Muzikë, Teatër, të cilat lidhen ngushtë dhe ndihmojnë në zhvillimin intelektual, emocional, social dhe kulturor të nxënësve, nga parashkollori deri në arsimin e mesëm të lartë.

Nëpërmjet përjetimit, vëzhgimit, krijimit, vlerësimit, artet mundësojnë për t'iu dhënë kuptim ideve dhe për të komunikuar nëpërmjet krijimeve artistike. Gjuha artistike dhe veprat e artit, të veshura me vlera sociale dhe kulturore të jetës së përditshme, kontribuojnë në zhvillimin e këtyre vlerave dhe pasqyrojnë historinë dhe shoqërinë njerëzore. Gjithashtu, artet luajnë një rol të rëndësishëm në shprehjen dhe ruajtjen e vlerave kulturore të shoqërisë dhe në zhvillimin, afirmimin dhe ruajtjen e identitetit kulturor dhe atij kombëtar.

Artet (Art pamor, Muzikë dhe Teatër) janë pjesë e kurrikulës me zgjedhje të arsimit të mesëm të lartë.

Kurrikula e arteve në arsimin e mesëm të lartë fokusohet në zgjerimin e njohurive artistike dhe zhvillimin e tyre për përdorimin dhe për zbatimin e tyre. Nxënësit krijojnë,

performojnë/realizojnë dhe vlerësojnë artet duke krijuar gjykime dhe qëndrime të qarta në klasë, përmes punëve të veta apo të autorëve të ndryshëm, duke zhvilluar kompetenca të qëndrueshme dhe të zbatueshme në këto disiplina artistike.

3.5.2 Qëllimi i fushës

Fusha e arteve ka si qëllim të zhvillojë njohuri e qëndrueshme artistike nëpërmjet tri disiplinave artistike duke ndihmuar në kuptimin, zbatimin dhe vlerësimin e veprave të arteve në përgjithësi, nëpërmjet trajtimit të elementeve dhe vlerave artistike kulturore të trashëgimisë kulturore shqiptare dhe asaj botërore, në kontekste të ndryshme kulturore.

Fusha e arteve synon:

- zgjerimin e njohurive dhe të koncepteve artistike në arte për këtë grupmoshë;
- krijimin e kompetencave artistike për të krijuar dhe realizuar punë të ndryshme artistike;
- aftësimin e nxënësve për të vlerësuar vepra të artit shqiptar dhe atij botëror, nga periudha dhe kontekste të ndryshme kulturore dhe historike;
- formimin e aftësive artistike;
- të menduarit kritik dhe krijues;
- zhvillimin personal, intelektual, social dhe kulturor të nxënësve;
- përfshirjen dhe bashkëpunimin në veprimtari artistike tradicionale, duke manifestuar vlerat e artit kombëtar si pjesë e pandashme e vlerave të artit botëror;
- ndërveprimin në mënyrë sociale, kulturore dhe intelektuale me grupet të ndryshme kulturore apo etnike;
- kontributin personal në zhvillimet artistike- kulturore në nivel lokal, kombëtar dhe më gjerë.

Tematikat e fushës dhe përshkrimi i tyre

Fusha e arteve në arsimin e mesëm të lartë, kërkon të vazhdojë përmbushjen e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve artistike, të cilat zhvillohen përmes disa tematikave. Ato shërbejnë si instrument i fuqishëm integruar në funksion të zhvillimit të kompetencave të fushës.

Në arsimin e mesëm të lartë zhvillohen, artet vazhdon të zhvillohet përmes tri (3) tematikave ku secila prej tyre përshkruhet veçmas gjatë hartimit dhe zbatimit të programeve për zhvillimin e kompetencave, ndërsa në kurrikul ato kanë elemente të përbashkëta.

Tematikat janë:

- a. Gjuha dhe komunikimi artistik,

- b. Teknika dhe procese artistike,
- c. Historia, kultura dhe shoqëria.

a. Gjuha dhe komunikimi artistik

Nxënësit i krijohen mundësi që në këtë nivel,të:

- formulojë ide të ndryshme rreth arteve përmes mendimit estetik;
- zhvillojë kuptimin e të bukurës në arte të ndryshme;
- përdorë dhe të zbatojë konceptet artistike në (Art pamor, Muzikë dhe Teatër), në funksion të komunikimit artistik;
- analizojë krijimet e veta dhe të tjerëve në (Art pamor, Muzikë dhe Teatër), duke komunikuar përmes një gjuhe artistike;
- prezantojë idetë artistike personale duke i komunikuar lirshëm ato;
- përjetojë vepra të ndryshme artistike, duke komunikuar ide dhe qëndrime personale;
- reflektojë mbi veprimtaritë ndryshme artistike, duke u shprehur përmes formave të ndryshme të shprehjes artistike;
- komunikojë ide dhe emocione, duke përdorur gjuhën artistike përkatëse në artin pamor, muzikë dhe dramë, në procese të ndryshme krijuese dhe performuese;
- shprehë para shokëve apo të tjerëve përjetimet dhe emocionet e përjetuara gjatë shikimit të një filmi, të një dramatizimi, koncerti apo vepre arti.

b. Teknika dhe procese artistike

Nxënësit i krijohen mundësi që në këtë nivel të:

- zbatojë teknika dhe procese të ndryshme artistike përmes një vepre konkrete;
- përdorë në mënyrë të vetëdijshme gjuhën artistike si: fjalët, tingujt, ngjyrat, format, për realizimin e një pune të caktuar artistike;
- krijojë punë individuale, duke përdorur mjete dhe teknika të ndryshme artistike, për të zhvilluar ide personale dhe origjinale;
- përdorë teknika dhe procese artistike të (Art pamor, Muzikë dhe Teatër), për të prezantuar në mënyrë artistike temat/projektet artistike që i interesojnë;
- reflektojë dhe të vlerësojë aktivitetet personale dhe të të tjerëve, duke u shprehur përmes formave të ndryshme artistike;
- përdorë mediat si mjete të rëndësishme të informimit, të komunikimit dhe të ndërveprimit në epokën digjitale, gjatë prezantimit të punës së vet.

c. Historia, kultura dhe shoqëria

Nxënësit i krijohen mundësi që në këtë nivel të:

- përjetojë dhe të reflektojë mbi vepra të ndryshme muzikore, teatrore apo figurative;
- kuptojë zhvillimin, rolin dhe ndikimin e artit apo një kulture të caktuar në një shoqëri të caktuar;
- njohë dhe të analizojë vepra dhe autorë të arteve në kontekste të ndryshme sociale, politike dhe kulturore;
- vlerësojë rolin e ndërveprimit të arteve me njëri-tjetrin në kontekste të ndryshme historike, shoqërore, kulturore etj.;
- identifikojë dhe të promovojë vlerat e trashëgimisë kulturore shqiptare dhe asaj botërore, të komunitetit, të kombit dhe më tej;
- respektojë vlerat e trashëgimisë kulturore kombëtare dhe më gjerë.

3.5.3 Përshkrimi i kompetencave që zhvillon fusha

I gjithë procesi i të nxënësve në fushën e arteve, zhvillohet duke patur si qëllim ndërtimin e kompetencave lëndore artistike. Kompetencat e fushës së arteve lidhen në mënyrë të natyrshme me kompetencat kyçe. Kompetencat lëndore për të gjitha lëndët brenda fushës së arteve (Art pamor, Muzikë dhe Teatër) janë:

Kompetenca 1: Krijimi artistik

Nxënësi:

- përdor ide të ndryshme për të krijuar punë me tematika të ndryshme;
- përdor elementet dhe parimet e gjuhës artistike për këtë nivel;
- zhvillon më tej idetë e veta artistike duke gjetur forma të ndryshme komunikimi;
- organizon krijimin e vet artistik, sipas elementeve dhe parimeve të gjuhës artistike;
- komunikon përmes një gjuhe artistike përvojat e veta krijuese me të tjerët.

Kompetenca 2: Performimi/realizimi artistik

Nxënësi:

- interpreton/realizon punë artistike nga autorë dhe vepra të ndryshme shqiptare apo botërore;
- zbaton teknikat dhe proceset artistike gjatë performimeve apo realizimeve të punëve të tyre;
- respekton gjatë interpretimit/realizimit rregullat artistike;
- ndan përvojat e veta performuese/realizuese të veprave artistike me të tjerë;
- analizon në mënyrë artistike punën e interpretuar/realizuar.

Kompetenca 3: Vlerësimi artistik

Nxënësi:

- njeh rrugën nëpër të cilat janë zhvilluar veprat artistike;
- shpjegon kuptimin e tematikës/ përmbajtjes artistike të veprave të realizuara/ performuara;
- bën një gjykim kritik dhe estetik të veprave të ndryshme artistike nga autorë, vende dhe kontekste të ndryshme kulturore;
- vlerëson përvojat e veta dhe të të tjerëve për punë të ndryshme të krijuara;
- prezanton vepra, biografi, kultura duke përdorur një gjuhë të pasur artistike.

Fusha e arteve, përmes disiplinave artistike brenda saj zhvillon aftësitë krijuese, interpretuese dhe vlerësuese. Nëpërmjet një përvoje sistematike të punës artistike, edhe në arsimin bazë, nxënësit janë bërë më të vetëdijshëm për potencialin e tyre krijues përmes përdorimit të gjuhës artistike. Nëpërmjet kontaktit me veprat e artit që ofrojnë shumëllojshmëri modelesh shprehëse dhe komunikimi, nxënësit janë aftësuar në vlerësimin e pasurisë së madhe të gjuhëve të ndryshme artistike, në eksplorimin e mjedisit të tyre kulturor dhe në përgatiten për zbulimin e kulturave të tjera.

Nxënësit, krijojnë, performojnë/realizojnë dhe vlerësojnë vepra arti, nëpërmjet kombinimit të perceptimeve, intuitës, përshtypjeve dhe njohurive të ndryshme. Ata reflektojnë, komunikojnë dhe përdorin informacione nga burime të ndryshme. Nxënësit inkurajohen të zhvillojnë aftësitë e tyre kritike dhe estetike dhe të hapin horizontin e tyre kulturor nëpërmjet njohjes së veprave të artit të artistëve shqiptarë dhe botërorë, në periudha dhe konteste të ndryshme kulturore.

Edukimi përmes arteve përfshin mundësinë e integritetit të teknologjisë në procesin mësimor duke e konsideruar atë si një mjet të ri të fuqishëm shprehës, frymëzimi dhe komunikimi.

3.5.4 Rezultatet e të nxënësve

Rezultatet e të nxënësve në fushën e kurrikulës së arteve.

Rezultatet e të nxënësve në përfundim të klasës së 12-të
1. Krijimi artistik
Nxënësi: - komunikon përmes një gjuhe artistike për vepra të ndryshme artistike; - krijon punë artistike, duke shprehur emocionet mbi të bukurën në art, përmes njohurive të marra; - interpreton forma të vogla vokale, individualisht dhe në grup; - krijon vepra dy dhe tredimensionale, në mënyrë të lirshme nga tematika të caktuara; - zhvillon idetë e veta personale, nëpërmjet përdorimit të mjeteve shprehëse të larmishme artistike në art pamor, muzikë dhe teatër;

- merr pjesë në aktivitetet artistike sipas prirjeve, mundësive dhe interesave të veta;
- zhvillon komunikimin për të bukurën në art nëpërmjet krijimit të eseve ose zhvillimit të *debateve të hapura*, nisur nga një qasje e caktuar artistike;
- interpreton në forma të ndryshme vokale, individualisht ose në grup, këngë dhe melodi nga gjini të ndryshme (popullore, e kultivuar, klasike, muzikë e lehtë);
- krijon vepra dy dhe tredimensionale, në mënyrë të lirshme ose mbi tematika të caktuara që janë shumë dimensionale.
- finalizon në shfaqje skenike, aftësitë e zhvilluara përmes teatrit apo këndimit vokal;
- interpreton individualisht ose në grup, në aktivitetet artistike të shkollës, komunitetit dhe më gjerë, sipas prirjeve, mundësive dhe interesave të tij.

2. Performimi/realizimi i veprave/ punëve artistike

Nxënësi:

- përdor teknikat artistike për të performuar/realizuar punë të vetat në arte;
- zbaton teknikat dhe proceset artistike gjatë performimit/realizimit në art pamor, muzikë dhe teatër;
- demonstroi aftësi performuese (interpretuese) vokale, teatrore, në një apo më shumë veprimtari artistike;
- realizon vepra dy dhe tredimensionale në një apo më shumë veprimtari artistike;
- zotëron teknikat dhe proceset gjatë realizimit të një pune arti;
- zotëron aftësi performuese/interpretuese në një apo më shumë veprimtari artistike;
- zotëron aftësi në realizimin e veprave dy dhe tredimensionale;
- zotëron aftësi bashkëpunimi në realizimin e punëve artistike në grup;
- përdor media dhe teknologji të ndryshme për të paraqitur punët artistike.

3. Vlerësimi i veprave artistike

Nxënësi:

- vëzhgon dhe analizon në mënyrë kritike punët artistike të vetat dhe të të tjerëve në muzikë dhe art pamor;
- përjeton një vepër artistike përmes përjetimit, vëzhgimit, dëgjimit;
- shpjegon përmes eseve, përjetimin emocional mbi një vepër artistike muzikore, dramatike figurative;
- çmon të bukurën punët artistike të vetat apo dhe të të tjerëve, në art pamor, muzikë dhe teatër, duke u argumentuar mendimin e tij;

- prezanton punën e vet në veprimtaritë artistike në klasë apo në ato publike (koncert, shfaqje dramatike, ekspozitë) duke përdorur mjetet të ndryshme digjitale;
- vlerëson dhe prezanton, në mënyrë kritike, punë apo vepra artistike;
- vlerëson të bukurën në një vepër muzikore, teatrore apo figurative;
- vlerëson krijimet artistike vetjake dhe të tjerëve duke analizuar formën, elementet artistike dhe teknikat në funksion të shprehjes artistike;
- prezanton vetëm ose në grup, punë artistike të realizuara në art pamor, muzikë dhe teatër;
- vlerëson duke gjykuar në mënyrë kritike mbi periudhat artistike, veprat dhe autorët nga kontekste dhe kultura të ndryshme;
- prezanton me sukses dhe vetëbesim punët e veta në aktivitetet e ndryshme artistike në shkollë, komunitet dhe më gjerë.

NJOHURI DHE KONCEPTE KRYESORE

Gjuha dhe komunikimi artistik

- Arti	- Melodia	- Kontrasti
- E bukura	- Sipërfaqja	- Përsëritja
- Tingulli	- Vëllimi	- Ndryshimi
- Ritmi	- Ngjyra	- Krahassimi
- Dinamika	- Roli	- Theksi
- Vija	- Zëri	- Uniteti
- Forma	- Fjala	- Harmonia
- Karakteri	- Dritat	- Zhvillimi
- Objekti	- Koha	- Sensi i kompozicionit
- Perspektiva	- Veprimi	- Sensi i tërësisë
- Hapësira		- Sensi i stilit
- Energjia		

Teknika dhe procese artistike

- Teknika vokale	- Këndimi
- Teknika e akuarelit	- Krijimi
- Teknika e vizatimit	- Dëgjimi
- Teknika e gdhendjes	- Luajtja në instrument
- Teknika e ngrohjes	- Interpretimi dramatik
- Teknika e shkontraktimit	- Vizatimi

- Teknika e kujtesës -	- Ngjyrosja - Modelimi - Nënteksti - Etydi - Dialogu - Monologu - Përjetimi emocional - Veprimi me anë të fjalës - Aktrimi - Sikuri - Veprimi fizik dhe psikik - Imitimi - Fotografimi - Modelimi - Gdhendja - Kolazhi - Kompozimi
Veprimtari artistike	
- Vepra të vogla dramatike - Dramatizim i një vepre - Ekspozitë individuale apo e përbashkët - Koncert koral	
Historia, kultura dhe shoqëria	
- Format muzikore - Format artistike - Trashëgimia botërore - Trashëgimia shqiptare /Isopolifonia etj. - Historia muzikore shqiptare dhe botërore - Historia e arti pamor shqiptar dhe botëror - Historia teatrale shqiptare dhe botërore -	- Gjinitë artistike (opera, teatri, portreti, peizazhi, kompozimi etj.). - Stilet artistike. - Vepra arti dhe veprimtari artistike (pamore, muzikore dhe dramatike). - Zhvillimi i arteve në periudha të ndryshme, nga lashtësia deri në ditët tona. - Veprimtari dhe institucione kulturore

	(opera, galeri, muze, teatro etj.). - Eksperienca artistike (takime dhe biseda me artistë, muzikantë, artizanë, dizajn etj.). - Profesione që lidhen me karriera të ndryshme artistike.
AFTËSI DHE SHKATHTËSI	
- Dëgjimi dhe përjetimi muzikor - Perceptimi pamor dhe vëzhgimi - Përjetimi artistik - Analizimi dhe vlerësimi artistik - Gjykimi dhe mendimi kritik - Mendimi krijues - Zhvillimi i vëmendjes dhe i kujtesës artistike - Vullneti dhe motivimi - Iniciativa dhe interesimi - Imagjinata dhe krijimtaria - Komunikimi dhe të shprehurit - Aftësia për të punuar në grup (kori, projektet artistike etj.) - Mendimi analitik, kritik dhe krijues	
QËNDRIME DHE VLERA	
- Qëndrimi ndaj një veprë arti përmes komunikimit artistik - Vetëbesimi gjatë krijimit - Pjesëmarrja aktive në krijimin e punëve në grup - Shoqërimi - Këmbëngulja - Respekti për punën e të tjerëve - Qëndrimi ndaj artit dhe konceptit të të bukurës në art - Respektimi i trashëgimisë kulturore kombëtare dhe trashëgimisë së kulturave të tjera - Respekti ndaj kulturave të ndryshme - Bashkëpunimi dhe përgjegjësia - Përqendrimi dhe durimi	

3.5.5 Ndarja e kohës

Në planin mësimor të arsimit të mesëm të lartë, fusha e arteve planifikohet të zhvillohet në kurrikulën me zgjedhje, me 2 orë mësimore në javë për secilën klasë.

Nxënësi zgjedh një prej lëndëve të ofruara:

- Art pamor
- Muzikë
- Teatër

Kurrikula me zgjedhje

Lëndët e fushës “Gjuhët dhe komunikimi”	Klasat X-XII (orë mësimore në javë)
Art pamor, Muzikë, Teatër	6 (2+2+2)

3.5.6 Udhëzime metodologjike

Metodat e mësimdhënies në arte janë çelësi për suksesin e nxënësve në mësimin e tyre. Mësuesit duhet të nxitin çdo nxënës të besojë se do të jetë i suksesshëm në mësimin e artit pamor, muzikës, teatrit, duke kuptuar shumë mirë interesat e tyre dhe nevojat që ata kanë ata për thellim të mëtejshëm në këto disiplina. Ata ndihmojnë nxënësit të aktivizojnë njohuritë e mëparshme, t’i rendisin dhe ti përdorin ato, jo vetëm nëpërmjet interpretimit, por edhe duke thelluar gjykimin artistik mbi vepra të ndryshme artistike. Udhëzimet për nxënës me nevoja të veçanta do të jenë të specifike në programet lëndore. Po kështu mësuesit duhet të nxitin dhe të inkurajojnë të gjithë nxënësit, duke krijuar mjedise ku nxënësit të kenë mundësi për të performuar/interpretuar/krijuar apo realizuar, nëpërmjet artit që ata kanë përzgjedhur të studiojnë më tej.

Gjatë procesit të mësimdhënies, mësuesit duhet të sigurojnë një shumëllojshmëri aktivitete të bazuara në vlerësimin e nevojave individuale të nxënësve, në nevojat e grupit dhe në praktikat më të mira mësimore. Gjithashtu, mësuesit duhet të krijojnë një mjedis të përshtatshëm në klasë për zhvillimin e veprimtarive të artit pamor, muzikës dhe teatrit.

Nxënësit vendosen në situata konkrete praktike muzikore, pamore apo dramatike në të cilat përjetojnë dhe provojnë vetë të krijojnë dhe të interpretojnë artistikisht punë të ndryshme artistike. Mësimdhënia e arteve, për nga vetë natyra, nënkupton një veprimtari emocionale, intelektuale dhe fizike, tashmë e vetëdijshme për ata, ku çdo përmbajtje dhe veprimtari mësimore muzikore, figurative dhe dramatike është e pëlqyeshme dhe krijon emocione. Është

shumë e rëndësishme kur nxënësit drejtohen drejt një veprimtarie artistike në mënyrë të vetëdijshme, gjë që u mundëson atyre shprehjen e potencialit të tyre intelektual dhe artistik në shumë aspekte.

3.5.7 Udhëzime për vlerësimin

Vlerësimi përshkon gjithë procesin mësimor dhe i shërben përmirësimit të këtij procesi. Kurrikula e arteve, ndryshe nga lëndët e tjera, mbështetet në parimin e individualizimit, ku çdo nxënës zotëron dhe zhvillon prirje të veçanta, duke u shprehur në mënyrë individuale në forma të ndryshme të artit. *Nxitja, imagjinata, vëzhgimi, shprehja origjinale dhe krijuese, interesimi, përjetimi artistik, interpretimi dhe prezantimi* i punëve artistike janë forma të cilat ndihmojnë në vlerësimin e punës krijuese të nxënësve në arte. Gjithashtu, pjesëmarrja dhe performimi individual apo në grup, në aktivitetet artistike të ndryshme që organizohen në klasë, në shkollë dhe në komunitet janë pjesë e procesit të vlerësimit.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në rezultatet e të nxënësve dhe objekt i vlerësimit janë krijimi i kompetencave artistike të nxënësve në fushën e arteve përmes krijimit, performimit/realizimit dhe vlerësimit. Arritjet në fushën e arteve janë individuale, prandaj duhet edhe të vlerësohen si të tilla, por edhe në grup.

Kjo gjë bëhet në funksion të matjes së kompetencave artistike të caktuara që arrin të zhvillojë nxënësi gjatë procesit mësimor, vetëm ose në grup, përmes veprimtarisë praktike d.m.th., përmes *të kënduarit, të aktrimit të një pjese tekstuale letrare, të dëgjuarit muzikor apo letrar i një veprë, të krijuarit e punëve dy dhe tredimensionale, të analizuarit të pjesëve artistike* etj. Nxënësit vlerësohen ndërsa demonstrojnë arritjet në punët konkrete artistike në mënyrë të vazhdueshme, vlerësohen për detyra përmbyllëse për grup njohurish nëpërmjet një produkti konkret dhe nëpërmjet dosjeve personale të nxënësit.

Vlerësimi i nxënësit kryhet nëpërmjet:

- vlerësimit të vazhduar;
- vlerësimit me detyrë përmbyllëse;
- vlerësimin me projekt kurrikular.

Vlerësimi i vazhduar për të nxënë është pjesë e mësimdhënies dhe motivon përparimin e nxënësit në të gjitha aspektet e të nxënësit, në situata të ndryshme të njohura dhe të panjohura.

Vlerësimi i të nxënit me **detyrë përmbledhëse** përdoret për të mbledhur prova dhe të dhëna që tregojnë nëse mësimdhënia ka realizuar qëllimin e saj. Zakonisht planifikohet në fund të një njësie apo të një periudhe të caktuar. Ky është një vlerësim i cili kryhet edhe për efekt raportimi. Në përfundim të periudhës (kur e parashikon mësuesi) kryhet *vlerësimi me detyrë përmbledhëse*, i cili ka për qëllim të matë nivelin e arritjeve të nxënësit për një grup të caktuar rezultatesh të nxëni për periudhën përkatëse.

Vlerësimi i të nxënit me **projekt kurrikular**. Projekti si veprimtari integruese me karakter kërkimor e krijues, nxit zhvillimin e aftësive të larta të të menduarit, aftësive komunikuese, të bashkëpunimit, të përdorimit të TIK, të sipërmarrjes etj. Projekti nxit të nxënit dhe mësimdhënies me në qendër nxënësin përmes së cilës nxënësit në mënyrë të pavarur ose/dhe si një anëtar i një grupi hulumtojnë mbi një çështje të caktuar ose një problem të lidhur me jetën reale. Projekti kurrikular nuk duhet të përmbajë njohuri të reja.

3.5.8 *Materialet dhe burimet mësimore*

Artet studiohen përmes njohjes dhe përdorimit të mjeteve, materialeve, teknikave e procedurave specifike artistike, për secilën lëndë.

Në artin pamor, në këtë nivel kemi punët dy dhe tredimensionale, ilustrimet (foto, punime të artistëve, objekte nga natyra, ilustrime veprash arti) ose materiale të tilla, si: letra, pëlhura, plastelina, materiale organike etj. Ndërsa për dëgjim muzikor, shikim të shfaqjeve apo ekspozitave/veprave të ndryshme, ndjekje të pjesëve dramatike, këngëve apo veprave të artit përdoren magnetofon, TV, CD dhe DVD.

Përveç materialeve shfrytëzohen edhe burime mësimore si teksti shkollor, interneti etj.

Më poshtë janë dhënë disa nga mjetet didaktike më të përdorshme.

- *Mjetet*: fotografitë, vizatimet etj.
- *Mjetet audiovizive*: Tv, magnetofon, video, video-projektor, kompjuter, internet, CD, DVD etj.
- *Mjetet verbale, tekstet*: tekstet mësimore (të detyruara), libri i mësuesit, katalogë, albume që mund të përdoren në shkollë për të mbështetur punën e nxënësve dhe për të demonstruar vepra të ndryshme arti.
- *Mjedisi mësimor*: klasa, kabinetet e artit, salla për performancat dramatike etj.

3.6 Fusha e të nxënës: Edukimi fizik, sportet dhe shëndeti

3.6.1 Hyrje

Fusha mësimore “Edukimi fizik, sportet dhe shëndeti” në arsimin parauniversitar ndihmon që nxënësit të zhvillojnë njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet e nevojshme, të cilat sigurojnë mirëqenien e shëndetit të tyre mendor, emocional, fizik dhe social, si dhe të ndihmojnë që të përballin me sukses sfidat e jetës së tashme dhe të ardhshme.

Fusha e edukimit fizik, sporteve dhe shëndetit do të afrojë një qasje të integruar të edukimit fizik dhe sporteve me edukatën shëndetësore e cila ofron nxënësve njohuri dhe aftësi të nevojshme për të zhvilluar një stil jetese të shëndetshëm dhe aktive, ku përfshijnë shpalosjen e mënyrave të jetës së shëndetshme apo mbrojtjen prej sëmundjeve dhe rreziqeve prej tyre.

3.6.2 Qëllimi i fushës

Fusha mësimore “Edukimi fizik, sportet dhe shëndeti” ka si qëllim të shihet si një mjet për promovimin e veprimtarisë së rregullt fizike, edukimin e një stili jetese të shëndetshme e aktive dhe fitimin e kompetencave të rëndësishme e të vlefshme përgjatë gjithë jetës. Fusha e edukimit fizik, sporteve dhe shëndetit në Arsimin e Mesëm të Lartë i mundëson nxënësit:

- zbatimin në praktikë të mënyrave të thjeshta të dhënies së ndihmës së parë në raste të traumave që ndodhin gjatë veprimtarisë fizike, si dhe mënyrat e parandalimit të tyre;
- njohjen me kontributin e veprimtarisë fizike në arritjen e gjendjes së fitnesit, si dhe hartimin dhe vënien në praktikë të një plani individual pune dhe ushqimi, në funksion të përmirësimit të gjendjes fizike;
- njohjen me rrezikun që vjen si pasojë e përdorimit të substancave narkotike, si dhe efektin e tyre në performancën sportive;
- njohjen dhe aplikimin në praktikë të koncepteve dhe parimeve të Olimpizmit dhe Lëvizjes Olimpike;
- njohjen me lashtësinë historike të edukimit fizik e të sportit, si dhe me vlerat e tyre në zhvillimin e shoqërisë njerëzore;
- njohjen me zhvillimin e sportit dhe Lëvizjes Olimpike në vend, si dhe njohjen me emra të personaliteteve e sportistëve të vendit tonë në këtë fushë;
- njohja me organizimin e Lojërave Olimpike Verore e Dimërore;
- njohjen me burimet kryesore të marrjes së ndihmës shëndetësore;
- kryerjen e kombinacioneve lëvizore me përmbajtje të aftësive lëvizore bazë, të manipulimit

lëvizor me dhe pa mjete, si dhe elemente të thjeshta akrobatike;

- krijimin e kombinacioneve lëvizore ritmike shoqëruar me muzikë ose numërim;
- ekzekutimin e teknikave të duhura të vrapimeve (të shpejtë, të rezistencës, me pengesa, etj.);
- ekzekutimin e teknikave të kërcimeve: së gjati dhe së larti (stil “gërshërë”);
- ekzekutimin e teknikave të shtytjes dhe flakjes së objekteve (gjyle, shtizë, etj.);
- zbatimin e saktë të teknikave të veprimeve lëvizore të mësuara në lojërat lëvizore e tradicionale, si dhe njohjen dhe reflektimin mbi aspektin edukativ të tyre;
- ekzekutimin e teknikave të elementëve kryesore teknik e taktik të lojërave: basketboll, volejboll, futboll dhe hendboll si dhe zbatimi i tyre në lojëra;
- zbatimin e rregullave të marshimit dhe vrapimit në natyrë;
- zbatimin e shprehive bazë të një prej veprimtarive sportive të përfshira në nëntematikën “Veprimtari sportive ndihmëse (opsionale)”;
- arbitrimin (gjykimin) e ndeshjeve të basketbollit, volejbollit dhe futbollit.

3.6.3 Tematikat e fushës dhe përshkrimi i tyre

Fusha e edukimit fizik, sporteve dhe shëndetit, në Arsimin e Mesëm të Lartë zhvillohet përmes tematikave të mëposhtme:

1. Edukimi nëpërmjet veprimtarive fizike

- Lojëra lëvizore e popullore
- Gjimnastikë
- Atletikë

Edukimi fizik u ofron nxënësve një platformë nga e cila mund të formojnë kompetenca për të zhvilluar kapacitetet fizike e aftësitë koordinative që ndihmojnë në zhvillimin e mëtejshëm të aftësive personale dhe ndërpersonale. Kjo tematikë u mundëson nxënësve të zhvillojnë dhe krijojnë aftësitë e nevojshme për pjesëmarrje në një gamë të gjerë të veprimtarive fizike, sportive, kulturore që ndikon në rritjen e mirëqenies së tyre fizike dhe i përgatit për jetë aktive dhe të shëndetshme.

2. Veprimtari sportive

- Basketboll
- Volejboll
- Futboll

- Hendboll
- Veprimtari sportive ndihmëse

Sportet u mundësojnë nxënësve përforcimin e njohurive dhe përdorimin e shumë elementeve e kombinacioneve tekniko-lëvizore dhe taktike që përfshihen në lojërat sportive. Nëpërmjet këtyre lojërave sportive (basketboll, volejboll, futboll, hendboll etj.) nxënësit krijojnë e fitojnë kompetenca shumë të rëndësishme për jetën, zhvillojnë më tej cilësitë fizike, aftësitë e komunikimit dhe të punuarit në skuadër, duke e konsideruar sportin si mundësi për karrierë, zhvillojnë aftësitë për pranimin dhe ndarjen e përgjegjësisë, si dhe gëzimin e suksesit, mësohen të respektojnë rregullat e lojës dhe fair-play-t në aktivitetet sportive në shkollë e jashtë saj. Të gjitha këto së bashku përbëjnë një model të respektit ndaj rregullave demokratike të jetës qytetare, si dhe formimin e kulturës së të ushtruarit sportiv gjatë gjithë jetës.

3. Edukimi në shërbim të komunitetit, mirëqenies dhe shëndetit

- Mirëqenia fizike, mendore, emocionale dhe sociale.
- Diferencat gjinore.
- Ruajtja e organizmit nga dëmtimet e mundshme gjatë të ushtruarit në veprimtari fizike e sportive.
- Edukimi olimpik dhe Fair-Play.
- Rreziqet nga përdorimi i substancave që krijojnë varësi.
- Varësia nga drogat e rënda.

Edukimi shëndetësor u mundëson nxënësve fitimin e kompetencave për ruajtjen dhe kultivimin e shëndetit të tyre dhe të të tjerëve, u mundëson zhvillimin e respektit për vetveten dhe të tjerët, të praktikojnë mënyrat e ruajtjes së organizmit nga dëmtimet e mundshme gjatë të ushtruarit me veprimtari fizike e sportive, të zbatojnë rregullat e dhënies së ndihmës së parë, të zbatojnë mënyra të drejta të të ushqyerit dhe praktika të sigurta dhe higjienike në rutinën ditore, të zbatojnë parimet e filozofisë olimpike, të respektojnë edhe në jetën e përditshme rregullat e Fair-Play-t, të zhvillojnë të kuptuarit e efekteve negative të përdorimit të substancave narkotike, si dhe të bëhen të ndërgjegjshëm për nevojën e ruajtjes së një mjedisi të shëndetshëm, në të cilin ata mund të mbrojnë veten dhe të tjerët nga faktorët e rrezikshëm.

3.6.4 Përshkrimi i kompetencave që zhvillon fusha

Gjithë procesi i të nxënësve në fushën e edukimit fizik, sporteve dhe shëndetit organizohet rreth tri kompetencave specifike të fushës. Të tria kompetencat e fushës lidhen me njëra-tjetrën.

Kompetenca 1: Zhvillimi i aftësive lëvizore në përshtatje me situata të ndryshme lëvizore e sportive

Në këtë kompetencë përfshihen: koordinimi, rregullimi, kontrolli, ndjesitë dhe shprehitë, të cilat i referohen aftësisë për të ekzekutuar veprime të ndryshme lëvizore. Kjo aftësi zhvillohet në situata të larmishme të të nxënës të lidhura me lloje të shumta veprimtarish si p.sh., kombinime me përmbajtje të lëvizjeve lokomotore (vrapimi, ecja, notimi, çiklizmi, etj.), lëvizjeve jo lokomotore (kërcimi, goditja, xhonglimi etj.), lëvizjeve manipulative me dhe pa mjete, kombinimeve teknike e artistike (gjimnastika artistike e ritmike).

Kompetenca 2: Ndërveprimi me të tjerët në situata të ndryshme lëvizore e sportive

Ndërveprimi me të tjerët nxit nxënësit të angazhohen në një proces ku ata zhvillojnë plane të ndryshme të veprimit për të përshtatur e për të sinkronizuar lëvizjet e tyre me ato të të tjerëve, si dhe për të komunikuar me njëri-tjetrin. Nxënësit mësojnë punën në grup, kryejnë detyra të përbashkëta dhe pranojnë fitoren dhe humbjen. Duke pasur parasysh se nxënësit do të përballen me situata të ngjashme në jetën e tyre të përditshme, kjo kompetencë i ndihmon ata të zhvillojnë aftësitë sociale dhe gjykimet etike të favorshme për të ndërtuar marrëdhënie harmonike ndërpersonale.

Kompetenca 3: Përshtatja e një stili jete aktiv dhe të shëndetshëm

Të përshtatësh një stil jetese aktiv dhe të shëndetshëm do të thotë të krijosh mundësitë për të jetuar një jete, e cila karakterizohet nga një mirëqenie e përgjithshme fizike, mendore dhe emocionale, në të cilën një individ gëzon aftësi për të ekzekutuar çdo ditë detyra energjike dhe aktivisht, kryen me kënaqësi veprimtaritë e kohës së lirë dhe realizon lehtësisht kërkesat e ditës. Për një nxënësi kjo kompetencë zhvillohet me edukimin e zakoneve të shëndetshme, angazhimin në forma të ndryshme të veprimtarisë fizike e sportive, të ushqyerit në mënyrën e duhur, mos ekspozimin ndaj substancave që krijojnë varësi, krijimin e një modeli jetese që do të sillte efekte të pëlqyeshme afatshkurtra, afatmesme e afatgjata.

3.6.5 Rezultatet e të nxënës

Rezultatet e të nxënës në përfundim të klasës së 12-të
1. Edukim nëpërmjet aktiviteteve fizike
Nxënësi:

- përshtat skema të ndryshme lëvizore sipas situatave të veprimtarisë fizike ose lojës;
- demonstroi aftësi të përshtatjes dhe krijimit të lojërave të reja lëvizore (referuar lojërave të parashikuara në program);
- demonstroi koordinim në kryerjen dhe koordinimin e kombinimeve lëvizore me elemente të gjimnastikës aerobike, gjimnastikës ritmike dhe gjimnastikës në grup;
- zbaton teknikat e duhura në kryerjen e ushtrimeve për zhvillimin e qëndrueshmërisë, forcës dhe fleksibilitetit;
- demonstroi koordinim lëvizor të cilësive fizike në kryerjen e vrapimeve të shpejtësisë, në kryerjen e vrapimeve me kalim pengesash dhe qëndrueshmërisë;
- demonstroi koordinim lëvizor, bashkëpunim me shokët e skuadrës, si dhe nivel të kënaqshëm të cilësive fizike në kryerjen e stafetës (lojë dhe atletikore);
- demonstroi koordinim lëvizor të cilësive fizike në kryerjen e shtytjes së gjyles;
- demonstroi koordinim lëvizor të cilësive fizike në kryerjen e kërcimeve së gjati dhe trehapësh;
- krijojnë kompleks ushtrimor me elemente të gjimnastikës artistike, ritmike dhe aerobike;
- demonstroi koordinim lëvizor, bashkëpunim me shokët e skuadrës dhe nivel të kënaqshëm të cilësive fizike në kryerjen e stafetës në lojërat lëvizore;

2. Aktivitete sportive

Nxënësi:

- njeh dhe zbaton rregulloren teknike në kushtet e lojërave sportive të parashikuara në program;
- zbaton elementet teknike e taktike bazë, të lojërave sportive;
- zbaton në mënyrë të harmonizuar veprimet taktike të sulmit dhe të mbrojtjes në lojërat sportive;
- demonstroi aftësi bashkëpunimi me partnerin dhe respekt ndaj kundërshtarit në lojë;
- njeh dhe zbaton rregulloren teknike në kushtet e lojërave sportive;
- zbaton teknikat e duhura veprimeve lëvizore të lojërave sportive;
- zbaton elementet teknike e taktike bazë, të lojërave sportive;
- zbaton në mënyrë të harmonizuar veprimet taktike të sulmit dhe të mbrojtjes në lojërat sportive;
- demonstroi aftësi bashkëpunimi me partnerin dhe respekt ndaj kundërshtarit në lojë;
- demonstroi aftësi të orientimit në natyrë duke vendosur marrëdhënie të qëndrueshme me

të; - arbitron (gjykon) ndeshje basketbolli, volejbolli, hendbolli dhe futboll.
3. Praktikim aktiviteteve në shërbim të komunitetit, mirëqenies dhe shëndetit
Nxënësi: - menaxhon emocionet e tij dhe i përshtat ato në situata të ndryshme (pune në grupe, lojë në shkollë dhe jashtë saj etj.); - argumenton përfitimet që sjell zbatimi në jetën e përditshme të veprimtarisë së rregullt fizike dhe ndikimet pozitive tek shëndeti; - identifikon shenjat e mbilodhjes prej veprimtarisë fizike; - argumenton lashtësinë historike të edukimit fizik e të sportit dhe vlerat e tyre në zhvillimin e shoqërisë njerëzore; - përshkruan përmbajtjen dhe organizimin e lojërave olimpike dhe vlerën e tyre historike e shoqërore (simbolet dhe kuptimin e tyre etj.); - identifikon vlerat e veprimtarive të ndryshme edukative e sportive, si dhe ndikimin negativ të anabolizantëve (dopingut) në këto veprimtari; - identifikon shenjat e gjendjes së varësisë nga drogat, si dhe pasojat në organizmin e njeriut. - zbaton metoda të përshtatshme për kryerjen e veprimtarisë fizike e sportive, me qëllim shmangien e mbilodhjes dhe traumave fizike; - harton dhe vë në praktikë një plan individual pune në funksion të përmirësimit të gjendjes fizike, në përshtatje me ndryshimet dhe nevojat që trupi i tij paraqet në këtë moshë; - harton dhe vë në praktikë një plan individual të të ushqyerit të shëndetshëm, në përputhje me nevojat që organizmi i tij paraqet në lidhje me veprimtarinë fizike e sportive që ushtron; - zbaton mënyra të dhënies së ndihmës së parë në raste traumash të ndryshme që mund të ndodhin gjatë të ushtruarit me veprimtari fizike e sportive; - njeh historikun e zhvillimit të sportit dhe të lëvizjes olimpike në vend, si dhe kontributin e tyre në zhvillimin e shoqërisë shqiptare; - identifikon vlerat personale më të rëndësishme, si respekti, barazia, pranimi/mospranimi, toleranca dhe mungesa e tolerancës; - identifikon burimet kryesore të marrjes së ndihmës shëndetësore.
NJOHURI DHE KONCEPTE



- Elemente të lëvizjes
- Lëvizje manipulative
- Lëvizje lokomotore
- Lëvizje jolokomotore
- Lojë lëvizore
- Rregulla të lojës
- Lojë tradicionale (popullore)
- Morali i lojës
- Lojëra sportive
- Marshim në natyrë
- Rregullat e sigurisë
- Ndihma e parë
- Mënyra të të ushqyerit
- Filozofi olimpik
- Histori i edukimit fizik dhe sportiv
- Fair-Play
- Substanca që krijojnë varësi
- Anabolizantët në sport
- Burim i marrjes së ndihmës
- Komunitet
- Vlera personale
- Planifikim
- Karrierë

AFTËSI DHE SHKATHTËSI

Nxënësi:

- praktikon skema të ndryshme lëvizore;
- përshtat skema lëvizore në situata të ndryshme sportive;
- krijon;
- analizon;
- diskuton;
- ushtron të drejtat e veta;
- shpjegon;

- menaxhon emocionet;
- demonstroi sjelle, veprime, shprehje;
- zbaton parime;
- përshkruan llojet e ushqimit dhe aktivitetet fizike;
- qëndrim të drejtë trupor;
- ndërton bashkëpunim;
- harton plane individuale;
- hulumton;
- arbitron (gjykon).

QËNDRIME DHE VLERA

Nxënësi:

- respekton veten dhe të tjerët;
- është i përgjegjshëm;
- është tolerant;
- respekton diversitetin;
- është i përkushtuar;
- mban qëndrim pozitiv;
- është bashkëpunues;
- respekton kodin e mirësjelljes;
- respekton kodin e veshjes;
- respekton rregulloret;
- tregon gatishmëri;
- është i sigurt.

3.6.6 Ndarja e kohës

Në Arsimin e Mesëm të Lartë planifikohen 3 orë mësimore në javë për edukim fizik, sporte dhe shëndet, për secilën klasë. Sportet kanë peshën kryesore në ndarjen e orëve mësimore, pasi eksperiencat lëvizore dhe njohuritë e mësuara, finalizohen në situatat e lojërave sportive duke u shndërruar në kompetenca të mirëfillta.

Kurrikula bërthamë

Lëndët e fushës “Edukimi fizik, sportet dhe shëndeti”	Klasat X-XII (orë mësimore në javë)
Edukimi fizik, sportet dhe shëndeti	9 (3+3+3)

Kurrikula me zgjedhje

Lëndët e fushës “Edukimi fizik, sportet dhe shëndeti”	Klasat X-XII (orë mësimore në javë)
EDUKIMI FIZIK, SPORTET DHE SHËNDETI	3 (1+1+1)

3.6.7 Udhëzime metodologjike

Metodologjia e mësimdhënies në edukim fizik përdor metoda të ndryshme për të ndihmuar nxënësit të arrijnë qëllimet e tyre më të mira në fushën e edukimit fizik dhe sportit.

Organizimi i mirë i procesit të mësimit të edukimit fizik, sporteve dhe shëndetit do të thotë që nxënësit të vendosen në situata konkrete praktike, ku ata përjetojnë dhe provojnë elementet lëvizore e sportive. Aktivitetet lëvizore (loja dhe sporti) nuk janë thjesht argëtuese për ta, por një punë serioze që dominon shumicën e jetës së tyre, duke i thithur pjesën më të madhe të kohës e të energjisë, duke edukuar aftësi dhe duke formuar sjellje shoqërore. Në orët e mësimit të edukimit fizik, sportiv e shëndetësor mësohen praktika të sigurtat të cilat do t’i ndihmojnë në zgjidhjen dhe përballimin e shumë situatave.

Parimi nga më e thjeshta tek më e vështira, vendosja e themeleve më parë nënkupton se të rinjtë duhet mësojnë elemente të thjeshta teknike përpara se t’i përdorin në situata loje. Nxënësit duhet të kryejnë me sukses më parë elemente të veçuara akrobatike përpara se të ekzekutojnë kombinimet e tyre. Kur zotërohen mirë bazat, siguria tek aftësitë lëvizore është më e lartë, duke edukuar kështu të njëjtën siguri për të vazhduar në të njëjtën mënyrë gjatë gjithë jetës.

Disa nga fushat në të cilat edukimi fizik, sportet dhe shëndeti konsiderohet komponent për një mbarëvajtje dhe sukses të procesit mësimor janë:

- Edukimi fizik, sportet dhe shëndeti si komponent i fitnesit.

Promovimi i fitnesit gjatë gjithë jetës është një nga prioritetet e specialistëve të edukimit fizik, sidomos tani që ne jemi në mes të një krize obeziteti dhe në një periudhë në të cilën fëmijët dhe të rinjtë janë më shumë të prirur për jetë sedentare se në çdo periudhë tjetër të historisë së njerëzimit. Vënia e theksit tek fitnesi si pjesë e bazave të programeve të fushës/lëndës “Edukim fizik, sporte dhe shëndet” është parësore.

- Edukimi fizik, sportet dhe shëndeti si komponent i formimit edukativ e social.

Duke marrë pjesë në procesin mësimor të edukimit fizik, një nxënës ka filluar të mësojë shumë gjëra për jetën. Ai fiton në disa lojëra dhe humbet në disa të tjera, kjo e bën atë të kuptojë se fitorja dhe humbja janë një pjesë e jetës dhe duhet të pranohen si të tilla. Kur një nxënës bëhet pjesë e një ekipi, ai mëson se bashkëpunimi me të tjerët është shumë i rëndësishëm në qoftë se duhet të arrihen qëllimet. Duhet të respektohen rregullat e lojës, vendimet e gjyqtarit dhe kundërshtari. Gjithashtu, pjesëmarrja në praktika lëvizore e sportive mundëson zhvillimin mendor e intelektual të nxënësve në mënyrë argëtuese dhe të drejtpërdrejtë.

- Edukimi fizik, sportet dhe shëndeti si komponent i arteve.

Edukimi fizik dhe sportiv e gjen veten mjaft mirë si komponent i edukimit artistik, sepse ata janë të ndërlidhur me njëri-tjetrin. Edukimi fizik, sportet dhe shëndeti ndihmon të gjithë trupin e njeriut dhe vallëzimi e muzika që e shoqëron atë, gjithashtu. Sinkronizimi dhe ritmizimi si aftësi koordinative janë pjesë përbërëse të edukimit fizik e artistik, të cilët së bashku ndihmojnë në një zhvillim dhe formim më të plotë të nxënësit.

- Edukimi fizik, sportet dhe shëndeti si komponent i edukimit estetik.

Edukimit fizik mund të konsiderohet edhe nga mënyra se si ai ndikon pamjen dhe estetikën e një nxënësi. Kur një nxënës merr pjesë në aktivitete fizike, ai bëhet më i aftë dhe më tërheqës, formon një trup të bukur dhe më të shëndetshëm. E gjitha kjo ndihmon për të rritur vetëbesimin e tij, pasi çdokush dëshiron të ndihet mirë dhe të duket bukur.

3.6.8 Udhëzime për vlerësimin

Vlerësimi i nxënësit përshkon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi. Vlerësimi i nxënësit nuk ka për qëllim vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj. Ai mbështetet tërësisht në përmbajtjen e programit lëndor dhe mësuesi nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ato kompetenca që nuk përshkruhen në program.

Fokus i vlerësimit janë edhe qëndrimet e nxënësve, si qëndrimet etiko-sociale, në përgjithësi, dhe ato të bashkëpunimit me të tjerët, në veçanti. Mësuesi zhvillon vetë dhe ndihmon nxënësit të zhvillojnë një larmi mënyrash vlerësimi, si:

- Përdoren fjalë e shprehje inkurajuese gjatë të mësuarit.
- Korrigjohen me kujdes lëvizjet e gabuara.
- Shpallen lojtarët më të mirë në lojëra të ndryshme (lëvizore, tradicionale, para-sportive dhe sportive).
- Matet koha në sekonda e realizimit të veprimit lëvizor mbi bazën e progresit individual.

- Vlerësohet sasia në herë e përsëritjeve të veprimit lëvizor mbi bazën e progresit individual.
- Matet distanca në metra e arritur nga veprimi lëvizor mbi bazën e progresit individual.
- Vlerësohen me kompleks ushtrimesh dhe me pikë.
- Vlerësohen me sistem pikësh për ushtrimet e veçanta.
- Vlerësohen me sistem pikësh për vallëzimin e kompozuar.
- Vlerësohen me teste e pikë për kombinacionet teknike.
- Vlerësohen me pikë për veprime teknike individuale.
- Vlerësohen me pikë për skemat lëvizore të vrapimeve të ndryshme.

Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë saj. Nxënësi vlerësohet edhe ndërsa demonstroi aftësitë dhe qëndrimet e tij, duke u shfaqur nëpërmjet veprimtarive të tjera, si p.sh., pjesëmarrje në veprimtari të ndryshme sportive apo sportive-artistike, të cilat organizohen nga shkolla dhe më gjerë. Në angazhimin e nxënësve me grupe apo skuadra të vogla, mësuesi parashtron peshën e vlerësimit të grupit, në tërësi, dhe të secilit nxënësi, në veçanti.

Mësuesi nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësve në çdo orë mësimore dhe të vendosë nota për secilën orë mësimore. Si rregull, nxënësit dhe mësuesi duhet të jenë të lirshëm të bashkëbisedojnë si partnerë rreth përvetësimit të njohurive dhe të aftësive të fituara në orët e mëparshme. Herë pas here mësuesi duhet të vlerësojë me notë, duke ua bërë të qartë nxënësve që në fillim qëllimin e vlerësimit dhe kriteret e tij.

Vlerësimi i nxënësve me nevoja të veçanta duhet të bëhet në mënyrë të tillë që t'u japë atyre mundësinë të demonstrojnë çfarë dinë dhe mund të bëjnë në përmbushje të rezultateve të të nxënësit. Për këtë qëllim mësuesi duhet të përshtatë detyrat/veprimtaritë vlerësuese me mundësitë dhe nevojat që këta nxënës kanë. Këto modifikime mund të përfshijnë:

- ndryshime dhe përshtatjen në formën e kontrollit të lëvizjeve,
- në formën e kryerjes të veprimeve lëvizore,
- në modelin e kërkesave lëvizore të ushtrimit,
- sipas formës së problematikës së nxënësit me nevoja të veçanta,
- duke i dhënë kohë shtesë nxënësit,
- me pauza të ndërmjetme,
- duke përdorur mjete specifike.

3.6.9 Materialet dhe burimet mësimore

Për zbatimin me sukses të fushës/lëndës “Edukim fizik, sporte dhe shëndet” është e rëndësishme të përdoren burime të ndryshme mësimore që të motivojnë nxënësin dhe të nxitin progresin e tij në mënyrë që të përvetësojë shprehje dhe shkathhtësi të nevojshme për jetën. Bazat materiale e sportive janë burime të vlefshme dhe të rëndësishme të nxënësve, por qasja e nxënësve në informacion nuk duhet kufizuar vetëm në to, por duhet të mundësohen edhe burime tjera, të cilat i shërbejnë për të planifikuar dhe për të realizuar sa më me cilësi procesin mësimor në klasë. Për realizimin e mësimin duhet të përdoren një spektër i gjerë i burimeve mësimore, përfshirë bazën materiale-sportive, udhëzuesin kurrikular për mësuesin, veprimtari të ndryshme sportive, projekte, studime, analiza dhe raporte të ndryshme, si dhe libra të fushave mësimore që mundësojnë qasje ndërkurrikulare.

3.7 Fusha e të nxënësve: Teknologji dhe TIK-u

3.7.1 Hyrje

Arsimi teknologjik është një komponent thelbësor i kurrikulës ku nxënësit zhvillojnë aftësitë digjitale për të përdorur TIK-un dhe disiplinat e tij në mënyrë efektive dhe të përshtatshme me qëllim krijimin dhe komunikimin e informacioneve dhe ideve, për të zgjidhur probleme dhe për të ndërvepruar në mjedise të ndryshme.

Ndryshimet digjitale dhe teknologjitë e reja si inteligjenca artificiale, po zbatohen në të gjitha aspektet e shoqërisë, ekonomisë dhe mjedisit, duke çuar në një ritëm më të shpejtë të ndryshimeve. Nxënësit tashmë po përjetojnë një integrim të thellë të teknologjisë në jetën e përditshme, prandaj arsimi duhet t’u përgjigjet me produkte cilësore për të transmetuar njohuri e aftësi sistematike, koherente dhe të qëndrueshme tek ta, duke garantuar krijimin e një të ardhmeje më të sigurt dhe produktive për të gjithë. Është thelbësore që nxënësit të jenë përdorues efektivë të Teknologjisë dhe TIK-ut dhe jo përdorues pasivë, duke siguruar njohuri, aftësi dhe qëndrime, të cilat rrisin besimin e nxënësve përgjatë ndërveprimit në një shoqëri që po drejtohet gjithmonë e më shumë nga teknologjia.

Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit ka ripërcaktuar dinamikën e komunikimit dhe bashkëpunimit, duke nxitur një komunitet global ku nxënësit mund të ndërveprojnë me bashkëmoshatarët e tyre, mësuesit dhe ekspertë edukimi nga e gjithë bota. Kjo gjë jo vetëm që rrit aftësitë e tyre ndërpersonale, por gjithashtu i ekspozon ata ndaj perspektivave dhe kulturave të ndryshme, duke kontribuar në një kuptim më të gjerë të peizazhit global. Nxënësit e moshës digjitale vijnë në shkollë me njohuri, gjykime, opinione dhe pyetje të marra nga burime të pafundme digjitale, të cilat mësuesi duhet t’i konsiderojë si pjesë të kurrikulës në tërësinë e saj.

“Teknologjia dhe TIK-u” është shndërruar një formë të veçantë të veprimtarisë krijuese, ku nxënësit ndërveprojnë në mjedise të ndryshme duke përdorur materialet, inputet dhe proceset e duhura në përgjigje të nevojave, dëshirave dhe mundësive të tyre. Është e rëndësishme që nxënësit të vlerësojnë dhe të kuptojnë marrëdhënien komplekse ndërmjet teknologjisë dhe shoqërisë. Si qytetarë, ata duhet të jenë të aftë të bëjnë gjykime vetjake mbi çështjet që lidhen me ndikimin e teknologjisë në jetët e tyre, në shoqëri dhe në mjedis. Nxënësit duhet të aplikojnë njohuritë për zgjidhjen e problemeve dhe aftësitë praktike në prodhimin e produkteve dhe të sistemeve të dobishme të pranishme në shumë fusha.

Prandaj bazuar në një shoqëri të orientuar nga teknologjia dhe ndryshimet digjitale, lind natyrshëm nevoja për individë, të cilët zotërojnë aftësi dhe njohuri shumë të mira në fushën e TIK-ut dhe Teknologjisë.

3.7.2 Qëllimi i fushës

Fusha "Teknologji dhe TIK" ka për qëllim të zhvillojë tek nxënësit aftësi dhe njohuri që lidhen me përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK). Qëllimi kryesor i kësaj fushe është të përgatisë nxënësit për një shoqëri gjithnjë e më shumë të digjitalizuar dhe të sigurojë që ata të jenë të aftë të përdorin teknologjinë në mënyrë efektive dhe etike.

- Të mundësojë zhvillimin e aftësive themelore në përdorimin e kompjuterit dhe pajisjeve digjitale, duke përfshirë sistemet operative dhe aplikacionet bazë, për të përgatitur nxënësit për përdorimin efektiv të teknologjisë në kontekste të ndryshme.
- Të inkurajojë zhvillimin e mendimit kritik dhe aftësive për zgjidhjen e problemeve, duke përdorur teknologjinë dhe të menduarin kompjuterik për të analizuar dhe adresuar probleme të jetës së përditshme në mënyrë inovative.
- Të promovojë krijimtarinë dhe inovacionin përmes përdorimit të teknologjisë, duke nxitur nxënësit të krijojnë përmbajtje digjitale, përfshirë grafikë, video, animacione dhe projekte të tjera kreative.
- Të përmirësojë aftësitë e komunikimit dhe bashkëpunimit në mjedisin digjital, duke përdorur platforma dhe mjete digjitale për komunikim të sigurt dhe interaktivitet cilësor në mjediset virtuale.
- Të rrisë ndërgjegjësimin për përdorimin e përgjegjshëm dhe etik të teknologjisë, duke edukuar nxënësit për rëndësinë e privatësisë dhe mbrojtjen e të dhënave personale.
- Të edukojë nxënësit për praktikatat e qëndrueshme në përdorimin e teknologjisë, duke i ndërgjegjësuar për ndikimin mjedisor të pajisjeve digjitale dhe duke promovuar mënyra për

të reduktuar ndikimin negativ në mjedis.

- Të rrisë ndërgjegjësimin për sigurinë digjitale duke edukuar nxënësit për rreziqet e mundshme online dhe për masat që duhet të ndërmarrin për të siguruar mbrojtjen e pajisjeve dhe sistemeve kompjuterike.
- Të kontribuojë në një edukim të balancuar, duke iu dhënë nxënësve një përvojë të gjerë dhe sfiduese, që do t'u krijojë mundësi atyre të fitojnë një grup njohurish, kuptimesh, aftësish njohëse e përpunuese dhe kompetenca të thjeshta, duke i përgatitur në këtë mënyrë që të jenë pjesëmarrës në një botë teknologjike.
- Të sigurojë një kontekst, në të cilin nxënësit mund të zbulojnë dhe vlerësojnë ndikimin e teknologjive në ekonomi, në shoqëri dhe në mjedisin përreth.

3.7.3 Tematikat e fushës dhe përshkrimi i tyre

Arkitektura dhe menaxhimi i sistemeve kompjuterike: Kjo tematikë ofron një hyrje në parimet dhe konceptet themelore të organizimit strukturor të komponentëve kompjuterik. Nxënësit eksplorojnë funksionimin e brendshëm të sistemeve kompjuterike, duke kuptuar se si komponentët hardwerik ndërveprojnë dhe bashkëpunojnë me njëri-tjetrin për të ekzekutuar programet në mënyrë efikase. Ata thellojnë njohuritë e tyre për strukturën dhe funksionimin e sistemeve kompjuterike si eksplorojnë arkitekturën e sistemeve kompjuterike dhe menaxhimin e burimeve përmes sistemeve operative. Në këtë tematikë nxënësit gjithashtu zhvillojnë aftësi në konfigurimin dhe administrimin e rrjetave kompjuterike dhe mësojnë të zgjidhin problemet që lidhen me performancën e sistemeve dhe administrimin e burimeve.

Menaxhimi i të dhënave dhe databasave: Në këtë tematikë, nxënësit zhvillojnë njohuri dhe aftësi në menaxhimin e të dhënave dhe krijimin e bazave të të dhënave. Përmes studimit të koncepteve themelore dhe praktikave të ndryshme, ata fitojnë një kuptim të gjerë të projektimit, krijimit, administrimit dhe sigurimit të bazave të të dhënave. Nxënësit përdorin SQL për të manipuluar të dhënat dhe për të realizuar operacione mbi bazat e të dhënave. Ata gjithashtu zhvillojnë aftësi për të krijuar dhe menaxhuar baza të të dhënash, për të analizuar dhe interpretuar informacionin në mënyrë efektive.

Algoritmika dhe programimi: Në këtë tematikë, nxënësit thellojnë njohuritë e tyre në algoritmikë dhe programim, ata mësojnë të krijojnë dhe optimizojnë algoritme për zgjidhjen e problemeve dhe zhvillojnë aftësi në programimin me gjuhë të ndryshme,. Nxënësit eksplorojnë konceptet e strukturave të të dhënave, si dhe parimet e programimit të orientuar drejt objekteve. Kjo tematikë synon të synon të pajis nxënësit me njohuri lidhur me dizenjimin efektiv të

algoritmeve dhe krijimin e programeve softwerike me qëllim zgjidhjen e problemeve të ndryshme.

Web development: Në këtë tematikë, nxënësit zhvillojnë aftësi për të krijuar dhe menaxhuar faqe dhe aplikacione web. Ata mësojnë të përdorin gjuhët HTML, CSS, JavaScript dhe PHP për ndërtimin dhe stilizimin e faqeve web. Nxënësit eksplorojnë teknikat e zhvillimit për frontend dhe backend, si dhe proceset menaxhimit të aplikacioneve web. Kjo tematikë përqendrohet në dhënien e një kuptim solid të gjuhëve të programimit, framework-eve dhe teknologjive të përdorura në dizejnimin dhe zhvillimin e faqeve të internetit, si dhe synon t'i pajisë nxënësit me njohuri dhe aftësi për krijimin dhe zhvillimin e faqeve të internetit që janë estetike, funksionale dhe të përdorshme.

Krijimi dhe menaxhimi i përmbajtjes multimediale: Në këtë tematikë, nxënësit zhvillojnë aftësi në krijimin dhe menaxhimin e përmbajtjeve multimediale dhe vizuale. Ata mësojnë të përdorin mjete për përpunimin e imazheve, videove dhe audios, dhe krijojnë përmbajtje të diversifikuara për platforma të ndryshme. Nxënësit eksplorojnë teknikat për optimizimin e përmbajtjes për publikim dhe shpërndarje, dhe zhvillojnë projekte që përfshijnë përpunimin e imazheve dhe krijimin e videove dhe prezantimeve interaktive. Kjo tematikë ndihmon në zhvillimin e aftësive krijuese dhe teknike për menaxhimin e përmbajtjes multimediale.

Siguria kibernetike dhe mbrojtja e informacionit: Në këtë tematikë, nxënësit zhvillojnë njohuri dhe aftësi për të menaxhuar sigurinë kibernetike dhe mbrojtjen e informacionit. Ata mësojnë për kërcënimet dhe rreziqet që lidhen me përdorimin e teknologjisë dhe mënyrat për të mbrojtur të dhënat personale. Nxënësit eksplorojnë praktika për sigurimin e informacionit, si përdorimi i fjalëkalimeve të sigurta, enkriptimi i të dhënave, dhe përdorimi i mjeteve të sigurisë si antivirus dhe firewalls. Kjo tematikë kontribuon në zhvillimin e aftësive për të ndjekur dhe zbatuar strategjitë e mbrojtjes së informacionit, duke adresuar gjithashtu sfidat etike dhe ligjore të përdorimit të teknologjisë së informacionit.

Teknologjitë në zhvillim: Në këtë tematikë, nxënësit eksplorojnë tendencat dhe inovacionet më të fundit në teknologji. Ata mësojnë për teknologjitë dhe ndikimin e tyre në fushat e ndryshme të jetës dhe ekonomisë. Nxënësit shqyrtojnë aplikimet e inteligjencës artificiale, , internet of things (IoT), cloud computing dhe realitetin virtual. Kjo tematikë ndihmon në zhvillimin e aftësive për të kuptuar dhe vlerësuar ndikimin e teknologjive të reja dhe për t'u përgatitur për sfidat dhe mundësitë që ato ofrojnë.

3.7.4 Përshkrimi i kompetencave që zhvillon fusha

Lënda: Teknologji Informacioni dhe Komunikimi

Operimi teknologjik dhe informacioni: Kjo kompetencë përfshin aftësinë për të përdorur në mënyrë efektive teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (TIK) për të kërkuar, vlerësuar, analizuar dhe menaxhuar informacionin. Ndërmjet kësaj kompetence synohet zhvillimi i njohurive për përdorimin e pajisjeve kompjuterike, programeve softuerike, aplikacioneve të ndryshme, si dhe aftësinë për të kuptuar dhe menaxhuar arkitekturën e sistemeve kompjuterike, menaxhimin e burimeve përmes sistemeve operative dhe zgjidhjen e problemeve që lidhen me performancën dhe administrimin e rrjetave kompjuterike.

Menaxhimi dhe administrimi i të dhënave: Kjo kompetencë lidhet me aftësinë për të mbledhur, organizuar, ruajtur dhe analizuar të dhëna në mënyrë të efektshme dhe të sigurt. Ajo përfshin njohuritë për përdorimin e mjeteve dhe teknologjive të ndryshme për krijimin dhe menaxhimin e bazave të të dhënave, si dhe aftësinë për të kuptuar dhe zbatuar praktikën më të mirë në ruajtjen e integritetit dhe privatësisë së të dhënave. Gjithashtu, kjo kompetencë përfshin aftësinë për të interpretuar dhe vizualizuar të dhëna, duke përdorur teknika dhe mjete të për të nxjerrë përfundime të vlefshme dhe për të prezantuar informacionin në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme.

Krijimi i përmbajtjes digjitale: Kjo kompetencë lidhet me aftësinë për të krijuar, modifikuar dhe ndarë përmbajtje digjitale. Kjo përfshin njohuritë për përdorimin e mjeteve dhe platformave të ndryshme për krijimin e tekstit, grafikave, videove, audiove, blogjeve, forumeve, website-ve dhe formave të tjera të përmbajtjes digjitale. Po ashtu kjo kompetencë përfshin edhe zhvillimin e njohurive për menaxhimin e të drejtave të autorit dhe licencave digjitale.

Komunikimi dhe bashkëpunimi: Kjo kompetencë përfshin aftësinë për të përdorur mjetet dhe platformat digjitale për të komunikuar dhe bashkëpunuar me të tjerët. Kjo përfshin aftësinë për të ndarë informacionin, për të punuar në projekte të përbashkëta, për të marrë pjesë në diskutime online, për të përdorur mediat sociale dhe për të menaxhuar komunikimet në mjedise të ndryshme virtuale. Po ashtu përfshin edhe aftësinë për të ndërtuar dhe mbajtur marrëdhënie efektive në internet.

Të menduarit kompjuterik dhe programimi: Kjo kompetencë lidhet me aftësinë për të aplikuar mendimin logjik dhe algoritmik për të analizuar dhe zgjidhur probleme nëpërmjet

mjeteve digjitale. Kjo përfshin aftësitë për të dizajnuar dhe zhvilluar algoritme, për të koduar, për të analizuar të dhëna, për të modeluar probleme dhe për të gjetur zgjidhje optimale ndërmjet përdorimit të mjeteve digjitale dhe aplikimeve të të menduarit kompjuterik.

Siguria dhe mbrojtja: Kjo kompetencë përfshin aftësinë për të mbrojtur veten dhe informacionin nga rreziqet dhe kërcënimet në mjedisin digjital. Ajo përfshin njohuritë dhe praktikën për sigurinë kibernetike, përdorimin e fjalëkalimeve të sigurt dhe mbrojtjen kundër virusëve dhe malwareve. Gjithashtu përfshin menaxhimin e privatësisë dhe mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe aftësinë për të njohur dhe reaguar në mënyrë të sigurt duke respektuar parimet e qytetarisë digjitale.

Inovacioni digjital: Kjo kompetencë përfshin aftësinë për të krijuar dhe zbatuar ide të reja dhe kreative në mjediset digjitale, duke përdorur teknologji të avancuara për të zhvilluar zgjidhje inovative. Ndërmjet kësaj kompetence nxënësit zhvillojnë aftësi për të identifikuar mundësi për përmirësim dhe transformim digjital, si dhe për të eksperimentuar me mjete dhe teknika të reja për të krijuar produkte, shërbime ose procese që sjellin vlerë të shtuar. Kjo kompetencë gjithashtu nxit aftësinë për të menduar në mënyrë kritike dhe për të bashkëpunuar në ekip me qëllim aplikimin e projekteve inovative që adresojnë nevoja dhe sfida të ndryshme në shoqërinë moderne digjitale.

3.7.5 Rezultatet e të nxënit sipas fushës

Rezultatet e të nxënit në fund të klasës së 12-të
Arkitektura dhe menaxhimi i sistemeve kompjuterike
Nxënësi: - analizon funksionet dhe performancën e komponentëve të sistemit kompjuterik, duke përfshirë procesorin, memorien RAM/ROM, hard-diskun dhe komponentët e tjerë, si dhe vlerëson ndikimin e këtyre komponentëve në performancën e përgjithshme të sistemit. - kupton organizimin dhe funksionimin e CPU-së, përfshirë ciklin fetch-execute, konceptin e pipelining dhe procesimin paralel, duke analizuar ndikimin e tyre në performancën e sistemit. - identifikon hierarkinë e memories dhe aplikon teknikat e hartës cache dhe menaxhimit të kujtesës për të përmirësuar performancën e sistemit. - kryen instalimin dhe konfigurimin e pajisjeve harduerike të ndryshme, diagnostikon dhe

zgjdh probleme në pajisjet harduerike duke aplikuar teknika të përshtatshme. - realizon operacione aritmetike në sisteme të numrave binar dhe decimal, duke përfshirë konvertimin dhe realizimin e veprimeve të mbledhjes dhe zbritjes. - konfigurron rrjete kompjuterike të thjeshta, duke përfshirë lidhjen e disa kompjuterëve përmes pajisjeve si routerë dhe switches, dhe identifikon parametrat bazë të rrjetit. - kupton dhe menaxhon burimet e sistemit duke përfshirë memorien, hapësirën në disk dhe procesorin, si dhe kryen aktivitete për optimizimin e performancës së sistemit operativ për të siguruar që sistemi të funksionojë në mënyrë efikase.
Menaxhimi i të dhënave dhe databasave
Nxënësi: - përshkruan dhe shpjegon konceptet themelore të bazave të të dhënave dhe rolin e tyre në ruajtjen, menaxhimin dhe analizimin e informacionit në organizata. - krijon dhe interpreton modele të bazave të të dhënave, duke përfshirë diagramet ER dhe përdorimin e teknologjive të ndryshme për modelimin e të dhënave. - familjarizohet me programin Microsoft Access për të krijuar dhe menaxhuar tabela, për të kryer operacione bazë si modifikimi, shtimi dhe fshirja e të dhënave, dhe për të krijuar formularë dhe raporte. - përdor komandat SQL për të manipuluar të dhënat në bazat e të dhënave, duke krijuar dhe ekzekutuar kërkesa për të nxjerrë, filtruar, përditësuar dhe fshirë të dhëna, si dhe për të realizuar operacione komplekse mbi informacionin e ruajtur. - menaxhon lidhjet midis tabelave për të ruajtur integritetin e të dhënave dhe aplikon teknikat e normalizimit për të eliminuar redundancën. - implementon praktikatat e sigurisë në bazat e të dhënave, duke përfshirë kontrollin e qasjes, autorizimin, dhe përdorimin e triggers dhe eventeve për automatizimin e operacioneve. - analizon trendet e reja si cloud computing dhe big data, dhe përshkruan ndikimin e tyre në menaxhimin dhe analizimin e të dhënave.
Algoritmika dhe programimi
Nxënësi: - përshkruan konceptet themelore të algoritmikës dhe programimit, duke përfshirë strukturat e të dhënave dhe algoritmet kryesore për zgjidhjen e problemeve. - përdor teknika të dizajnit të algoritmeve për të optimizuar performancën e kodit dhe për të minimizuar kompleksitetin e tij.

- dallon dhe aplikon strukturat algoritmike lineare, të degëzuara dhe ciklike për të krijuar dhe implementuar algoritme që ndjekin sekuenca të ndryshme veprimesh.
- identifikon dhe aplikon metodat për verifikimin e korrektësisë dhe efikasitetit të algoritmeve dhe zhvillon aftësi për të testuar dhe optimizuar kodin.
- kupton rolin e assembler, interpretuesit dhe kompilatorit në përkthimin e kodit nga gjuhët e programimit në gjuhën e makinës.
- identifikon dhe përdor elementët thelbësorë të gjuhëve të programimit, duke përfshirë sintaksën, variablat, tipet e të dhënave, operatorët, instruksionet kushtëzuese dhe strukturat ciklike.
- përdor konceptet e OOP-së për të krijuar dhe menaxhuar klasa dhe objekte në gjuhët e programimit të orientuar drejt objekteve, duke përfshirë përdorimin e trashëgimisë, polimorfizmit, dhe inkapsulimit për të zhvilluar kod të strukturuar dhe të ripërdorshëm.
- analizon dhe përmirëson programet duke përdorur teknika të debugging dhe testimit për të identifikuar dhe korrigjuar gabimet në kod.
- krijon dhe menaxhon projekte në gjuhë të ndryshme programimi për të zhvilluar dhe praktikuar aftësitë e programimit.

Web development

Nxënësi:

- krijon dhe dizajnon faqe interneti duke përdorur HTML, CSS dhe JavaScript, duke përfshirë strukturën, stilizimin e elementëve dhe shtimin e funksionaliteteve dinamike.
- aplikon parimet e dizajnit të përdorshëm dhe responsiv për të krijuar faqe që janë të lehta për t'u naviguar dhe që adaptohen në pajisje të ndryshme.
- përshkruan dhe përdor komponentët bazë të një faqe interneti, duke përfshirë tituj, menutë e navigimit, zonat e përmbajtjes dhe identifikon rolet e zhvilluesve në frontend dhe backend.
- kupton funksionin e shfletuesve të internetit dhe ndërveprimin e tyre me webserverat për të shfaqur dhe menaxhuar përmbajtjen e webit.
- aplikon teknikat e CSS për stilizimin dhe dizajnimin e faqeve web, duke përfshirë përdorimin e selektorëve dhe atributëve të ndryshme të stilizimit.
- identifikon parimet e 'user interface' dhe 'user experience' për të krijuar faqe që janë të lehta për t'u naviguar dhe që ofrojnë një përvojë pozitive për përdoruesit.
- përdor JavaScript për të shtuar funksionalitete interaktive në faqet e internetit, duke

krijuar dhe përdorur funksione, objekte dhe evente me qëllim ndikimin në sjelljen e elementeve dhe ndërveprimin me përdoruesin. - zbaton PHP për të krijuar dhe menaxhuar aplikacione dinamike në web, duke përfshirë instalimin, konfigurimin dhe përdorimin e funksioneve të PHP për të përpunuar të dhënat dhe validimin e formularëve.
Krijimi dhe menaxhimi i përmbajtjes multimediale
Nxënësi: - përdor mjete të specializuara për të krijuar dhe redaktuar përmbajtje multimediale, përfshirë imazhe, video dhe audio, duke siguruar që përmbajtja të jetë e optimizuar për cilësi dhe format të ndryshme. - zhvillon projekte që përfshijnë krijimin dhe shpërndarjen e materialeve multimediale në platforma të ndryshme, duke aplikuar teknika të optimizimit në performancë. - krijon dhe menaxhon prezantime dhe materiale interaktive duke integruar në mënyrë të efektshme video, imazhe dhe audio, për të ofruar përvoja të pasura dhe tërheqëse që angazhojnë dhe informojnë audiencën. - përdor teknika avancuara për përpunimin e imazheve dhe videove, duke përfshirë redaktimin, shtimin e efekteve dhe krijimin e grafikave.
Siguria kibernetike dhe mbrojtja e informacionit
Nxënësi: - përshkruan kërcënimet dhe rreziqet që lidhen me përdorimin e teknologjisë dhe shpjegon rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave personale. - identifikon dhe përdor praktikat e sigurta për mbrojtjen e informacionit, përfshirë përdorimin e fjalëkalimeve të forta dhe teknikave të enkriptimit. - krijon dhe implementon strategji për sigurimin e sistemeve dhe informacionit duke përdorur mjete të sigurisë si antivirusë dhe firewalls. - analizon dhe adreson sfidat etike dhe ligjore të lidhura me përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe mbrojtjen e të dhënave. - përdor teknika të thjeshta të monitorimit dhe auditimit për të ndjekur dhe vlerësuar nivelin e sigurisë në sistemet dhe informacionet e mbrojtura.
Teknologjitë në zhvillim
Nxënësi: - përshkruan ndikimin e teknologjive të reja si Inteligenca Artificiale (AI) në fushat e

ndryshme të jetës dhe ekonomisë, duke identifikuar aplikimet dhe përfitimet e saj. - analizon rëndësinë e të dhënave në zhvillimin e inteligjencës artificiale, dallon llojet e të dhënave dhe përshkruan algoritmet bazë të vendimmarrjes dhe përdorimin e tyre në modele dhe procese automatizimi. - interpreton çështjet etike dhe rreziqet e sigurisë në përdorimin e AI, përfshirë dezinformimin dhe manipulimin, si dhe zhvillon projekte të thjeshta praktike duke përdorur inteligjencën artificiale. - kupton dhe vlerëson ndikimin e Internet of Things (IoT) në përmirësimin e efikasitetit dhe përmirësimin e jetës së përditshme përmes lidhjes dhe automatizimit të pajisjeve të ndryshme. - analizon avantazhet dhe sfidat e përdorimit të Cloud Computing për ruajtjen dhe menaxhimin e të dhënave në internet, duke përfshirë aspektet e sigurisë dhe kostos. - zhvillon aftësi për t'u adaptuar ndaj ndryshimeve teknologjike, duke vlerësuar mundësitë dhe sfidat që ato ofrojnë.
KONCEPTET THEMELORE
- Komponentë hardwerikë dhe arkitektura kompjuterike - Rrjeta kompjuterike - Sisteme operimi - Instalimi dhe konfigurimi i pajisjeve kompjuterike - Modelet e bazave të të dhënave - SQL dhe manipulimi të dhënave - Normalizimi i të dhënave - Strukturat e të dhënave dhe algoritmet kryesore - Programimi i orientuar drejt objekteve (OOP) - Kodim - Parimet e dizenjimit të faqeve të internetit - HTML, CSS, JavaScript dhe PHP - Përmbajtja digjitale dhe multimedia - Siguria kibernetike - Inteligjenca artificiale
QËNDRIME DHE VLERA
Nxënësi:

- shpreh kuriozitet dhe entuziazëm për teknologjinë dhe eksploron se si mund të përdoren mjetet teknologjike për të zgjidhur probleme të ndryshme;
- zhvillon një ndjenjë përgjegjësie për mbrojtjen e informacionit;
- mëson të jenë fleksibël dhe të adaptohet ndaj ndryshimeve të shpejta në teknologji dhe në mënyrën e përdorimit të saj;
- inkurajohet të përdorë kreativitetin për të dhënë zgjidhje inovative për problemet teknologjike dhe për të zhvilluar përmbajtje digjitale;
- vlerëson dhe zbaton në praktikë njohuritë e nevojshme për çështjet e shëndetit dhe të sigurisë;
- kupton rëndësinë e punës në grup dhe bashkëpunimit me nxënësit e tjerë dhe për të siguruar një mjedis të sigurt në laboratorin e TIK-ut;
- mendon në mënyrë kritike dhe kërkon informacione të reja duke ndihmuar në zhvillimin e aftësive për të mësuar gjatë gjithë jetës;
- tregon integritet në aksesimin dhe përdorimin etik të informacionit;
- ndan me të tjerët përvojat dhe njohuritë e përftuara nga vëzhgimet individuale;
- pranon dhe reflekton mbi feedback-un për të përmirësuar performancën në projektet dhe aktivitetet teknologjike.

3.7.6 Ndarja e kohës

Fusha kurrikulare “Teknologjia dhe TIK-u” në kurrikulën bërthamë përfshin aktivitete që mundësojnë zhvillimin e aftësive, qëndrimeve dhe vlerave për të kërkuar, mbledhur e përpunuar informacionin, për ta përdorur atë në mënyrë kritike dhe sistematike dhe përdorimin e teknologjive me qëllim zgjidhjen e problemeve të ndryshme apo zhvillimin e njohurive të reja. Kjo fushë kërkon gjithashtu një qëndrim kritik dhe reflektues ndaj përdorimit të teknologjive të ndryshme, duke vlerësuar përkatësinë dhe rolin e tyre në jetën e përditshme. Kjo fushë përfshin lëndët: TIK, Baza inxhinierike dhe Teknologji

Kurrikula bërthamë

Lëndët e fushës “Teknologji dhe TIK”	Klasat X-XII (orë mësimore në javë)
TIK	3 (2+1+0)

Kurrikula me zgjedhje

Lëndët e fushës “Teknologji dhe TIK”	Klasat X-XII (orë mësimore në javë)
--------------------------------------	--

TIK	3 (0+1+2)
Baza e inxhinierisë dhe Teknologjisë	3 (0+1+2)
Totali:	6

3.7.7 Udhëzime metodologjike

Përdorimi i metodologjive efikase në procesin e të nxënësve është kusht në rritjen e cilësisë së arritjeve nga ana e nxënësve, duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin që zotëron brenda vetes. Mësimdhënia në fushën e Teknologjisë dhe TIK, udhëhiqet nga parimi që çdo nxënës është i aftë të përvetësojë kompetencën digjitale dhe synon gjithëpërfshirjen, motivimin, barazinë në të gjitha aspektet duke u bazuar në mësimdhënien/ nxënien që ndërton kompetenca dhe mësimdhënien me në qendër nxënësin.

Metodologjia e zbatimit të kurrikulës bërthamë luan rol thelbësor për përmbushjen e qëllimeve të fushës “Teknologji dhe TIK. Të nxënësve përmes kësaj fushe mund të realizohet me anë të pjesëmarrjes aktive të nxënësve, në mënyrë që ata të kuptojnë, të brendësojnë, të vlerësojnë dhe të përdorin përmbajtjen e synuar për të ndërtuar mbi të njohuri, aftësi dhe shkathtësi digjitale në situata të ndryshme me të cilat do të përballen në të ardhmen. Mësuesi angazhon nxënësit në një proces kërkimi ku ata parashtrajnë pyetje dhe formulojnë përgjigje, inkurajon mendimin krijues dhe kritik duke nxitur diskutimin ndërmjet tyre, si dhe duke promovuar pavarësinë, iniciativën dhe ndërveprimin. Në këtë qasje, mësuesi nxit shpirtin udhëheqës të nxënësve, bashkëpunimin, tolerancën, vetëbesimin, të cilat reflektohen në rezultatet e të nxënësve dhe zhvillimin e aftësive dhe kompetencës digjitale.

Zhvillimi i lëndës së TIK-ut dhe aftësisë teknologjike praktik është një proces i rëndësishëm dhe kompleks që kërkon një qasje të integruar dhe të balancuar. Është e rëndësishme të përcaktohen rezultate të qarta dhe të arritshme për çdo orë mësimore. Këto rezultate duhet të përfshijnë zhvillimin e aftësive teknike, të menduarit kritik, zgjidhjen e problemeve dhe aftësitë bashkëpunuese.

Një mësimdhënie e mirëmenduar dhe e mirëplanifikuar krijon kushtet e nevojshme për një nxënie të suksesshme dhe lehtëson, si punën e mësuesit, ashtu edhe atë të nxënësit. Nxënësit janë aktivë, kur përfshihen në veprimtari, hulumtime, ndërtime ose simulime të njohurive, aftësive, krahasime të rezultateve apo nxjerrje konkluzionesh. Për të siguruar këtë pjesëmarrje aktive të nxënësve, mësuesi duhet të krijojë një atmosferë që i bën ata të ndihen të lirshëm dhe të zhdërvjellët për të zhvilluar njohuritë e tyre në këtë lëndë.

Projektet kurrikulare lejojnë nxënësin të zbatojë njohuritë dhe aftësitë që zotëron nga njëra anë, dhe nga ana tjetër nxënësi arrin të krijojë lidhje integruese me fushat/ lëndët e tjera. Edhe paraqitjet e projekteve, diskutimet, gjatë realizimit të tyre janë mundësi shumë e mirë për përvetësimin e njohurive dhe aftësive të marra në lëndën e arkitekturës kompjuterike por mbi të gjitha të kompetencave kyçe.

Ora e mësimi duhet të bazohet në një tematikë të përshtatur për moshën e nxënësit. Kompjuteri përdoret si mjet për të luajtur me programet, qoftë lojëra zbavitëse mësimore, qoftë programe për shkrim, prerje, prezantime, kërkim në internet ose komunikim. Në këtë mënyrë nxitet kreativiteti, zhvillohet motorika dhe nxitet të menduarit për zgjidhjen e problemeve. Nëpërmjet punës në grupe nxënësi vlerëson bashkëpunimin me shokët e shoqet e klasës, krijon lirshmërinë e vendimmarrjes dhe të përgjegjësisë ndaj komunitetit. Njohuritë e përfutuara gjatë orës mësimore bëhen më konkrete dhe më të realizueshme nëse detyrat lidhen edhe me veprimtaritë në shkollë dhe me veprimtaritë që nxënësit mund të realizojnë jashtë shkollës. Puna në grup jep mundësi për debat ose konsultim. Kështu zhvillohet përgjegjësia ndaj komunitetit ose komunikimi me të tjerë, duke fituar siguri vetjake, aftësi në përdorimin e saktë të mjeteve të TIK-ut me një synim të caktuar.

Për nxënësit do të ishin të përshtatshme edhe metodat gjysmë kërkimore për një problem të caktuar. Këto metoda i nxisin nxënësit të kërkojnë vetë në fillim zgjidhjen e problemit dhe më pas, të punojnë në grup për zgjidhjen e plotë të tij. Gjatë këtyre hapave mësuesi ka rolin e lehtësuesit dhe i ndihmon ata të shkojnë drejt zgjidhjes së duhur. Për zhvillimin sa më të mirë të kompetencës digjitale të nxënësit po dhe të kompetencave të tjera kyçe është rëndësishme që gjithë ora e mësimi të jetë e bazuar në situata konkrete të cilat e kërkojnë zgjidhjen e problemit nëpërmjet të mësuarit duke bërë gjithashtu përpunimin e njohurive nëpërmjet punëve praktike.

Për të zhvilluar fushën e Teknologjisë dhe TIK-ut , është e rëndësishme të përdoret një qasje metodologjike që promovon pjesëmarrjen aktive, kreativitetin dhe mendimin kritik të nxënësve. Këtu janë disa udhëzime metodologjike të cilat mund të aplikohen:

- *Aktivitetet praktike:* Përfshirja e nxënësve në eksperimente dhe ushtrime praktike që u lejojnë atyre të zbulojnë konceptet kryesore të TIK-ut dhe teknologjisë.
- *Probleme reale:* Prezantimi i probleme reale që nxënësit duhet t'i zgjidhin duke përdorur njohuritë e tyre në teknologji.
- *Puna në grup:* Organizimi i nxënësve në grupe për të punuar në projekte që kërkojnë bashkëpunim dhe ndarje të njohurive.

- *Zgjidhja problemore*: Prezantimi i situatave problemore që kërkojnë përdorimin e aftësive analitike dhe teknologjike për të gjetur zgjidhje.
- *Përdorimi i softuerëve edukativë*: Përdorimi i softuerëve dhe aplikacionve edukative për të lehtësuar mësimin e koncepteve të TIK-ut dhe teknologjisë.
- *Integrimi i materiale interaktive*: Përdorimi i materiale mësimore interaktive si video, simulime dhe lojëra edukative.
- *Aplikimi i qasjes STEM*: Integrimi i teknologjisë me shkencën, inxhinierinë dhe matematikën për të krijuar një qasje të plotë dhe të integruar ndaj mësimdhënies.
- *Projekte ndërlëndore*: Zhvillimi i projekteve që përfshijnë njohuri nga disiplina të ndryshme për të treguar lidhjen midis teknologjisë dhe fushave të tjera të studimit

3.7.8 Udhëzime për vlerësimin

Vlerësimi është pjesë integrale e procesit të të nxënës. Ai mat shkallën në të cilën kompetencat janë arritur nga nxënësi. Ai përfshin mbledhjen e informacioneve me anë të teknikave të ndryshme të vlerësimit për arritjen e rezultateve të pritshme të të nxënës në nivel klase. Me këtë informacion, mësuesi merr vendime për vlerësimin përfundimtar të nxënësve, bazuar në gjykimin e tij për nivelin e zotërimit të kompetencave të lëndës nga ana e nxënësit. Ndërsa vlerësimi u shërben shumë qëllimeve, është e rëndësishme që mësuesi t'ia përshtatë llojin e vlerësimit, qëllimit specifik të synuar. Para marrjes së një gjykimi në lidhje me një aspekt të caktuar të performancës së nxënësit, mësuesi duhet të sigurojë që mënyra e vlerësimit të përdorur të sigurojë informacionin që reflekton saktësisht një aspekt të veçantë të performancës që ka për qëllim të vlerësojë mësuesi. Mësuesit duhet ta përqendrojnë vlerësimin e arritjeve të nxënësve tek kompetencat lëndore si pjesë e natyrshme e mësimin. Vëmendja duhet përqendruar te vlerësimi formues që kryhet në vazhdimësi nga mësuesi për të kuptuar përparimin e nxënësve dhe për t'u siguruar me komentet për të cilat kanë nevojë. Vlerësimi formues duhet të jetë pjesë e situatave mësimore në të cilat ndodhen nxënësit. Gjithashtu është e rëndësishme që situatat mësimore të jenë komplekse në mënyrë që nxënësit të kenë më tepër lirshmëri për të dhënë zgjidhje problemore të ndryshme, por edhe të zhvillojnë mendimin kritik dhe krijues gjatë realizimit të situatës. Vlerësimi si proces lidhet me tërësinë e metodave, praktikave dhe teknikave që përdorin mësuesit për të testuar, kontrolluar, analizuar dhe matur nivelin e njohurive, aftësive dhe të performancës së nxënësve. Vlerësimi duhet të jetë i realizueshëm, i vlefshëm, korrekt, i besueshëm dhe i saktë. Vlerësimi duhet të japë një pasqyrë për arritjet e nxënësve, si edhe vështirësitë që mund të kenë nxënësit gjatë realizimit të

detyrave. Të vlerësosh nxënësit nuk do të thotë t'i vendosësh atyre një vlerësim, por t'i ndihmosh atë të kalojnë vështirësitë gjatë arritjes së kompetencave. Ky vlerësim formues duhet të bazohet mbi disa parime kyç:

- Përdorimi i metodave të ndryshme për të vlerësuar arritjet e nxënësit.
- Përdorimi i metodave të ndryshme të mësimdhënies për t'iu përgjigjur stileve të ndryshme të të nxënit.
- Përfshirja aktive e nxënësve.
- Komente të vazhdueshme dhe mësimdhënie e diferencuar.
- Identifikimi i arritjeve specifike të synuara për çdo nxënës në pika kyç përgjatë vitit.

3.7.9 Materiale dhe burime mësimore

Për arritjen me sukses të kompetencave në fushën e TIK-ut dhe Teknologjisë është e rëndësishme të përdoren materiale dhe burime mësimore që japin një informacion të kuptueshëm për moshën e nxënësit dhe që e ndihmojnë atë të zhvillojë aftësi, shkathtësi, njohuri dhe qëndrime të nevojshme për të mësuarin gjatë gjithë jetës. Një nga burimet e thjeshta mësimore, që përdoret shpesh nga nxënësit dhe mësuesit, është teksti mësimor mirëpo me zhvillimin e shpejtë të teknologjisë dhe të shtimit të informacionit digjital, mësuesi duhet ta shohë tekstin më tepër si një burim nxitës por jo të mjaftueshëm për të zhvilluar kompetencat kyçe të nxënësit.

Mësuesit mund të bashkëpunojnë online për të gjetur burime të besueshme informacioni, që u vijnë në ndihmë jo vetëm nxënësve për të zhvilluar aftësitë e tyre, por edhe mësuesve për të zhvilluar një qasje të re metodike. Nëpërmjet rritjes së shumëllojshmërisë së burimeve në nxësim më shumë nxënësit të zhvillojnë mendimin kritik, krijues, zgjidhjen e problemeve dhe të menduarit kompjuterik gjatë procesit mësimor. Disa nga burimet që mund të përdoren nga mësuesit për zhvillimin e orës mësimore përfshijnë bibliotekat elektronike, të cilat ofrojnë qasje në një gamë të gjerë librash dhe artikujsh shkencorë që mund të përdoren për të thelluar njohuritë e nxënësve në fushën e teknologjisë dhe TIK-ut. Broshurat informuese apo ndërgjegjësuere dhe enciklopeditë mund të përdoren si materiale plotësuese për të ilustruar konceptet kryesore dhe për të ofruar një pamje të gjerë mbi tematikat e diskutuara.

Softwaret edukativë mund të përdoret për të mësuar bazat e programimit përmes lojërave dhe projekteve interaktive. Gjithashtu, studimet shkencore me fokus në Teknologji dhe TIK mund të përdoren për të sjellë në klasë praktikën më të fundit dhe për të diskutuar zgjidhjet inovative që janë duke u zhvilluar në këtë fushë. Për mësimet interaktive dhe angazhuese, mjete të



ndryshme për krijimin e kuizeve dhe prezantimeve mund të përdoren për të vlerësuar njohuritë dhe për të mbajtur nxënësit të angazhuar përgjatë procesit mësimor.

4 PLANI MËSIMOR

4.1 Përshkrimi i planit mësimor

Plani mësimor i arsimit të mesëm të lartë (AML) përcakton strukturën e kurrikulës, fushat e të nxënësve dhe lëndët që përfshihen në to, si dhe shpërndarjen e kohës mësimore për klasat 10-12.

Kurrikula në arsimin e mesëm të lartë është e organizuar në:

- kurrikul bërthamë;
- kurrikul me zgjedhje;
- kurrikul në bazë shkolle.

Kurrikula bërthamë në të tri vitet e arsimit të mesëm të lartë është e detyruar dhe e përbashkët për të gjithë nxënësit.

Kurrikula me zgjedhje është pjesë e kurrikulës e cila zhvillohet në përputhje me interesat dhe nevojat e nxënësve, brenda kohës së planifikuar në planin mësimor. Kurrikula me zgjedhje u ofron nxënësve mundësinë të zgjedhin disa nga lëndët/ modulet sipas preferencave të tyre; ajo përfshin një menu lëndësh/modulesh nga e cila nxënësit janë të detyruar të zgjedhin. Lënda/moduli me zgjedhje ka status të njëjtë me lëndët e kurrikulës bërthamë, d.m.th., është e detyrueshme për të gjithë nxënësit që e përzgjedhin.

Kurrikula në bazë shkolle nuk është e detyruar për nxënësin.

Shkolla ka detyrim t'i sigurojë secilit nxënësi:

- kurrikulën e plotë bërthamë;
- numrin e orëve mësimore të kurrikulës me zgjedhje për nxënësi;
- numrin e orëve për shërbimin komunitar.

Plani mësimor për klasat 10-12 është konceptuar mbi bazën e fushave të të nxënësve: Gjuhët dhe komunikimi, Matematikë, Shkencat e natyrës, Shkencat shoqërore, Arte¹, Edukimi fizik, sporte dhe shëndeti, Teknologji² dhe TIK.

Në tabelën e mëposhtme të planit mësimor është paraqitur shpërndarja e kohës mësimore për kurrikulën bërthamë sipas fushave të të nxënësve, për secilën klasë, si edhe shpërndarja e kohës mësimore për kurrikulën me zgjedhje dhe kurrikulën në bazë shkolle, për secilën klasë (e shprehur në përqindje).

¹ Fusha e arteve bëhet aktive në kurrikulën me zgjedhje.

² Teknologjia bëhet aktive në kurrikulën me zgjedhje.

Tabela: Shpërndarja e kohës sipas fushave të të nxënimit në arsimin e mesëm të lartë (në përqindje)

FUSHA & LËNDA	KLASA X	KLASA XI	KLASA XII
	<i>(Orë /javë)</i>	<i>(Orë /javë)</i>	<i>(Orë /javë)</i>
GJUHËT DHE KOMUNIKIMI	22%	22%	22%
MATEMATIKË	13%	13%	19%
SHKENCAT E NATYRËS	19%	19%	0%
SHKENCAT SHOQËRORE	19%	19%	9%
TEKNOLOGJI DHE TIK	6%	3%	0%
EDUKIMI FIZIK, SPORTE DHE SHENDETI	9%	9%	9%
KURRIKULA ME ZGJEDHJE	6%	9%	35%
KURRIKULA NË BAZË SHKOLLE	6%	6%	6%
TOTALI	100%	100%	100%

Përshkrimi i shpërndarjes së kohës mësimore për secilën fushë si më poshtë:

Fusha “Gjuhët dhe komunikimi” përfshin lëndët: Gjuhë shqipe, Letërsi, Gjuhë e huaj e parë, Gjuhë e huaj e dytë.

Matematika përfaqësohet si fushë e të nxënimit dhe si lëndë mësimore në të gjitha klasat e arsimit të mesëm të lartë.

Fusha “Shkencat e natyrës” përfshin lëndët: Biologji, Fizikë dhe Kimi.

Fusha “Shkencat shoqërore” në arsimin e mesëm të lartë përfshin lëndët: Qytetari, Filozofi, Histori, Gjeografi, Ekonomi, Sociologji, Psikologji.

Fusha “Teknologji dhe TIK” përfshin lëndët: TIK, Baza inxhinierike dhe Teknologji.

Fusha “Arte” përfshin lëndët: Muzikë, Art pamor, Teatër.

Edukimi fizik, sporte dhe shëndeti përfaqësohet si fushë e të nxënimit dhe si lëndë mësimore në të gjitha klasat e arsimit të mesëm të lartë.

4.2 Menaxhimi dhe zbatimi i planit mësimor nga shkolla

Për zbatimin e planit mësimor, shkolla duhet të marrë parasysh:

- nevojat e nxënësve në mënyrë që zbatimi i planit të përshtatet me mënyrën si ata mësojnë më mirë;
- sigurimin e mjeteve didaktike dhe burimeve të të nxënësve të nevojshme për zbatimin e planit;
- ndihmën shtesë për nxënësit me nevoja të veçanta në përputhje me nevojat e tyre të individualizuara;
- përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për të përmirësuar mësimin dhe për ta bërë më tërheqës për nxënësit;
- bashkëpunimin me prindërit për të siguruar mbështetjen e tyre në zbatimin e planit mësimor dhe për të monitoruar përparimin e nxënësve;
- krijimin e një mjedisi të mësuari stimulues dhe të sigurt për nxënësit.

5 KURRIKULA ME ZGJEDHJE NË ARSIMIN E MESËM TË LARTË

Kurrikula me zgjedhje është pjesë e rëndësishme e kurrikulës së arsimit të mesëm të lartë. Kurrikula me zgjedhje ka si qëllim të plotësojë dhe të zgjerojë kurrikulën bërthamë bazuar në politikat arsimore, në nevojat dhe interesat e nxënësve për formimin e mëtejshëm dhe në kërkesat e shoqërisë.

Kurrikula me zgjedhje ofrohet në të tria klasat e arsimit të mesëm të lartë, por ajo vjen duke u rritur në klasën XII, ku merr përqindje të konsiderueshme të orëve. Përmes kurrikulës me zgjedhje nxënësve u krijohen kushtet dhe mundësitë për të plotësuar më mirë nevojat, prirjet dhe interesat në përputhje edhe me kërkesat dhe nevojat e shoqërisë dhe të tregut të punës.

Nxënësi zgjedh lëndë/module nga lista/menuja e kurrikulës me zgjedhje, në përputhje me numrin e orëve të përcaktuara në planin mësimor të gjimnazit për kurrikulën me zgjedhje për secilën klasë.

Kurrikula me zgjedhje hartohet në nivel qendror. Përmbajtja e kurrikulës me zgjedhje organizohet me të njëjtën strukturë me atë të kurrikulës bërthamë.

Planifikimi i zgjedhjes në nivel shkolle, kërkon bashkëpunimin ndërmjet mësuesve, nxënësve dhe prindërve. Lënda me zgjedhje vendoset nga nxënësit dhe aprovohet nga organet përkatëse duke fituar status të njëjtë me lëndët e kurrikulës bërthamë, d.m.th., është e detyrueshme për të gjithë nxënësit që e për zgjedhin.

Kurrikula me zgjedhje monitorohet, vlerësohet dhe evidentohet bazuar në kritere dhe parime të njëjta me ato të kurrikulës bërthamë.

6 KURRIKULA NË BAZË SHKOLLE NË ARSIMIN E MESËM TË LARTË

Kurrikula në bazë shkolle në arsimin e mesëm të lartë është pjesë e kurrikulës së përgjithshme e cila zgjidhet nga shkolla dhe zhvillohet, brenda kohës së përcaktuar në planin mësimor, në përputhje me interesat, potencialet, njohuritë paraprahe të nxënësve, mundësitë e shkollës, specifikat rajonale, kërkesat e aktualitetit.

Përmes kurrikulës në bazë shkolle nxënësve u krijohen kushtet dhe mundësitë për të plotësuar më mirë nevojat, prijet dhe interesat në përputhje edhe me kërkesat dhe nevojat e shoqërisë dhe të tregut të punës.

Kurrikula në bazë shkolle ka si qëllim të:

- ofrojë lëndë/module të cilat nuk trajtohen në kurrikulën bërthamë.
- ofrojë module me bazë temash ndërkurrikulare që kanë lidhje me problematikat shoqërore, kulturore dhe natyrore.
- krijojë mundësi për zhvillimin e kurrikulës në nivel lokal.
- nxitë të mësuarin me projekte.

6.1 Organizimi i kurrikulës në bazë shkolle

Kurrikula në bazë shkolle zë rreth 6 % të kurrikulës shkollore në secilin vit të AML.

Përmbajtja e saj hartohet dhe iu ofrohet nxënësve sipas nevojave të tyre dhe mundësive të shkollës. Vendimi për përcaktimin e kurrikulës në bazë shkolle del si rezultat i një procesi konsultativ që përfshin nxënësit, prindërit, shkollën dhe ZVAP-në. Partnerë të fuqishëm në zhvillimin e kurrikulës në bazë shkolle janë prindërit dhe përfaqësues të tjerë të komunitetit.

Kurrikula në bazë shkolle ofrohet nga shkolla në formën e:

- Moduleve kurrikulare (lëndore, profesionale);
- Veprimtarive shtesë që ndihmojnë në zhvillimin e kompetencave si: projekte kurrikulare, shërbim komunitar, orientim për karrierë, veprimtari sportive, artistike etj.

Modulet kurrikulare ndihmojnë nxënësit të vendosin një marrëdhënie konkrete dhe të drejtpërdrejtë me veprimtaritë praktike, përfshirë ato me karakter profesional; krijojnë kushte për zbatimin e kompetencave të fituara nga nxënësit në kurrikulën bërthamë dhe atë me zgjedhje si dhe krijojnë premisa për një orientim më të mirë të nxënësve për sipërmarrjet dhe karrierën e tyre të ardhshme. Në rastet kur në kurrikulën në bazë shkolle planifikohen të zhvillohen module kurrikulare, këto module mund të përzgjidhen nga lista e ofruar nga MAS dhe ASCAP ose module të hartuara nga shkolla dhe të miratuara nga ZVAP-ja përkatëse.

Shërbimi komunitar është veprimtari konkrete e kryer nga nxënësit, pa shpërblim financiar, në dobi të komunitetit. Shërbimi komunitar ka si qëllim të formojë te nxënësit prirjen për vullnetarizëm si një qëndrim gjatë gjithë jetës, të ndërgjegjësojë nxënësit për nevojat e komunitetit dhe të japë përvoja të cilat u duhen nxënësve për jetën e përditshme dhe karrierën. Lloji i shërbimit komunitar, vendi ku do të kryhet dhe veprimtaritë përkatëse planifikohen nga nxënësit në bashkëpunim me prindërit, shkollën dhe institucionin ose individët përfitues.

Gjatë tri viteve të gjimnazit, secili nxënës duhet të kryejë 18 orë shërbim komunitar. Për kryerjen e shërbimit komunitar nxënësi pajiset me një dëshmi.

Projektet ndërkurrikulare nxisin aftësitë STEM, psiko-sociale të nxënësve, zhvillojnë më tej kompetencat kyçe të nxënësit gjatë gjithë jetës, ndikojnë në përfundimin, integrimin e kompetencave të fushës dhe lëndëve në situata kontekstuale nga realiteti.

Nëse në kurrikulën në bazë shkolle përzgjidhet të zhvillohet një projekt kurrikular, detyrimisht ky projekt duhet të jetë me karakter integruar. Përgjegjësinë për mbarrëvajtjen e projektit e ka shkolla, pikërisht ekipi i mësuesve që është ngarkuar për zhvillimin e projektit dhe drejtorja e shkollës e cila cakton dhe ngarkesën mësimore të secilit mësues të përfshirë në projekt.

Projekti kurrikular që mund të zhvillohet në kurrikulën në bazë shkolle nuk i mbivendoset dhe nuk përjashton projektet kurrikulare që janë pjesë e detyrimit për t'u zhvilluar nga nxënësit në cdo lëndë.

6.2 Planifikimi dhe metodologjia e zhvillimit të kurrikulës në bazë shkolle

Vendimi për përcaktimin e kurrikulës në bazë shkolle del si rezultat i një procesi konsultativ që përfshin nxënësit, prindërit, shkollën dhe ZVAP-në. Partnerë të fuqishëm në zhvillimin e kurrikulës në bazë shkolle janë prindërit dhe përfaqësues të tjerë të komunitetit.

Për të gjitha format e organizimit të kurrikulës në bazë shkolle, shkolla duhet të hartojë programet mësimore apo të përshtasë programe të sugjeruara nga MAS dhe ASCAP.

Disa ndër karakteristikat kryesore që duhen mbajtur parasysh në planifikimin dhe zhvillimin e kurrikulës në bazë shkolle përfshijnë:

Qëllimet/Rezultatet e të nxënësit: Përcaktohen rezultatet e të nxënësit që duhet të arrijnë nxënësit gjatë periudhës së caktuar.

Struktura e veprimtarive: Përshkruhen veprimtaritë që do të zhvillohen gjatë vitit shkollor.

Materialet dhe burimet: Specifikohen burimet dhe materialet mësimore (libra, video, softuerë, etj.) që do të përdoren për të mbështetur veprimtaritë.

Metodologjitë mësimore: Identifikohen metodat/ strategjitë mësimore (praktikat mësimore, projektet, diskutimet etj.) që do të përdoren për të ndihmuar nxënësit në arritjen e qëllimeve.

Vlerësimi: Specifikohen mënyrat e vlerësimit të arritjeve, përfshirë detyrat dhe vlerësimin e përgjithshëm të performancës së nxënësve.

Bashkëpunimi me prindërit dhe nxënësit: Përshkruhen detajet mbi ndërveprimin me prindërit dhe nxënësit në shkollë, përfshirë konferenca, raporte periodike dhe aktivitete shkollore.

Për realizimin e kurrikulës në bazë shkolle duhet të përdoren metodologji të mësimdhënies dhe nxënies që janë në funksion të parimeve të kurrikulës, gjithëpërfshirjes, zhvillimit të kompetencave, mësimdhënies/nxënies së integruar, të menduarit kritik, krijues, zgjidhjes së problemeve, zhvillimit të aftësive digjitale etj.

Orët e kurrikulës në bazë shkolle janë të planifikuara për t'u zhvilluar në mjedise mësimore, nën drejtimin e drejtpërdrejtë të mësuesit ose të mësuesve, dhe shënohen në regjistër po ashtu si orët e tjera mësimore.

6.3 Vlerësimi i kurrikulës në bazë shkolle

Modulet kurrikulare apo projektet që zhvillohen në kuadër të kurrikulës në bazë shkolle **NUK** vlerësohen me notë. Ato shënohen vetëm si shlyerje.

Mësuesi bën kujdes të monitorojë dhe të motivojë nxënësin për angazhimin e tij në kryerjen e veprimtarive të kurrikulës në bazë shkolle.

7 UDHËZIME METODOLOGJIKE

7.1 Hyrje

Kurrikula e arsimit të mesëm të lartë nënvizon përdorimin e qasjeve që mbështesin të nxënit efektiv dhe zhvillimin e kompetencave të nxënësve. Këto qasje synojnë jo thjesht dhënien e njohurive, por zhvillimin e kompetencave për të nxënit gjatë gjithë jetës të nxënësve për të përballuar sfidat e jetës e për të marrë pjesë suksesshëm në jetën personale dhe profesionale. Për zhvillimin e kompetencave për të nxënit gjatë gjithë jetës *kurrikula e arsimit të mesëm të lartë* promovon:

7.2 Të nxënit bazuar në kompetenca

Jeta dhe puna në shoqërinë bashkëkohore, ndryshimet e shpejta dhe konkurrenca gjithnjë në rritje kërkojnë nga individit njohuri të reja, aftësi, shkathtësi, vlera dhe qëndrime, pra kompetenca të reja që e vënë theksin te novatorizmi, shpirti krijues, komunikimi në mënyrë efektive, aftësia për të zgjidhur probleme dhe për të menduar në mënyrë kritike etj. Një sistem arsimor tradicional, i cili theksin e vë te njohuritë, e ka të pamundur zhvillimin e kompetencave, ndaj është e nevojshme një qasje e re në hartimin e kurrikulës dhe në procesin e mësimdhënies.

Mësimdhënia e bazuar në kompetenca kërkon që mësuesit të përzgjedhin strategji, metoda, teknika dhe forma të ndryshme pune, si dhe të organizojnë përvojat mësimore të nxënësve që integrojnë njohuritë përkatëse me shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet.

Mësimdhënia dhe të nxënit, bazuar në kompetenca janë të lidhura ngushtë edhe me procesin e vlerësimit. Për të vlerësuar kompetencat e nxënësve është e rëndësishme që secili mësues të përzgjedhë teknika dhe instrumente vlerësimi, të cilat u mundësojnë nxënësve demonstrimin e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve, e jo vetëm njohuritë faktike. Në këtë mënyrë mësuesit sigurojnë informacion për cilësinë e mësimdhënies, arritjet e nxënësve dhe zhvillimin e kompetencave.

7.3 Të nxënit me në qendër nxënësin

Kurrikula në arsimin e mesëm të lartë promovon mësimdhënien me në qendër nxënësin. Kjo nënkupton që:

- metodat e mësimdhënies duhen përshtatur me nevojat individuale, interesat dhe veçoritë e nxënësve, me qëllim që të sigurohet suksesi i secilit prej tyre;
- duhet pranuar nga mësuesit që stilet e të nxënit ndryshojnë nga një nxënës te tjetri;

- duhen përzgjedhur metoda, teknika dhe strategji të mësimdhënies që nxitin përfshirjen aktive të nxënësve në orën e mësimi;
- duhen përdorur burime të ndryshme të nxëni që nxitin pjesëmarrjen, vëzhgimin, pavarësinë, kërkimin dhe kureshtjete nxënësve;
- duhet krijuar një mjedis i këndshëm e miqësor në klasë me qëllim që të nxitet interesi dhe motivimi i nxënësve për të nxënë;
- duhen njohur dhe trajtuar në mënyrën e duhur nxënësit e talentuar dhe ata që kanë vështirësi në të nxënë.

Realizimi i mësimdhënies me në qendër nxënësin kërkon bashkëpunim të përhershëm mes mësuesve për metodat dhe mjetet mësimore, me qëllim shkëmbimin e eksperiencave pozitive mes tyre.

Po kështu, puna edukative cilësore e shkollave nënkupton bashkëpunim të rregullt dhe të vazhdueshëm me prindërit për të mundësuar një ndarje të qartë të përgjegjësi për arritjen e rezultateve të të nxënit dhe kompetencave kyçe të nxënësit.

7.4 Të nxënit e integruar

Të nxënit e nxënësve varet shumë nga ajo që shkolla u mëson. Nëse u mësojmë nxënësve lidhjen dhe integrimin, ata do t'i shohin gjërat në këtë këndvështrim. Nëse u mësojmë ndarjen dhe mungesën e vazhdimësisë në kohë të gjërave, ata do të marrin njohuri, shkathtësi, qëndrime të fragmentuara (të shkëputura). Me qëllim që të integrohen këto aspekte, kurrikula bërthamë realizohet përmes lëndëve të integruara në fusha të nxëni dhe përmes mësimdhënies së integruar.

Mësimdhënia e integruar lidh përmbajtjet e veçanta të lëndëve mësimore me qëllim arritjen e rezultateve të të nxënit të kompetencave për fushë me rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe.

Për t'i përmbushur kërkesat e kurrikulës, mësuesit duhet të kryejnë:

- lidhjen ndërmjet fushave të të nxënit, ku përmbajtjet e veçanta mësimore kontribuojnë në zhvillimin e kompetencave kyçe;
- lidhjen midis rezultateve të të nxënit të kompetencave të fushave të të nxënit me rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe, me qëllim që zbatimi i njohurive, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave të jetë i lidhur me situata konkrete nga jeta e përditshme;
- integrimin në mësimdhënie të karakteristikave të përbashkëta të lëndëve të fushës përkatëse (p.sh. fizikës dhe biologjisë) apo karakteristikave të përbashkëta të fushave të të nxënit

(p.sh.fushës “Shkencat shoqërore” me fushën e “Shkencave të natyrës”);

- aktivitete me nxënës që zhvillojnë kompetencat për të gjetur dhe përpunuar informacione në mënyrë efektive dhe të përgjegjshme si dhe duke përdorur TIK-un;
- aktivitete me nxënës që promovojnë perspektivën e edukimit global, të cilat i ndihmojnë nxënësit që të zhvillojnë kompetencat e tyre për t’u përballur me sfidat dhe mundësitë brenda zhvillimeve të shoqërisë dhe ekonomisë së sotme dhe të ardhshme.

7.5 Zhvillimi i temave ndërkurrikulare

Temat ndërkurrikulare janë tema madhore, me të cilat përballet shoqëria tani dhe në të ardhmen. Zhvillimi i temave ndërkurrikulare mbështet të nxënit e integruar. Trajtimi i tyre synon përvetësimin e disa njohurive specifike, kultivimin e disa aftësive, vlerave e qëndrimeve të caktuara të nxënësit. Temat ndërkurrikulare integrojnë fushat kurrikulare të të nxënit, ndihmojnë nxënësit të interpretojnë botën dhe të rritin lidhjen e arsimit me jetën dhe me interesat e saj. Temat ndërkurrikulare përcaktohen sipas politikave kombëtare afatmesme e afatgjata dhe konkretizohen e zbërthehen në nivel vendor e në bazë shkolle.

Temat ndërkurrikulare janë:

- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.
- Qytetaria aktive dhe sipërmarrja.
- Shëndeti mendor e fizik dhe siguria.
- Zhvillimi i qëndrueshëm dhe qëndrueshmëria mjedisore,
- Teknologjia, shoqëria dhe media.

7.6 Zhvillimi i veprimtarive ndërkurrikulare

Konceptimi i kurrikulës me bazë kompetencat krijon mundësitë dhe kërkon zbatimin e integruar të saj. Të gjitha fushat shërbejnë në zhvillimin e kompetencave kyçe, të cilat nga ana e tyre mundësojnë integrimin e përmbajtjeve të vetë fushave. Kështu, për zhvillimin e kompetencës së të menduarit, kontribuojnë të gjitha fushat e të nxënit, si matematika, shkencat e natyrës, shkencat shoqërore etj. Duke mësuar në mënyrë të integruar, nxënësit jo vetëm përvetësojnë kompetencat, por fitojnë një këndvështrim holistik të botës, dukurive dhe marrëdhënieve që i hasin në jetën e përditshme.

Veprimtaritë ndërkurrikulare integrojnë fushat e të nxënit, ndihmojnë nxënësit të interpretojnë botën dhe të rritin lidhjen e arsimit me jetën dhe me interesat e saj.

Kurrikula bërthamë përfshin edhe hapësirën përtej kufijve lëndorë në mënyrë që nxënësit të ndërtojnë lidhje mes fushave të të nxënësve. Veprimtaritë ndërkurrikulare duhet të ofrojnë përvoja të përshtatshme dhe sfiduese që sjellin kënaqësi në kontekstin e përmbushjes së nevojave dhe kërkesave të ndryshme të nxënësve.

Krijimi i lidhjeve ndërmjet fushave të të nxënësve krijon mundësi për progres në zhvillimin e shkathtësive të nxënësve, për njohjen dhe të kuptuarit e koncepteve të reja, rishikimin dhe përforcimin e këtyre koncepteve dhe shkathtësive nga perspektiva të ndryshme. Gjithashtu, kjo qasje ndihmon që kurrikula të jetë koherente dhe më kuptimplote nga pikëpamja e nxënësit.

Integrimi i veprimtarive ndërkurrikulare në kurrikulën bërthamë mund të realizohet përmes:

- Gjetjes së lidhjeve midis lëndëve/temave apo njësive mësimore me qëllim realizimin/arritjen e ndonjë kompetence kyçe (p.sh. nëse tema mësimore është nga mbrojtja e mjedisit, atë e lidhim edhe me çështjet gjuhësore).
- Projekteve kurrikulare, të cilat lidhen duke ndihmuar njëra-tjetrën në tema apo fusha të ndryshme, (p.sh. projekte në fushën “Shkencat shoqërore” me fokus edukimin për karrierë etj.), të cilat gjithashtu mundësojnë realizimin e kompetencave të veçanta.

Trajtimi i tyre synon përvetësimin e disa njohurive specifike, kultivimin e disa aftësive, vlerave e qëndrimeve të caktuara të nxënësit.

7.7 Zhvillimi i veprimtarive ekstrakurrikulare

Veprimtaritë ekstrakurrikulare janë veprimtari të strukturuar mësimore që ndodhin jashtë kontekstit të fushave dhe lëndëve mësimore formale, por që ndihmojnë arritjen e kompetencave për ciklet e arsimit. Për secilën nga veprimtaritë e mundshme, shkolla duhet të përgatisë një plan dhe program të qëllimshëm, të orientuar e jo aktivitete të rastit.

Mësimdhënia në fushat e ndryshme të të nxënësve do të mbështetet me anë të veprimtarive ekstrakurrikulare të organizuara, si:

- vizita në muze, parqe, vende historike, institucione, galeri, teatër etj.;
- veprimtari me raste festash të ndryshme;
- pjesëmarrje në grupet mësimore, në aktivitete të lira dhe në shoqata;
- diskutime me të ftuar (p.sh. me drejtues të bashkisë, prindër, përfaqësues të bizneseve lokale, politikanë, njerëz të medias etj.);
- punë me projekte që fokusohet në tema dhe çështje specifike të karakterit shumë dimensional që përkojnë me moshën e nxënësve;
- organizime ekspozitash (p.sh. artet e bukura, fotografia);

- shërbime komunitare (p.sh. ndihma për njerëzit në nevojë; mbrojtja e mjedisit; forcimi i lidhjeve midis brezave);
- lojëra sportive, aktivitete artistike, revista ose gazeta e shkollës etj.

Rekomandohet që të gjithë nxënësit të përfshihen në veprimtari ekstrakurrikulare. Sipas preferencave dhe talentit personal, ata mund të jenë pjesë e një grupi në aktivitete të ndryshme: ekipe sporti, grup muzikor, grup vallëzimi, kor, grup teatri etj.

7.8 Të nxënit sipas qasjes STEM

Qasja STEM si metodologji mësimore bazohet në një qasje praktike që nxit integrimin dhe zhvillimin e lëndëve shkencore dhe teknologjike në një kuadër të vetëm ndërdisiplinor me një qasje didaktike që garanton transversalitetin e procesit të mësimdhënie - nxënies përmes shkencës, teknologjisë, inxhinierisë dhe matematikës.

Zbatimi i qasjes STEM kërkon një lidhje të qëllimshme midis rezultateve të të nxënit të kurrikulës, standardeve, vlerësimeve, planifikimit dhe zbatimit të kurrikulës.

Objektivi kryesor i kësaj metodologjie është t'u sigurojë nxënësve kompetenca për të mësuarit eksperimental duke zhvilluar të menduarit kritik, zgjidhjen e problemeve, bashkëpunimin dhe inovacionin.

Zbatimi i qasjes STEM në mësimin e shkencave dhe teknologjisë gjithashtu i pajis individët me një sërë aftësish që i bën ata më të përgatitur për kërkesat e sotme të tregut të punës.

STEM si metodologji mësimore thekson:

- Punën në ekip për të zgjidhur problemet të botës reale përmes aktiviteteve mësimore praktike.
- Të mësuarit përmes kërkimit dhe eksperimentimit që nxit motivimin.
- Mësimdhënien kontekstuale për shkak të natyrës së saj shumëdisiplinore.
- Promovimin e kreativitetit me të cilin mund të zgjidhen problemet nga një këndvështrim kritik.

7.9 Përdorimin e teknologjisë digjitale

Integrimi i teknologjisë në procesin mësimor rrit angazhimin, efektivitetin, lehtëson aksesin në burime dhe informacione dhe ofron mundësi për përvoja të të mësuarit ndërveprues. Mjetet e teknologjisë, burimet digjitale dhe prezantimet multimediale lehtësojnë përvojat interaktive të të nxënit dhe mbështesin nevojat të ndryshme mësimore. Komunikimi, bashkëpunimi dhe aksesin në informacion mund të ndodhin pavarësisht nga koha dhe vendi. Përdorimi i softuerëve

arsimor, burimeve multimediale, platformave online dhe i mjeteve digjitale në mësim zhvillon mundësi të reja didaktike dhe metodologjike. Ato mbështesin lloje të ndryshme të nxënies, promovojnë nxënësit me talente dhe mbështesin nxënësit me aftësi ndryshe.

7.10 Platformat digjitale në edukim

Platformat digjitale janë mjete elektronike, të cilat ofrojnë mjedise virtuale për të kryer veprimtari si: *mësimdhënia dhe nxënia, komunikimi, vlerësimi, dhe bashkëpunimi*. Këto platforma përdoren për të gjitha lëndët e kurrikulës dhe janë shndërruar në një pjesë thelbësore të mësimdhënies moderne, duke ofruar një mjedis të sigurt dhe efikas gjatë mësimdhënies dhe nxënies. Platformat digjitale nuk janë të gjitha interaktive edhe pse, shumica e tyre ofrojnë një lloj interaktiviteti, por shkalla dhe natyra e këtij interaktiviteti mund të ndryshojë në varësi të llojit të platformës dhe qëllimit të saj.

7.10.1 Platformat interaktive

Platformat interaktive përmbajnë mjedise digjitale me aplikacione, softuerë, video-lojëra, simulime interaktive, materiale multimediale etj. përmes të cilave përdoruesit mund të bëjnë demonstrime interaktive virtuale, eksplorojnë koncepte shkencore dhe matematikore në një mjedis virtual, zgjidhin ushtrime dhe problema, zhvillojnë eksperimente interaktive virtuale, kryejnë projekte duke ndërvepruar me simulimin/ appletin apo aplikacionin që përdorin. Gjithashtu platformat interaktive ofrojnë mundësi për të përcaktuar progresin e nxënësve përmes testeve interaktive, si dhe përmirësojnë aftësitë e mendimit kritik dhe krijues të tyre, duke i nxitur ata të mendojnë në mënyrë të pavarur dhe të zhvillojnë aftësi të nevojshme për t'u përgatitur për sfidat e zhvillimit të teknologjisë. Këto platforma përdoren kryesisht në lëndët e fushës së matematikës dhe të shkencave të natyrës dhe përmbajnë:

1. *Simulime interaktive*. Simulimet interaktive janë video - lojërat, që përdoren në procesin mësimor për të hulumtuar konceptet shkencore dhe matematikore duke ndërvepruar me simulimin.
2. *Aplikacionet mobile*: Përdoruesit mund të ndërveprojnë me aplikacionet për të hulumtuar konceptet ose për të kryer veprime me lojra përmes aplikacioneve të ndryshme online.
3. *Uebet dhe faqet e internetit*: Përdoruesit mund të klikojnë, të kërkojnë, të regjistrohen, të komentojnë dhe të ndajnë përmbajtje me njëri-tjetrin në haqe të ndryshme interneti.
4. *Lojërat elektronike*: Përdoruesit janë pjesëmarrës aktivë në ndryshimet, që lidhen me botën e lojrave elektronike, si p.sh., duke krijuar personazhe, duke zgjidhur përzgjedhur strategji, ose duke kontribuar në konceptimin e ndërtimit të një loje.

7.10.2 *Platformat jo-interaktive*

Platformat jo-interaktive që përdoren në kurrikulën shkollore përmbajnë mjete dhe burime, të cilat nuk kërkojnë ndërveprim direkt të përdoruesve gjatë përdorimit. Këto platforma shpesh ofrojnë informacione dhe materiale burimore në një format të strukturuar dhe të paracaktuar, ku përdoruesit mund të shfletojnë, lexojnë, ose shikojnë përmbajtjen pa pasur nevojë për të reaguar ose për të marrë pjesë në mënyrë aktive. Këto platforma përdoren për mësimin e lëndëve të të gjithë fushave të kurrikulës. dhe përmbajnë:

1. *Simulime jo-interaktive*. Simulimet jo-interaktive janë video-lojra ku nxënësi nuk mund të ndërveprojë me to gjatë përdorimit të tyre.
2. *Libra dhe materiale të shkruara*: libra, manuale shkollore, artikuj dhe materiale të tjera të shkruara që përdoren për të mësuar dhe kuptuar konceptet, që i ndeshim në temat mësimore. Përdoruesit mund të zhvendosin faqet, por nuk kanë mundësi të ndryshojnë përmbajtjen apo të ndërveprojnë me të në mënyrë të larmishme.
3. *Video tutoriale dhe materiale multimediale*: Materiale multimediale, që përdoren për të shpjeguar koncepte të ndryshme, siç janë: video mësimore, eksperimente virtuale, podcaste, dhe intervista.
4. *Prezantime Power-Point*: Prezantime të hartuara paraprakisht, që përdorin imazhe dhe tekste për të shpjeguar tema të ndryshme në një mënyrë të strukturuar.
5. *Fotografi dhe ilustrime*: Fotografi, diagrama, dhe ilustrime të tjera që paraqesin informacione në një formë vizuale.
6. *Artikuj dhe ese*: Materiale shkencore dhe akademike që diskutojnë dhe shpjegojnë tema të ndryshme me një qasje të re të hulumtimit.
7. *Burime në internet dhe biblioteka digjitale*: Platforma që ofrojnë qasje në baza të të dhënave, libra elektronikë, artikuj shkencorë dhe burime të tjera për të mësuar, duke zhvilluar kërkime shkencore.
8. *Uebet dhe faqet e internetit*: Faqet që ofrojnë informacion të përhershëm dhe nuk lejojnë përdoruesit të bëjnë ndryshime të mëdha apo të manipulojnë përmbajtjen.

7.10.3 *Rëndësia e përdorimit të platformave digjitale*

Disa avantazhe të rëndësishme të përdorimit të platformave digjitale:

1. *Akses i shpejtë i materialeve*: Mundëson mësuesit dhe nxënësit të aksesojë materialet mësimore nga kudo dhe në çdo kohë.

2. *Mësimdhënie e personalizuar*: Lejon përshtatjen individuale të mësimdhënies sipas nevojave individuale të nxënësve.
3. *Bashkëpunim dhe komunikim efikas*: Mundëson bashkëpunimin në grup, komunikimin me mësuesit dhe shkëmbimin e informacionit me nxënësit e tjerë.
4. *Inovacion dhe zhvillim teknologjik*: Kontribuon në rritjen e aftësive teknologjike të nxënësve dhe mësuesve.

Përdorimi i platformave digjitale siguron një përvojë mësimore të pasur dhe të përshtatshme për nxënësit dhe i ndihmon ato të zhvillojnë aftësitë e tyre në një mënyrë aktive dhe angazhuese. Kombinimi i të gjitha materialeve të ndryshme burimore ofron mundësi të shumta për të përmirësuar mësimin dhe për të arritur qëllimet e edukimit STEM në kontekstin e shkollave moderne.

8 UDHËZIME PËR VLERËSIMIN

Vlerësimi në arsimin e mesëm të lartë është procesi gjatë të cilit mbledhen të dhëna dhe gjykohet mbi bazën e një kriteri të caktuar për arritjen e një rezultati arsimor.

Qëllimi kryesor i vlerësimit është marrja e vendimeve që synojnë përmirësimin e rezultateve të nxënies dhe procesit mësimor. Kjo kërkon grumbullimin e informacionit për të analizuar dhe vlerësuar të gjithë aspektet e procesit. Praktikrat e vlerësimit ndikojnë fort në procesin e të nxënies. Parimet kryesore të vlerësimit janë:

- ***Vlerësimi është i drejtë.*** Metodrat e vlerësimit duhet të mbështeten në objektiva të vendosura paraprakisht dhe qëllimet e pasojat e tij duhet të jenë të qarta për të gjithë të interesuarit.
- ***Vlerësimi bazohet në kritere të njëjta, të unifikuara*** në nivel kombëtar të njohura, të qarta e të pranueshëm për nxënësit, mësuesit, prindërit dhe të interesuarit e tjerë. Kjo kërkon që këto kritere t'u bëhen të qarta nxënësve dhe prindërve që në fillim të procesit mësimor.
- ***Vlerësimi ka në qendër nxënësin.*** Qëllimi i vlerësimit është të ndihmojë nxënësin të zhvillojë njohuritë dhe aftësitë e tij. Për këtë arsye, vlerësimi duhet të jetë i përshtatshëm për nivelin dhe nevojat e individit dhe të ofrojë informacione të sakta dhe të rëndësishme për përmirësimin e mëtejshëm të performancës së tij në fushën e caktuar.
- ***Vlerësimi është i orientuar nga e ardhmja.*** Vlerësimi duhet të sigurojë informacion të vlefshëm dhe të orientuar nga e ardhmja për nxënësin, për prindërit, sikurse edhe për mësuesit dhe shkollat për mënyrën si të përmirësojnë praktikrat e të mësuarit dhe të mësimin.
- ***Vlerësimi është i vlefshëm.*** Vlerësimi duhet të matë atë që synohet në rezultatet e të nxënies të secilës fushë/lëndë.
- ***Vlerësimi është i qëndrueshëm.*** Ai duhet të prodhojë rezultate të qëndrueshme dhe koherente. Kjo do të thotë që rezultatet e vlerësimit duhet të jenë të përsëritshme në rast se administrohet e njëjta procedurë për të njëjtin nxënësin edhe nga një vlerësues i jashtëm.
- ***Vlerësimi është i barabartë.*** Një metodë e drejtë matjeje/vlerësimi siguron që të gjithë nxënësit, pavarësisht nga karakteristikat e tyre demografike ose karakteristikat e tjera, të kenë mundësi të barabarta për të treguar nivelin e tyre të kompetencës. Zbatimi i këtij parimi merr rëndësi të veçantë kur rezultatet e vlerësimit të nxënësve janë të rëndësishme për të dhe ndikojnë në të ardhmen e tij.
- ***Vlerësimi është transparent.*** Transparenca nënkupton që nxënësit duhet të marrin paraprakisht informacione të hapura, të sakta dhe të qarta për vlerësimin. Një procedurë transparente e matjes është ajo në të cilën nxënësit informohen paraprakisht për qëllimin e

vlerësimit, për *rezultatet* e pritshme të nxënies që do të vlerësohen, *llojet e procedurave* të vlerësimit që do të përdoren dhe kriteret e vlerësimit.

- **Vlerësimi është i zbatueshëm.** Parimi i zbatueshmërisë do të thotë që çdo metodë e matjes duhet të jetë e realizueshme, duke pasur parasysh burimet, kohën dhe kufizimet praktike që zbatohen. Kufizimet që e bëjnë një metodë jopraktike mund ta bëjnë atë edhe jo të qëndrueshme/besueshme dhe të pavlefshme. Ky parim merr më shumë vlerë në rastet kur ekzistojnë kufizime të ndjeshme për nxënës ose grupe të caktuar nxënësish, për shkak të rrethanave objektive.

8.1 Llojet e vlerësimit

Llojet kryesore të vlerësimit arsimor që realizohen në arsimin parauniversitar, janë:

- Vlerësimi i brendshëm (vlerësimi i vazhduar, periodik dhe përfundimtar).
- Vlerësimi i jashtëm (në fund të vitit shkollor, në fund të nivelit arsimor).

8.1.1 Vlerësimi i brendshëm

Vlerësimi i brendshëm bëhet në nivel shkolle/klase nga mësuesit, sipas procedurave e kriterëve për secilin lloj të vlerësimit të brendshëm, të rregulluara me akte nënligjore.

Vlerësimi i brendshëm çmon përparimin dhe arritjen e nxënësve, planifikimin e punës me nxënësit, identifikimin e prirjeve dhe të talenteve të nxënësve etj. Ai duhet t'u mundësojë nxënësve të shprehin njohuritë e reja dhe të tregojnë nivelin e kompetencave, duke përfshirë:

- kërkesat e përcaktuara në programet lëndore;
- përballjen me sfida të nivelit të përcaktuar me rezultatet e të nxënës;
- aftësinë për t'i zbatuar ato në situata dhe rrethana të reja.

Fokusi i vlerësimit të brendshëm duhet të jetë mbështetja e nxënësve drejt zotërimit të kompetencave dhe kjo arrihet më së miri nga kombinimi i *vlerësimit të vazhduar dhe periodik*.

LLOJET	KOHA	REALIZUESI	QËLLIMI	DOKUMENTIMI
Vlerësimi i vazhduar	Gjatë procesit të nxënies	Mësuesit e lëndëve.	▪ Ndihma për nxënësit ▪ Informimi dhe raportimi.	Pasqyrimi i notave në regjistrin elektronik (SMIP).

Vlerësimi periodik	Në fundin e çdo periudhe mësimore	Mësuesit e lëndëve.	▪ Ndihma për nxënësit. ▪ Informimi dhe raportimi. ▪ Vendosja e notës në fund të periudhave të caktuara mësimore.	Pasqyrimi i notave në regjistrin elektronik (SMIP).
Vlerësimi përfundimtar	Në fund të vitit shkollor	Mësuesit e lëndëve.	▪ Vendosja e notës ▪ përfundimtare në fund të vitit mësimor/ shkollor. ▪ Informimi dhe raportimi. ▪ Planifikimi për mbështetjen e të nxënit të nxënësve në vitin vijues.	Pasqyrimi i notave në regjistrin elektronik (SMIP). Vlerësimet paraqiten në dëftesën elektronike të nxënësit.
Vlerësimi në fund të nivelit	Në fundin e klasës XII	Drejtorja e shkollës. Ekipi lëndor.	▪ Verifikimi i arritjeve. ▪ Ndihma e nxënësve për nivelin pasues. ▪ Informim dhe raport për prindërit dhe organet e prore. ▪ Diplomimi.	Vlerësime paraprake përpara provimeve kombëtare.

8.2 Vlerësimi i jashtëm

Me vlerësim të jashtëm do të kuptohet vlerësimi i realizuar nga autoritetet qendrore ose rajonale të arsimit.

Vlerësimi i jashtëm mund të bëhet për qëllime:

- Inspektimi dhe verifikimi i cilësisë së vlerësimit, në nivel klasë apo shkolle.
- Vlerësimi të standardizuar.

- Hulumtimi për përmirësim.
- Vendimmarrjeje arsimore në nivele, fusha ose aspekte të ndryshme.

Arritja e nxënësve vlerësohet nga testet kombëtare bazuar në kampionime dhe nga vlerësimet e standardizuara shtetërore që organizohen në përfundim të nivelit arsimor. Këto vlerësime përqendrohen në përcaktimin e nivelit të demonstrimit nga nxënësit të arritjeve të parashikuara për arsimin e mesëm të lartë.

Vlerësime dhe teste të standardizuara shtetërore	Qëllimet e vlerësimit	Dokumenti i certifikimit
Testet kombëtare bazuar në kampionim	Rezultatet përdoren për monitorimin kombëtar të arritjeve.	Nuk ofrohet dokument
Vlerësimi shtetëror në fund të klasës XII	Matja e nivelit të demonstrimit të arritjeve për regjistrim në arsimin e mesëm të lartë.	Certifikata e maturës në fund të klasës XII

Vlerësimi i nxënësve në arsimin e mesëm të lartë, përveç formave të ndryshme joformale gjatë gjithë procesit të të nxënës, bëhet nëpërmjet shkallës së vlerësimit që përfshin notat nga 4- 10.

Nota 4: Një arritje që tregon performim të pamjaftueshëm të njohurive dhe kompetencave.

Nota 5: Një arritje që tregon performim minimal të njohurive të reja dhe të kompetencave.

Nota 6: Një arritje që tregon performim të mjaftueshëm të njohurive të reja dhe të kompetencave.

Nota 7: Një arritje që tregon performim të kënaqshëm të disa njohurive të reja dhe të kompetencave.

Nota 8: Një arritje që tregon performim të mirë të disa njohurive dhe të kompetencave.

Nota 9: Një arritje që tregon performim shumë mirë të shumicës së njohurive dhe të kompetencave.

Nota 10: Një arritje që tregon performim shumë të mirë dhe original të njohurive dhe të kompetencave.

Shënim. Procedurat e vlerësimit dhe dokumentacioni përkatës rregullohen me udhëzime të veçanta të MAS.

9 FJALORI I TERMINOLOGJISË KURRIKULARE

TERMI SHQIP	TERMI ANGLISHT	FJALORI IBE (UNESCO) - SHQIP
Aftësi	<i>Skill</i>	Zotësia për të kryer detyra dhe për të zgjidhur probleme që përfshijnë zbatimin praktik të njohurive teorike në detyra ose situata të veçanta.(CEDEFOP, 2011).
Aftësitë për jetën	<i>Life Skills</i>	Një grup kompetencash psikosociale dhe aftësish ndërpersonale që i ndihmojnë njerëzit të marrin vendime të informuara, të zgjidhin problemet, të mendojnë në mënyrë kritike dhe krijuese, të komunikojnë në mënyrë efektive, të ndërtojnë marrëdhënie të shëndetshme, të kuptojnë të tjerët dhe të përballojnë dhe menaxhojnë jetën e tyre në një mënyrë të shëndetshme dhe produktive (Eorld Health Organizata 2003).
Edukimi digjital	<i>Digital Literacy</i>	Edukimi që synon edukimin e zotësisë për të përdorur me besim, në mënyrë kritike dhe të përgjegjshme teknologjinë digjitale për qëllime mësimore, për punë dhe për pjesëmarrje aktive në shoqëri. Edukimi digjital përfshin edukimin për median, informimin dhe menaxhimin e të dhënave, komunikimin dhe bashkëpunimin për ndarjen e informacionit, aftësinë për të krijuar përmbajtje digjitale, sigurinë (mirëqenien digjitale dhe kompetencat që lidhen me sigurinë kibernetike), çështjet që lidhen me pronësinë intelektuale, aftësitë e zgjidhjes së problemit dhe të marrjes së vendimit. (Komisioni evropian)
Arsim	<i>Education</i>	Procesi i përvetësimit të njohurive, aftësive, vlerave, qëndrimeve gjatë jetës dhe që zhvillohet në mjedise të ndryshme formale dhe / ose joformale dhe që nxit të menduarit kritik, aftësitë për zgjidhjen e problemeve,

		rritjen personale etj.
Arsim bazë	<i>Basic education</i>	Themeli për të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe për zhvillimi njerëzor mbi të cilin vendet mund të ndërtojnë, sistematikisht, nivelet dhe llojet e mëtejshme të arsimit dhe trajnimit. (Burimi: UNESCO 1992). Arsimi bazë zakonisht përfshin arsimin fillor dhe të mesëm të ulët, dhe gjithnjë e më shumë një ose më shumë vite të arsimit parashkollor. Zakonisht përfshin shkollimin e detyrueshëm
Arsim dhe formim profesional	<i>Vocational education and training</i>	Arsimi që u mundëson nxënësve të fitojnë dhe përdorin njohuri dhe kompetenca për punë dhe kualifikime profesionale për profesione të caktuara, përveç arritjes së kompetencave kryesore të përcaktuara në KK.
Arsim formal	<i>Formal education</i>	Arsim i institucionalizuar, i qëllimshëm, i planifikuar, i strukturuar në mënyrë hierarkike, nga niveli parashkollor deri në atë pasuniversitar. Rezultatet dhe kualifikimet në arsimin formal njihen me certifikata dhe diploma.
Arsim gjithëpërfshirës	<i>Comprehensive education</i>	Procesi i forcimit të kapacitetit të sistemit arsimor për të arritur tek të gjithë nxënësit, në zbatim të parimit se arsimi është një e drejtë themelore e njeriut dhe themeli për një shoqëri më të drejtë dhe më të barabartë (UNESCO, 2009).
Arsimi parashkollor	<i>Preschool education</i>	Arsimi parashkollor i përket "Nivelit me kodin 0" (KSNA 0). i cili synon zhvillimin shoqëror, intelektual e fizik, të çdo fëmije, ushtrimin e rregullave themelore të sjelljes e të higjienës, kultivimin e vlerave, si dhe përgatitjen për arsimin fillor. Përfshin moshën nga 3 deri në 6 vjeç.
Arsim	<i>Primary</i>	Në SAPU, Arsimi fillor i përket "Nivelit me kodin 1"

fillor	<i>education</i>	që merret në klasën përgatitore dhe vijon gjatë pesë viteve të para të shkollimit (KSNA 1). Arsimi fillor ofron aktivitete mësimore dhe edukative të dizajnuara zakonisht për t'u ofruar nxënësve aftësi themelore në lexim, shkrim dhe matematikë (p.sh. shkrim-lexim dhe numërim) dhe vendos një bazë solide për të mësuarit dhe të kuptuarit e fushave thelbësore të njohurive dhe zhvillimit personal, duke u përgatitur për arsimin e mesëm të ulët.
Arsim i mesëm i ulët	<i>Lower secondary education</i>	Në SAPU, niveli i ulët i arsimit të mesëm (katërvjeçar) (KSNA 2). Programet e arsimit të mesëm të ulët zakonisht janë të dizajnuara për t'u ndërtuar mbi rezultatet e të nxënësve nga arsimi fillor. Zakonisht, qëllimi është konsolidimi i bazës për të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe zhvillimin njerëzor mbi të cilin sistemet arsimore më pas mund të zgjerojnë mundësitë e mëtejshme arsimore.
Arsim i mesëm i lartë	<i>Higher secondary education</i>	Në SAPU, niveli i dytë i arsimit të mesëm (trevjeçar) (KSNA 3). Programet e arsimit të mesëm të lartë janë zakonisht arsim i krijuar për të përfunduar arsimin e mesëm në përgatitje për arsimin terciar ose për të ofruar aftësi të rëndësishme për punësim, ose të dyja. Programet e këtij niveli u ofrojnë nxënësve përmbajtje më të larmishme, të specializuara dhe më të thelluara sesa programet në nivelin e arsimit të mesëm të ulët. Ato janë më të diferencuara, me një gamë të shtuar opsionesh të disponueshme. (UIS, 2012).
Autonomi e shkollës	<i>School autonomy</i>	E drejtë e garantuar shkollës që të vendosë për hartimin dhe zbatimin e kurrikulës në bazë shkolle, për vlerësimin, menaxhimin e burimeve njerëzore, materiale dhe financiare në dispozicion, në kontekstin e kurrikulës zyrtare. Autonomia lidhen me

		llogaridhënie.
Burim për të nxënë	<i>Learning Resource</i>	Çdo burim – duke përfshirë materialet e shtypura dhe jo të shtypura dhe burimet online/të hapura – që mbështet dhe përmirëson, drejtpërdrejt ose tërthorazi, mësimdhënien dhe të mësuarit. Burimet janë të jashtme (mësuesi, shokët, përmbajtjet e programeve apo tekstet, mjete didaktike etj., me të cilët nxënësi bashkëvepron, kur trajton situatat) dhe të brendshme (njohuri, aftësi, shkathtësi, vlera, qëndrime etj.).
Burim konjitiv	<i>Cognitive resource</i>	Tërësi e njohurive që ka ndërtuar nxënësi (trashëgimia njohëse e tij); ndryshe, njohuri vetjake dhe / ose shoqërore që ai i aktivizon dhe përdor për trajtimin e situatave.
Burim fizik	<i>Physical resource</i>	Aftësi dhe kapacitete për të përdorur fizikun njerëzor (qëndrueshmëria kardiovaskulare/respiratore, qëndrueshmëria, forca, fleksibiliteti, fuqia, shpejtësia, koordinimi, shkathtësia, ekuilibri dhe saktësia) dhe mjetet fizike për të kryer operacione dhe funksione.
Dije	<i>Knowledge</i>	Njohuri e arsyetuar dhe e provuar si e vërtetë nga komuniteti i kërkuesve sipas kriterëve të përcaktuara, e kodifikuar në tekstet akademike, shkollore apo në vepra të specializuara, si produkt i një ose disa shkencëtarëve. Dija është shoqërore.
E-Learning	<i>E-Learning</i>	Të gjitha format e mësimdhënies dhe të nxënies të bazuar në kompjuter dhe web që përfshijnë përvetësimin dhe zbatimin e njohurive dhe aftësive. Mund të zhvillohet brenda ose jashtë klasës. Ai është shpesh një komponent thelbësor i arsimit në distancë dhe mund të përfshijë mjedise të të mësuarit virtual.
E-Portofoli	<i>E-Portfolio</i>	Portofol elektronik që shfaq punën, arritjet dhe reflektimet e një nxënësi që përdoret shpesh për

		vlerësimin dhe paraqitjen e kompetencave të fituara.
Edukimi për sipërmarrje	<i>Entrepreneurship education</i>	Edukimi për sipërmarrj është edukimi që synon zhvillimin e zotësisë për të shfrytëzuar idetë dhe shanset për t'i shndërruar ato në vlera për të tjerët. Ky edukim synon zhvillimin e zotësisë për të përdorur mendimin kritik, aftësitë krijuese dhe të zgjidhjes së problemit, zotësisë për të ndërmarrë nisma e për të qenë këmbëngulës si dhe aftësisë për të punuar në bashkëpunim me të tjerë për të planifikuar dhe menaxhuar projekte me vlera kulturore, shoqërore ose financiare.
Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm	<i>Education for sustainable development</i>	Procesi i zhvillimit të njohurive, aftësive, vlerave dhe qëndrimeve të nxënësve të të gjitha grup moshave, të nevojshme për të trajtuar sfidat e ndërlidhura globale, duke përfshirë ndryshimet klimatike, humbjen e biodiversitetit, përdorimin jo të qëndrueshëm të burimeve dhe pabarazinë. Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm i fuqizon nxënësit të marrin vendime të mirinformuara dhe të ndërmarrin veprime (individuale dhe kolektive) për ndryshimin e shoqërisë dhe kujdesin për planetin (UNESCO 2023)
Inteligjencë artificiale	<i>Artificial intelligence</i>	I referohet teorisë dhe zhvillimit të sistemeve kompjuterike të aftë për të kryer detyra që normalisht kërkojnë inteligjencë njerëzore, të tilla si perceptimi vizual, njohja e të folurit, vendimmarrja dhe përkthimi ndemjet gjuhëve (English Oxford Living Dictionary).
Fushë e nxënies / të nxënit	<i>Learning area</i>	Grup lëndësh të ndërlidhura që u ofrojnë nxënësve përmbajtje dhe situata mësimore të cilat i trajtojnë për të ndërtuar / përdorur njohuri të reja dhe kompetenca.
Kodim kompjuterik	<i>Computer coding</i>	Proces i dizenjimit, shkrimit, testimit dhe mirëmbajtjes së kodit burimor ose udhëzimeve për

		kompjuterin për të interpretuar gjuhët njerëzore.
Kompetencë	<i>Competency</i>	Një interpretim i ngushtë i kompetencës është zbatimi i përvojës dhe i aftësive për të bërë diçka me sukses. Në këtë interpretim, kompetenca interpretohet si specifike për fushën, p.sh. me njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet brenda një lënde ose disipline specifike. Një interpretim më i gjerë e interpreton kompetencën shumë më tepër sesa thjesht zbatimin e njohurive dhe aftësive për të përmbushur kërkesat e specifikuar.
Kompetenca kyçe	<i>Key competences</i>	Tërësi njohurish, aftësish, qëndrimesh dhe vlerash që zhvillohen gjatë shkollimit dhe jetës që janë thelbësore për të jetuar dhe punuar me sukses në shoqërinë bashkëkohore. Këto kompetenca nxënësi i ndërton gjatë APU-së sepse konsiderohet thelbësore për jetë të suksesshme në shoqërinë dhe në ekonominë e dijes.
Koncept	<i>Concept</i>	Strukturë mendore që personi e ndërton për të përfaqësuar në vetëdije tipare / veti / karakteristika të qenësishme dhe të përbashkëta të një kategorie objektesh / dukurish / procesesh. Koncepti shprehet / paraqitet me simbole (fjalë, shenjë, grafikë etj.).
Kurrikul	<i>Curriculum</i>	Tërësia e parimeve, vlerave, qëllimeve të pranuar shoqërore mbi bazën e të cilave përcaktohen njohuritë, aftësitë, vlerat dhe qëndrimet me të cilat duhet të pajisen nxënësit përmes arsimimit, mënyra e organizimit të përmbajtjes mësimore, pedagogjia e mësimdhënies, përvojat e të mësuarit në të cilat përfshihet nxënësi për t'i realizuar dhe mënyra e vlerësimit të arritjeve.
Kurrikul bazuar në kompetenca	<i>Competency based curriculum</i>	Kurrikula që synon zotësinë e zbatimit të njohurive dhe aftësive në jetën reale, kurrikula që ka pikënisje dhe pikëmbërritje kompetencën.

Kornizë kurrikulare	<i>Curriculum frameëork</i>	<i>Korniza kurrikulare</i> përmbledh në vetvete argumentimin e nevojave për ndryshime kurrikulare, parimet e përgjithshme mbi të cilat mbështetet kurrikula dhe reformimi i saj, synimet e përgjithshme të kurrikulës, fushat kurrikulare dhe objektivat e tyre të përgjithshëm, drejtimet ndërkurrikulare, parimet e mësimdhënies dhe të nxënësve efektiv, si dhe ato të vlerësimit.
Korniza STEM	<i>The STEM frameëork</i>	STEM (ndryshe Shkencë, Teknologji, Inxhinieri dhe Matematikë) është akronim për një qasje arsimore ndërdisiplinore dhe të integruar që fokusohet në këto disiplina. STEM thekson përdorimin e njohurive shkencore, matematikore, teknike dhe inxhinierike për zgjidhjen e problemeve shoqërore, duke e bërë mësimin e shkencës, teknologjisë, inxhinierisë dhe matematikës më kuptimplotë dhe kontekstual. <i>Edukimi shkencor</i> Njohuri, qëndrime, aftësi dhe vlera për të identifikuar pyetjet dhe problemet në situata të jetës për të shpjeguar botën natyrore dhe të projektuar; dhe nxjerrë konkluzione të bazuara në prova në lidhje me çështjet që lidhen me STEM si dhe një gatishmëri për t'u përfshirë në çështjet që lidhen me STEM si një qytetar konstruktiv, i përgjegjshëm dhe reflektues (Bybee, 2013, f.5).
Kurrikul bërthamë	<i>Core curriculum</i>	Tërësia e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve që pritet të mësohen nga të gjithë nxënësit, përgjithësisht të organizuar në lëndë dhe fusha të nxënësve që janë të përbashkëta për të gjithë nxënësit, si gjuhët, matematika, artet, edukimi fizik, shkenca e natyrës dhe shkencat sociale.
Kurrikul	<i>School based</i>	Grup i caktuar kursesh / veprimtarish që zhvillon

që zhvillon shkolla	<i>curriculum</i>	shkolla për të përmbushur nevojat arsimore të komunitetit të shkollës. Kurrikula në bazë shkolle mund të planifikohet dhe realizohet si lëndë e veçantë, modul ose projekt mësimor që përmbajnë tema apo kapituj të lidhur me një fushë të nxëni / lëndë mësimore apo me tema ndërlëndore.
Kurrikul e përvetësuar	<i>Acquired curriculum</i>	Njohuritë, aftësitë, qëndrimet dhe kompetencat që nxënësit zotërojnë në fund të përfundimit të një programi kurrikular ose niveli arsimor.
Kurrikul me zgjedhje	<i>Elective curriculum</i>	Kurset ose lëndët nga të cilat nxënësit mund të zgjedhin sipas interesave dhe nevojave të tyre, të referuara edhe si "kurrikule më zgjedhje". Kjo kurrikul zakonisht ofrohet në arsimin e mesëm dhe të lartë dhe plotëson kurrikulën bazë që duhet të ndjekin të gjithë nxënësit. Zgjedhja e lëndëve në kuadrin e kurrikulës me zgjedhje mund të jetë e detyrueshme ose e lirë, në varësi të planit mësimor.
Lëndë mësimore	<i>Subject content</i>	<i>Lënda/fushë e të nxënit</i> Një degë e dijes e organizuar si një disiplinë mësimore diskrete dhe e mësuar në mënyrë sistematike me kalimin e kohës. Terma të tjerë të përdorur shpesh në mënyrë të ndërsjellë përfshijnë lëndën mësimore, lëndën akademike, disiplinën akademike dhe fushën e studimit/e të nxënit.
Llogaridhënie në arsim	<i>Accountability in education</i>	Përgjegjshmëria, transparenca dhe llogaridhënia e institucioneve arsimore, e politik bërësve dhe e aktorëve të tjerë të interesuar në arsim ndaj cilësisë dhe rezultateve të pritshme e të shpallura të arsimimit në lidhje me nevojat e nxënësve dhe të shoqërisë.
Mendim kritik	<i>Critical thinking</i>	Zbatimi i aftësive njohëse të analizës, interpretimit, përfundimit, shpjegimit, vlerësimit, monitorimit dhe korrigjimit të arsytimit të dikujt. Mendimi kritik

		përfshin pyetje efektive, mbledhjen dhe renditjen e informacionit përkatës, lidhjen e informacionit të ri me njohuritë ekzistuese, rishqyrtimin e besimeve dhe supozimeve, arsyetimin logjik dhe nxjerrjen e përfundimeve të besueshme dhe të besueshme. Zhvillimi i tij kërkon përpjekje të vazhdueshme për të zbatuar konstruktet teorike për të kuptuar një problem, për të marrë në konsideratë provat dhe për të vlerësuar metodat ose teknikat për të formuar një gjykim (Seel, 2012). Attribute të tilla si kurioziteti dhe fleksibiliteti dhe një qëndrim dyshues janë të lidhura ngushtë me të menduarit kritik. I referuar gjithnjë e më shumë si një kompetencë/kompetencë kyçe dhe aftësi e shekullit të 21-të.
Mendim krijues, krijimtaria	<i>Creative thinking, creativity</i>	Aftësia për të gjeneruar zgjidhje të veçanta dhe origjinale të problemeve në fusha dhe veprimtari të ndryshme jetësore.
Metoda e vlerësimit	<i>Evaluation method</i>	<i>Vlerësimi (në mësimdhënie dhe të nxënësve) UNESCO</i> Një proces sistematik i bazuar në standarde që synon të gjykojë efektivitetin e çdo programi të mësimdhënies dhe të nxënësve dhe të orientojë veprimet për përmirësim.
Mësim i diferencuar	<i>Differentiated teaching</i>	Një qasje pedagogjike që ka si pikënisje nevojat e ndryshme mësimore të nxënësve dhe kërkon nga mësuesit të përshtatin, në mënyrë fleksibël, mjedisin dhe kushtet e të nxënësve, për të siguruar shanse të barabarta për të mësuar për çdo nxënëse.
Mësimi i përzier	<i>Blended Learning</i>	Një kombinim i mësimdhënies tradicionale (ballë për ballë) me mësimin dixhital për t'i lejuar nxënësit të kenë kontroll më të madh ose të personalizuar në rrugën e tyre të të mësuarit dhe ritmin individual të të mësuarit, duke pasur dhe përfitimin nga mbikëqyrja e

		mësuesit.
Mjedis të nxëni	<i>Learning environment</i>	Mjedisi fizik i nxënësit (klasa, shkolla), burimet e vëna në dispozicion për të mbështetur procesin e të mësuarit dhe ndërveprimi social ose llojet e marrëdhënieve shoqërore që funksionojnë brenda këtij konteksti që kanë ndikim në të nxënit.
Mjedis miqësor për fëmijët	<i>Child friendly environment</i>	Një mjedis arsimor dhe komuniteti mbështetës që është gjithëpërfshirës, i shëndetshëm, miqësor, mbrojtës dhe i bazuar në të drejtat. Modeli i shkollës miqësore për fëmijët, i zhvilluar nga UNICEF, promovon gjithëpërfshirjen, ndjeshmërinë gjinore, tolerancën, dinjitetin dhe fuqizimin personal.
Shanse për të mësuar	<i>Learning opportunities</i>	Veprimtari mësimore dhe edukative që zhvillohen në klasë dhe/ose jashtë saj që zhvillohen në një mjedis të sigurt, miqësor e motivues që ofron mundësi të barabarta që të gjithë nxënësit të zhvillojnë potencialin e tyre plotësisht.
Njohuri	<i>Knowledge</i>	Njohuritë, konceptet, idetë dhe teoritë për botën natyrore dhe njerëzore, njerëzit dhe shoqëritë e saj dhe strukturat dhe modelet e tyre të ndërlidhura që janë krijuar nëpërmjet të mësuarit dhe/ose përvojës. Njohuria është personale.
Nxënie / Të nxënit	<i>Learning</i>	Proces psiko-social kompleks dhe afatgjatë me të cilin një individ fiton ose modifikon njohuritë, aftësitë, qëndrimet, vlerat dhe sjelljet përmes përvojës, praktikës, studimit ose udhëzimit (UIS, 2012). Vini re se përkufizimi i të mësuarit varet nga qasja filozofike dhe psikologjike e përshtatur.
“Nxënës në qendër”	<i>“Student – centered learning”</i>	Qasja me në qendër fëmijën, bazohet në të mësuarit konstruktivist që thekson rolin e nxënësit në ndërtimin e kuptimit përmes harmonizimit të informacionit të ri

		dhe njohurive paraprake, duke zhvilluar autonominë, pavarësinë dhe përgjegjësinë e nxënësit në procesin e të mësuarit e të menduarit.
Orientimi për karrierën	<i>Career guidance</i>	Shërbime dhe aktivitete që synojnë të ndihmojnë individët në çdo moment gjatë jetës së tyre, të marrin vendime të mirinformuara për të bërë zgjedhje arsimore, trajnimi dhe profesionale dhe të menaxhojnë karrierën e tyre. Ai përfshin ofrimin e ndihmës, të informacioneve dhe burimeve për t'i ndihmuar personat të kuptojnë interesat, pikat e forta, dobësitë dhe vlerat e tyre, dhe më pas t'i bashkojnë ato me opsione të ndryshme karriere në sektorin privat.
Përmbajtje mësimore	<i>Subject content</i>	Parimet, teoritë, njohuritë dhe metodologjitë që lidhen me një fushë të caktuar dijeje, të cilat përzgjidhen të kthehen e të organizohen në përmbajtje dhe me qëllime mësimore, në një nivel të caktuar gjerësie e thellësie, në një lëndë shkollore.
Platformë ndërvepruese (interaktive)	<i>Interactive platform</i>	Platformat ndërvepruese janë përmbajtje të synuara dhe të personalizuara digjitale që mundësojnë një përvojë gjithëpërfshirëse si për komunikimin e jashtëm ashtu edhe për atë të brendshëm. Nëpërmjet një portali ndërveprues në internet, përdoruesit mund të kenë akses, p. sh. në informacione, produkte dhe oferta specifike. Një platformë ndërvepruese ose mund të jetë pjesë e faqes së internetit ose të veprojë si një portal i pavarur.
Program mësimor	<i>Program of study</i>	Një dokument që përshkruan qëllimet, përzgjedhjen dhe rendin e përmbajtjeve që do të mbulohen, mënyrën e organizimit, materialet që do të përdoren, detyrat dhe aktivitetet mësimore, objektivat ose rezultatet e pritura të të nxënit dhe skemat e

		vlerësimi/vlerësimi të një kursi të caktuar, njësie studimi ose lëndë mësimore. Shpesh përdoret si ekuivalent i termit "kurrikula" e marrë kjo në kuptimin e ngushtë të saj.
Përvojë e nxënies	<i>Learning experience</i>	Një shumëllojshmëri e gjerë përvojash në kontekste dhe mjedise të ndryshme që transformojnë perceptimet e nxënësit, lehtësojnë të kuptuarit konceptual, i rrisin inteligjencën emocionale dhe ushqejnë përvetësimin e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve. Në mjediset arsimore, përvojat e të mësuarit janë në mënyrë ideale sfiduese, interesante, të pasura, tërheqëse, kuptimplota dhe të përshtatshme për nevojat e nxënësve. Përvojat e mëparshme të të nxënësit konsiderohen si faktorë kyç që parashikojnë të mësuarit e mëtejshëm.
Proces mësimor	<i>Teaching proces</i>	Procesi i planifikuar dhe organizuar nga mësuesi për plotësimin e objektivit që duhet arritur nga nxënësit nëpërmjet 'rajtimit të përmbajtjeve mësimore dhe vlerësimi të arritjeve.
Plani mësimor	<i>Course schedule</i>	Dokument që me vendim të MAS-it, përcakton lëndët për një klasë apo nivel arsimor, fondin e orëve mësimore për secilën lëndë mësimore për secilën klasë.
Qëndrim	<i>Attitude</i>	Një prirje për të menduar dhe për të reaguar ndaj ideve, personave ose situatave në mënyra të caktuara, që e kanë bazën në sistemin e brendshëm të vlerave, bindjeve ose besimeve, të zhvilluara me kalimin e kohës. Qëndrimet ndikohen nga emocionet, sjelljet dhe mendimet dhe priren të jenë të varura nga konteksti, të ndjeshme ndaj ndikimit shoqëror dhe të hapura ndaj ndryshimeve. Qëndrimi, si besim, opinion ose marrëdhënie me gjërat ose personat, ndërtohet

		mes përvojave dhe edukimit.
Rezultat i nxënies	<i>Learning Outcome</i>	Pohime të që referojnë në sjellje të vëzhgueshme e të matshme që përcaktojnë njohuritë, aftësitë ose përvojën specifike që një nxënës duhet të zotërojë gjatë procesit të të mësuarit, në kuadrin e një periudhe shkollimi, trajnimit etj.
Situatë e nxënësit	<i>Learning situation</i>	Situata e të mësuarit nënkupton mjedisin e veçantë në të cilin zhvillohet procesi i të nxënës, që përfshin harmonizimin e kushteve, të pajisjeve, të ndërveprimeve dhe të veprimtarie që modelojnë këtë proces me synim përmbushjen e rezultateve të pritshme të tij.
SMIP	<i>SMIP</i>	SMIP është shkurtime për “Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar” me qëllim përmirësimin e sistemit arsimor në Shqipëri. Ai mbledh dhe përpunon informacionin e APU, duke rritur nivelin e ndërveprimit digjital të shkollave, duke ndihmuar në regjistrimin dhe transferimin e nxënësve nga një shkollë në tjetrën. SMIP mundëson edhe regjistrimin elektronik të notave dhe mungesave.
Standard i përmbajtjes	<i>Content standard</i>	Standardet e përmbajtjes janë një kompromis shoqëror që përcaktojnë çfarë nxënësi duhet të dijë dhe të jetë i aftë të bëjë nga pikëpamja e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve në një fushë të caktuar studimi/lënde, në fund të një cikli shkollimi, në nivel kombëtar
Standard i arritjes	<i>Achievement standard</i>	Standardet e arritjes përcaktojnë nivelet në të cilat nxënësit përmbushin standardet e përmbajtjes ose rezultatet e pritshme në fund të një periudhe arsimore. Standardet e arritjeve miratohen nga autoritet arsimore dhe unifikojnë kriteret e vlerësimit të nxënësit në nivel kombëtar, si një instrument i rëndësishëm që garanton ndershmërinë e vlerësimit.

		Standardet e arritjeve përdoren nga mësuesit dhe sistemi për vlerësimin e nxënësve.
Strategji mësimore	<i>Teaching strategy</i>	Qasje ose metodë e planifikuar dhe sistematike që përfshin përzgjedhjen dhe zbatimin e metodave, teknikave dhe përvojave mësimore për të lehtësuar procesin të mësuarit dhe për të përmbushur objektivat e të mësuarit.
Tekst arsimor dixhital	<i>Digital educational text</i>	Tekste të krijuar përmes teknologjisë digjitale ose elektronike për qëllime arsimore të cilat mund të përdoren në pajisje të ndryshme si kompjuterë, tableta, lexues elektronikë ose telefona inteligjentë, mbulon një gamë të gjerë lëndësh dhe mund të ekzekutohet si tekst shkollor, material mësimor, udhëzues studimi, leksion dhe burime tjera mësimore.
Tema Çështje/tema ndërkurrikulare	<i>Crosscurricular issues/ themes</i>	Përmbajtje e rëndësishme kurrikulare që duhet të trajtohen, për shkak të rëndësisë së tyre, edhe përmes lëndë vetë ndryshme, krahas trajtimit në lëndën që e ka objekt të vet të studimit. Të tilla çështje janë për shembull: të drejtat e njeriut, çështjet gjinore, edukimi për paqen, edukimi për zhvillim të qëndrueshëm, mjedisi etj.
Teori konstruktiviste	<i>Constructivism</i>	Konstruktivizmi e sheh të nxënit si një proces në të cilin nxënësi ndërton në mënyrë aktive ide ose koncepte të reja bazuar idetë e reja dhe në njohuritë dhe/ose përvojën e tij të mëparshme (Kridel, 2010).
Teori biheavioriste	<i>Behaviorism</i>	Një teori e të mësuarit e bazuar në idenë se të gjitha sjelljet fitohen përmes kushtëzimit që lind nga ndërveprimi me mjedisin . Biheavioristët besojnë se përgjigjet tona ndaj stimujve mjedisorë formojnë veprimet tona (e njohur edhe si psikologjia e sjelljes) (Krapfl, 2016).
		Një grup i ndërlidhur aftësish dhe praktikash

Të menduar kompjuterik	<i>Computational thinking</i>	kompjuterike për zgjidhjen e problemeve komplekse; një mënyrë për të mësuar tema në shumë disiplina dhe domosdoshmëri për të marrë pjesë në një botë digjitale.
Të nxënit gjatë gjithë jetës	<i>Lifelong Learning</i>	Tërësia e aktiviteteve mësimore të ndërmarra gjatë gjithë jetës, që rezultojnë në përmirësimin e njohurive, aftësive, kompetencave dhe/ose kualifikimeve për arsye personale, sociale dhe/ose profesionale (CEDEFOP, 2011).
Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK)	<i>Information and Communication Technology (ICT)</i>	Një grup i larmishëm mjedesh dhe burimesh teknologjike të përdorura për të transmetuar, ruajtur, krijuar, ndarë ose shkëmbyer informacion. Këto mjete dhe burime teknologjike përfshijnë kompjuterët, internetin (faqet e internetit, blogjet dhe emaillet), teknologjitë e transmetimit të drejtpërdrejtë (radio, televizion dhe transmetim në internet), teknologjitë e transmetimit të regjistruar (podcasting, luajtës audio dhe video dhe pajisje ruajtëse) dhe telefoninë (fiks ose celulare). , satelit, vizion/video-konferencë, etj.) (UIS, 2009).
Nxënie elektronike	<i>E-learning</i>	Të gjitha format e mësimdhënies dhe të nxënit të mbështetur në mënyrë elektronike, veçanërisht përvetësimi dhe zbatimi i njohurive dhe aftësive të bazuara në web dhe kompjuterik Mund të zhvillohet brenda ose jashtë klasës. Ai është shpesh një komponent thelbësor i arsimit në distancë dhe mund të përfshijë mjedise të të mësuarit virtual.
Vlerësim	<i>Evaluation</i>	Një proces sistematik që synon të gjykojë efektivitetin e çdo programi të mësimdhënies dhe të nxënit dhe të orientojë veprimet për përmirësim.
Vetëvlerësimi	<i>Self-evaluation</i>	Vetëvlerësimi Vlerësimi me anë të të cilit nxënësi mbledh

		informacion dhe reflekton mbi të mësuarit e tij ose të saj, gjykon shkallën në të cilën ai pasqyron qëllimet ose kriteret e shprehura në mënyrë eksplicite, identifikon pikat e forta dhe të dobëta dhe rishikon në përputhje me rrethanat. Është vlerësimi i vetë nxënësit për përparimin personal në njohuri, aftësi, procese dhe qëndrime (Ministria e Arsimit e Ontarios, 2002).
Vlerësim diagnostikues	<i>Diagnostic evaluation</i>	Vlerësim që synon identifikimin e pikave të forta dhe të dobëta të nxënësit me synimin për të ndërmarrë veprimet e nevojshme për të përmirësuar të nxënit. Ai tenton të përdoret si një formë para vlerësimi që ndihmon një mësues për të diagnostikuar vështirësitë e një nxënësi dhe për të vlerësuar gatishmërinë ose nivelin e arritjeve të nxënësit, në mënyrë që të drejtojë plan programin dhe planifikimin e mësimit dhe nivelin e diferencimit dhe/ose individual ose mbështetje në grup që mund të jetë e nevojshme.
Vlerësimi (matja) i arritjeve	<i>Educational assessment</i>	Vlerësimi (matja) në arsim nënkupton përshkrimin sistematik dhe matjen e nivelit të zotësisë ose të arritjeve të një nxënësi' Kjo i ndihmon mësuesit të kuptojnë nëse dhe në çfarë shkalle procesi i mësimdhënies i ka ndihmuar e mbështetur nxënësit në mënyrë efektive në zhvillimin e kompetencave të synuara, duke ofruar informacion të vlefshëm për planifikimin dhe përshtatjen e fazave vijuese të mësimdhënies
Vlerësim formues i arritjeve	<i>Formative assessment</i>	Vlerësimi i kryer gjatë gjithë procesit arsimor me synimin për të përmirësuar të nxënit e nxënësve. Ai nënkupton: nxjerrjen e provave për të mësuarit për të mbyllur hendekun midis performancës aktuale dhe asaj të dëshiruar (në mënyrë që të ndërmerren veprime për të mbyllur hendekun); ofrimin e komenteve për

		nxënësit; dhe përfshirja e nxënësve në procesin e vlerësimit dhe të të nxënit (CCSSO, 2008).
Vlerësimi përmblledhës	Summative assessment	Vlerësimi i arritjeve të nxënësit në fund të një semestri, stadi, kursi ose programi zakonisht, megjithëse jo domosdoshmërisht, përfshin testime ose provime formale. Vlerësimi përmblledhës përdoret më së shpeshti për renditjen, vlerësimin dhe/ose promovimin e studentëve dhe për qëllime certifikimi.
Vlerësim autentik	<i>Authentic assessment</i>	Vlerësimi autentik buron nga të mësuarit autentik, që përfshin detyra dhe veprimtari që pasqyrojnë sfidat e botës reale dhe standardet e performancës. Ky vlerësim kërkon nga nxënësit zotërimin e aftësive të larta mendore dhe ato të zgjidhjes së problemeve komplekse përmes detyrave që kërkojnë zbatime praktike të njohurive të zotëruara. Si i tillë, të mësuarit dhe vlerësimi autentik ndihmon nxënësit të shohin lidhjen e të mësuarit me jetën reale.
Vlerësim i jashtëm	<i>External evaluation</i>	Një proces dhe metodë vlerësimi që e zhvillon dhe e përdor një agjenci apo organ vlerësues që të bëjë një gjykim për cilësinë e arritur.
Vlerësim i shokut nga shoku	<i>Peer-to-peer evaluation</i>	Vlerësimi i arritjes së një nxënësi nga shoku i tij.

10 REFERENCA

MAS (2024). Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar në Shqipëri

MASHT (2017). Kurrikula bërthamë për arsimin e mesëm të ulët (klasa VI, VII, VIII, IX). Prishtinë.

<https://masht.rks-gov.net/kurrikula-berthame-e-arsimit-te-mesem-te-ulet-te-kosoves-klasa-vi-vii-viii-dhe-ix/>

Council of Europe (2020). Kuadri i Përbashkët Evropian i Referencave për Gjuhët. (Volumi Shoqërues) <https://rm.coe.int/common-european-frameëork-of-reference-for-languages-learning-teaching/16809ea0d4>

National Curriculum Framework of Croatia. (2010), For pre-school education and general compulsory and secondary education.

Québec Education Program. (2024). <https://www.quebec.ca/en/education/preschool-elementary-and-secondary-schools/quebec-education-program/elementary#c235016>

Ministry of Education. (2023). The Ontario Curriculum, Grades 1-8, Language. Ontario https://assets-us-01.kc-usercontent.com/fbd574c4-da36-0066-a0c5-849ffb2de96e/0dabb9f4-e0a9-43fe-8809-b01acf228e77/Language_G1-8_2023_AODA.pdf

Ministry of Education, Singapore (2020). English Language Syllabus. Singapor

http://eacea.ec.europa.eu/education/eurydice/index_en.php Eurydice, European Comision

Mathematics Education in Europe: Common Challenges and national policies- European Comision

EACEA: National System of Education. (të gjitha shtetet Europiane)

<https://www.gov.uk/national-curriculum/key-stage-3-and-4>

<https://www.gov.uk/government/publications/national-curriculum-in-england-mathematics-programmes-of-study>

National Core Curriculum for basic education, estonia,

<https://www.riigiteataja.ee/en/eli/524092014014/consolide>

K -12 Learning Standards Ëashington State.

Orstein, C. A., Hunkins P. F. (2003). Kurrikula - bazat , parimet dhe problemet. Instituti i Studimeve Pedagogjike.


Québec Education Program. <https://jaquebec.org/en/programmes-scolaires-pour-les-ecoles-secondaires/>

Ministry of Education of Singapore “Science syllabus primary

2014”<http://www.moe.gov.sg/education/syllabuses/sciences/files/science-primary-2014.pdf>

Ministry of Education of Singapore “Science syllabus Loëer and Upper Secondary”

<http://www.moe.gov.sg/education/syllabuses/sciences/files/science-loëer-secondary-2013.pdf>



Quebec Education Program, Preschool Education, Elementary Education, Secondary Education

http://www1.mels.gouv.qc.ca/sections/programmeFormation/primaire/index_en.asp

Australian Curriculum, Science F-10 Curriculum

<http://www.australiancurriculum.edu.au/science/Rationale> <http://www.acara.edu.au/default.asp>

Eurydice: Developing key competences at schools in Europe, Challenges and Opportunities for Policy,

2013 http://eacea.ec.europa.eu/education/eurydice/documents/thematic_reports/145EN.pdf

http://eacea.ec.europa.eu/education/eurydice/thematic_reports_en.php#2013

OECD: PISA Programme for international student

Karta e Këshillit të Europës për Edukimin për Qytetari Demokratike dhe për të Drejtat e Njeriut

Konceptet bazë dhe aftësitë-kyçe për edukimin me qytetari demokratike, Këshilli i

Bashkëpunimit Kulturor (KBK/CDCC), Strasbourg 2000, DGIV/EDU/CIT (2000)

How all teachers can support citizenship and human rights education: a framework for the development of competences, Council of Europe Publishing, Council of Europe, March 2009

Music, drama, visual art compulsory program, optional program, music and multimedia, Quebec

Edvin Dashi dhe Teuta Dashi “Edukimi fizik në shkollë”, Shtëpia Botuese “Ora”, Tiranë

2007.

Guido Subashi dhe Jani Daci “Didaktika e Edukimit fizik”, Shtëpia botuese e Librit

Universitar, Tiranë 2004

Teknologjia dhe TIK-u

ISTE: International Society for Technology in Education (U.S. & Canada), 2007,

<http://www.iste.org>.

Ferrari, A.(2013). DIGCOMP: A Framework for Developing and Understanding Digital

Competence in Europe. Luxembourg:Office of the European Union.

Janssen, J., & Stoyanov, S. (2012). Online Consultation on Experts' Views on Digital Competence.

Seville: JRC-IPTS. Marre, 2 shkurt 2014, nga:

<http://ipts.jrc.ec.europa.eu/publications/pub.cfm?id=5339>.